

VRASJET NË TERRITORIN E GJYKATËS SË QARKUT TË PEJËS (një vështrim kriminologjik 1989-2017)

Haki Kabashi

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil E Drejta Penale, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Luan Gjonçaj

Numri i fjalëve: 75874

Tiranë 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Haki Kabashi

(nënshkrimi)

ABSTRAKT

Përmes këtij hulumtimi synohet të prezantohet lëvizja e kriminalitetit të vrasjeve në Rajonin e Pejës, vëllimi dhe dinamika e këtij fenomeni gjatë periudhës kohore (1989-2017) e kushtëzuar nga rrethana të ndryshme shoqërore, historike, politike dhe regjime anti-shqiptare duke patur parasysh specifikat e veçanta që kanë përcjellë historikisht këtë fenomen në Kosovë edhe pas vendosjes së Kosovës nën administrimin ndërkombëtar të OKB-së (1999) dhe pas shpalljes së pavarësisë së saj më 17 shkurt 2008.

Qëllimi kryesor në këtë hulumtim ka të bëjë me identifikimin e disa faktorëve kriminogjenë që ndikojnë në mënyra të ndryshme në rritjen e veprave penale të vrasjeve dhe veprave të tjera kundër jetës dhe trupit duke u bazuar në disa objektiva.

E para, ky hulumtim ka si qëllim studimin e fenomenit të vrasjeve në aspektin kriminologjik ku i është kushtuar kujdes i veçantë identifikimit të faktorëve politikë, vëllimit dhe dinamikës së vrasjeve. Në këtë kuadër janë evidentuar të dhëna të terrorizmit shtetëror kundër popullsisë së këtij rajoni dhe ndikimi i tyre në nxitjen e faktorëve kriminogjenë të cilët kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në rritjen e fenomenit të vrasjeve. Bazuar në këtë, ka rezultuar se faktikisht nuk ka funksionuar parimi i ligjshmërisë në njërën anë dhe shtimi i arbitraritetit të organeve shtetërore serbe në anën tjetër të cilat kanë sjellë një dhunë të paparë të terrorit shtetëror mbi shqiptarët e Kosovës, siç janë: vrasjet, shpërnguljet, djegiet, arrestimet dhe pushkatimet pa gjyq, helmimet, vrasjet e ushtarëve dhe rekrutëve shqiptarë, izolimet e intelektualëve e deri tek përfshirja e drejtëpërdrejtë e shërbimeve sekrete serbe në ekzekutimin e qytetarëve të Kosovës.

E dyta, ka të bëjë me identifikimin e faktorëve fenomenologjik dhe etiologjik që ndikojnë në uljen apo rritjen e fenomenit të vrasjeve në Kosovë dhe në veçanti në Rajonin e Pejës.

E treta, ka të bëjë me identifikimin e faktorëve institucional të cilët nga pozitat e nëpunësve publikë (forca policore, paramilitarë, ushtarakë, anëtarë të sistemit gjyqësor, dhe zyrtarë të tjerë shtetërorë) duke shpërdoruar detyrën e tyre ndikojnë në rritjen e kriminalitetit duke shkelur të gjitha procedurat ligjore, afatet ligjore, tejkalimin e këtyre afateve ligjore për një proces të drejtë dhe të arsyeshëm në çështjet penale dhe

administrative e deri te parashkrimi i ndjekjes penale dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve për të kulmuar me institutin e faljes si e drejtë ekskluzive e kryetarit të shtetit.

E katërta, përfshinë të dhëna relevante të cilat kanë dalë si rezultat i analizimit të të dhënave analitike nga target grupet (policia, sistemi gjyqësor, gjyqtarë të krimeve të rënda, prokurorë të krimeve të rënda, të dënuar për vepra penale të vrasjesve, meshkuj, të mitur dhe femrat).

Hulumtimi, përmes literaturës përkatëse, ligjeve dhe kodeve të ndryshme, botimeve të ndryshme, raporteve zyrtare nga Policia e Kosovës, të dhënave arkivore nga Arkivi Ndërkomunal në Pejë, raporteve nga Prokuroria e Shtetit në Pejë, Gjykata Themelore në Pejë, shtypit periodik dhe ditor, janë prezentuar të dhëna të cilat hedhin dritë për lëvizjen e krimit të vrasjes në këto hapësira.

Fjalët kyçe: vrasjet, drejtësia hibride, rajoni i Pejës, fenomenologjia kriminale, reagimi publik

ABSTRACT

Through this research it is intended to represent the movement of the crime of murder in Peja Rajon, the volume and dynamics of this phenomenon in the period of 1989-2017, conditional to different anti-albanian regimes, social, historical and political circumstances taking into consideration the particular specifics that have historically followed this phenomenon in Kosova even after the mandate of international administration of the UN (1999) and after the Declaration of Independence on 17th of February 2008.

The main goal of this research has been layed out to identify various criminogenic factors that affect in different ways the rise of the crime of murder and other offenses toward life and body based on a few objectives.

First, this research is aimed at studying the phenomenon of murder in the criminologic aspect, where added caution is taken in the identification of the political factors in the volume and dynamics of murders and state terrorism against its own people in this region from foreign occupying powers and their affection in the encouragment of the crimonogenic factors who have directly affected the rise of the crime of murder. In this framework, we have seen the elimination of the principle of legality and the addition of arbitrariness by the Serbian state organs, therefore inciting state terrorism toward the Albanians in Kosova, murders, displacements, burnings, poisoning, isolation of the intellectuals, arrests and liquidations without trail, murdering of Albanian soldiers and recruits in Serbia and finally the direct involvement of the Serbian secret service in the execution of Albanian citizens of Kosova.

Second, the identification of phenomenologic and etiologic factors that affect the fall and the rise of the phenomenon of the crime of murder in Kosova and in the Region of Peja in particular.

Third, the identification of institutional factors, which from the abuse of duty by the officials of the state (police force, paramilitary and army, judiciary system, prosecutors and other state officials) affect on the rise of criminality by violating all the legal procedures, their processing, legal deadlines, violating these legal deadlines for a fair and reasonable process in the penal and administrative procedure, to the prescription of criminal prosecution and the prescription of the execution of punishments, to culminate with the institution of pardon as an exclusive right of the president.

Fourth, it includes all relevant data that have been derived through data analysis of the analytic data from the target groups (police force, judiciary system, judges of serious crimes, prosecutors of serious crimes and convicts of penal offenses of murder, men, women and juveniles).

The research, through respective literature, laws and different codes, different publications, official reports from the Kosova Police, archived data from the Inter-Municipality Archive in Peja, reports from the State Prosecution in Peja, Basic Court in Peja, periodic and daily press, have been represented in data that shed light to the movement of the crime of murder in this region.

Key words: murder, hybrid justice, region of Peja, criminal phenomenology, public reaction

Falenderim

Kam shumë për të falenderuar, por së pari dua të falenderoj atë që beri të mundur që të kryejme studimet doktorale dhe na përkrahu gjatë këtyre viteve dhe ai është Universiteti European i Tiranës, profesorët dhe stafi i tij drejtues i cili na i hapi dyert, na pranoi në gjirin e tij dhe me një përkushtim të ngrohtë dhe profesional u kujdes për ne që nga fillimi deri sot.

Falënderimi i veçantë i shkon profesorit tim të nderuar z. Luan Gjonçaj i cili më ka qëndruar pranë gjatë tërë kohës që nga ditët doktorale e deri sa arrita ta përfundoj temën time doktorale. Afërsia prindërore, butësia, mendimet e mprehta dhe këshillat e tij të urta dhe profesionale më kanë përcjellë gjatë gjithë kohës së punës sime dhe do më përcjellin edhe në vitet në vazhdim.

Faleminderit profesor!

Falenderoj të gjithë ata që më kanë përkrahur gjatë punës sime e posaçërisht falenderoj punonjësit e Arkivit Regjional në Pejë, administratorin dhe prokurorët në Prokurorinë e Shtetit në Pejë, administratorin dhe gjyqtarët në Gjykatën Themelore në Pejë, zv. drejtoreshën e Qendrës Korrektuese në Dubravë, drejtorin në Qendrën korrektuese për femra dhe të mitur në Lipjan, Policinë e Kosovës dhe kolegët e mi të punës.

Një falenderim i veçantë shkon për bashkëshorten time dhe katër fëmijët e mi, për durimin e tyre, përkrahjen dhe mbështetjen që më kanë dhënë në ditët dhe netët e gjata të punës sime deri në përfundimin e kësaj teme.

PËRMBAJTJA:

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	II
ABSTRAKT.....	III
ABSTRACT.....	V
LISTA E FIGURAVE.....	XIII
LISTA E TABELAVE.....	XVI
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	XVII
Kapitulli I	19
1.1. Hyrje.....	19
1.2. Qëllimi i punimit	20
1.3. Metodot dhe metodologjia e kërkimit.....	21
1.4. Hipoteza dhe pyetjet hulumtuese.....	23
1.5. Mundësitë dhe kufizimet	24
1.6. Rëndësia e studimit.....	26
1.7. Plani i strukturës së punimit	27
Kapitulli II: Vështrim penal – juridik i vrasjeve në Kosovë	29
2.1. Rregullimi juridik penal i vrasjeve në ish-RSFJ (1945-1989).....	29
2.2. Ligji Penal i Krahinës Socialiste të Kosovës (1977)	31
2.3. Rregullimi juridiko- penal i vrasjeve nën administrimin e Serbisë (1989– 1999)	32
2.4. Rregullimi juridik - penal i vrasjeve nën administrimi e UNMIK -ut	32
2.5. Rregullimi juridik - penal i vrasjeve pas Shpalljes së Pavarësisë	35
Kapitulli III: Rrethanat shoqërore historike në Kosovë dhe terrorizmi shtetëror serbo- jugosllav.....	37
3.1. Terrorizmi malazez ndaj popullsisë civile shqiptare pas nënshkrimit të “Kontratës së Shtupeqit”	38
3.2. Terrorizmi shtetëror nën Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene mbi shqiptarët(1918-1941)	42
3.3. Vrasjet gjatë periudhës së sundimit të Titos në Jugosllavi (1945-1981).....	44
3.3.1. Vrasjet për motive politike në Rajonin e Pejës (vrasjet e intelektualëve, ushtarëve dhe qytetarëve të thjeshtë)	49
3.3.2. Rasti i Paraqinit	51
3.4. Vrasjet dhe aktet e tjera të terrorizmit shtetëror (1990-1999).....	56

3.4.1. Izolimet dhe Helmimet - akte terroriste shtetërore	56
3.4.2. “Rasti Panda”	62
Kapitulli IV: Vrasjet në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës	70
4.1. Vrasjet në Kosovë me theks të veçantë në Rajonin e Pejës	70
4.2. Vrasjet në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës – krahasimet dhe ngjashmëritë	76
4.3. Vrasjet në Kosovë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës	82
Kapitulli V: Fenomenologjia e vrasjeve në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës (1989-2017).....	85
5.1.1 Struktura gjinore e autorëve të dënuar për vepra penale kundër jetës dhe trupit (1989- 2017).....	93
5.1.2. Struktura gjinore e viktimave të veprave penale kundër jetës dhe trupit (1989-2017)	96
5.1.3. Struktura kombëtare e të dënuarve (1989-2017)	99
5.1.4. Struktura kombëtare e viktimave të krimit (1989-2017)	100
5.1.5. Gjeografia kriminale dhe shtrirja e saj fshat-qytet (1989-2017).....	102
5.1.6. Vendi i kryerjes së veprave penale (1989-2017).....	103
5.1.7. Koha e kryerjes së veprave penale gjatë ditës (1989-2017).....	105
5.1.8. Veprat penale të kryera sipas muajve të vitit (1989-2017)	108
5.1.9. Mjetet e kryerjes së veprave penale (1989-2017)	109
5.1.10. Motivi i kryerjes së veprave penale (1989-2017)	112
5.1.11. Shkalla e arsimimit të autorëve të veprave penale (1989-2017).....	115
5.1.12. Struktura sociale e autorëve të veprave penale (1989-2017)	117
5.1.13. Moshë e autorëve të veprave penale (1989-2017)	119
5.1.14. Llojet e dënimeve të caktuara nga Gjykata e Qarkut të Pejës (1989-2017)	121
5.1.15. Lartësia e dënimit të caktuar nga Gjykata e Qarkut të Pejës (1989-2017).....	123
5.1.16. Lidhja midis autorit dhe viktimës (1989-2017)	124
5.1.17. Recidivizmi.....	125
Kapitulli VI: Faktorët dhe teoritë e kriminalitetit (etiologjia kriminale)	129
6.1.1. Krimi i vrasjes dhe tipologjia e kriminelit	132
6.2. Faktorët e jashtëm (egzogjenë) të vrasjeve në Rajonin e Pejës.....	140
6.2.1. Ndikimi i luftës dhe kriminaliteti	140
6.2.2. Varfëria dhe kriminaliteti	142
6.3. Faktorët socio-ekonomik që ndikojnë në dukurinë e vrasjes	142

6.3.1 Problemet sociale- papunësia dhe kriminaliteti	142
6.3.2 Marrëdhënjet pronësore juridike.....	144
6.3.3. Arsimi dhe kriminaliteti.....	146
6.3.4. Familja dhe kriminaliteti.....	147
6.3.5 Bixhozi dhe kriminaliteti	148
6.3.6 Trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni dhe kriminaliteti	149
6.3.7 Alkooli dhe kriminliteti	152
6.3.8 Mediat dhe kriminaliteti	153
6.4. Vrasjet nga hakmarrja dhe pasojat e këtyre vrasjeve në shoqërinë kosovare	154
6.4.1. Hakmarrja dhe gjakmarrja, pasojat e saj në shoqërinë kosovare	154
6.5. Disa nga faktorët e brendshëm (endogjen) dhe ndikimi i tyre tek veprat penale kundër jetës dhe trupit.....	161
6.5.1 Inteligjenca dhe kriminaliteti	162
6.5.2. Motivet dhe kriminaliteti	163
6.6. Faktorët e tjerë dhe kriminaliteti.....	164
6.6.1. Joserioziteti dhe joprofesioanlizmi i organeve të ndjekjes penale në luftimin e krimeve të rënda	164
6.6.2. Joefikasiteti i gjykatës	168
6.6.3. Sistemi gjyqësor paralel i Serbisë në Kosovë	170
6.6.4 Në kontekstin e mosaplikimit korrekt të ligjit	171
6.6.5 Në kontekstin e heqjes dorë në mënyrë të heshtur nga ndjekja penale - procedura e parashkrimit.....	172
6.6.6 Caktimi nën minimumin ligjor të dënimit nga ana e gjykatës	174
6.6.7. Tejzgjatja e procedurave gjyqësore	178
6.6.8. Instituti i faljes dhe kriminaliteti.....	180
Kapitulli VII: Vrasjet dhe hetimi i tyre sipas të drejtës pozitive në Kosovë.....	183
7.1. Hetimi i vepres penale të vrasjes	185
7.1.2. Sigurimi i provave materiale.....	188
7.1.3 Marrja e provave materiale nga policia gjyqësore	189
7.1.4. Kqyrja e vendit të ngjarjes me rastin e vepres penale të vrasjes	190
7.1.5. Arrestimi i autorit dhe kontrolli i trupit të tij dhe personave të tjerë të përfshirë në vrasje	192
7.1.6. Kontrolli i banesës e cila kryhet për shkak të vepres penale të vrasjes	193
7.1.7. Deklaratat e dëshmitarëve dhe dëshmitë e tjera të marrura nga vendi i ngjarjes.....	195

7.1.8. Deklarimi i të dyshuarit në çështjen penale e cila zhvillohet për veprën penale të vrasjes	195
7.1.9. Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve.....	197
7.1.10. Dokumentet si provë të cilat lidhen me veprën penale të vrasjes	198
7.2. Masat për marrjen dhe sigurimin e provave përmes urdhërit të gjykatës	198
7.2.1. Ekspertimi dhe llojet e ekspertimit për veprën penale të vrasjes	198
7.2.2. Kqyrja e kufomës dhe Autospia.....	199
7.2.3. Ekspertimi psikologjik.....	201
7.2.4. Ekspertimi toksikologjik.....	201
7.2.5 Ekspertimi balistik	201
7.2.6. Ekzaminimet molekulare dhe gjenetike.....	202
7.2.7. Analizat kompjuterike	202
7.2.8. Analizat financiare.....	203
7.2.9. Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit për veprën penale të vrasjes	204
7.2.10. Rindërtimi i vendit të ngjarjes për veprën penale të vrasjes	205
Kapitulli VIII: Analiza dhe rezultatet e kërkimit	207
8.1 Analiza e hulumtimit me autorë të veprave penale të vrasjes dhe organet për zbatimin e ligjit.....	207
8.2 Pjesëmarrësit në hulumtim	207
8.3 Analizimi dhe rezultatet e kërkimit që janë realizuar me prokurorët, gjykatësit dhe policia gjyqësore për veprat penale të vrasjes – Analiza e regresionit	209
8.4 Analizimi dhe rezultatet e kërkimit që janë realizuar me personat e rritur të dënuar për veprat penale të vrasjes që ekzekutojnë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Dubravë të Istogut – Analiza e regresionit	210
8.5 Analizimi dhe rezultatet e kërkimit që janë realizuar me personat e mitur të dënuar për veprën penale të vrasjes që ekzekutojnë dënimin në Institutin e të Miturve në Lipjan – Analiza e regresionit	211
8.6 Analizimi dhe rezultatet e kërkimit që janë realizuar me femrat e dënuara për veprën penale të vrasjes që ekzekutojnë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për femra dhe të mitur në Lipjan – Analiza e regresionit	213
Kapitulli IX: konkluzione përfundimtare dhe rekomandime	215
9.1 Konkluzione përfundimtare	215
9.2 Rekomandime	219
Literatura	225

Shtojca.....	240
Dekretligji i Monarkisë së Serbisë i datës 21 shtator 1913.....	240
Pyetësi për të akuzuarit e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Dubravë	245
Pyetësi për gjykatësit, prokurorët dhe policinë gjyqësore	248
Pyetësi për të dënuarit për vrasje në Institutin e të Miturve në Lipjan	250
Pyetësi për femrat e dënuara për vrasje në Institutin e të Miturve në Lipjan.....	252
Tabelat e Crostab-ulimit dhe analiza faktoriale për të dënuarit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Dubravë	254
Tabelat e Crostab-ulimit dhe analiza faktoriale për gjykatësit, prokurorët dhe policinë gjyqësore.....	268
Tabelat e Crostab-ulimit dhe analiza faktoriale për të miturit e dënuar në Institutin e të Miturve në Lipjan	272
Tabelat e Crostab-ulimit dhe analiza faktoriale për femrat e dënuara në Institutin e të Miturve në Lipjan	282

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Terrorizmi shtetëror serb në vitin 1912 në Kosovë.....	40
Figura 2. Vrasjet e ushtarëve shqiptarë në armatën popullore të Jugosllavisë në vitin 1987.....	52
Figura 3. Dokumenti origjinal i Komunikatës së Komandës së Armatës së Dytë me seli në Nish dërguar në Komandën e Korpusit të 52 të APJ-së në Pejë.....	53
Figura 4. Kryetitulli "Procesi ka qenë i montuar"	55
Figura 5. Kopja e procesverbalit të policisë drejtuar Prokurorisë së Qarkut të Pejës, datë 15.12.1998 i nënshkruar nga Majori i policisë hetimore në Pejë, Danilo Bullativiq	63
Figura 6. Kopja e procesverbalit kriminalistik i nënshkruar nga kapetan Zoran Aleksiq	64
Figura 7. Kryetitulli “Vuçiq të vërtetën ua ka borxh prindërve” në ballinën e gazetës beogradase "Vesti online", me datë 04.05.2014.....	66
Figura 8. Llambadar nga kokat e shqiptarëve (Lampe od albanskih lobanja).....	69
Figura 9. Numri i vrasjeve në 100.000 banorë në Kosovë 2000-2005.....	79
Figura 10. Numri i përgjithshëm i vrasjeve sipas viteve 1999-2017 në Republikën e Kosovës	80
Figura 11. Numri i përgjithshëm i vrasjeve sipas viteve 1999-2017 në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës	84
Figura 12. Numri i vrasjeve sipas ndarjes rajonale në Kosovë (1999-2014)	88
Figura 13. Veprat penale të vrasjes në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës (1989 – qeshor 1999).....	89
Figura 14. Vëllimi dhe struktura e veprave penale të gjykuara të vrasjes në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës (1989-1999)	89
Figura 15. Vëllimi i veprave penale të vrasjes të gjykuara në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës, qeshor 1999-2017	90
Figura 16. Struktura dhe vëllimi i veprave penale të gjykuara në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës 1999-2017	91
Figura 17. Vepra penale kundër jetës dhe trupit gjatë periudhës 1989-1999.....	92
Figura 18. Vepra penale kundër jetës dhe trupit gjatë periudhës 1999-2017.....	93
Figura 19. Të dënuarit sipas gjinisë për veprat penale kundër jetës dhe trupit në Gjykatën e Qarkut në Pejë (1989-1999).....	94

Figura 20. Të dënuarit sipas gjinisë për veprat penale kundër jetës dhe trupit në Gjykatën e Qarkut në Pejë (2000-2017).....	95
Figura 21. Viktimat e veprave penale kundër jetës dhe trupit sipas gjinisë (1989-1999)	97
Figura 22. Viktimat e veprave penale kundër jetës dhe trupit sipas gjinisë (2000-2017)	98
Figura 23. Struktura nacionale e të dënuarve për veprat penale kundër jetës dhe trupit në gjykatën e Qarkut në Pejë (1989-1999).....	99
Figura 24. Struktura nacionale e të dënuarve për veprat penale kundër jetës dhe trupit në gjykatën e Qarkut në Pejë (2000-2017).....	100
Figura 25. Nacionaliteti i viktimave të veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës (1989-1999).....	101
Figura 26. Nacionaliteti i viktimave të veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës (2000-2017).....	101
Figura 27. Vëllimi i vrasjeve dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit në relacioni fshat-qytet (1989-1999).....	102
Figura 28. Vëllimi i vrasjeve dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit në relacion fshat-qytet (2000-2017).....	103
Figura 29. Vendi i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (1989-1999).....	104
Figura 30. Vendi i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (2000-2017).....	105
Figura 31. Koha e kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (1989-1999).....	106
Figura 32. Koha e kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (qershor 1999-qershor 2017)	107
Figura 33. Muaji në të cilin është kryer vepra penale kundër jetës dhe trupit 1989-qershor 1999.....	108
Figura 34. Muaji në të cilin është kryer vepra penale kundër jetës dhe trupit qershor 1999-qershor 2017	109
Figura 35. Mjeti i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit 1989-1999.....	110
Figura 36. Mjeti i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit 2000-2017.....	110
Figura 37. Motivi i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (1989-1999) ...	112
Figura 38. Motivi i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (2000-2017) ...	113

Figura 39. Niveli arsimor i kryesve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 1989-1999	116
Figura 40. Niveli arsimor i kryesve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 2000-2017	116
Figura 41. Profesionit i kryesve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 1989-1999	118
Figura 42. Profesionit i kryesve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 2000-2017	119
Figura 43. Mosha e kryesve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 1989-1999	120
Figura 44. Mosha e kryesve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 2000-2017.....	121
Figura 45. Llojet e dënimeve të shqiptuara në Gjykatën e Qarkut në Pejë (1989-1999)	122
Figura 46. Llojet e dënimeve të shqiptuara në Gjykatën e Qarkut në Pejë (2000-2017)	122
Figura 47. Kohëzgjatja e dënimit me burg 1989-1999.....	123
Figura 48. Kohëzgjatja e dënimit me burg 2000-2017.....	124
Figura 49. Relacioni në mes të kryesit dhe viktimes 1989-1999	124
Figura 50. Relacioni në mes të kryesit dhe viktimes 2000-2017	125
Figura 51. Lista me emrat e personave përgjegjës për krime kundër popullsisë civile në Komunën e Pejës (Burimi i të dhënave: Human Rights Watch, 2001)	167
Figura 52. Numri i lëndëve të pazbuluara në Kosovë gjatë periudhës 2000 - mars 2007 (Burimi i të dhënave: Raporti i Auditorit të Brendshëm i UNMIK-ut).....	168
Figura 53. Diferenca kohore mes kohës kur kishte ndodhur krimi dhe kohës kur është shqiptuar aktgjykimi përfundimtar 1989-1999	179
Figura 54. Diferenca kohore mes kohës kur kishte ndodhur krimi dhe kohës kur është shqiptuar aktgjykimi përfundimtar 2000-2017	180

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Të dhënat nga raporti i KMDLNJ-së në Kosovë për vitet 1997-1998	62
Tabela 2. Numri i vrasjeve në Kosovë nga viti 1957-1977.....	71
Tabela 3. Numri i vrasjeve në Kosovë nga viti 1978-1983.....	72
Tabela 4. Numri i personave të dënuar madhor sipas delikteve të gjakut.....	73
Tabela 5. Vrasjet në Kosovë gjatë periudhës qershor 1999-qershor 2017	81
Tabela 6. Vëllimi dhe dinamika e zbulimit të veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës (1999-2017)	84
Tabela 7. Vëllimi dhe dinamika e veprave penale kundër jetës dhe trupit sipas ligjit penal të Kosovës (1989-1999)	86
Tabela 8. Skema krahasimore e vëllimit të vrasjeve në Rajonin e Pejës në periudhat 1989 – 09 qeshor 1999 dhe 10 qeshor 1999 – qershor 2017	87
Tabela 9. Punëkërkesit e regjistruar në qendrat e punësimit në bazë të kualifikimit në Kosovë gjatë periudhës 2008-2012	143
Tabela 10. Numri i familjeve të cilat jetojnë nga frika e gjakmarrjes në Rajonin e Pejës	157
Tabela 11. Pjesëmarrja e policëve të UNMIK-ut dhe të Shërbimit Policor të Kosovës.....	166
Tabela 12. Lartësia e dënimit për vepra të caktuara penale të aplikuara nga trupi gjykues i gjyqtarëve vendor dhe atyre ndërkombëtar (2000-2012).....	178
Tabela 13. Përmbledhja e modelit.....	209
Tabela 14. Përmbledhja e modelit (II)	210
Tabela 15. Përmbledhja e modelit (III)	211
Tabela 16. Përmbledhja e modelit (IV).....	213

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AI	Amnesty International
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
ASHAK-ARP	Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës-Arkivi Regjional Pejë
APJ	Armata popullore e jugosllavisë
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit
GJQ	Gjykata e Qarkut
GJTH	Gjykata Themelore
HRW	Human Rights Watch
KFOR	Forcat për Kosovën
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KLD	Kanuni i Lekë Dukagjinit
KMDLNJ	Këshilli për mbrojtjen e lirive dhe të drejtat e njeriut
KOS	Sherbimi kundërinformativ Ushtarak
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës
KQJ	Komiteti Qendror i Jugosllavisë
KSAK	Krahina Socialiste Autonome e Kosovës
KSH	Kryeprokurori i Shtetit
LKS	Lidhja komuniste e Sërbisë
LPB	Ligji i Punëve të Brendshme
LPJ	Ligji Penal i Jugosllavisë

LPK	Ligji Penal i Kosovës
LPPJ	Ligji i Procedurës Penale të Jugosllavisë
LPS	Ligji Penal i Serbisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSKS	Mbretëria Serbe Kroate Sllovene
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri e Bashkimit European
OZN	Organet për mbrojtjen e popullit (Organ za Zaštitu Naroda)
PK	Prokuroria Komunale
PK	Policia e Kosovës
PQ	Prokuroria e Qarkut
PSBE	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
PSH	Prokurori i Shtetit
PSRK	Prokuroria Speciale e Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
PTH	Prokuroria Themelore
QK	Qendër Korrektuese
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
SHKK	Shërbimet Korrektuese të Kosovës
UDB	Drejtoria e Shërbimit Shtetëror (Uprava Državne Bezbednosti)
UNMIK	United Nations Mission in Kosovo

Kapitulli I

1.1. Hyrje

Kërcënimi ndaj jetës së njeriut radhitet ndër veprimet më rrezikshmëri më të lartë shoqërore që bota ndonjëherë e ka hasur gjatë historisë. Ndër kërcënimet më të rënda konsiderohet vrasja. Lehtë e modifikueshme dhe shumë rezistente ndaj ndryshimeve shoqërore, pavarësisht nga angazhimi i institucioneve për të parandaluar ose luftuar atë, vrasja si fenomen negativ shoqëror po rritet me ritme të larta. Vrasja është dukuri shoqërore socio-patologjike dhe si e tillë trajtohet si vepra më e rëndë penale. Në tërësinë e vet vrasja paraqet një akt njerëzor e cila, shikuar historikisht, e pranishme në të gjitha fazat e zhvillimeve të shoqërisë njerëzore me një zhvillim dinamik dhe në varësi të kushteve të ndryshme të strukturave shoqërore dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore. Në kuptimin e gjërë me vrasje nënkuptohet çdo akt (veprim ose mos veprim) njerëzor që rezulton drejtpërdrejtë me vdekjen e një njeriu tjetër. Në kuptimin e ngushtë, vrasja është privim i jetës së njeriut nga njeriu në kundërshtim me ligjin. Pothuajse të gjitha vendet në sistemet e tyre ligjore gjerësisht në legjislacionet e tyre penale, vrasjen e konsiderojnë si një nga krimet më të rënda dhe parashikojnë sanksionet më të rënda.

Edhe shoqëria kosovare nuk ka qenë immune ndaj fenomenit të vrasjes, posaçërisht gjatë gadi tre dekadave të fundit. Si rrjedhojë e ndryshimeve të ndryshme politike dhe ekonomike, kriminaliteti i vrasjeve ka përcjell dinamikën e përgjithshme të zhvillimit shoqëror në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, në varësi të rrethanave të ndryshme ekonomike, politike e juridike, vendi ynë është i ekspozuar ndaj ndryshimeve të gjithanshme e sidomos ndaj atyre politike, nga koha kur ka qenë njësi autonome e ish-Jugosllavisë socialiste, nën okupim klasik serb, administrimin e UNMIK-ut deri në shpalljen e Pavarësisë më 17 shkurt 2008.

Pavarësisht se çfarë lloje të veprave penale kryhen, veprat penale të vrasjeve zënë vend të posaçëm në kriminalitetin e një shoqërie. Si rregull, viktimat e krimeve të vrasjeve janë “produkt” i vrasjeve, që realisht i ka vendi ynë, në mënyre të ngjashme si çdo shoqëri bashkëkohore. Por, ky fenomen në rrethanat dhe kohën që e kemi studiuar del se në rrethana të caktuara vet institucionet shtetërore, diku më pak e diku më shumë, veprojnë ose nuk veprojnë në drejtimin e duhur për uljen e numrit të vrasjeve.

Qëllimi i këtij punimi, nga këndvështrimi kriminologjik, është hulumtimi i rrethanave, shkaqeve dhe faktorëve që kanë ndikuar dhe ndikojnë në paraqitjen e veprës penale të vrasjes dhe veprave të tjera kundër jetës dhe trupit në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës gjatë viteve 1989-2017. Përkundër asaj se që nga viti 2013 nga territori i Gjykatës së Qarkut të Pejës shpërndahet territori i Gjakovës, (sepse me organizimin e ri në këtë qytet funksionon Gjykata Themelore e saj), vrasjet dhe veprat penale kundër jetës dhe shëndetit janë trajtuar si tërësi në bazë të organizimit të vjetër territorial të gjyqësorit në Republikën e Kosovës. Në shumë aspekte rajoni i Pejës dhe vet qyteti i Pejës ka veçori që e bëjnë të veçantë në shumë dimensione. Në realitet, nga periudha Ilire e deri më tani Peja është njohur me emra të ndryshëm. Nga dokumentet historike përmendet si Siparantum, Pech, Peke, Peka, Penza, Forno, Pechi dhe Peć. Peja me rrethinën e vet shtrihet në cepin më perëndimor të Kosovës, ka qenë gjithnjë qendër e lëvizjeve historike, kombëtare dhe kulturore. Peja përveç si njësi administrative, ajo ishte edhe qendër administrative e cila quhej Qarku i Pejës, Regjioni i Pejës në kuadër të së cilës përfshihen qytetet: Peja, Deçani, Gjakova (deri në dhjetor 2012), Klina dhe Istogu me një sipërfaqe prej 2.653 km², me 314.894 banorë, të shtrirë në 327 fshatra (Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2012, fq.9). Në këtë territor prej pesë komunash deri në dhjetor të vitit 2012 ka funksionuar Gjykata e Pejës e cila herë quhej Gjykatë e Rrethit dhe herë Gjykatë e Qarkut, ndërsa që nga 1 janar 2013, kjo gjykatë quhet Gjykata Themelore e Pejës.

1.2. Qëllimi i punimit

Vrasja, marrja e jetës së një njeriu nga njeriu, historikisht është paraqitur si një ndër veprat më të rënda dhe më të rrëzikshme shoqërore dhe për të cilën ka aq shumë studime, artikuj, hulumtime nga studiues të ndryshëm dhe institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Pavarësisht gjithë këtyre studimeve, vrasjet janë një kategori e veprave penale që paraqesin gjithmonë interes për studiues, njerëz laik, gazetar dhe hulumtues të fushave të ndryshme shkencore. Qëllimi i të gjithë atyre që merren me problemin e vrasjeve është të vijnë në një qëllim të caktuar të ndriçimit të elementeve të ndryshme fenomenologjike, etiologjike që ndikojnë në kryerjen e kësaj vepre të rëndë penale. Pavarësisht se në literaturën kriminologjike dhe penale juridike në ish Jugosllavi vrasjet bëjnë pjesë në deliktet e gjakut, prapëseprapë veprat për të cilat janë në fokus të interesimit, bëjnë pjesë në kapitullin e XVI-të të Kodit Penal të Kosovës “Veprat penale kundër jetës dhe trupit”. Këto vepra të përfshira në këtë

kapitull, janë vepra të rënda penale dhe në shumicën e rasteve kryhen nga meshkujt edhe pse nuk janë të vogla rastet kur vrasjet kryhen edhe nga femrat dhe nga të miturit. Me qëllim që ky studim të jetë më i kompletuar, hulumtimi është drejtuar në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës, territor i cili përfshin territoret e pesë komunave të Rrafshit të Dukagjinit që përmenden më lartë. Periudha e hulumtimit përfshin një kohë relativisht të gjatë duke filluar nga viti 1989 deri në qershor të vitit 2017. Ky hulumtim është bërë në Arkivin Rajonal në Pejë dhe përfshinë periudhen 1989-1999 (ku mungojnë shumë çështje të kësaj periudhe, shumica prej të cilave janë asgjësuar ose marrë nga serbët pas largimit nga Kosova), pastaj kam hulumtuar në arkivin e Gjykatës së Qarkut të Pejës. Gjatë hulumtimit rëndësi të veçantë i është kushtuar studimit të disa karakteristikave të autorëve dhe viktimave të kësaj vepre penale siç janë: mosha dhe gjinia e autorit të kësaj vepre penale, koha e kryerjes, mjeti me të cilin është kryer, motivi i kryerjes, vendi i kryerjes, përkatesia kombëtare, përkatesia sociale dhe arsimimi. Me qëllim që të verifikojmë kohëzgjatjen e procesit penal, duke u bazuar në këto të dhëna, ka rezultuar se ajo kohë ishte relativisht e gjatë. Gjithashtu janë përshkruar raportet mes vet autorit dhe viktimës dhe lidhshmërisë së tyre në kryerjen e vepres penale të vrasjes, masa e dënimit, etj. Një vështirësi në vetvete ishte aplikimi i disa ligjeve penale qoftë para apo pas luftës në Kosovë. Përkundër përpjekjeve dhe vështirësive gjatë kohës së hulumtimit të këtij punimi, qëllimi kryesor është që lexuesëve dhe studiuesëve të ardhshëm t'u prezantojmë një punim që trajton veprat e vrasjeve në territorin e Gjykatës Themelore të Pejës.

1.3. Metodatat dhe metodologjia e kërkimit

Puna hulumtuese e kërkimore për veprat penale të kategorizuara kundër jetës dhe trupit, në veçanti veprat penale të vrasjeve janë të kufizuara në territorin gjeografik, sipas Ligjit për Gjykatat, ka qenë dhe është në kompetencë territoriale të Gjykatës së Qarkut të Pejës.

Vlerësojmë se metodologjia e zbatuar e studimit i është përshtatur arritjes së qëllimeve të këtij punimi. Në varësi të hipotezës apo pyetjeve të sistemuara në kapituj të veçantë të punimit, janë zbatuar edhe metodatat adekuate të hulumtimit shkencor. Pavarësisht nga natyra e studimit kriminologjik të çështjes, qasja kryesore metodike në këtë studim është aspekti *normativ e kriminologjik*, i cila konsiston rreth asaj se si është zbatuar norma, e në asnjë mënyrë si është dashur të zbatohet.

Metoda e studimeve kriminologjike. Përmes metodës së studimeve kriminologjike

jam përpjekur për të sqaruar teoritë kryesore juridike të elaboruara prej doktrinės për natyrën dhe qasjen juridike të veprës penale të vrasjes. Është shumë e nevojshme për kërkuesin, por edhe për lexuesin të kuptojë natyrën juridike dhe veçoritë që paraqet fenomeni, që në rastin konkret është objekt i fokusit të vetë punimit.

Punimi është ndërtuar mbi bazën e metodës së studimeve kriminologjike siç janë metoda cilësore (*kualitative*) dhe metoda kuantitative (sasiore) të kërkimit, përmes të cilave është siguruar kuptimi dhe qartësimi i rasteve studimore, objektivat e hulumtimit, nga këndvështrimi historik e juridik, duke mbledhur të dhëna me qëllim krahasimin dhe analizimin e tyre. Pa dyshim, mund të konstatohet se këto dy metoda të kërkimit shkencor (përqasja cilësore dhe ajo sasiore) funksionojnë si të ndara nga njëra-tjetra, ato sjellin informacion të mjaftueshëm të cilat ndihmojnë në trajtimin e të dhënave të mbledhura dhe plotësojnë këtë studim.

Duke ju referuar fushës së studimit, hipotezës dhe pyetjeve kërkimore të ngritura, punimi kryesisht është i bazuar në metodën cilësore. Në këtë funksion është orientuar mbledhja dhe analizimi i të dhënave të doktrinės juridike për temën në fjalë, të dhëna këto të shtjelluara në literaturë. Gjithashtu mbledhja dhe analiza do të adresohet në kuadrin normativ të brendshëm, shoqëruar edhe me interpretimin e këtij kuadri nga jurisprudenca. Për aq sa ka qenë e mundur, në disa kapituj të veçantë, me referenca të veçanta, janë analizuar të dhënat sipas metodës kuantitative (sasiore). Kjo metodë është aplikuar me synimin që të mësohet sa më shumë nga përpjekjet dhe veprimtaria që kanë bërë të tjerët, tërësia e burimeve të informacionit e cila është e botuar dhe përdorur si literaturë shkencore. Natyrisht, gjetjet në literaturë, janë në raport korrekt me projektin e kërkimit në një numër rrugësh – përfshirë përcaktimin e problemit, objektivat, kuadrin konceptual të metodave e procedurave.

Metoda statistikore. Me aplikimin e metodës statistikore dhe krahasimin e tyre me fenomene të ndryshme, nuk arrihen të kuptohen vetem shkaqet e lindjes dhe paraqitjes së kriminalitetit por mund të përcaktohen edhe mënyrat e parandalimit të tij. Në këtë kuadër është aplikuar *modeli krahasues* (zgjedhja e rasteve konkrete), *teknika korrelacionit* (*ndërveprimi*), krijimi i korelacioneve të kriminalitetit me variablat si gjinia, mosha, profesioni, arsmi, vepra penale, masa e dënimit dhe mbi këtë bazë janë nxjerrë përfundime. Ndërsa *aplikimi i modelit të shifrës mesatare* ka dhënë rezultate të cilat janë paraqitur në tabela, diagrame, dhe mesatare të ndryshme të shprehur në koeficientë dhe shifra të caktuara. Konkretisht në punim është zbatuar edhe metoda

krahasuese, metoda e interpretimit dhe ajo dokumentare.

Metoda krahasuese. Metoda krahasuese përceptohet si proces i konstatimit të ngjashmërisë dhe ndryshimeve mes dukurive të ndryshme. Kjo metodë ka vlerën e vetë praktike në këtë punim, sepse duke krahasuar dukuritë e ndryshme shoqërore dhe duke zbuluar vetitë e njëjta apo të ndryshme nga ky krahasim, konstatohen përparësitë apo mangësitë konkrete të asaj që dëshirojmë të studiojmë dhe të njohim. Në studimin tonë kjo metodë është vlerësuar e rëndësishme për studim krahasues midis sistemeve juridike kombëtare, në fushën e të drejtës penale - vrasjes dhe posaçërisht në njohjen e përparësive dhe dobësive që këto sisteme shfaqin dhe në sistemin juridik kosovar. Po kështu metoda paraqet epërsi në krahasimin midis interpretimeve të bëra në vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat dhe institucionet e tjera penale.

Metoda dokumentare. Aplikimi i kësaj metode ka qenë i domosdoshëm për shkak se gjatë punës kemi eksploruar mjaft dokumente të cilat kanë qenë një bazë e mirë përmes të cilave kemi arritur të paraqesim informacion të mjaftueshëm dhe me interes për këtë studim kriminologjik. Këto dokumente janë nga më të ndryshmet e posaçërisht janë çështje të gjykuara gjyqësore të cilat dëshmojnë për mungesat profesionale, pengesat dhe barrierat e tjera ligjore që ndërlidhen dhe me mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë gjatë kohës së UNMIK- ut dhe pas saj.

Nëpërmjet metodologjisë së mësipërme është synuar nxjerrja e të dhënave, paraqitja e analizës dhe nxjerrja e konkluzioneve për të vërtetuar hipotezën dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura. Gjithashtu aplikimi i kësaj metode garanton përqasjen e një punimi induktiv: mbi bazën e konstatimeve të rezultuara nga hulumtimi i literaturës, krahasimi i fenomeneve, analiza e dokumenteve dhe rasteve studimore dhe do të nxirren përfundime për situatën e përgjithshme.

1.4. Hipoteza dhe pyetjet hulumtuese

Në këtë pjesë lexuesi njihet me mënyrën se si është realizuar studimi, duke përfshirë të gjithë elementet e tij dhe mënyrën e kombinimit të tyre për të përftuar rezultatet e duhura. Realisht, këtu janë prezantuar qasjet metodike dhe metodat kërkimore që janë përdorur për realizmin e studimit, si dhe është shpjeguar përshtatshmëria e këtyre metodave me temën kërkimore. Kështu, në këtë seksion është paraqitur plani i studimit; ku dhe si është marrë informacioni i nevojshëm; janë përshkruar metodat e mbledhjes së të dhënave; procedurat dhe instrumentet e përdorura; procedurat e përdorura për të siguruar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e rezultateve, si dhe kufizimet e metodologjisë së përdorur.

Këndvështrimi metodologjik në mënyrë të pashmangshme është përcaktuar duke marrë për bazë qëllimin e vetë hulumtimit. Pyetjet e hulumtimit kanë rëndësi thelbësore në një punim shkencor, ato shprehin qëllimin e hartimit të punimit, por dhe drejtojnë procesin e hulumtimit. Pyetjet hulumtuese në këtë punim janë:

- 1) Si ka evoluar legjislacioni penal për veprat penale të vrasjes në Republikën e Kosovës?
- 2) Si ka ndikuar shteti dhe pushteti shtetëror në vëllimin dhe dinamikën e veprave penale kundër jetës dhe shëndetit?
- 3) Cilët janë faktorët që ndikojnë tek vepra penale e vrasjes?
- 4) Cila është fenomenologjia e vrasjeve në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës?
- 5) Cilat janë shkaqet e kryerjes së veprave penale të vrasjes duke ju referuar pyetësorëve të realizuar me autorët e këtyre veprave?
- 6) Cilat janë problematikat institucionale në luftimin dhe parandalimin e veprave penale të vrasjeve?
- 7) Cilat janë problematikat në hetimin e veprave penale të vrasjes?

Duke vlerësuar çështjen të cilën e kemi shtruar në planin juridik e kriminologjik, legjislacionin që ka rregulluar çështjen juridike-penale të vrasjeve gjatë periudhës dhe rajonit të studimit dhe në këtë rast edhe praktikën e gjyqësorit kosovar. Në këtë këndvështrim janë paraqitur dy hipoteza të cilat duhet verifikuar.

Hipoteza e parë e ngritur në punim është: **Mosfunksionimi i shtetit ligjor ka ndikim të drejtëpërdrejtë në vëllimin dhe dinamikën e vrasjeve.**

Hipoteza e dytë është: **Mosreagimi institucional dhe konform ligjit i pushtetit shtetëror ndikon në uljen dhe rritjen e vrasjeve dhe të veprave të tjera penale kundër jetës dhe shëndetit.**

1.5. Mundësitë dhe kufizimet

Meqenëse për një kohë relativisht të gjatë jam pjestar i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, më është dhënë mundësia e hulumtimit të dosjeve për vrasjet që kanë ndodhur në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës. Këto dosje (me mungesa të mëdha) më janë ofruar në shikim nga Arkivi Rajonal i Pejës të cilat i takojnë periudhës 1989-1999. Gjithashtu, edhe për periudhën e pas luftës 1998-1999, kam pasur mundësi të shikoj dosjet e arkivuara në arkivin e Gjykatës Themelore të Pejës, dosjet e arkivuara

të çështjeve penale të vrasjes në Arkivin e Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në Pejë dhe dosjet e arkivuara në arkivin e Prokurorisë Themelore të Pejës.

Me qëllim që të nxjerrim një analizë përmbajtësore për fenomenin e vrasjeve në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës, me mitatimin e Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve të Kosovës kam bërë hulumtime me të dënuarit për vrasje dhe vepra të tjera penale kunder jetës dhe shëndetit të cilët kryejnë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Dubravë të Istogut dhe të dënuarit e mitur në Qendren Korrektuese në Lipjan. Gjithashtu një ndihmesë në analizimin e faktorit institucional më ka dhënë edhe hulumtimi përmes pyetësorëve që janë marrë nga punonjës të policisë së krimeve të rënda në Pejë, gjyqtarët e krimeve të rënda në Gjykatën Themelore të Pejës dhe me prokurorët që merren me hetimin e krimeve të rënda në Prokurorinë Themelore të Pejës. Edhe njohja e gjuhës serbo-kroate më ka mundësuar që të shfrytëzoj literaturë të shkruar nga kjo gjuhë të cilat janë shfrytëzuar gjatë hartimit të tezës së doktoraturës.

Meqënëse vrasjet dhe veprat e tjera kundër jetës dhe trupit në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës përfshijnë një zonë pothuajse të gjerë gjeografike (tërë Rrafshi i Dukagjinit), duke përfshirë një periudhë relativisht të gjatë kohore (1989-2017) vetvetiu janë krijuar edhe kufizime të cilat konsistojnë në të dhëna të kufizuara dhe here- herë kontradiktore, mungesën e dosjeve (si rezultat i djegies nga lufta, i asgjësimit gjatë luftës, i tërheqjes së këtyre dosjeve nga zyrtarët serbë dhe dërgimin e tyre në Serbi pas tërheqjes nga Kosova me 10 qershor të vitit 1999, asgjësimin e tyre edhe pas luftës nga palë të interesuara) në bazë të cilave sigurisht që do ketë ndikim në paraqitjen e saktë sasiore dhe cilësore.

Gjatë hulumtimit të dosjeve të vrasjeve të periudhës së pas luftës kemi hasur në kufizime të ndryshme të cilat lidhen me mungesën e një regjistri të besueshëm të çështjeve për shkak të pozitës protektoriale nga UNMIK-u dhe gërshetimit të një metode të vjetëruar të evidentimit të çështjeve nga e kaluara me metoden elektronike. Si rezultat i këtyre “evidencave” është krijuar një paqartësi e prezentimit të saktë të levizjes së kriminalitetit në Rajonin e Pejës. Kjo për faktin se çështjet penale regjistrohen në regjistrin penal në çdo shkrimore dhe pastaj ato reregjistrohen në regjistrat e gjykatave në të gjitha nivelet edhe pse bëhet fjalë për të njejtën çështje. Sipas këtyre regjistrave del se secila nga gjykatat e vendit, me rastin e pranimit të çështjes në shkallë të parë e regjistron atë, çka do të thotë se çdo gjë deri këtu është në rregull. Kur kjo çështje shkon në shkallën e dytë, merr një numër të ri dhe nëse kjo çështje kthehet

në rigjykim prap merr një numër të ri. Kjo formë e mbajtjes së regjistrit ka shkaktuar konfuzion në paraqitjen e kriminalitetit në përgjithsi në Kosovë e pse jo edhe rritje “artificiale të kriminalitetit” në rajonin e Pejës në veçanti. Kjo për faktin se gjykatat e niveleve të ndryshme në Kosovë, e kanë detyrim paraqitjen e punës së tyre duke i paraqitur publikut statistikën vjetore në fund të çdo viti kalendarik. Pavarësisht këtyre kufizimeve të mundshme, është arritur që të pasqyrohet një gjendje reale, por pa pretenduar se nuk mund të jenë pasqyruar edhe gabime të cilat mund të korigjohen nga studiues të ndryshëm në të ardhmen.

1.6. Rëndësia e studimit

Në fushën e studimeve kriminologjike në Kosovë ka ekzistuar një literaturë e bollshme e cila ka trajtuar fenomenin e vrasjeve dhe veprave të tjera kundër jetës dhe trupit edhe pse ato me përjashtim të studimit të profesor Ismet Salihut, janë të pjesshme, i dedikohen një periudhe të caktuar kohore. Studime të tilla rreth shfaqjes dhe prezencës së fenomenit të vrasjeve në përgjithësi dhe të vrasjeve nga hakmarrja dhe gjakmarrja në veçanti në Kosovë kanë ekzistuar edhe në nivel të ish-Federatës Jugosllave edhe pse shpeshëherë janë prezentuar të dhëna jo të sakta dhe me perfundime tendencioze. Nuk mund të mohohet fakti se dukuria e vrasjeve ka ekzistuar dhe ekziston edhe sot në Kosovë, por kjo dukuri nuk është diçka që nuk ekziston në trevat e tjera, në vende të tjera pavarësisht shkallës së zhvillimit shoqëror politik dhe ekonomik të tyre. Dukuria e vrasjeve dhe vrasjeve nga hakmarrja dhe gjakmarrja ka ekzistuar dhe ekziston edhe sot në shtetet që kanë dalë nga Jugosllavia ku vrasjet nga hakmarrja e paskrupullt është e sanksionuar si vrasje e rëndë e cila diku shkruhet si “hakmarrje e paskrupullt “ (iz bezobzirne osvete-kodi penal serb dhe ai malazias”, „ ubistvo iz bezobzirne odmazde- Kodi Penal i Kroacisë”, „iz bezobzirnog maščevanja-kodi penal i Sllovenisë etj.)

Periudha e cila është marrë në studim, literatura e përdorur, duke përfshirë edhe literaturë plotësuese nga shkencat e tjera shoqërore, gjeografia, historia, etnologjia, ekonomia, statistika etj. ia shtojnë rëndësinë dhe vlerën këtij studimi i cili do të plotësojë kërkesat e të interesuarve, studiuesëve, institucioneve kërkimore shkencore dhe atyre institucionale. Nga ana tjetër, ky punim doktorature mendoj se do të jetë një ndihmesë dhe një avancim në fushën e studimeve kriminologjike, penale dhe shoqërore në përgjithsi në Kosovë. Në këtë punim jam përpjekur që të nxjerr disa rekomandime të cilat do të jenë bazë e mirë për agjencitë e zbatimit të ligjit, të cilat kanë detyrim dhe prioritet luftimin e kriminalitetit në përgjithsi si dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në veçanti. Përkundër përpjekjeve të mia modeste, ky studim imi nuk ka synimin

e vendosjes së një pike ku nuk mund të shkohet tutje, por ka si qëllim që të jetë një pikënisjeje e cila mund të vazhdohet, pasurohet dhe plotësohet në të ardhmen.

1.7. Plani i strukturës së punimit

Punimi përveç përmbajtjes, pjesëve hyrëse dhe çështjeve metodologjike është strukturuar në nëntë kapituj ku secili nga kapitujt veç e veç është i ndërlidhur me qëllimin dhe objektivat e studimit.

Kapitulli i parë në tërësinë e vet ka përmbledhur qëllimin e punimit, metodologjinë dhe metodat të cilat janë përdorur në punim, duke përfunduar me hipotezën e ngritur dhe pyetjet hulumtuese, mundësitë dhe kufizimet dhe rëndësia e punimit.

Kapitulli i dytë kryesisht përmbledh vështrime lidhur me kualifikimin penal - juridik të vrasjeve në Kosovë dhe aplikimin e ligjeve penale në territorin e saj gjatë 87 viteve të historisë së saj nën administrimin serb. Gjithashtu në këtë kapitull është përfshirë edhe aplikimi i legjislacionit gjatë kohës që ajo kishte autonominë e saj si dhe ligjet dhe rregulloret që janë aplikuar gjatë kohës së administrimit ndërkombëtar të OKB (UNMIK-ut) dhe pas vitit 2008 që lidhet me Shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Kapitulli i tretë përfshinë rrethanat historike dhe terrorizmin shtetëror të aplikuar në Kosovë që nga viti 1912-1918 (nga Mali i Zi dhe Serbia) pastaj nga Mbretëria SKS (1918-1941), nga Jugosllavia e Titos (1945-1989, nga regjimi i Serbisë në kohën e Millosheviqit (1989-1999). Në bazë të të dhënave shkencore është pasqyruar terrori shtetëror i MSKS-së mbi shqiptarët gjatë viteve 1918-1941, vrasjet gjatë periudhës 1945-1981, vrasjet gjatë periudhës 11 mars 1981- 23 mars 1989, vrasjet me motive politike në rajonin e Pejës (vrasjet e intelektualëve, ushtarëve dhe qytetarëve të thjeshtë), vrasjet dhe aktet e tjera të terrorizmit shtetëror (1990-1999) dhe izolimet e helmimet - akte terroriste shtetërore.

Kapitulli i katërt trajton vrasjet në territorin e rajonit të Pejës në një periudhë specifike nga 23 mars 1989 deri me 10 qershor 1999. Në këtë territor vrasjet janë analizuar sipas metodës së krahasimit duke i identifikuar edhe ngjashmëritë. Në vijim në mënyrë të gjithanshme janë analizuar vrasjet në Kosovë pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Kapitulli i pestë trajton fenomenologjinë e vrasjeve në territorin e rajonit të Pejës për gjatë periudhës së studimit 1989- deri në qershor të vitit 2017. Nga ky kontekst është hulumtuar struktura gjinore e autorëve të dënuar të veprave penale kundër jetës dhe trupit, struktura gjinore, struktura kombëtare e të dënuarve, struktura kombëtare e viktimave të krimit, gjeografia kriminale dhe shtrirja e saj fshat-qytet, vendi i kryerjes së

veprës penale, koha e kryerjes së veprave penale gjatë ditës, veprat penale të kryera sipas muajve të vitit, mjetet e kryerjes së veprave penale, motivi i kryerjes së veprave penale, shkalla e arsimimit të autorëve të veprave penale, struktura sociale e autorëve të veprave penale, mosha e autorëve të veprave penale, lidhja mes autorit e viktimës dhe recidivizmi.

Kapitulli i gjashtë përfshinë faktorët dhe teoritë e kriminalitetit gjerësisht etiologjinë kriminale. Në mënyrë më specifike janë analizuar faktorët e jashtëm (ekzogjenë) që kanë ndikuar në vrasjet e rajonit të Pejës. Këto çështje janë të lidhura edhe me ndikimin e luftës dhe kriminalitetin, varfërinë dhe kriminalitetin.

Në këtë kapitull, në mënyrë më të thelluar janë trajtuar faktorët e tjerë siç janë problemet sociale-papunësia dhe kriminaliteti, marrëdhëniet e pronësisë, arsimi, familja, bixhozi, trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni, media, inteligjenca, motivet, hakmarrja dhe gjakmarrja, faktorët institucional (joseriozitetit dhe joprofesioanlizmit i organeve të ndjekjes në luftimin e krimeve të rënda, joefikasitetin e institucioneve gjyqësore, ndikimin e sistemit paralel të gjyqësisë së Serbisë në Kosovë, caktimin joadekuat të dënimeve nga ana e gjykatës dhe instituti i faljes nga ana e presidentit).

Kapitulli i shtatë përfshinë aspektin hetimor të veprës penale të vrasjes duke përfshirë këqyrjen e vendit të ngjarjes, ekspertimin, ekspertizat të ndryshme (balistike, daktiloskopike, autopsia) analiza të ndryshme (financiare dhe kompjuterike) si dhe rikonstruksionin e vendit të ngjarjes.

Kapitulli i tetë përfshinë analizën dhe rezultatet e kërkimit.

Kapitulli i nëntë përfshinë konkluzionet përfundimtare dhe rekomandimet.

Kapitulli II: Vështrim penal – juridik i vrasjeve në Kosovë

2.1. Rregullimi juridik penal i vrasjeve në ish- RSFJ (1945-1989)

Vrasja është njëra ndër veprat më të rënda penale e cila është e inkriminuar në të gjitha kodet penale që nga kohët më të hershme të historisë njerëzore deri më sot, sepse me vrasje shuhet një jetë njeriu dhe me shuarjen e jetës shuhet të gjitha të drejtat e tjera. Për këtë arsye e drejta penale i kushton rëndësi parësore mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njeriut. Për autorët e vrasjeve dhe veprave të tjera kundër integritetit trupor, në të gjitha shoqëritë e organizuara njerëzore janë parashikuar dënime të rënda me burgim dhe në disa raste edhe deri me vdekje. Në literaturën juridike janë të njohura një seri ligjesh, kodesh penale ku veprat më të rënda penale që cenojnë jetën e njeriut janë parashikuar dënime mjaft të rënda me qëllim që të ndikojnë në ndërgjegjësimin e autorëve të mundshëm se me çfarë pasojash mund të përballen nëse kryejnë një vepër të tillë. Inkriminimi i vrasjes si vepër e dënueshme parashikohej nga Kodi i Hamurabit, Ligji i XII Tabelave, etj (Ismaili, 2001) deri tek ligjet dhe kodet penale që janë aplikuar para dhe pas luftës së dytë botërore në ish-Jugosllavi duke përfshirë edhe legjislationin penal të Kosovës (Ligjin penal të Kosovës (1977), Kodin e përkohshëm penal të Kosovës (2004) dhe Kodin Penal të Kosovës (2013).

Duket theksuar se ligjet, në përgjithësi kodet e vjetra penale nuk kanë pasur dispozita të sistemuara ligjore për veprat penale kundër jetës dhe shëndetit, siç janë të sistemuara sot, por, për veprimet që janë konsideruar se janë të kundërligjshme janë ndërmarrë masa mjaft të rënda penale.

Sa i përket Kosovës, aplikimi dhe rregullimi penal juridik i vrasjeve ka ndjekur rrjedhën historike-politike të saj. Pavarsisht se Kosova ishte pjesë e një shteti i cili konsiderohej i konsoliduar (ish-Jugosllavia) për sa i përket rregullativës ligjore, ajo në rrethana dhe në kohë të caktuar ishte jashtë sistemit të drejtësisë dhe ishte e detyruar që për zgjidhjen e problemeve shoqërore të aplikonte të drejtën e vet zakonore.

Pas shkatërrimit të perandorisë turke, Kosova mbeti jashtë shtetit shqiptar, ndërsa pas Luftës së Parë Botërore mbeti nën Mbretërinë Serbo- Kroate - Sllovene deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Kosova u përpoq që të fitojë pavarësinë e saj politike, por rezultatet e Luftës së Dytë Botërore ia bënë të pamundur këtë objektiv dhe ajo mbeti nën Jugosllavinë e Titos. Në të tilla kushte, në mars të vitit 1945, në Kosovë vendoset administrimi ushtarak jugosllav, dhe në këto kushte më 8 korrik 1945 në Prizren ishte nxjerrë “Rezoluta mbi aneksimin dhe

bashkimin e Kosovës dhe Metohisë Serbisë Federale” rezolutë e cila as sot e kësaj dite nuk është publike. (Salihu, 2012:112). Në gusht të vitit 1945 Kuvendi i Jugosllavisë miraton Ligjin për veprat penale kundër popullit dhe shtetit, i datës 25 gusht 1945 dhe i plotësuar me 16 korrik 1946. Ky ligj në vitin 1947 zëvendësohet me Ligjin Penal (Kodi Penal, gazeta zyrtare e RFPJ nr. 106/47) i cili edhe për nga emërtimi ashtu edhe për nga përmbajtja kishte karakter hakmarrës dhe përndjekës ndaj të gjithë atyre siç i quanin atëherë “bashkëpunëtor dhe kolaboracionistë të armikut”. Ky Ligj në vetvete ishte reperesiv, por krahas tij, ky represion bëhej edhe më i ndjeshëm sepse një numër i madh i shtetasve (shqipëtarët posaçërisht) ishin nën një terror ndjekjeje të pamëshirëshme të Shërbimit të Sigurimit të Popullit (OZNA - Odsek za zaštitu naroda) të cilët përfundonim me ekzekutime pa gjyq në emër të gjoja eliminimit të armikut të popullit dhe “reaksionarëve e kolaboratorëve” me arsyetim se kanë qenë bashkëpunëtor të anmikut. Ky ligj ka qenë fatal për shqiptarët e Kosovës dhe të të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi, të cilët ishin ngarkuar me bagazhin e së kaluarës antikomuniste dhe antijugosllave, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Me 29 nëntor 1947 Jugosllavia nxjerr një ligj penal i cili ka 106 nene dhe kishte fuqi retroaktive duke filluar që nga data 6 prill 1941 (neni 104) për të gjitha ato vepra penale që janë kryer pas kësaj date. Në këtë ligj i cili ndahet në shtatë kapituj, nuk kemi një ndarje tradicionale sipas veprave penale, përveç pjesës së përgjithshme (kreu i I), përgjegjësia penale (pjesa e II), kryerja e veprës penale (pjesa e III), dënimet, masat edukative përmirësuese dhe shëndetësore (pjesa IV), etj.

Në ligjin penal të Jugosllavisë të vitit 1951, (362 nene), veprat penale kundër jetës dhe trupit janë në një kapitull të veçantë (XII). Sipas këtij ligji vrasjet ndaheshin në vrasje të rëndomta (neni 135 par 1) dhe vrasje të kualifikuara (neni 135 par 2 dhe 3) ku bënin pjesë vrasjet e kryera në mënyrë mizore, vrasjet e kryera me paramendim dhe duke i vënë në rrezik edhe personat e tjerë, vrasjet për interes, ose me qëllim të kryerjes ose të fshehjes së veprës penale, vrasjet nga hakmarrja e paskrupullt ose për motive të dobëta, vrasja e nëpunësve publik, ushtarak dhe vrasja me paramendim e shumë personave. Sipas këtij ligji, për veprën penale të vrasjes ishte parashikuar dënimi me burgim së paku 5 vjet e deri me vdekje. Ndërsa për vrasjet e privileguara, siç janë vrasja e çastit (neni 136), vrasja nga pakujdesia (neni 137) dhe vrasja e foshnjës gjatë lindjes, ishin të parashikuara dënime më të lehta “nga tre muaj deri në 10 vjet” (Krivični Zakonik, FNRJ, 1971).

2.2. Ligji Penal i Krahinës Socialiste të Kosovës (1977)

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 në Jugosllavi, edhe në fushën e të drejtës penale pati një zhvillim pozitiv. Krahina Socialiste Autonome e Kosovës (siç quhej zyrtarisht Kosova) nxjerr për herë të parë Ligjin Penal të saj krahas shtatë ligjeve të njësive federale dhe Ligjit Penal të Jugosllavisë (LPJ). Në Ligjin Penal të Jugosllavisë ishin të përfshira veprat penale që cenonin interesat në nivel federativ, ndërsa ligjet penale të njësive federale rregullonin çështje penale specifike me kusht që të mos ishin në kundërshtim me LPJ dhe vlerat morale të shoqërisë së atëhershme socialiste. Sa i përket veprave penale të vrasjes, Ligji penal federativ rregullonte fusha specifike të nivelit federativ duke përfshirë çështje të karakterit të përgjithshëm (p.sh. vrasjen e mbetur në tentativë, mbrojtjen e nevojshme, nevojën ekstreme, dënimin me vdekje etj. (LPJ, 1977). Me ligjet e veçanta të njësive federale janë paraparë veprat penale dhe masat e dënimit në përputhje në ligjin federativ.

Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (Përmbledhje e ligjeve penale, 1979) veprat penale kundër jetës dhe trupit i parashikonte në nenin 30 të tij. Sipas këtij ligji pavarësisht nga motivet dhe mënyra e kryerjes, njihen tri lloje të vrasjes, vrasja e rëndomtë (neni 30 par 1, vrasja e rendë (neni 30 par 2) dhe vrasja e privilegjuar e cila kryhet në mungesë të elementit të dashjes (vrasje nga pakujdesia, neni 34). Edhe vrasja e foshnjës gjatë lindjes (neni 35) konsiderohet si vrasje e privilegjuar nëse ajo kryhet brenda një afati të caktuar kohor, derisa lehona gjendet në një situatë të rëndë psikike, që për disa autorë, kjo kohë kufizohet brenda afatit prej 24 orësh. Përcaktimi i një afati të tillë, juridikisht nuk është argumentuar, sepse gjendjen psikike dhe ngarkesat e tjera fizio-psikologjike mund t'a caktoj vetëm eksperti për çdo rast konkret.

Në ndryshim nga ligjet që përmendëm më lartë, Ligji Penal i Kosovës përveç veprimeve të njëjta inkriminuese dhe dënimeve të njëjta me ligjet që trajtuam më lartë, parashikon vrasjen për gjakmarrje në kuadër të vrasjes së kualifikuar (që është specifike e këtij ligji). Sipas nenit 30 paragrafi 2 pika 4 me dënim me burgim së paku 10 vjet dhe me dënimin me vdekje dënohet “kush tjetrin e privon nga jeta për gjakmarrje”. Duhet thënë se, ligjvënësit kosovarë kishin parashikuar këtë nen të veçantë i cili i referohej specifikave të veprave penale të vrasjes nga gjakmarrja. Përveq këtij neni, edhe neni 47 paragrafi 1 i këtij ligji ishte specifik dhe kishte për qëllim mbrojtjen nga hakmarrja. Me këtë nen dënohej “Kush kryesit të veprës penale ose të afërmeve të tij ua kufizon lirinë e lëvizjes, duke shprehur qëllimin se do të hakmerret, dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. Në rast të pajtimit ndjekja nuk do të fillojë, e nëse ka

filluar do të pezullohet “thuhet në paragrafin 2 të këtij neni. Sipas prof. Salihut është një vepër specifike e parashikuar në LPK-në dhe paraqet një “fenomen tipik ...nëpërmjet së cilës privohet apo kufizohet liria e lëvizjes, është dukuria ende e pranishme e burgjeve shtëpiake në KSA të Kosovës...” (Salihu, 1981, f:155-156). Prof. Salihu mendon se kërcënimi dhe frika nga hakmarrja ka ndikuar që familja e autorit të mbyllet në burg shtëpiak, fakt ky që e ka nxitur ligjëvënësin t’a sanksionoj këtë si veper penale (Salihu, 1981a, f:156). Si rezultat i shkeljes së këtij neni – sipas prof. Salihut – në vitin 1976 ishin të privuar nga liria 1360 familje (në Kosovë) me gjithsej 15.459 anëtarë. Në fakt, ndjekja kundër autoreve të kësaj vepre penale ishte më “tepër se modeste” shkruan Salihu duke përmendur faktin se deri në mesin e vitit 1979 janë regjistruar vetëm katër raste të tilla të ndjekjes penale për këtë vepër (Salihu, 1981b, f:160).

2.3. Rregullimi juridik - penal i vrasjeve nën administrimin e Serbisë (1989 – 1999)

Pas ndërhyrjes në kundërshtim me Serbinë kundër autonomisë së Kosovës në nëntor të vitit 1989. Ligji Penal i Kosovës zëvendësohet me Ligjin Penal të Serbisë i cili është aplikuar në territorin e Kosovës deri në fillimin e luftës 1998-99. Edhe me këtë ligj dënimet për vepra penale kundër jetës duke përfshirë edhe veprën penale të vrasjes ishin të rënda. Në nenin 47-të paragrafi 2 pika 4 i këtij ligji, ishte parashikuar dënimi më së paku 10 vjet ose me vdekje kush kryen vepër penale “për gjak ose nga hakmarrja e paskrupullt” (iz krvi ili bezobzirne osvete). Ky ligj, juridikisht është aplikuar në territorin e Kosovës deri më 10 qershor 1999, kur Kosova u çlirua fal përpjekjeve të faktorit politik shqiptar të Kosovës dhe luftës së lavdishme të UÇK-së dhe të NATO-s. (Salihu, 2012a).

2.4. Rregullimi juridik - penal i vrasjeve nën administrimi e UNMIK-ut

Pas ndërhyrjes 78-të ditëshe ushtarake të NATO-së kundër Serbisë, me 10 qershor 1999 dhe vendosjes se Administratës së Përkohshme të OKB- UNMIK-ut (Rezoluta 1244 e OKB) në Kosovë, janë përcaktuar ligjërisht edhe cilat ligje janë të aplikueshme në territorin e saj. (UNMIK/REG/1999/1; UNMIK/REG/1999/24). Sipas kësaj rregulloreje, në Kosovë, ligj i aplikueshëm mbetet Ligji penal i Kosovës i vitit 1977, Ligji Penal dhe ai i procedurës penale i RSFJ-së me ndryshime dhe plotësime të mëvonshme. Me ndryshimin e Rregullores nr.1999/24 Mbi ligjin në fuqi në Kosovë të datës 27 tetor 2000 (UNMIK/REG/2000/59), në nenin 1.6 thuhej “Për çdo vepër penale për të cilën sipas ligjit në fuqi të Kosovës të datës 22 mars 1989 parashikohet dënimi me vdekje, dënimi do të jetë me burgim ndërmjet minimumit që parashihet për atë vepër dhe maksimumit prej dyzet (40) vitesh”. Ky ligj bashkë me rregulloret e UNMIK-ut është

aplikuar në Kosovë deri në nxjerrjen e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës i cili ka hyrë në fuqi me 6 prill të vitit 2004 (Neni 357 KPPK). (Salihu, 2012b, f:113-118).

Sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, veprat penale kundër jetës dhe trupit përfshihen në Kapitullin e XV-të dhe pothuajse janë të përshkruara nga Ligji Penal i Kosovës, që në fakt përfshinë vrasjen e rëndomtë (neni 146) dhe vrasjet e rënda të përfshira në klasifikimin e këtij si vrasje të kualifikuara neni (147) dhe në fund edhe vrasejt e privilegjuara. (vrasja e kryer në afektin mendor (neni 148), vrasja nga pakujdesia (neni 149) dhe vrasja e foshnjës gjatë lindjes (neni 150).

Vrasje të rëndomta konsiderohen të gjitha ato vrasje të cilat nuk kanë tipare të veprës së rëndë (neni 146 KPPK). Në KPPK, ligjvënësi kishte parashikuar vrasjen e rëndë, e cila bazuar në rrethanat, mënyrën e kryerjes, motivet, mjetet e përdorura, objektin e sulmuar, pasojat e krijuara dhe janë cilësuar si vrasje të kualifikuara për të cilat veprime ishin parashikuar dënime deri në dyzet vjet heqje lirie (neni 37 KPPK). Në Kodin e ri Penal i cili ka hyrë në fuqi në janar 2013, për veprën penale të vrasjes së kualifikuar parashihet dënimi me burgim të përjetshëm (neni 44 KPK). Duhet cekur se në Kodin e ri Penal pothuajse janë parashikuar të njejtat vepra penale, me përjashtim të shtimit të veprës penale të vrasjes së anëtarit të familjes (neni 179 par1.3) dhe heqjes nga ky kod veprat penale nga neni 147 par 6 ku bëhej fjale për vrasjen e personit tjetër për motive racore, nacionale apo fetare. Në kuadër të vrasjës së rëndë (neni 146 të KPPK) për të cilat janë parashikuar dënime më së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë kundër atij personi i cili: 1) Privon nga jeta fëmijën; 2) femrën për të cilën e di se ajo është shtatzënë; 3) personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake; 4) personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave; 5) personin tjetër duke vepruar mizorisht e dhunshëm; 6) personin tjetër për motivet racore, kombëtare apo fetare, 7) personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore; 8) me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale; 9) personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta; 10) personin tjetër zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo të pasurisë, zbulimit të veprave penale, arrestimit të autorit të veprës penale, ruajtjes së personave të privuar nga liria ose ruajtjes së rendit dhe të paqes publike; 11) dy apo më shumë persona, përveç veprave për të cilat janë parashikuar në nenet 148 dhe 150 të këtij Kodi ose 12) vrasja e personit nga recidivisti i cili më parë ka qenë i dënuar për vrasje. (KPPK, UNMIK/RREG/2003/25)

Vrasja e fëmijës deri në 18 vjet, konsiderohet si njëra ndër veprat më të rënda penale. Që të cilësohet si vepër e tillë, duhet që autori i kësaj vepre penale të ketë ditur se viktima e kësaj vrasjes është fëmijë.

Edhe vrasja e gruas shtatëzënë konsiderohet sipas këtij kodi, vrasje e kualifikuar sepse këtu bëhet fjalë për vrasje edhe të fëmijës së palindur. Që të kualifikohet si e tillë, autori duhet që ta ketë kryer vrasjen i shtyrë nga motive xhelozie, dhe duke e ditur se viktima ishte shtatëzënë. Rreth asaj se autori ka patur njohuri për këtë fakt ose jo, duhet të vërtetohet në procesin gjyqësor.

Vrasja e personit tjetër në mënyrë mizore apo dinake konsiderohet ajo vrasje e cila kryhet duke përdorur mashtrimin, dhe duke i shkakuar dhimbje të tmerrshme viktimës. Në këtë rast duhet të plotësohen elementet objektive dhe subjektive me qëllim që të cilësohet si vrasje e kualifikuar. Në aspektin objektiv duhet që viktimës t'i shkaktohet dhimbje fizike, ndërsa në aspektin subjektiv këto veprime të dhunshme që autori kryen kundër viktimës duhet të ndërmerren me vetëdije të plotë.

Vrasja e personit tjetër duke i venë në rrezik edhe personat e tjerë, kryhet atëherë kur autori kryen veprime të kundërligjshme me qëllim që të kryejë një vrasje, me dashje dhe në vende publike dhe me këtë rast vë në rrezik edhe persona të tjerë apo duke përdorur mjete të ndryshme (psh. eksploziv) dhe me këtë veprim rrezikon edhe jetët e të tjerëve. Vrasja e personit tjetër duke vepruar mizorisht dhe dhunshëm është gjithashtu një vrasje e cilësuar e cila kryhet nga autori i cili duke përdorur dhunën fizike ndaj viktimës i shkakton tjetrit dhimbje të mëdha fizike dhe më pas edhe e vret.

Vrasja për motive që kanë të bëjnë me racën, kombësinë apo fenë, ishte parashikuar në këtë kod, si vepër e cilësuar. Sipas ligjvënësit objekt i mbrojtjes juridike penale janë komunitetet e ndryshme fetare, racore dhe kombëtare. Vrasja e personit tjetër me qëllim të fitimit të interesit pasuror është njëra ndër veprat e cilësuar e cila kryhet nga autori me qëllim të fitimit të interesit pasuror. Kjo vepër kryhet gjithashtu me vetëdije të plotë dhe me vullnetin e lirë të autorit.

Vrasja me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale kryhet nga autori i cili këtë veprim e ndërmerr me vetëdije të plotë. Kjo vepër në shumicën e rasteve kryhet ndaj atyre personave që dinë për veprimet e kundërligjshme të autorit (eliminimi i dëshmitarëve).

Vrasja e personit tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta është njëra ndër veprat më të rënda që ndodhin në relitetin tonë kosovar. Këto vrasje kryhen

për motive të hakmarrjes, që konsiston në vrasjen e anëtarëve të tjerë të familjes, vrasjen e shumë personave, hakmarrja pas pajtimit ose vrasja gjatë kohës së besës etj. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me veprimet konkrete të autorit i cili i kryen me vetëdije të plotë dhe e dëshiron pasojën.

Vrasja e nëpunësve publikë gjatë kohës së ushtrimit të detyrës (e policëve, doganierëve, guardianëve, gjyqëtarëve, prokurorëve, ushtarakëve etj) konsiderohet vrasje e cilësuar e cila kryhet me vetëdije, me qëllim dhe me dëshirën e plotë të autorit.

Vrasja e dy ose më tepër personave gjithashtu konsiderohet vrasje e cilësuar.

Vrasja e kryer nga personi i cili më parë ka qenë i dënuar për vepër penale të vrasjes paraqet një vrasje tjetër të cilësuar. Sipas kësaj del se kemi të bëjmë me një autor recidiv i cili i shtyrë nga motive të ndryshme kryen edhe një vrasje të re.

2.5. Rregullimi juridik - penal i vrasjeve pas Shpalljes së Pavarësisë

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, është nxjerrë Ligji Nr. 03/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës në të cilin janë parashikuar vetëm dy nene. Me nenin 1 ndryshohet vetëm titulli i kodit, ndryshohet dhe zëvendësohet në Kodi Penal i Kosovës ndërsa në nenin 2 parashikohet pranimi i fajësisë dhe klauzola për uljen e dënimit ose caktimin e një dënimi më të butë nga ana e gjykatës. Në pjesën normative përveç disa ndryshimeve të vogla në emërtim (psh vrasja e çastit emërtohet vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore) dhe rritja e dënimit kapital për disa vepra të rënda penale të vrasjes (denimi i përjetshëm) pjesa tjetër e këtij kapitulli mbetet e pandryshuar. Risi në Kodin Penal janë dy vepra penale Hakmarrja (neni 396) dhe Vetëgjyqësia (neni 418) të cilat bëjnë pjesë në kapitullin e veprave penale kundër Administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Sipas ligjvënësit, autor i veprës penale të hakmarrjes janë personat zyrtarë, personat përgjegjës dhe persona të tjerë fizikë. Inkriminimi i hakmarrjes si vepër e re penale përfshinë mbrojtjen e jetës nga një game e gjërë e veprimeve të motivuara nga hakmarrja të cilat mund të jenë nga më të ndryshmet (psh. vrasje që lidhen me punën, ndërrimin e vendit të punës, largimin nga puna, uljen e pagës, dhënja e informatave organeve të rendit për zbardhjen e veprës penale ose dhënja e informatave administratës tatimore ose policisë gjyqësore për kryerjen e transaksioneve të ndryshme të paligjshme etj). Në aspektin subjektiv, kjo vepër duhet të kryhet me dashje dhe me qëllim të hakmarrjes ndaj të dëmtuarit.

Ndërsa në kuadër të veprave penale kundër rendit publik është paraqitur si vepër e re penale “Vetëgjyqësia” (neni 418) me objekt mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të cilat

janë të cënuara nga arbitrariteti i personave të ndryshëm fizik. Kjo vepër mund të kryhet nga kushdo i cili, përkundër realizimit të kërkesave të tij përmes organeve gjyqësore dhe administrative, në mënyrë arbitrare, me dashje dhe me përdorimin e forcës kërkon realizimin e të drejtave të supozuara. Me të drejtë është konstatuar se inkriminimi i vepres penale të hakmarrjes është i panevojshëm sepse veprimet e tilla janë të inkriminuara në vepren penale “Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare” (neni 394 i KPK) dhe në vepren penale të vrasjes së rëndë (neni 178 pa1.8 dhe 1.9). (KPK, 2008).

Kapitulli III: Rrethanat shoqërore historike në Kosovë dhe terrorizmi shtetëror serbo-jugosllav

Të gjitha shtetet, në aktet më të larta juridike, në kushtetutë dhe në ligjet e tyre i kushtojnë rendësi parësore mbrojtjes së jetës së shtetasve të tyre. Megjithatë, shtetet dhe regjimet e ndryshme anë e mbanë globit shpesh herë “harrojnë” këto akte të shkruara dhe për arsye të ndryshme politike ndërmarrin akte represive kundër qytetarëve të vetë të cilat konsiderohen edhe akte të terrorizmit shtetëror. (Halili, Kriminologjia me Penologji, 1995, f:91). Vrasjet e tilla udhëhiqen nga shteti dhe kryhen nga grupe të caktuara legale dhe gjysmëlegale (shërbimi sekret, grupe të caktuara paramilitare dhe militare) për qëllime të ndryshme politike. Lidhur me këtë problem duhet përmendur autori Thomas A. Petee i cili vrasjet masive i cilëson edhe vrasje me elemente të terrorizmit. Lidhur me këtë ai shkruan:

“Zakonisht vrasjet masive janë të motivuara politikisht me elemente të terrorizmit. Motivimi së pari është ideologjik dhe me një kauzë të përcaktuar politike – ndoshta me lidhje religjioze – ose për ndryshime politike” (Petee, 2000).

Ndërsa profesor Rudolph J. Rummel vrasjet masive të cilat në vetëvete përfshijnë vrasjen e një personi ose grupi a një pjese të një populli nga qeveria e tij duke përfshirë vrasjet politike dhe gjenocidin, i quan vrasje nga qeveria (death by government).

Duke iu referuar konstatimit të profesor Rummel-it se shteti ekzekuton shtetasit e vetë në mënyrë masive dhe të kundërligjshme, mund të konstatojmë se Serbia dhe Mali i Zi, për plot 87-të vjet të sundimit të Kosovës bashkërisht kanë kryer krime masive kundër popullatës civile shqiptare përkundër të drejtave të garantuara ndërkombëtarisht me nenin 27 dhe 35 të Konventës së Berlinit të datës 13 qershor 1878. (Lluka, 2014, f:184-188)

Lidhur me terrorin e ushtruar nga këto dy vende ndaj shqiptarëve dhe eliminimit të tyre nga jeta politike, vlen të përmendet konstatimi i autores serbe Dubravka Stojanović e cila shkruan:

“Gjatë dy shekujsh përpjekjesh për “liri dhe bashkim të popullit serb” për krijimin e shtetit të madh nacional, udhëheqësit serb nuk arriten që në këto rajone (Kosovë-konstatim yni) të qeverisin në atë mënyrë që këta banorë të rinj, (shqiptarët-konstatim yni) këtë shtet ta pranojnë si të tyre”. (Stojanovic, 2010, f:271).

3.1. Terrorizmi malazez ndaj popullsisë civile shqiptare pas nënshkrimit të “Kontratës së Shtupeqit”

Vrasjet për arritjen e qëllimeve politike dhe të kryera drejtpërdrejtë nga pushteti shtetëror malazez kanë filluar menjëherë pas hyrjes në Pejë të ushtrisë malazeze me 16 tetor 1912. Edhe pse delegacionet malazeze dhe ato të qytetit të Pejës për dorëzimin e qytetit kishin nënshkruar një Marrëveshje mes tyre (e njohur si Marrëveshja e Shtupeçit-fshati ku ishte nënshkruar marrëveshja), për respektim të dyanshëm dhe mospërdorim të dhunës, represaljet malazeze ndaj popullsisë civile fillojnë menjëherë pas hyrjes në qytet. Ndërmarrjen e këtij terrori, zyrtarët ushtarak e arsyetonin me vendosjen e rendit dhe qetësisë edhe pse qyteti ishte dorëzuar pa dhunë. Si rezultat i këtyre masave i cili ushtrohej nga pushteti okupues malazez, shumë burra kishin dal (kaçak) në mal. Në rrethana të tilla, ushtria, xhandarët dhe zyrtarët publikë ishin të autorizuar që të vrisnin kudo dhe këdo që kapej me armë.

Presioni politik, kombëtar (për shpërngulje masive) dhe fetar (për ndërrimin e fesë), kolonizimi i viseve të Dukagjinit me element serb e malazez ishin politika kryesore e zbatuar nga pushtuesit e rinj e cila bëhëj me qëllim të ndërrimit të strukturës kombëtare dhe fetare. (Folic, 2013); (Krasniqi, 1984, f:29).

Në këtë dhunë ushtarake ishte angazhuar edhe kleri dhe kisha serbe e cila bënte një propagandë të jashtëzakonshme për konvertim. Ata që nuk pranonin të konvertoheshin në fenë ortodokse vriteshin pa mëshirë edhe në prezencën e familjarëve dhe bashkëfshatarëve të tyre. Ky konvertim nuk kërkohet vetëm nga popullsia shqiptare e besimit islam por ai kërkohet edhe nga popullsia shqiptare e besimit katolik. Si rezultat i këtij kundërshtimi ishin vrarë me qindra qytetarë shqiptarë të të dyja besimeve. Vlenë të përmendet rasti i At Luigj Palaj, një meshtar katolik me shërbim në Kishën Katolike në Glllogjan të Pejës të cilin xhandaret malazez e kishin kapur në fshatin Janosh të Gjakovës, e kishin torturuar me qëllim që ai të pranonte konvertimin në fenë ortodokse. Pas dy ditë torturash, ai qëndron i pa lëkundur ndaj besimit të të parëve të tij katolik, i'a presin dy gishtërinj, por prapë nuk arrijnë ta thyejnë qëndresën e tij dhe më në fund e therin me bajonetë. (Cana, 1996, f:40).

Sipas të dhënave, ky terrorizëm shtetëror aplikohet kundër shqiptarëve me aprovimin e strukturave të larta nga Cetina. Se si ka funksionuar kjo formë e ekzekutimit flet një dëshmitar i rastit i cili ka qenë pjesë e këtij terrori. Sipas të dhënave që jep autori Cana, për ekzekutimin e civilëve shqiptarë, organizoheshin gjyqe “ad hoc” në krye të të cilit ishte Sava Lazareviq – me profesion bujk dhe shef i policisë në Pejë. Këto gjyqe “ad

hoc” formoheshin kudo që e kërkonte nevoja dhe anëtar të këtyre gjyqeve ishin vet ekzekutuesit, pa ndjekur kurrfarë procedure. Procedura që ata ndiqnin ishte e thjeshtë. Ja si e përshkruan një ushtar malazez funksionimin e këtyre gjyqeve:

„Shkonim nëpër fshatra, ku mund të kishim komoditet për zhvillimin e hetimeve dhe mbajtjen e gjykimeve formale. Tek e mbramja as që kishim nevojë ta bënim këtë, sepse provat për gjykimim e tyre me vdekje ishin momentalisht para nesh, qëndronin veprat, në të cilat ishin zënë. Për shembull, kur pas gjithë atyre urdhëresave – me kërcnim me vdekje dhe kur pas nënshkrimeve tek unë dhe zyrtari krahinor i gjenim pushkët tek individët, atëherë nuk kishte nevojë as për hetime as për aktgjykime, por ata i nxjerrnim (përjashta) dhe i pushkatonim menjëherë në vend” (Cana, 1996a, f:251-254).

Për vrasjet masive dhe ekzekutimet e civilëve shqipëtar të kryera në zonat e Plavës, Gucisë e deri në Pejë, ku nuk kishin lenë “asnjë hundë pa ua prerë kufomave” dhe ku kishin përdorur metodën e “varrosjes së viktimave të gjalla” kishte shkruar edhe autori Cohen (Cohen, 1997, f:36).

„Metodat e përdorura kundrejt qytetarëve ishin mjaft të rënda. Disa i fusnin në ujë të ftohtë akull e pastaj i hidhnin në zjarr, të tjerët goditeshin në organet gjenitale me strajcën e mbushur me rërë, goditja me çekan në boshtin kurrizor, goditje e cila shkaktonte menjëherë invaliditet të rëndë në mos edhe vdekjen e viktimës, djegia në stufën e skuqur, gjymtimi dhe vrasja me bajontë, e deri të ekzekutimi me një “prerje të vogël në nyje të duarve, në bërryla dhe në fyt më qëllim që vdekja t’iu zgjat sa më shumë”. (Cohen, 1997a, f:37)

Më qëllim të përfitimit material, ndëshkimit dhe varfërimit të popullsisë vëndase, zyrtarët malazez, me aprovimin e Cetinës, në prill 1913 kishin formuar një komision për pajtimin e “vllazërive të ngatërruara” dhe të atyre që ishin në gjak në përbërje të të cilit komision ishte një serb dhe një shqiptar. Ky komision kishte filluar punën me datën 21.IV.1913 nën kryesinë e Teodor Gashiqit, një serb nga Peja dhe Ejup Beu nga Peja nënkryetar, ku ishte vendosur çmimi që duhej të paguhej për gjaqe dhe ngatërresa dhe kishte efekt retroaktiv.

Ky komision kishte caktuar çmimin e gjakut që ishte 1,200 perper (monedhë e Malit të Zi), plaga e sakatit ishte caktuar 600 perper, plaga e shëruar 300 perper ndërsa për rrahje ishte caktuar shuma prej 400 perper.

Ai që vritej në punë të ligë natën në shtëpinë e huaj shkonte gjakhupës, për të gjitha

gjaqet ishte caktuar një çmim pa marr parasysh kombësinë. Çmimi i gjakut ishte caktuar të paguhej në tre këste, plaga dhe vrasja e shkaktuar nga fëmijët llogaritej për gjysmë çmimi. Qëllimi i formimit të këtij komisioni ishte që të rishqyrtoheshin edhe ato çështje që dikur ishin shqyrtuar nga gjykatat turke në Pejë dhe për të cilat kërkohej dëmshpërblimi. Pas rreth dy muajsh ky komision kishte pushuar së funksionuari sepse kishin filluar ankesat nga vet serbët vendas ndaj veprimeve korruptuese të këtij komisioni. (Cana, 1996b, f:347)

Në anën tjetër të Rrafshit të Dukagjinit, përtej lumit Krena në Gjakovë, që ishte një kufi natyral, Serbia kishte shtrirë pushtetin e saj ushtarak, duke përdorur të njejtin terror shtetëror kundër shqiptarëve nga Gjakova deri në Kerçovë e Shkup. Për terrorin shtetëror serb ka shkruar edhe Dimitrije Tuceviq duke i quajtur këto zona “krematorium barbar në të cilin ishin djegur me qindra gra e fëmijë të gjallë”. (Tucovic, 1946, f:52). Ndërsa gazeta prestigjioze amerikane “The New York Times” të datës 31 dhjetor 1912 në artikullin e saj me titull “Ushtria serbe lë gjurmë gjaku” mes të tjerash shkruan: “në mes Kumanovës dhe Shkupit janë vrarë 3,000 veta. Afër Prishtinës 5,000 ekskluzivisht shqiptarë të cilët kishin rënë në duar të serbëve ...”. Po kjo gazetë njohton se ushtria serbe kishte zbatuar metodat më barbare duke djegur fshatra të tërë, duke vrarë burrat në prani të grave të tyre dhe duke therë me bajoneta fëmijët në prezencën e nënave të tyre. Kjo kasaphane kishte përfshirë Sjenicën dhe pjesë të Maqedonisë. (The New York Times, 1912).




Figura 1. Terrorizmi shtetëror serb në vitin 1912 në Kosovë (*Burimi i të dhënave: Gazeta The New York Times, e publikuar me 31 dhjetor, 1912*).

Edhe Lav Trocki, një gazetar rus përshkruan tmerret e masakrat e kryera nga ushtria serbe gjatë luftrave ballkanike kundër popullsisë shqiptare. Ai i përshkruan ushtarët serb si plaçkitës dhe vrasës gjakëftohetë të cilët vrisnin burrat në prezencën e fëmijëve dhe

grave të tyre, plaçkitnin çdo gjë dhe më pas i digjinin shtëpitë e tyre. Këto tmerre, vrasje, djegie e plaçkitje i bënë edhe ndaj popullsisë turke dhe hebrenjve të cilët ishin gjetur atë kohë në qytetin e Shkupit. (Trocky, 2002).

Sipas autorit kroat, Branko Horvat “oficerët serb të dehur nga fitorja, nxorën një konkluzion së mënyra më e mirë për pacifikimin e Shqipërisë është asgjësimi i plotë i shqiptarëve” duke vrarë mes 12,000-25,000 shqiptarë, trupat e të cilëve notonin nën urën kryesore të lumit të Vardarit. (Horvat, 1989, f:58-59).

Në prag të luftimeve ballkanike pushteti i mbretërisë serbe, përmes një proklamate publike, i ishte drejtuar publikisht shqiptarëve duke iu premtuar respektimin e të drejtave kombëtare, fetare, kulturore dhe politike, por në terren, ushtria, dhe çetat çetnike serbe kryenin krimet më makabre kundër popullsisë civile shqiptare. (Peter, 1913). Ky gjenocid dhe spastrim etnik zgjati afërsisht një vit pas të cilit, kralji serb nxjerr një Dekretligj (33 nene, 21 shtator 1913) i cili aplikohet vetëm në territorin e viseve të aneksuara të Kosovës dhe Maqedonisë. Me këtë Dekretligj pezullohet Kodi Penal Serb (1860) dhe hyn në fuqi edhe Ligji për ndjekjen dhe shkatërrimin e banditëve (8 Gusht 1913). Me këtë dekretligj, i jepen autorizime të pa kufizuara forcave të xhandarmërisë (neni 1) të cilët kishin fuqi ekzekutive dhe gjyqësore, sepse mjaftonte vendimi i xhandarmërisë që dikush të shpallej fajtor apo i rebeluar. Nëse të rebeluarit (kaçakët) kundër pushtetit nuk ktheheshin në shtëpi mbrenda 10 ditëve, ai mund të vritej nga çdo zyrtar publik ose ushtarak (neni 2). Përveç pasojave individuale që pësonin personat e nxjerrë jashtë “ligji”, edhe familjet e tyre i nënshtroheshin masave të rënda të humbjes së pasurisë dhe deportimit të tyre në zona të caktuara. (neni 3)

Sipas këtij dekretligji, kryetari i komunës ishte autoriteti kryesor mbi forcat e rendit dhe ishte autoritet gjyqësor i cili kishte të drejtë të caktonte dënime deri në 3 vjet burgim dhe dënime me gjobë deri në 1000 dinar. (neni 26)

Në emër të ruajtjes së rendit dhe sigurisë, me këtë Dekretligji, Kodi Penal serb nuk prodhonte më efekte juridike, ndërsa terrori shtetëror kundrejt popullsisë civile shqiptare dhe të tjerëve në viset e aneksuara kishte marrë përmasat e genocidit. Ky terror kundër banorëve shkupjanë kishte filluar në emër të aksionit për mbledhjen e armëve dhe dëbimin nga shtëpitë e tyre. Personat që kapeshin në shtëpi i dërgonin para një lloji gjyqi i cili udhëhiqej nga majori serb Gërbiq. Gërbiq kishte formuar një komision, anëtarët e të cilit duheshin të deklaroheshin para tij për secilin personse:

“A është i mirë apo i keq? Nuk kishte diskutime, nuk bëhej fjalë për mbrojtje”.

Dhe “një në dhjetë persona që ishin të thirrur i shpëtonte dënimit me vdekje. Viktimave gjysmë të zhveshur dhe të lidhur, ju merreshin paratë e gjetura tek ata dhe në prezencën e komisionit i merrte Major Gerbiq. Myslimanët e dënuar ishin lidhur në pemë, dërgoheshin në thërtore (slaughter house) dhe vriteshin, në disa raste pas torturimit dhe gjymtimit”. (Carnegie Endowment for International Peace, 1914, f:74, 160-162).

Disa nga të dyshuarit e paguanin lirinë e tyre për të jetuar duke paguar deri në 100 funta dhe me rastin e blerjes së lirisë për të jetuar, atyre i'u lëshohej “çertifikata që i lejohej të jetojë”.

3.2. Terrorizmi shtetëror nën Mbretërinë Serbo- Kroato-Slllovene mbi shqiptarët (1918-1941)

Pas luftës së Parë Botërore, në Konferencën e Versajës iu mundësua zgjerimi i MSKS (1 dhjetor 1918) me marrëveshjen e 28 korrikut 1919. Neni 2 i kësaj marrëveshje garantonte të drejtat kombëtare, pa marrë parasysh “prejardhjen, gjuhën racën ose fenë”. Duhet thënë se edhe në këtë konferencë, Serbia u përkrah hapur nga disa vende europiane të cilat kishin pranuar kundërshtimin e delegacionit serb (5 nëntor 1919) i cili kishte kërkuar riformulim të këtij neni, i cili pas riformulimit thotë: “Rregullat sipas këtij neni vlejnë vetëm për ato territore të cilat iu janë ndarë Serbisë pas datës 1 janar 1913” (Časopis kritiko znanosti, 1989, f:47). Edhe në këtë konferencë, ishte dëshmuar se Serbia gëzonte një përkrahje europiane në politikën e saj që aplikonte genocidin kundër shqiptarëve në ballkan, pavarësisht se çfarë shkruhej në marrëveshje. Pas shtrirjes së autoritetit të saj në Kosovë, Serbia, fillon masakrat që ende mbahen mend nga banorët e Rugovës, të datës 16 shkurt 1919, ku ishin ekzekutuar pa gjyq 842 banorë të saj të moshave prej 1 deri 100 vjeç. (Elsie, 2009). Naçelnikët serb të vendosur anembanë viseve të aneksuara, vrisnin këdo që mendonin se ishte i rrezikshëm për sigurinë e vendit dhe që shumë njerëz ishin detyruar t'i kundërvihen me armë këtij regjimi dhe kështu lindi Lëvizja Kaçake. (Elsie, 2002, f:47-96).

Shtypi serb i kohës shkruante se Lëvizja Kaçake udhëhiqej nga Komiteti për Mbrojtjen e Kosovës, posaçërisht nga qeveria e Tiranës e cila kishte infiltruar oficer karriere të cilët ishin në kontakt të drejtëpërdrejtë me Hasan Prishtinën, Azem Bejtës, etj. (Jovanović, 2007, f:9). Terrorizmit shtetëror serb, pas vitit 1912 e deri në vitin 1929, i kundërvihet Lëvizja Kaçake e cila me vrasjen e Azem Galicës, në Drenicë (16 qershor 1924) ishte dobësuar shumë. (Gazeta Vreme, 1924). Për luftimin e çetave kaçake, MSKS-ja përveç ushtrisë dhe xhandarmërisë kishte organizuar edhe “20 formacione

fluturuese” siç i quanin ata formacionet e armatosura të cilët menaxhoheshin nga naçelnikët e qarqeve me detyrë eliminimin dhe shtypjen me forcë të Lëvizjes Kaçake. Ky numër i këtyre formacioneve të armatosura arrinte shifrën prej 8,000 vetash plus 25,000 veta të angazhuar, 40,000 trupa ushtarake dhe 10,800 xhandarë. Nga viti 1925, ky numër kishte aritur shifrën prej 21.000 vetash. (Jovanoviq, 2007a, f:12). Sipas të njëjtit autor del se në dy vitet e para të MSKS-së ishin vrarë 742 civil, shkatërruar 50 xhami, ishin djegur 6,344 shtëpi në 132 fshatra dhe ishin detyruar të dalin kaçak 55,068 veta. Sipas këtij autori nga viti 1919-1929 ishin kryer 1,500 vrasje politike mes të cilëve rreth 300 veta ishin njerëz me autoritet. (Jovanoviq, 2007b, f:14-16). Sipas këtij autori, kryetarët e qarqeve, organizonin vrasje të tilla politike siç është rasti i vrasjes së deputetit federativ Nazmi Gafurri (1927) dhe vrasja e organizuar e mësuesit, priftit dhe kodifikuesit të Kanunit të Lekë Dukagjinit, At Shtjefën Gjeçovin (1929) nga një pusi në fshatin Krajë, të Prizrenit nga kryetari i komunës së Prizrenit, Bozhoviqi. (Horvat, 1989a, f:70); (Malcom, 2011, f:350).

Sipas autorit Horvat “kaçakët nuk ishin produkt historik, por produkt i ngjarjeve të atëhershme” (Horvat, 1989b, f:63) të cilët ishin të detyruar të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe të bënin një rezistencë e cila i’u ishte imponuar nga dhuna shtetërore, gjendja e rëndë ekonomike, reforma agrare dhe kolonizimi. Sipas të dhënave që nga themelimi i MSKS-së, në kuadër të ashtuquajturës reformë agrare deri në vitin 1931, në Kosovë ishin vendosur 12.000 familje koloniste shumica nga Mali i Zi dhe nga Serbia të shpërndarë në 374 vendbanime të pastra sllave. Vetëm në territorin e Pejës, nga viti 1919-1939, ishin marr 9674 hektarë tokë e shqiptarëve, tokë e kaçakëve e cila i’u ishte dhënë kolonistëve. Sipas një raporti të datës 11. XI. 1940, në territorin e Pejës, Mitrovicës, Ferizajit, Shkupit dhe Prizrenit ishin marr për llogari të reformës agrare me qendër në Shkup 381.245 ha tokë dhe ishin ndërtuar 15.943 shtëpi për kolonistë. (Jovanoviq, 2006, f:27,39).

Sipas autorëve Bieber & Daskalovski “nga dhuna serbe për në Turqi gjatë periudhës 1912-1941 ishin deportuar rreth 300.000 mijë shqiptarë dhe në tokat e tyre ishin vendosur 14.000 familje serbe (...) duke rënë numri i shqiptarëve nga 90% sa ishte në vitin 1912 në 70% në vitin 1941”. Më poshtë këta autorë japin të dhëna të cilat korrespondojnë mes viteve 1918-1938 mbi aktivitetin e djegieve të 320 fshatrave shqiptarë nga ushtria serbe dhe vrasjen e 12.346 shqiptarëve dhe burgosjen e 22.160 të tjerëve në burgjet serbe dhe djegijen e 6.125 shtëpive të tyre. (Bieber & Daskalovski, 2003, f:17). Ky terrorizëm shtetëror nuk ushtrohej vetëm ndaj shqiptarëve por edhe ndaj

atyre që ndihmonin shqiptarët. Kështu me datën 18 shkurt 1931, agjenti serb Nikolla Jukiq, pjestar i një organizate terroriste serbe, me urdhërin e komandantit të ushtrisë serbe në Zagreb, gjeneralit Bela Markoviq, vret mu në mes të Zagrebit, historianin kroat Millan Shuflaj i cili kishte shkruar një libër për historinë e Shqipërisë. (Cohen, 1997b, f:40).

Sipas autorit Noel Malcom – “deri në vitin 1921 nga pushteti serb ishin vrarë 12.371 shqiptarë, ishin burgosur 22.110 veta dhe ishin djegur 6.000 shtëpi”. Për vrasjet e pas luftës së dytë botërore, edhe pse ky autor mendon se statistikat janë të ekzagjeruara, nga komunistët e Jugosllavisë deri në vitin 1950, janë vrarë “në betejë ose të pushkatuar” 47.300 shqiptarë, nga të cilët 28.700 vetëm nga Kosova. Duke i’u referuar shifrave serbe dhe kroate rreth numrit të të vrarëve shqiptarë ai kap shifrën 10.000 – 24.000 të vrarë shqiptarë që i referohen statistikave të vitit 1941-1945. (Malcom, 2011a, f:358, 296). Ndërsa autori Rumel në veprën e tij “Death by Government” në kapitullin “Kasaphanja e Titos (**Tito’s Slaughterhouse**) shkruan se në Jugosllavinë e Titos janë vrarë 50.000 shqiptarë por duke mos e precizuar saktë periudhën kohore. (Rummel, 1994, f:361).

3.3. Vrasjet gjatë periudhës së sundimit të Titos në Jugosllavi(1945-1981)

Përkundër rregullativës ligjore, në Jugosllavinë e Titos shërbimi sekret jugosllav (OZN-ja) bënte politikën dhe ligjin. Kundër kësaj praktike terroriste të kësaj organizate policore kishte reaguar njëri ndër udhëheqësit e Kosovës, malaziasi Milladin Popoviq i cili, 33 ditë pas këtij reagimi vritet në zyrën e tij në Prishtinë, me datën 13 mars 1945, rreth orës 10:30 të mengjesit. (Horvat, 1989c, f:77). Për këtë vrasje ngarkohet dhe ekzekutohet mësuesi gjakovar Haki Taha, i cili sipas dëshmive të vitit 1985, nga një bashkëkohës i Milladinit, vrasësi i tij nuk ishte mësuesi gjakovar por Spasoje Gjakoviq (shef i atëhershëm i OZN-s për Kosovë) dhe ishte kryer me urdhër të ministrit të brendshëm të Jugosllavisë Aleksander Rankoviq. (Bytyqi, 2009, f:112-113).

Ndër të ekzekutuarit nga OZN-a janë edhe shumica prej 15 anëtarëve të delegacionit shqiptar të Kosovës i cili kishte marr pjesë në takim me Titon me 6 prill 1945 në Beograd. Si duket shkaku i ndjekjeve dhe eliminimit të shumicës prej tyre (9 anëtarë të këtij delegacioni ishin likuiduar në ndërkohë) ishin kërkesat politike për zgjidhjen e çështjes së Kosovës që ata i kishin parashtruar Mareshalit Tito. (Časopis za kritiko znanosti, 1989a, f:25); (Bajrami, 2002, f:113-120); (Horvat, 1989d, f:26). Ky shërbim, menjëherë pas çlirimit të vendit kishte hartuar një listë për familjet në hasmëri me qëllim që të nxisnin vrasjet gjegjësisht gjakmarrjet mes tyre. Në këto “lista të zeza” për

likuidim fizik ishin të shënuar 782 veta, kishte planifikuar vrasjen e 297 shqiptarëve nga rrethi i Mitrovicës, 326 vetave nga rrethi i Llapit dhe 248 vetave nga Rrethi i Vushtrrisë. Eleminimi i tyre duhej të bëhej me faza kështu që në fazën e parë (1945) kishin evidentuar eleminimin e 41 familjeve të nacional demokratëve shqiptar. Në fazën e dytë (1946) kishin në evidencë eleminimin e 78 familjeve nga të gjitha trevat shqiptare të Kosovës dhe e të dy besimeve fetare (islame dhe katolike). Në fazën e tretë ishin të evidentuar për likuidim 89 familje. Këto familje ishin të personaliteteve të shquara të kohës si familja e Qamil Luzhës (ishte njëri ndër 15 delegatët që kishin marr pjesë në takim me Titon me 6 prill 1945) dhe familja e Ibrahim Fehmiut (babai i aktorit të famshëm Bekim Fehmiu, etj). (Bajrami, 2002a, f:120, 174-180, 210-213).

Përveç listave për likuidim, ekzistonin edhe listat e veçanta për ndjekjen e mësuesëve anë e mbanë Kosovës. Në këtë listë ishin të evidentuar mësuesit që nuk cilësosheshin të sigurtë, reaksionarë, nacionalistë dhe armiqësor. Pastaj, sipas kësaj liste, shërbimi sekret serb, disa i kishte regjistruar në listat e arrestimit ndërsa disa të tjerë i kishte larguar nga puna. (Kojcini- Ukaj, 1997, f:117-124).

Përveç kësaj forme të terrorit, pushteti jugosllav, në fillim të vitit 1945, në qytete të ndryshme të Kosovës dhe Maqedonisë kishte filluar me organizimin e proceseve të montuara gjyqësore. Kështu, në Gjykatën e Prizrenit akuzohen 34 veta për veprimtari armiqësore, nga të cilët 6 veta dënohen me burgim me vdekje, ndërsa të tjerët me dënime afatgjatë ndër të cilët edhe Marije Shllaku një intelektuale e shquar. Në procesin e dytë të Prizrenit i mbajtur në qershor – korrik, akuzohen 29 veta nga të cilët 4 veta dënohen me vdekje, ndërsa të tjerët me dënime afatgjata. Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë (1947) dënohen 15 veta nga të cilët 4 me vdekje, (ndër të cilët edhe Gjon Sereqi), 6 veta dënohen me dënime afatgjata ndërsa 5 lirohen nga përgjegjësia penale. Në Gjykatën e Qarkut në Gjilan (1947) dënohen 38 veta nga të cilët njëri me vdekje, 31 të tjerë me burgim afatgjatë, ndërsa 6 veta lirohen nga përgjegjësia penale. Në Gjykatën e Qarkut të Shkupit (1947) dënohen 19 shqiptarë nga të cilët 4 dënohen me vdekje (njërit i zëvendësohet ky dënim me 20 vjet heqje lirie, ndërsa të tjerët dënohen me burgim afatgjatë. Kjo valë e arrestimeve dhe gjykimeve drakonike nga gjykatat e instaluar në Kosovë fillon për të dytën herë në fillim të vitit 1950. Këto gjykime ishin mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ku ishin akuzuar 15 veta, nga të cilët 11 veta dënohen me burgime aftagjata derisa 4 veta lirohen nga përgjegjësia penale. Krahas kësaj në Gjykatën e Qarkut në Prizren gjykohen 19 veta nga të cilët, kjo gjykatë i shpall

të gjithë fajtor dhe i dënon me burgim afatgjatë. Personat e dënuar për “veprimtari armiqsore”, “mbi 436 persona” mes të cilëve shumë intelektual shqiptar kishin përfunduar në burgun famëkeq jugosllav “Goli Otok” në Kroaci. (Bytyqi, 2009a, f:178).

Përveç ndjekjeve për veprimtari armiqësore kundër shtetit, shqiptarët përndiqeshin përshtak se kundërshtonin regjistrimin e tyre në qytetar “turq”. Kjo lojë e pushtetit serb dhe jugosllav kishte prapavijë politike me qëllim të realizimit të Marrëveshjes Gjentelmene mes Jugosllavisë dhe Republikës Turke të vitit 1953 për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Të përndjekur nga UDB-a ishin edhe ata që agjitojnë kundër ndryshimit me forcë të kombësisë dhe regjistrimit të shqiptarëve si “turq”. Sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë të vitit 1948, në Kosovë kishte gjithsej vetëm 1.315 turq, ndërsa ky numër përmes formave të ndryshme të presionit, në vitin 1953 kishte arritur në 34.583. Përmes dhunës dhe makinacioneve të pushtetit ky numër i qytetarëve të “deklaruar si turq” në nivel vendi (Kosovë, Mali i Zi, Sanxhak, Maqedoni) në vitin 1966 kishte arritur në 246,000 veta. (Malcom, 2011b, f:407).

Në vazhden e terrorit shtetëror, në vitin 1956, UDB-a shpik “aksionin për mbledhjen e armëve” duke marr preteks vrasjen e pandriçuar të kryetarit të komunës së Vrellës, Rrethi i Istogut (Bajrami, 2015, f:229).

Për “Aksionin e mbledhjes së armëve” në Kosovë, autori Noel Malcolm shkruante “...popullata shqiptare filloj të shikohej si çerdhe potenciale e përfaqësuesve të kolonës së pestë e të tradhtarëve. Një shenjë të kësaj politike, në mes të viteve '50 ishte edhe shtimi i obsesionit për kërkimin e armëve nga shqiptarët e Kosovës: fshatra të tëra më parë rrethoheshin nga kordonë të policisë, banorët merreshin në pyetje dhe rriheshin në polici” (Malcom, 2011c, f:405).

Përveç qytetarëve që i ishin nënshtruar një terrori të paparë, edhe zyrtarë të lartë partiak dhe shtetëror shqiptar ishin objekt i përgjimeve dhe përndjekjeve ku ishin hapur rreth 900 dosje hetimore. (Bajrami, 2015a, f:186). Sipas autorit Abdullah A. Bytyqi numri i dosjeve të krijuara nga UDB-ja përfshinte 21.798 intelektual shqiptar, 220 dosje të udhëheqësve politik dhe 4 dosje të funksionarëve shqiptar në federatën jugosllave. (Bytyqi, 2009b, f:181). Në kuadër të kësaj përndjekjeje nga sigurimi i shtetit, në Prizren (1956) ishte kurditur një proces i montuar politik ku ishin të përfshirë intelektual të ndryshëm, politikan të cilët ishin dënuar me burgime afatgjata. Ky aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Prizren ishte anuluar pas rënjes së ministrit të brendshëm Ranković në

vitin 1966. (Bajrami, 2015b, f:142, 144, 209).

Në listën e UDB-së, përveç familjeve të hasmëri ishin edhe elita politike dhe kulturore shqiptare e kohës kundër të cilëve ishin krijuar mbi 50.000 dosje. Në këtë kuadër ishin formuar 900 dosje të udhëheqësve politik të nivelit lokal, krahinor, republikan dhe federativ. Dhuna dhe terrori i këtij shërbimi kishte sjell edhe vrasjet e qytetarëve të pafajshëm shqipëtar. Kështu, UDB-ja në Prizren kishte vrarë 8 qytetarë, në Gjakovë 19 veta, në Vushtrri 6 veta derisa ishin kryer edhe dy vetëvrasjeve. Një mësues ishte thirrë për bisedë informative në polici, ishte keqtrajtuar fizikisht dhe më pas nga plagët e shkaktuara kishte vdekur. Kufoma ishte vendosur në arkivol dhe i ishte dorëzuar familjes duke i'u thënë se kishte vdekur nga një sëmundje ngjitëse, me porosi që arkivoli të mos hapej. Në fshatin Hereq të Deçanit kishin vrarë kryetarin e rinisë dhe më pas, kufomën e kishin gjuajtur në bunar (pus) ndërsa rastin e kishin shpall si vetëvrasje. Në vazhden e krimeve dhe ekzekutimeve pa gjyq, duhet përmendur vrasjen e mësuesit Fazli Grajqevci i cili kishte vdekur sa ishte nën arrest policor dhe ishte lëshuar me diagnozë se gjeja kishte vdekur nga sulmi kardiak. Dhunën fizike dhe psikike, pjesëtarët e UDB-së e kishin orientuar kundër rinisë, nxënësëve, studentëve dhe studenteve shqiptare të cilat fillimisht i akuzonin për veprimtari anmiqësore e pastaj abuzonin seksualisht me to. (Casopis kritiko znanosti, 1989b, f:78, 83, 84, 89); (Bajrami, 2015c, f:163). Në suaza të specialitetit agjenturor, UDB-ja ishte e përfshirë edhe në vrasje të personave me autoritet dhe më pastaj i denonconin kryesit – bashkëpuntorët e tyre me qëllim të nxitjes së gjakmarrjes. Një veprim të ngjashëm, UDB-ja e kishte aplikuar me rastin e vrasjes së një qytetari të fshatit Isniq të komunës së Deçanit i cili me vonë ka perfunduar me gjakmarrje. Ndër format më të rënda të abuzimit të pushtetit, ishte arrestimi nga ana e policisë i katër mësuesëve nga Istogu, të cilët gjatë kohës së natës i kishin nxjerr nga dhomat e paraburgimit të Pejës dhe i kishin dërguar në kufi me Shqipërinë e më pas i kishin ekzekutuar me preteks se kishin tentuar të kalonin ilegalisht kufirin Kosovë-Shqipëri. Ekzekutimet e tilla i arsyetonin me gjëja kapjen dhe likuidimin e kriminelëve të cilët kishin shkelur vijën e kufirit. Ndër format e përdorura të ekzekutimit ishte edhe vrasja e qytetarëve “të rrezikshëm” gjatë natës dhe hedhja e kufomës në puse uji me qëllim të fshehjes së krimit. (Bajrami, 2002b, f:107-109).

Ky shërbim merrej edhe me montimin e vrasjeve dhe më pastaj u'a veshte këto akte personave të tjerë të pafajshëm. Një rast i tillë kishte ndodhur në fshatin Lumbardh të Deçanit ku për një vrasje që kishte ndodhur në këtë fshat ishin ngarkuar padrejtësisht dhe ishin dënuar me 39 vite, katër vllazërit Lekaj nga po ky fshat. (Bajrami, 2002c,

f:157). Sipas të dhënave, gjatë përiudhës 10 vjeçare (1956-1966), nga torturat e ushtruara nga ky shërbim kishin vdekur 103 qytetar, kishin pësuar invaliditet të plotë (...) së paku 10.000 veta” ndërsa ishin shpërngulur për në Turqi 450.821 shqiptarë. (Bytyqi, 2009c, f:184).

Duke iu referuar periudhës së pas luftës së dytë Botërore deri në vitin 1948 që lidhet me terrorin që shërbimi sekret jugosllav kishte ushtruar kundër shtetasve të vet, autori amerikan Rumel shkuan se si ky shërbim kishte “... organizuar 220.000 gjykime, ndërsa në vitin 1949 edhe 160.000 kryesisht politikë” (Rummel, 1994a, f:356). Palët e përfshira në këto procese gjyqësore konsideroheshin si delikuentë politik dhe shumica nga ata kishin përfundur në burgun famëkeq Goli Otok të cilët, janë të rrallë (ata) që kanë dal nga ky burg me shëndet të plotë” (Rummel, 1994b, f:356).

Pas rënjes së Rankoviqit (Brione, 1966), forumet partiake në Kosovë kishin themeluar një komision për hetimin e keqpërdorimeve të kryera nga UDB-ja në Kosovë (1967/68). Nga të dhënat e grumbulluara nga komisioni shtetëror në Kosovë kishte filluar edhe procedimi penal kundër keqpërdorimeve në organet e Shërbimit të Sigurimit Shtetëror. Kështu Prokuroria Publike e Qarkut të Prishtinës kishte ushtruar 55 kallëzime penale kundër 130 zyrtarëve të UDB-së. Në prokuroritë Publike Komunale (Rrethin e Prishtinës, Gjilanit, Ferizajit dhe Mitrovicës) ishin ushtruar kallëzime penale për veprat penale: dëmtime të rënda trupore (neni 141 par 2 i KP-së), ishin paraqitur 70 kallëzime penale për veprën penale “dëmtime të rënda trupore me pasojë vdekjen” (neni 141 par 3 i KP-së), 44 kallëzime penale për veprën penale të „Vrasjes” (neni 135 i KP-së), 8 kallëzime penale për “Dëshmi të marrë me dhunë” (neni 151 par 2 i KP-së), 4 kallëzime penale për veprën penale “Privim i kundërligjshëm nga liria” (neni 150 par 5 i KP-së), 2 kallëzime penale për “Keqpërdorim të pozitës zyrtare” (neni 314 par 2 i KP-së). Sipas të dhënave që jep Bajrami nga këto 130 kallëzime të filluara në Prokuroritë publike komunale, 105 prej tyre ishin hedhur poshtë, ndërsa tjerat ishin në shqyrtin, ndërsa disa prej tyre hudhëshin poshtë me pretendimin se është bërë vjetërsimi i plotë i ndjekjes penale! Sipas prokurorisë së atëhershme, ndjekja penale kishte pushuar edhe ndaj 55 pjeshtarëve të UDB-së të cilët ishte dëshmuar se kanë marr pjesë në vrasje dhe likuidime gjatë viteve 1947-1948, me pretendimin se është bërë parashkrimi absolut i ndjekjes penale! Rasti me I rëndë ishte vrasja në burg e mësuesit Fazli Grajqevci i cili ishte mbajtur në burg pa dijenin e prokurorit publik i cili kishte pushuar hetimet me datën 8 gusht 1964, por ai nuk ishte lëshuar nga paraburgimi deri me datën 17 gusht 1964, kur

edhe vdes në ambientet e Burgut të Qarkut të Prishtinës. (Bajrami, 2015d, f:64, 278-279).

Në Prokurorinë Publike të Qarkut në Pejë, zyrtarisht ishin paraqitur 28 kallëzime penale kundër pjestarëve të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror (UDB-së), ndërsa 15 kallëzime penale i kishin parashtruar vet qytetarët e dëmtuar. Duhet cekur se në arkivin e Gjykatës së Qarkut në Pejë nuk kami arritur të gjejmë dosjet e kësaj priudhe kohore dhe nuk kemi mundësi të dëshmojmë të vërtetën, që sipas disa të dhënave, këto gjykime ishin një farsë. (Bajrami, 2015dh, f:289).

Për terrorin shtetëror qindvjeçar serb mbi shqiptarët, autorja serbe Dubravka Stojanoviq duke shkruar për pasionin e verbër nacionalist dhe pastrimin etnik të territorëve me “elemente të huaj” përkujton se “Pastrimi etnik dhe fetar i shtetit ishte qëllim opsesiv, i cili në vetëvete, si qëllim kryesor përbënte fshirjen e kombeve “tjera”, popujve me të cilin ndajmë të njejtën hapësirë”. Për realizimin e këtij qëllimi opsesiv, Serbia thotë autorja „...Janë të njohura rastet kur ushtria hynte në vendbanime, i ndante meshkujt nga gratë dhe fëmijët, i vriste, me radhë vetëm njërin nga këto grupe ose që të dyjat”. (Stojanovic, 2010a, f:137, 143, 265, 362).

3.3.1. Vrasjet për motive politike në Rajonin e Pejës (vrasjet e intelektualëve, ushtarëve dhe qytetarëve të thjeshtë)

Duke shikuar të kaluarën e zhvillimit ekonomik dhe politik të Kosovës nën sundimin jugosllav (1918-1974), periudha pas vitit 1974 karakterizohet me një zhvillim epokal në të gjitha sferat. Gjatë sundimit të MSKS-së, Kosova ishte vetëm një emër gjeografik që ekzistonte brenda sovranitetit jugosllav, e privuar nga çdo program zhvillimi. Derisa në Kosovë brenda periudhes 1918-1941 funksiononin vetëm minierat e Trepçës dhe Novobërdës, në viset e tjera të mbretërisë së jugosllave, industrializimi i vendit kishte shënuar hapa gjigantë. Vetëm “nga viti 1918-1938 ishin ndërtuar 403 fabrika në Slloveni, 635 në Kroaci dhe Sllavoni, 97 në Dalmaci, 129 në BeH, 390 në Vojvodinë, 428 në Serbi, 99 në Maqedoni dhe 12 në Mal të Zi”. Në aspektin arsimor, shqiptarët në ish-Jugosllavi ishin pothuajse jashtë sistemit arsimor sepse “në tërë periudhën mes dy Luftërave Botërore në fakultetet jugosllave kanë diplomuar gjithsejt 11 shqiptar”. (Petranovic, 1914-1941, f:69, 327).

Zhvillime të tilla ekonomike, politike dhe arsimore Kosova i ka përjetuar deri në vitet 70 të shekullit të kaluar. Pas ndryshimeve kushtetuese në Jugosllavi në vitin 1968, Kosova themelon Universitetin e Prishtinës (1970), Akademinë e Shkencave dhe Arteve

të saj, e shumë institucione të tjera shkencore e edukative. Pas avansimit kushtetues juridik të vitit 1974, Kosova pati një zhvillim të gjithanshëm ekonomik, politik dhe edukativ arsimor. Në vitin akademik 1977/1978, në Universitetin e Prishtinës studionin 40.820 student në 8 fakultete, një akademi arti dhe 9 shkolla të larta, (f:13) me 5.414 profesorë universitarë, 15.782 mësues e arsimtar (f: 308), 27.018 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme (1976/77, f:307) dhe 140.648 punëtorë. (Enti i Statistikës së Kosovës, 1978, f:51, 307, 313). Me gjithë këtë zhvillim, prapseprapë Kosova kishte të punësuar rreth 10% të popullatës së saj, e në këtë përqindje bënin pjesë, sipas çelsit nacional që aplikohet atëherë në Jugosllavi, të gjithë pjestarët e kombeve dhe kombësive që jetonin në Kosovë. Numri në rritje i popullatës kosovare, numri në rritje i njerëzve të arsimuar kërkonte rritje të investimeve dhe hapje të vendeve të reja të punës. Mungesa e vendeve të reja të punës dhe krijimi i një gjendje të paperspektivë rezultoj me një pakënaqësi që solli “pranverën kosovare” të vitit 1981 ku përveç kërkesave sociale u parashtruan edhe kërkesa politike për avansim juridik kushtetues të Kosovës në nivel të Republikës. Këto kërkesa gjithëpopullore, nga ana e pushtetit u cilësuan si kërkesa armiqsore, kundër revolucionare të cilat u shtypën me dhunë ushtarake policore. Në këto demonstrata, sipas zyrtarit të lartë policor të Jugosllavisë Stane Dolanc, ishin vrarë 11 persona, nga të cilët 9 sish ishin demonstrues e dy polic dhe ishin plagosur 54 të tjerë. Në këtë konferencë, Dollanc kishte deklaruar se dy demonstruesit e parë janë vrarë në turmë, ndërsa tek demonstruesit në Ferizaj dhe Podujevë nuk është qëlluar nga policia, dhe se vrasjet sipas tij kishin ndodhë nga “...ndonjë veprim kriminal apo ka qenë në pyetje hakmarrja”, ndërsa “..të tjerët janë gjetur të vrarë në rrugë dhe në fshat”. (BIGZ, 1981, f:18, 29-39).

Pranvera kosovare e vitit 1981 ishte produkt i bazuar në tre shkaqe, e para, politikanët e Kosovës u zunë ngusht me rastin e vdekjes së Titos (1980) përball kërkesave retrograde të Beogradit, e dyta, gjendja e vështirë ekonomike dhe sociale dhe presioni i rinisë për ndryshime radikale që solli përplasje të mëdha dhe përfundoj në gjakderdhje dhe e treta, dënimi kuturu i këtyre demonstratave nga udhëheqja e politike e Kosovës dhe qëndrimi patenalist ndaj strukturave politike të Beogradit të cilat kërkonin revidimin e ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974 dhe krijimin e Serbisë së madhe.

Cilësimi politik i këtyre demonstrative si armiqsore dhe kundërevolucionare dhe irredentiste nga forumet e partisë shtet, solli diferencimet e mëdha ideopolitike që nga lagjet e deri në Universitetin e Prishtinës i cili atëherë konsiderohej çerdhe e “nacionalizmit dhe irredentizmit” shqiptar në Jugosllavi. Si pasojë e një politike të

ngathtë kosovare kundrejt situatës së krijuar politike të asaj kohe, që nga marsi i vitit 1981 deri me 18.10.1988 janë ndjekur dhe persekutuar në cilësinë e “irredentistëve” dhe “kundër revolucionarëve” 584.000 (Horvat, 1989dh, f:149) ose rreth 36% e numrit të përgjithshëm të banorëve të Kosovës, shumica nga të cilët ishin nxënës, student, profesor, arsimtar, intelektual dhe drejtues të zot të jetës shoqërore, politike dhe ekonomike të Kosovës.

3.3.2. Rasti i Paraqinit

Aktivitetet policore ushtarake dhe masat drakonike të caktuara kundër shqiptarëve në gjyqet e montuara politike përkundër një propagandë të sëmurë të politikës informative që udhëhiqej kundër shqiptarëve për 24 orë në ditë, nga mediumet elektronike (RTB) dhe të shkruara ditore në gjuhën serbe (Večernje Novosti, NIN, Politika) përkundër angazhimit aktiv të kleronacionalistëve të Kishës Ortodokse Serbe, nuk ishte arritur ende ajo që dëshironin serbët të arrinin në nivel jugosllav. (Tomaniq, 2006). Këto medime shtetërore serbe i paraqisnin shqiptarët si “dhunues fëmijësh e grash serbe e malazeze”. Nën ndikimin e politikës së Beogradit dhe strukturave të caktuara ishte kërkuar një studim lidhur me dukurinë e kriminalitetit të shqiptarëve kundër serbeve në Kosovë nga viti 1981-1987. Ky studim ishte paraqitur në formë raporti zyrtar dhe tejet sekret nga Sekretariati Federativ i Punëve të Brendshme. Sipas këtij raporti, kriminaliteti në Kosovë ishte nga 5 deri në 15 herë më i vogël se mesatarja e Jugosllavisë dhe se serbët ishin 8 herë më shumë të viktimizuar nga vet serbët, sesa nga shqiptarët. Horvat, duke u thirr në këtë raport shkruan se nga viti 1986-1988 nuk ishte kryer as një vepër penale e vrasjes as e vrasjes në tentativë kundër serbëve dhe malazezëve. (Horvat, 1989e, f:153-154).

Megjithatë, problemi i serbëve dhe malazezëve dhe çështja e shpërnguljes së tyre nga Kosova ishte shëndrruar në çështje politike me të cilën po merrej shteti jugosllav dhe forumet më të larta partiake përfshirë dhe akademinë serbe. (Memorandumi i ASHAS-së 1986; Raporti i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, 1987).

Bazuar në rekomandimet e Kongresit të 13 të LKJ, Komiteti Qendror i LKS (9 korrik 1987) kishte nxjerrë planin operacional prej 49 pikash, për realizimin e të cilit, partia kishte ngarkuar qeverinë serbe. Ndër pikat kryesore ishte lufta kundër nacionalizmit shqiptar, rishikimi i historisë dhe kulturës shqiptare, planifikimi familjar (pika 26), eliminimi i “deformimeve në sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe krijimi i ekipeve të përbashkëta (pika 4, 5), autorizimet e policisë serbe në territorin e Kosovës (pika 9) e

deri te thëllimi i diferencimit ideopolitik mbrenda shqiptarëve dhe ndryshimet kushtetuese që do fuqizonin Serbinë në Jugosllavi!

Megjithë sukseset që kishte arritur Serbia në këtë drejtim, në formë të heshtur plani i saj kundërshtoj nga Sllovenia dhe Kroacia, të cilat, problemet e serbëve dhe malazezve në Kosovë i shihnin me një sy tjetër. Të vendosur për ndryshime kushtetuese dhe rikonfigurim të pozitës së saj në Jugosllavi, Serbia aktivizoj shërbimet e UDB-së dhe KOS-it serb që kryesisht udhëhiqeshin nga vet serbët. Për realizimin e qellimeve politike, Serbia përmes mediave të saja të kontrolluara shfrytëzoi shumë mirë rastin e vrasjes së katër rekrutëve ushtarak në Kazermen e Paraqinit që kishte ndodhur me datën 03 shtator 1987 i njohur si “Masakra e Paraqinit”. Të gjitha mediat shtetërore serbe dhe jugosllave, shkruanin atë ditë se si një i ri shqiptar, nga motive nacionaliste, kishte vrarë dhe plagosur kolegët e tij ushtarë dhe për kohëzgjatje, të gjithë viktimat ishin të nacionaliteteve të ndryshme jugosllave!



Figura 2. Vrasjet e ushtarëve shqiptar në armatën popullore të Jugosllavisë në vitin 1987
(Burimi i të dhënave: kryetitulli “Kelmendi ka shtënë në Jugosllavi”)

Kjo vrasje në Paraqin ishte dhe mbetet temë ditë pothuajse në të gjitha mediat Jugosllave, ku secila garonte me tituj bombastik. Psh., gazeta ditore beogradase “Politika” nxjerr artikullin bombastik “Kelmendi shtinë në Jugosllavi”, ndërsa gazeta tjetër beogradase “Borba” me titull “Të shtëna në Jugosllavi” shkruan se si Aziz Kelmendi, një rekrut shqiptar, kishte shtënë në Jugosllavi duke aluduar se ai ka vrarë ushtarët, kolegët e tij (të kombit dhe kombësive të ndryshme) për motive nacionaliste. (Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, 1987a).

komanda 52.korpusa
str.pov.br.1213-4
04.09.1987.godine

vrlo hitno
-na licnost komandanta-

od komande 2.armije dobili smo informaciju sledece sadrzine:
"dana 03.09.1987.godine u 03,05 casova u kasrani "branko krs-
manovic" u praracinu dogodio se tezak szlocin. vojnik keljmendi
sadika aziz, rodjen 15.01.1967. godine u s.karadzic so lipljan,
nastanjen u s.dusanovo, so prizren student pravnog fakulteta
u pristini, albanske narodnosti, u jna od 16.09.1986.godine,
u vreme vrsenja duznosti dezurnog jedinice uzeo je automatsku
pusku iz soske, provalio vojnicki ormaric u kojem je cuvana mu-
nicija za kurire, uzeo 10 /deset/ metaka i naoruzan dosao do
mesta gde se nalazio komandir straze /desetar alibegovic riza/,
prisilio ga da otvori sanduk sa municijom i z koga je uzeo dva
napunjena okvira. sa uperenom puskom u potiljak destaru, pri-
silio ga je da krene ispred njega do spavacih soba jedinice.
zapretivsi destaru alibegovicu smrću naredio mu je da ne obave-
stava dezurnog, upao je u vojnicku spavoanicu i otvorio vatru a
zatim presao u susednu spavoanicu i postupio na isti nacin. sve
se to odigralo za 10-15 sekundi. u ovom zlocinu usmrtio je 4 voj-
nika i 5 ranio koji su van zivotne opasnosti. tom prilikom usled
iskakanja kroz prozor povredjen je jedan vojnik. zlocinac je po-
begao van kruga kasarne i u sumi na kilometar od kasarne izvrsho
samoubistvo oko 05.00 casova.

-4-

-stanje bezbednosti, zastite i samozastite,
-funkcionisanje pozadniskog obezbedjenja i zbrinjavanja,
-predlozi i zahtevi komandi korpusa,

izvestaje dostavljati pismeno teleprinterom svakog dana do 17
casova sa sta njem u 16 casova sa potpisom rukovodeceg dezurnog
tima.

9.- informacije, mere i zadatke date ovim naredjenjem koristiti
za trajan politicki rad i planiranje mera bezbednosti i samoza-
stite u svim komandama i jedinicama korpusa.

za realizaciju ovog naredjenja cinim odgovornim komandante pu-
ka-brigada, nacelnika staba i pomocnike komanda 52.korpusa.

komandant
general-major
veso srdic

PRIMLJENO:	07.09.87	11.20
	(dan i mesec)	(čas i minut)
LAUNA 4863 2020	08.09.87	08.30
	(dan i mesec)	(čas i minut)
OBRADENO:	08.09.87	14.30
	(dan i mesec)	(čas i minut)
PREDATO:	07.09.87	14.50
	(dan i mesec)	(čas i minut)

dostavljeno: komandantima 15.pmtbr, 125.pbr, 549.ppbr
52.map, 27.go, 28.go, 202.tehn. baza, 418.int.baza
102.mposp, 492.vb, 83.lap, gar.pec

Figura 3. Dokumenti original i Komunikatës së Komandës së Armatës së Dytë me seli në Nish dërguar në Komandën e Korpusit të 52 të APJ-së në Pejë

Pas këtij rasti, me datën 23 shtator 1987, shefi i ushtrisë jugosllave, admirali Branko Mamulla kishte kërkuar verifikim për 3.792 ushtrinë shqiptarë të Kosovës të cilët gjindeshin në atë kohë në ushtrinë jugosllave, sepse sipas tij “ka ende Kelmendas që vijnë në ushtri apo ka të tillë që gjinden mes nesh” dhe mund të përsërisin akte të tilla. Ushtria, kishte thënë ai, nuk mund të rrijë duarkryq dhe të pres “kur ndonjë tjetër Kelmend të ndezë fitilin”. (Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, 1987b).

Rasti i Paraqinit hap problemin e pjesëmarrjes së rekrutëve shqiptarë të cilët, sipas kreut ushtarak jugosllav nga viti 1981-1987 ishin dënuar për veprimtari armiqsore 216 grupe ilegale me 1.435 pjestarë (Binder, 1987, f:14) por numri prej 200.000 rekrutëve

shqiptarë cilësohej si “bombë e kurdisur” në ushtrinë jugosllave.

“Masakra e Paraçinit” siç e quante shtypi serb pati pasoja jo vetëm për Aziz Kelemendin i cili u vra 7 ditë para se ta kryejë obligimin ushtarak, por edhe familja e tij. Nënë ia kishin arrestuar dhe dërguar në Burgun e Mitrovicës, babain ia kishin dërguar në Burgun e Nishit ndërsa dy vëllezërit dhe motrën ia kishin dërguar në Burgun e Prizrenit. Veprimet e një denimi kolektiv kundër familjes Kelmendi, autori Horvat i cilëson si veprime hakmarrëse të shtetit jugosllav “... të një karakteri fisnor që kryen hakmarrje kolektive”. (Horvat, 1989f, f:173).

Asnjeri nga këta pjestarë të arrestuar të familjes Kelmendi edhe pas gadi një vit qendrimi në burgjet jugosllave, nuk kanë ndonjë dokument me shkrim se pse ka ndodhur arrestimi dhe burgosja e tyre. Familja Kelemndi nuk ka asnjë dokument autopsie apo ndonjë dokument tjetër që dëshmon se djali i tyre ka bërë vetvrasje! Për këtë krim ishin akuzuar disa shqiptarë dhe një boshnjak (Kurti, 2008, f:208) nga Prokuroria Ushtarake e Nishit sipas aktakuzës VTK nr. 122/87 të datës 7 dhjetor 1987 për veprat penale “Bashkim për veprimtari armiqësore” nga neni 136 par 1 i LPJ-së në lidhje me nenin 114 si dhe “Ndihmë në vrasje me qëllime armiqësore” nga neni 202 të LP-së të Serbisë. Pas njëmbëdhjetë seancash gjyqësore, Gjykata ushtarake në Nish, me Aktgjykim Pnr.135/87 të datës 28.01.1988 (prej 167 faqesh), tetë të akuzuarit e këtij rasti i shpall fajtor dhe i dënon me gjithsej 67 vite burg. (Mertus, 1999, f:151; Shatri & Shatri, 2011, f:295, 305; Ibishi, 2012).

Ky Aktgjykim ishte apeluar nga të denuarit në Gjykatën Supreme Ushtarake në Beograd, e cila duke vendosur ne ankesën e të dënuarve, me datën 20.04.1988 kishte nxjerr Aktgjykimin II, Pnr.98/88 (29 faqe) sipas të cilit të ankimuarve ua rrit denimin në gjithsej 94 vite.

Për “Masakrën e Paraçinit” autorja amerikane Julie A. Mertus, shkruan se në këtë rast ishin të përfshirë “drejtëpërdrejtë ushtria që nga fillimi ose ishte përfshirë menjëherë mbas vrasjeve”. E ballafaquar me vështirësi në hulumtimin e rastit për shkak të pengesave në lëvizjen e lirë nga policia serbe dhe mungesën e guximit për komunikim të lirë të aktorëve të këtij rasti ajo shkruan: “Unë e mbyll çështjen Kelmendi aty ku e kam filluar. Secili e kishte të vërtetën e vet”. (Mertus, 1999a, f:173).

Për “dy të vërtetat” serbe dhe shqiptare të këtij rasti shkruajnë edhe autorët Dushan Janjiq, Anna Lalaj dhe Besnik Pula. Sipas tyre, serbët këtë krim e shohin si konspiracion anti-serb ndërsa shqiptarët e shohin si konspiracion serb kundër

shqiptarëve për të justifikuar represionin policor kundër popullatës shqiptare. (Janjic, Lalaj, & Pula, 2009, f:276).

Sipas autorit Clark, “Masakra e Paraqinit”, ishte një shans për Millosheviçin i cili duke i shfrytëzuar mediat serbe të asaj kohe (RTS, Beograd, Politika, Borba Vecernje Novosti etj), arriti të përfitojë përkrahjen politike jo vetëm në Serbi por edhe në Jugosllavi dhe të përforcojë pozitën e tij politike kundrejt forcave reformiste. (Clark, 2000, f:18-19). “Masakra e Paraqinit” konsiderohet ndër faktorët kryesor të shkatërrimit të Jugosllavisë. Duke shkruar për këtë rast, autori boshnjak Nihad Halilbegović shkruan se vrasjet e ushtarëve jo serb nëpër garnizone të ndryshme të ish APJ-së ishin vrarë nga ushtarët serb të cilët më pas i deklarorin si të vetvuarë. Edhe për vrasjet e 64 ushtarëve shqiptar në ish APJ- në, ai shkruan se ata ishin vrarë nga afërsia, nga kolegët e vet ushtar serb, nga oficerët e tyre dhe më pas, ishin kthyer në familjet e tyre në arkivole me të dhëna se gjëja kanë bërë vetëvrasje. (Halilbegović, 2002, f:19, 22,23 50-54, 95, 163, 335-351). Në fakt, mbrenda periudhës 1981-1991, nga ushtria jugosllave, gjatë kohës së shërbimit ushtarak janë vrarë 108 ushtarë shqiptarë për të cilët kjo ushtri i ka deklaruar si të vetvuarë. (Ramosaj, 2008, f:25-46).

Duke fol për rastin e Paraqinit, në të përditshmen “Vreme” të Beogradit, z. Adem Demaçi kishte shprehur dyshimin se si një i ri shqiptarë, natën nëpër terr përzgjedh të vras “...një serb, kroat, maqedonas, boshnjak”. (Nikolic, 1998).

Se “Masakra e Paraqinit” ishte një proces i montuar politik dhe një vrasje e kryer nga shërbime sekrete ushtarake serbe dëshmon një ish anëtar i kolegjit të Gjykatës Ushtarake të Nishit.

našaborba
NE ZAVISNI POLITIČKI DNEVNIK

Petak, 9. maj 1997.

NOVO SVEDOCENJE O SLUCAJU UBISTVA U PARACINSKOJ KASARNI

"Proces je bio montiran"

Bivši vojni tužilac u Sarajevu izjavio da je proces u Paracinskom predmetu bio montiran, a advokat dr Jovan Buturović obratio se vrhovnom vojnom tužiocu da podnese zahtev za ponavljanje krivičnog postupka

Izjava pukovnika u penziji, bivšeg vojnog tužioca u Sarajevu, da je proces u Paracinskom predmetu bio montiran razlog je dopisa advokata dr Jovana Buturovića vrhovnom vojnom tužiocu da podnese zahtev za ponavljanje krivičnog postupka. Podsetimo, reč je o ubistvu četiri vojnika i ranjavanju sestorice u Paracinskoj kasarni 1988. godine koje je izvršio vojnik Aziz Keljendi posle čega je, kako je zvanično saopšteno, izvršio samoubistvo. Nakon toga, osuđeno je osam Albanaca, navodnih saučesnika na kazne zatvora od četiri do dvadeset godina.

Figura 4. Kryetitulli "Procesi ka qenë i montuar" (Burimi i të dhënave: gazeta e Beogradit “Naša Borba”, 9 maj 1997)

Lidhur me këtë proces të montuar gjyqësor dr. Jovan Baturoviq shkruan: “Ju rikujtoj se në atë kohë ishte krijuar një atmosferë linçuese në mjetet informative në Jugosllavi dhe se nga kreu i APJ-së dhe Kryesia e RSFJ-së kërkohej me çdo kusht zbulimi dhe dënimi i autorëve të masakrës në Kazermën e Paraqinit”. (Ilic, 1997).

Për rastet e montuara të vrasjeve të ushtarëve shqiptarë në ushtrinë jugosllave dëshmon edhe ish-prokurori ushtarak, Lakiq Gjoroviq nga Beogradi. Në intervistën e tij për opinionin publik të datës 26 mars 2013, ai kishte tërheq paralele mes rastit të Paraqinit 1987 dhe rastit të vitit 1994 ku ishte vrarë ushtari Shaban Bajrami (viq), (një djal i vetëm i familjes nga fshati Kapit i Komunës së Medvegjës) dhe dy ushtarëve serb të cilët ishin me shërbim në Kazermën Sajmishte, Posta Ushtarake 3417 në qytetin e Mladenovcit, Serbi, të cilat sipas tij ishin kryer nga KOS-i. Sipas tij, ushtar Shabani ishte shantazhuar nga inteligjenca ushtarake serbe, të cilët kishin kërkuar nga ia që të kryejë disa vrasje të liderëve shqipëtarë në Kosovë dhe në Zvicër. Kur ai nuk kishte pranuar të kryejë këto vrasje, ishte vrarë në mjediset e kazermës në Sajmishte menjëherë pas kthimit nga pushimi disa ditë që i kishte bërë familjes së tij. (Shatri & Shatri, 2011a, f:313).

Sipas Gjoroviqit, pas “Masakrës së Paraqinit” ushtarët shqipëtarë e kishin të ndaluar të bënin roje. Përkundër kësaj urdhërese, shkruan Gjoroviq, me datën 01/02 maj 1994 ai ishte caktuar të bëjë rojë dhe “Rreth orës 02:00, të datës 02 maji 1994, kur ushtarët tjerë ishin në gjumë dëgjohen të shtëna automatiku, vriten dy ushtarë në vend roje të kombësisë serbe”. Me qëllim që të arrihet efekti politik, ata vrasin edhe dy ushtarë të komunitetit serb në po këtë kazermë dhe pastaj e lansojnë lajmin se gjëja ushtari shqiptar i kishte vrarë dy ushtar serb dhe se organet e sigurimit pastaj e kishin vrarë atë. Lidhur me këtë vrasje të trefishtë, nënkoloneli Gjoroviq, pranë Gjykatës ushtarake në Beograd kishte ngrit aktakuzë KTN.nr.130/1994 për vrasje kundër pjestarëve të caktuar të sigurimit ushtarak të cilët kishin qenë në detyrë atë natë në Kazermën ushtarake në Mlladenovc. (Djorovic, 2013).

3.4. Vrasjet dhe aktet e tjera të terrorizmit shtetëror (1990-1999)

3.4.1. Izolimet dhe Helimet - akte terroriste shtetërore

Ndër masat që pushteti jugosllav ndërmori kundër popullsisë shqiptare të Kosovës para se ai të zhbëjë autonominë e saj politike ishte “Izolimi” i intelektualëve, mësuesve, profesorëve, udhëheqësve politik, akademikëve, studentëve dhe të tjerëve.

Kjo masë kishte për qëllim eliminimin për një kohë të caktuar nga aktivitetet politike të kohës të të gjithë atyre që me forcë kundërshtonin ndërhyrjen antikushtetuese kundër autonomisë së Kosovës. Ky veprim ishte ndërmarr mes datës 27-28 mars 1989. Kjo masë e përkohshme e izolimit ishte e parashikuar në nenin 47 të Ligjit të Punëve të Brendshme të KSAK-ut (1977) dhe nenin 53 par. 2 i LPB të KSAK-ut (1987). Sipas këtij ligji, nga viti 1981 deri në vitin 1989 ishin dërguar në izolim mbi 253 qytetarë të Kosovës ku kishin qëndruar me muaj të tërë. Të izoluarit ishin dërguar në burgje të ndryshme në qytetet e Serbisë pa vendim gjykatë dhe pa dijeninë e prokurorisë. Kur një grua shqiptare nga Prishtina kishte kërkuar nga avokati kroat Rajko Danilović që të angazhohet në gjetjen e burrit të saj i cili ishte dërguar në izolim nga policia serbe dhe nuk dinte asgjë për 30 ditë, ai i çuditur nga kjo situatë kishte pyetur, “Çështje izolimi? E pranoj – kishte thënë avokati – se deri kohë më parë nuk kam ditur se diçka e tillë ekziston”. (Kabashi, 2016, f:73). Ndërsa avokati tjetër po ashtu kroat z. Danko Spoljaric, mbasi kishte pranuar kërkesën e familjarve që të mbronin një të izoluar tjetër kishte deklaruar “nuk e ndjeja veten si avokat, por si një detektiv që kërkonte personin e humbur”. (Kabashi, 2016a, f:44-50).

Në pranverën e vitit 1992, Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut me seli në Prishtinë, i nisi një Prememorje Konferencës së Hagës për Jugosllavi, z. Karington, Sesionit 44 të komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në New York, OSBE-së dhe sekretarit general të OKB-së, z. Butros Butros Gali, përmes së cilës i'u bëhet me dije se Serbia po bënë një gjenocid kulturor kundër shqiptarëve të Kosovës duke shkatërruar ekonominë e saj, arsimin, shëndetësinë, kulturën, shkencën dhe sportin. Gjithashtu, këto institucione njoftohen për 96 shqiptarët e vrarë nga të cilët 18 të mitur, për 610 të plagosur nga të cilët 49 të mitur. Vetëm gjatë protestave të muajit mars - prill 1989, në 11 qytete dhe 5 fshatra të Kosovës, janë vrarë gjithsej nga policia 30 qytetar të moshës nga 11 deri në 54 vjet. (KMLDNJ Prishtinë, 1992, f:11, 27, 35, 71). Për këtë terrorizëm shtetëror jugosllav që kishte lidhje me vrasjet e ushtarëve shqiptarë, helmimet, arrestimet dhe keqtrajtimet e ndryshme, opinioni ndërkombëtar ishte njoftuar edhe nëpërmjet institucioneve të besueshme siç ishte Human Rights Watch. (Nizich, Laber, & Watch, 1992).

Në një vjetorin e ndërhyrjes së forcave serbe (23 mars 1989), Kosova përsëri përballej me fenomenin e helmimit masiv të rreth 3.500 nxënësve të shkollave të mesme dhe fillore. Ky fenomen nga Beogradi zyrtar dhe nga shtypi qeveritar cilësohej si “ngjarje teatrale” të organizuara nga “irridenta shqiptare”. (Wassenius, 2014); (Benedet,

1990, f:22). Zyrtarisht, për Beogradin, në Kosovë nuk kishte helmime dhe për zbardhjen e kësaj çështje asnjëherë nuk kanë filluar hetimet zyrtare. (Mertus, 1999b, f:197).

Përveç këtyre akteve të dhunës institucionale mbi popullatën shqiptare, Serbia vazhdoi me përvetësimin në mënyrë të kundërligjshme të së drejtës së pronësisë të 367 ndërmarrjeve ekonomike të Kosovës duke i bashkuar me ndërmarrjet në Serbi me qëllim nënshtrimin ekonomik të saj. Në shtator të vitit 1990 Serbia përjashtoi mbi 120.000 punëtorë shqiptarë. Përveç nënshtrimit ekonomik, Serbia s'pastroj gjyqësorin dhe policinë, duke i larguar nga detyra të gjithë gjyqtarët, prokurorët shqiptarë dhe duke i zëvendësuar ata me qytetarë serb e malazez. (KMLDNJ, Prishtinë, 1992a, f:68). Ndërsa në fushën e sigurisë, regjimi serb i largoi nga puna rreth 4.000 polic shqiptar dhe në vend të tyre angazhoj serb lokal dhe refugjatë serb të ardhur nga BeH dhe Kroacia të cilët ishin pjesë e formacioneve paramilitare që kishin marrë pjesë në frontet e luftës në Kroaci dhe BeH. (AI, 1994). Në rrethana të tilla, armatosja e serbëve lokal e cila kishte filluar që nga viti 1987-88 ishte në vazhdim e sipër dhe kryhej në kazermën ushtarake në Pejë. Në këtë kazermë kishte filluar regjistrimi i vullnetarëve serb të cilët formonin grupacione paramilitare ku ishin të përfshirë parti dhe grupe të ndryshme kriminale. (HRW, 1993, f:97).

Me qëllim të kundërvënjes së këtij okupimi klasik dhe terrori serb, shqiptarët organizuan sistemin paralel me qëllim që të ruhet subjektiviteti juridik dhe politik i Kosovës. (ASHAK, 2005). Mbas krijimit të strukturës shtetërore të Kosovës, qarqet policore serbe u bënë më agresive, ndërsa politika serbe këto struktura i quante “struktura paralele”. Si të tilla, Institucionet e Kosovës njiheshin edhe në opinionin ndërkombëtar, përveç Republikës së Shqipërisë. (Mertus, 1999c, f:771). Ndjekja, persekutimi, arrestimi dhe vrasjet pa shkas të shqiptarëve ishin përditshmëri. Sipas të dhënave nga Stejt Departamenti amerikan, “15 shqiptarë kishin vdekur në duar të policisë serbe në vitin 1993”, ndërsa sipas burimeve vendore kosovare 5.700 veta ishin keqtrajtuar nga policia, 1.400 ishin arrestuar për vetëm tetë muaj dhe kishin kontrolluar 2.500 shtëpi. Për aplikimin e dhunës fizike dhe torturave ndaj personave të arrestuar kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Vojislav Zhiviq kishte deklaruar publikisht “ne kemi të drejtë të rrahim bile edhe t'i vrasim ata që na cenojnë territorin e Jugosllavisë e pastaj të ankohen”. (HRW, 1993a).

Sipas autorit Halili, veprimet e tilla të pushtetit serb janë një “Terrorizëm Politik” (Halili, 1995a, f:92-93) dhe ka për qëllim spastrimin etnik të Kosovës dhe

viseve të tjera në Jugosllavi dhe kolonizimin e saj me serb e malazez në bazë të një “Programi për realizimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit në Krahinën Socialiste të Kosovës” (1990). (AI, 1994a).

Pas viteve të 90-ta, Kosova ishte një fushë eksperimentale ku kriminel të veshur me pushtet eksperimentonin çdo ditë me metodat e tyre shtypëse të cilat i përdornin kundër nxënësve, studentëve, pleqëve, femijëve, të rriturve, intelektualve, biznesmenëve, gazetarve, ish-policëve dhe ushtarakëve kosovar. (Commision on Human Rights, 1992).

Në vitin 1992 kishte filluar një vale e re e përndjekjeve dhe e arrestimeve të të rinjëve shqiptarë të akuzuar për veprimtari armiqësore kundër shtetit jugosllav. Ndër keto grupe të arrestuara në rajonin e Pejës ishte edhe grupi i Gjakovës të cilët akuzoheshin për veprat penale “Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 dhe “Cenimi i tërësisë territoriale” nga neni 116 al. 1 dhe 2 i LPJ-së. Sipas vendimit Pnr.16/92 të datës 20.X.1992 në Gjykatën e Qarkut të Pejës, ky grup prej 19 vetash dënohet me gjithsej 70 vjet burgim. Gjatë shqyrtimit të ankimit, shkalla e dytë (Gjykata Supreme e Serbisë) ua kishte zbritur dënimin gjithsej 42 vite burg. (Vendimi A.pnr.I. 41/93 i Gjykatës Supreme të Serbisë dt. 11.10.1993. Ky vendim ishte vërtetuar nga Gjykata Supreme Federative sipas vendimit KPS -16/94 i datës 13 dhjetor 1994). Paralelisht edhe në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës zhvillohej një gjykim i ngjashëm dhe për vepra të ngjashme penale. Kjo Gjykatë Grupin e Prishtinës e kishte dënuar me dënime afatgjata. (Nizich, Laber, & Watch, 1992a). Në vitin 1995 arrestohen dhe dënohen 9 ish-zyrtarëve policorë me akuzën për vepër penale “Bashkimi për veprimtari armiqësore” nga neni 136 al 2 dhe “Cenimi i tërësisë territoriale” nga neni 116 al.1 i LPJ-së. Këta ish zyrtarëve policor të Kosovës, me Aktgjykimin Pnr.8/95 të datës 19.04.1995, në gjykatën e Qarkut të Pejës dënohen me burgime afatgjata.

Përveç këtyre gjykimeve të montuara politike, kundër ish-strukturave ushtarake dhe policore të Kosovës të cilët ishin arrestuar dhe dënuar në vitin 1994-1995, vrasjet e njerëzve të zakonshëm dhe atyre me autoritet ishte dukuri e zakonshme. (Amnesty International, 1994b).

Ndër të keqtrajtuarit fizikisht nga policia serbe në mars të vitit 1994 ishin edhe personalitet e njohura të jetës publike dhe shkencore në Kosovë si, kërkuesit shkencorë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, prof. Sadri Fetiu, prof. Anton Cetta, prof. Ragip Mulaku, prof. Mehmet Halimi e shumë e shumë të tjerë. (AI, 1994c).

Ndër vrasjet që ka shqetësuar atë kohë opinionin pejan dhe kosovar ishte vrasja e drejtorit të shkollës fillore në fshatin Strellc të Deçanit, i cili kishte vdekur si pasojë e torturave policore në stacionin e policisë në Deçan dhe vdekja e kryetarit të Odës së Avokatëve të Pejës, doajenit të gjyqësisë së Kosovës z. Mikel Markut nga Peja. Për këto vrasje si dhe për shumë të tjera nuk janë zhvilluar hetime, nuk është arrestuar askush përkundër depozitimit të kallëzimit penal të familjarëve të tij në Gykatën e Qarkut në Pejë. (AI, 1994d).

Ekzekutimeve nga policia serbe nuk mund t'i iknin as shtetasit e huaj, mjaftonte që ata të ishin shqiptarë. Një rast i ekzekutimit policor serb ishte kryer ndaj qytetarit Ali Sahit Haxhiu nga qyteti i Kukësit i cili ishte kapur në komunën e Ferizajit dhe ishte torturuar për shkak të mospagesës së një gjobe që kishte të bënte për shkeljet e qarkullimit rrugor. Me 25 nëntor 1991, në orën shtatë të mbrëmjes, ai kapet nga policia e Ferizajit, të cilët e rrahin dhe e torturojnë dhe më pas e dërgojnë në Stacionin e Policisë. Si pasojë edhunës policore, i dëmtuari ndërron jetë 15 minuta pas futjes në qeli. Familja e tij njoftohet me datën 26 nëntor, ndërsa autorët e këtij krimi të vrasjes kurrë nuk janë hetuar. (AI, 1994dh).

Në këtë kuadër duhet përmendur edhe vrasja e datës 28 janar 1997, të ish-gjyqtarit të gjykatës Supreme të Kosovës Qazim Tolaj, në gjykatorën e Gjykatës së Qarkut të Pejës nga një polic me origjinë shqiptare që ishte në shërbim të serbëve. Procedura hetimore kishte filluar vetëm kundër vrasësit, por jo edhe kundër dy personave tjerë që e kishin ndihmuar vrasësin të kryente këtë krim. Kërkesa e familjarëve për ndjekje penale, Pnr.KIO nr 105/97 dt. 06.07.1997, ishte refuzuar nga Kryeprokurori Publik i Qarkut në Pejë, Milladin Popoviq me vendim të Prokurorisë së Qarkut KT nr. 11/97 i datës 30.09.1997 me motivin se nuk ka elemente të mjaftueshme për ndjekjen penale të personave të tjerë në lidhje me krimin e varsjes. Kjo vërtetohet edhe me vendimin e Gjykatës së Qarkut P.nr 39/97 të dates 22.10.1997 i cili vërtetohet edhe nga vendimi i Gjykatës Supreme të Serbisë Kzh.II 812/97 dt. 25 nëntor 1997. Lënda e kësaj vrasje si shumë të tjera nuk gjenden në arkivin e Gjykatës as në Arkivin ndërkomunal në Pejë. Sipas të dhënave të autorit Ali Bajgora i cili i referohet Këshillit për Mbrojtjen dhe Liritë e Njeriut në Prishtinë, gjatë vitit 1989 ishin vrarë 33 kosovarë të moshave të ndryshme, në vitin 1990 ishin vrarë 39 shqiptarë, në vitin 1991 ishin vrarë 15 shqiptarë, në vitin 1992 ishin vrarë 20 shqiptarë, në vitin 1993 ishin vrarë 15 shqiptarë, në vitin 1994 ishin vrarë 18 shqiptarë, në vitin 1995 ishin vrarë 14 shqiptarë, në vitin 1996 ishin vrarë 14 shqiptarë, në vitin 1997 ishin vrarë 70 shqiptarë ndërsa në vitin 1998 ishin të

vrarë 104 shqiparë duke bërë kështu që numri në total i vrasjeve gjatë kësaj periudhe të arrij në 342 të vrarë.

Të dhëna nga raporti i KMDLNJ-së për vitin 1997 dhe vitin 1998			
Sipas viteve	97	98	Σ
Të vrarë dhe të masakruar	70	104	174
Të plagosur		44	44
Tentim vrasje		30	30
Të zhdukur		28	28
Të keqtrajtuar në forma të ndryshme		3095	3095
Fëmijë të keqtrajtuar		42	42
Pleq të keqtrajtuar		33	33
Femra të keqtrajtuara		249	249
Aktivist të keqtrajtuar		121	121
Humanitar të keqtrajtuar		25	25
Klerik të keqtrajtuar		7	7
Arsimtar të keqtrajtuar		44	44
Me lëndime të rënda trupore		690	690
Të arrestuar arbitrarisht		341	341
Të ndaluar arbitrarisht	596	522	1118
Të thirrur në polici	803	176	979
Të kërcënuar nga policia	207		207
Marrja peng nga policia	5	136	141
Kidnapime policore	3		3
Të kërkuar nga policia		69	69
Ndërhyrja në shkolla	57		57
Ndërhyrja në parti politike	8		8
Ndërhyrja në institucione kulturore	3		3
Ndërhyrja në institucione humanitare	5		5
Përdhosja e simboleve kombëtare	10		10
Uzurpime të pronës	10	14	24
Konfiskime të pasurisë	9		9
Ndalimi i veprimtarisë ekonomike	10		10
Pengimi i festave private	3		3
Marrja e pasaportave	39		39

Ndalimi i kthimit në vendlindje	14		14
Thirrje për në ushtrinë serbe	12		12
Bastisje	427	100	527
Biseda informative	480		480
Arrestime	1073		1073
Të keqtrajtuar për armë		143	143
Të dënuar penalisht	125		125
Femra të dhunuara	1		1
Gazetar të keqtrajtuar		24	24

Tabela 1. Të dhënat nga raporti i KMDL NJ-së në Kosovë për vitet 1997-1998 (*Burimi i të dhënave: Bajgora, 1998, f:203-220*)

Sa i përket shifrave të paraqitura për vrasjet dhe masakrat nga 24 mars 1999 – 10 qershor 1999, të kryera nga pushteti shovinist i Serbisë në Kosovë, kalimthi vetëm po i përmend sepse kjo nuk është pjesë e studimit tonë, sepse ato krime bëjnë pjesë në veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.

3.4.2. “Rasti Panda”

Ndër vrasjet më enigmatike të cilat ishin kryer në Pejë dhe të cilat kanë ndikuar në rritjen e presionit dhe terrorit serb me qëllim të spastrimit etnik në rrethinën e Pejës dhe Rrafshit të Dukagjinit, ka qenë vrasja e gjashtë fëmijëve serb në kafiterinë “Panda” në Pejë, me 14 dhjetor 1998. (Human Rights Watch, 2001, f:91). Për këtë akt kishte reaguar opinioni ndërkombëtar, ambasada amerikane në Beograd dhe përfaqësuesi i saj në Komisionin Verifikues z. Shaun Byrnes si dhe nga vetë shefi i këtij misioni në Kosovë, z. William Walker.

Kjo vrasje kishte pasuar masakren e 13 dhjetorit 1998, e kryer në Zonën e Hasit në kufi me Shqipërinë, dhe me këtë rast ushtria jugosllave kishte vrarë “36 pjestarë të guerillës” shqiptare. (The New York Times, 1998)

lokvama krvi. Sa leve strane na podu su zatežena četiri leđa
du se vidi 17 udara projektila kao i 3 udara u šank sa
prednje strane. Na podu u blizini šanka su pronađene tri
kal. 7,62 mm AP, kineske proizvodnje a iz šanka 7 zrna projektila
na vratima kuhinje koja se nalazi iz šanka se vidi jedan
projektil.

po nalogu istražnog sudije. lezevi su prebačeni u kapot po nalogu istražnog sudije Okružnog suda u Peči, izvršeni su lezevi i tom prilikom konstatovano sledeće: 1. lezevi ivna je konstatovana jedna ustrelina rana u predelu desne noge, dve prostrelne rane i jedna prostrelna rana u predelu desnog stopala, dve prostrelne rane i jedna prostrelna rana kao i jedna okružna izbojka u predelu glave kao i jedno okružno izbojke u predelu glave, tri prostrelne rane u predelu leve i desne ruke, četiri prostrelne izbojke u predelu leve noge, tri prostrelne rane i dve u predelu tela, jedna prostrelna rana u predelu leve ruke i jedna prostrelna rana u predelu desnog stopala, izbojka u predelu leve prostrelne rane u predelu glave, dve prostrelne u predelu tela kao i osam rana na desnoj i šest na levoj nozi od koje jedna, projektila.

Prema izjavama izveštaja, laževa Stana
više Zorana i kćeri Svesislava.

Prema izjavi oštećenaca, dvojica terorista sa "fantomkama" na glavi, napuštali su AP su se ulaznih vrata kafića, otvorili kafiću najprije sa goste, nakon čega su se udaljili sa licima maskama u nepoznatom pravcu. U momentu napada u kafiću se nalazilo oko dvadesetak gostiju, od kojih niko na napad nije upozoren.

Kriminalistički poligon

L a n e t a n

Aleksi: 2000

Здравствуй

(Burimi i të dhënave: Gazeta “Expres” e Prishtinës, e diel, 13 dhjetor 2015).

64

302/98 i datës 18.12.1998) kishte caktuar masën e paraburgimit në afat prej 30 ditësh “me dyshim të bazuar së kanë kryer veprën penale të “Terrorizmi-t” , neni 125 lidhur me nenin 139 pika 1 LP të RFJ-së” masë e cila ka vazhduar deri me datën 18.3.1999. Për shkak të situatës së krijuar - siç thuhet në aktvendimin e Gjykatës Supreme të Serbisë Pnr.409/99 të datës 09.07.1999, këtë lëndë e delegon në kompetencë për gjykim në Gjykatën e Qarkut në Leskovc. Prokurori publik i Qarkut në Leskovc, kundër të pesë të arrestuarëve për terrorizëm ngriti akuzë (Kt.br 50/99 të datës 2.8.1999), pra, pas 8 muaj e 16 ditë të plota. Sipas vendimit Pnr.41/99 të kësaj gjykate, (data e vendimit është e palexueshme), përkundër kërkesës së Prokurorit publik, gjykata i gjykon që të gjithë me nga një vit burgim, për veprën penale nga neni 136 i LPJ-së “Bashkimi për veprimtari armiqësorë” në lidhje me nenin 125 për terrorizëm. Askund gjatë hetimit dhe as në gjykim nuk përmendet se të pesë të akuzuarit, kanë lidhje ose janë autorë të vrasjes së pesë fëmijëve serb në kafiterinë “Panda” në Pejë, për çka dhe ishin arrestuar. Të denuarit, sipas deklaratave të tyre, pas një kalvari vuajtjesh në burgun e Qarkut të Pejës, me datën 11 qershor 1999, janë dërguar në burgun e Leskovcit. Me datën 15.12.1999, nën ndërmjetsimin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, nga Burgu i Leskovcit lirohen të pesë të dënuarit e “Rastit panda” (Certificate of detention YUK-000318 lëshuar nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Shkup 01.10.2001). Përkunder vendimeve të gjykatave serbe lidhur me këtë rast, Millosheviqi në Gjykatën e Hages i akuzon shqiptarët si vrasës të fëmijëve në kafiterinë “Panda” në Pejë. Edhe krerët e Kishës Orthodokse serbe pothuajse në çdo përvjetor, akuzonin dhe akuzojnë shqiptarët si vrasës të fëmijëve serb, por deklarimi publik i vetë kryeministrit të Serbisë në TV-Pink të cilën e sjell para publikut gazeta “Blic” e Beogradit, e datës 29.12.2013 ka shokuar opinionin publik në Serbi. Kryeministri serb Vuçiç në TV-Pink në emisionin “Fjalë të rënda” për “rastin Panda” kishte deklaruar “...ka shumë gjëra të tmerrshme me të cilat duhet të ballafaqohemi...nuk ka dëshmi se vrasjet i kanë kryer shqiptarët, siç është besuar”. (Tanjug, 2013). Ndërsa gazeta tjetër “Mondo” e Beogradit e datës 14.1.2014 duke iu referuar kryeministrit serb për “Rastin Panda” paralajmëron opinionin serb se “Për atë që ka ndodhur në “Panda” të gjithë neve mund të na dhemb koka”. (Mondo.rs, 2014).



Figura 7. Ballina e gazetës beogradase "Vesti online", i datës 08.05.2014

“Vuqiç të vërtetën ua ka borxh prindërve”

Për montimet dhe likuidimet e shqiptarëve dhe të vetë serbëve për qëllime politike dëshmon edhe një prokuror i prokurorisë ushtarake serbe, Lakiq Gjoroviq në artikullin e tij në e-novinë i datës 24.10.2012 me titull “Gjykatat sekrete ushtarake të Serbisë”. Mes tjerash në këtë artikull ky ish-prokuror me gardë nënkoloneli shkruan: “organet e sigurimit ushtarak, kriminelëve dhe grupeve kriminale, duke i shantazhuar, ju jepnin kartelat dhe emblemat e pjestarëve të policisë sekrete, vrasësit i lironin nga vuajtja e dënimit, i organizonin, i detyronin dhe i dërgonin në kryerjen e veprave më të rënda penale në territorin e ish Jugosllavisë, duke përfshirë edhe kafiteritë në Serbinë e ngushtë” (Djorovic, 2012).

Pas “Rastit Panda” i gjithë aparati shtetëror represiv duke përfshirë policinë, forcat militare dhe paramilitare ishin në aksion hakmarrës dhe filluan realizimin e planit famëkeq “Patkoj”. Nuk mbeti lagje, fshat e qytet që nuk ishte përfshirë në një dhune

dhe terror të paparë policor - ushtarak. Arrestimet ishin në masë, arrestohej çdo mashkull madhor dhe dërgohej në Serbi. Ky aparat i dhunës policore ushtarake i shpërndarë gjithandej Kosovës filloj s'pastrimin etnik të saj. Së pari, ushtria sulmonte me armë të rënda, pastaj futej në përdorim policia dhe paramilitaret të cilët vrisnin, plaçkisnin dhe më pas u'a fusnin flakën vendbanimeve të tëra.

Vrasjet e elitës (Elitocide) – Njëkohësisht kishin filluar vrasjet në masë të popullsisë civile, rrëmbimi dhe eliminimi i njerëzve nga autoritet siç ishte rasti me vrasjen e avokatëve, Urim Rexha nga Gjakova, Mehdi Elshani nga Theranda, Ismet Gashi nga Prizreni, Bajram Kelmendi me të dy femijet nga Prishtina, aktivistet politikë siç ishte, Mark Malota nga Gjakova, Agim Hajrizi dhe Latif Berisha nga Mitrovica, shkrimtari Teki Dervishi dhe promotori i lëvizjes për pavarësi të Kosovës, prof.Fehmi Agani i cili me datën 6 maj 1999, bashkë me familjen e tij kishte tentuar të largohej nga Kosova, por ishte kthyer nga kufiri i Maqedonisë. Ai ishte rrëmbyer në Prishtinë, të nesërmen trupi i tij i pajetë ishte gjetur në afërsi të Lipjanit. (OSCE, 2003, kapitulli22).

Më qëllim që t'i humbnin gjurmët e krimeve, shteti serb kishte urdhëruar fshehjen e gjurmëve, djegijen e trupave të pajetë, transportimin e tyre në Serbi dhe varrosjen në varreza masive, hedhjen në puse me ujë, hedhjen në lumenj dhe në miniera të ndryshme. Djegia e tyre bëhej për se gjalli duke i djegur bashkë me shtëpi ose e dërgonin në minierat e Trepçës, Borit dhe Majdanpekut (në Serbi), hedhjen e trupave të pajetë në puse uji dhe më pastaj i rrafshonin me tokë (Martinsen, 2006), transportimin e mbi 80 trupave të pa jetë me kamion frigorifer dhe hedhjen e tyre në lumin Danub në afërsi të qytetit Kladovë në kufi me Rumaninë. Sipas stacionit amerikan "National Public Radio" i transmetuar me datën 25 janar 2001, gjatë luftës së vitit1999, në minierën e Trepçës ishin djegur mes 1.200 deri 1.500 kufoma. Ndërsa në varreza masive janë gjetur vetëm 4.300 trupa, ndërsa për 11.334 nuk dihet asgjë. Për 3.525 qytetarë konsiderohen ende të zhdukur. (Human Rights Watch, 2001a, f:175, 182-184). Sipas dëshmimeve, në këto krime ishin angazhuar edhe vrasës ordiner të cilët ishin liruar nga burgjet serbe, ishin armatosur nga shteti dhe ishin dërguar në Kosovë që të vrisnin qytetarët e pafajshëm. Duke cituar gazetarin e Wall Street Journal, HRW sjell para pulikut një deklaratë të dy ish-të burgosurëve të cilët kishin marrë pjesë në vrasje të porositura në Kosovë të cilët likuidonin njerëz sipas listës që e mernin nga udhëheqësit e tij në kazermën e ushtrisë në Pejë. Ai thotë: "zyrtarisht, Arkani nuk ka ardhur në burg, por kanë ardhur njerëzit e tij. Kishte listën e të burgosurve dhe dosjet e tyre. (...) vetëm një gjë ka pyetur a je i gatshëm të shkosh në Kosovë...nuk ka qenë vendim i gjykatësit ose

drejtorit të burgut. Ai ka qenë vendimi i Arkanit”. Më pastaj shton ky ish i dënuar, “kemi marr listën e personave të kërkuar të cilët duheshin sjell të gjallë a të vdekur para tyre....kam pasur leje edhe të vras”. (HRW, 2001b, f:137). Ndër masat më të rënda të terrorit serb ishin dhunimet publike të femrave shqiptare të cilat ishin në ikje me familjet e tyre. Një rast të tillë dhunimi të një gruaje 30 vjeçare e sjellin para publikut, hulumtuesit e HRW: “Na ndalen dy serb me uniformë. Njëri që ishte i plotë me urdhëroj të zbres nga traktori... dhe urdhëroj “Ti” duke u drejtua nga unë. Nuk zbrita nga traktori kur më urdhëroj. Atëherë bërtiti: “Ti! Zbrit! Fëmija im tre vjeçar flinte në krahroren tim. Filloj të bërtiste: Zbrit! Zbrit! Më tërhoqi nga traktori dhe mi grisi rrobat. Pantollonat i kishte shpërthyer dhe i shihej organi gjenital jashtë. Mi grisi reçipetat fillova të lemeris dhe të qaj. Serbi tjetër u afrua dhe ma vendosi armën në gjoks. E veshur kisha qëllim që të dukem më e vjetër. Ai mi hoqi pantollonat. Më urdhëroj të ulem ... ishim afër traktorit”. Dhe fillon ta dhunoj në prezencën e personave tjerë që ishin në traktor. (Human Rights Watch, 2001c, f:187); (Latifi, 2011, f:206-215).

Këta vrasës në uniformë kishin vrarë shumë femra para dhe pas aktit të dhunimit e sidomos femra që ishin shtatëzëna. (OSCE, 2003a, kapitulli 16).

Sidomos pas fillimit të bombardimeve të NATO-së (pas 24 marsit 1999) në kërkim të këtyre grupeve kriminale serbe të veshura në uniforma të shtetit jugosllav, ishin sidomos të rinjtë, pleqtë me plis të bardhë, fëmijët, familjet e pasura, personat me handikap, aktivistët humanitar e politikë dhe mjekët. (OSCE, 2003).

Sipas raportueseve të HRW-së në një pikë kontrolli një polic me uniformë e pyet një nënë të re për gjinin e fëmijës që e mbante në duar, gruaje i'a kthen: është djalë. Polici e pyet prap: a ke mjaft qumësht për ta ushqyer. Po, kam mjaft ia kthen ajo. Polici i inatosur, ia rrëmben djalë nga dora dhe ia përplas në tokë. E kap prej rrobash nënën e mjerë, nxjerr thikën nga brezi dhe ia pret gjirin me një goditje të shpejtë.

Gjithë kjo çmenduri e një regjimi terrorist, e cila kishte filluar me vrasje, rrëmbime, arrestime, dhunime, deportime, dëbime në masë, ishte e planifikuar nga elita politike dhe ushtarake serbe. Ky projekt i spastrimit etnik kryhej përmes përdorimit të ushtrisë, policisë dhe forcave paramilitare kundrejt popullsisë civile shqiptare për të vetmen arsye se ishin të një kombi tjetër, të një gjuhe tjetër ndaj të cilëve shfryhej urrejtja shekullore. Ky terror shtetëror serb i aplikuar kundër popullsisë civile shqiptare të Kosovës mund të ilustruhet me ndjenjat e sëmuara të një polici të Çetës së Pirotit i cili ishte në përbërje të Detashmentit 87 të Njësisë Speciale të Policisë. Ky polic, gjatë

periudhës 25 mars-korrik 1998 kishte marr pjesë në vrasjen masive të 150 civilëve shqiptarë në rrethinat e Rahovecit. Sipas deklaratës publike të kolegut të tij Slllobodan Stojanović, ky polic, ia kishte prerë kokën një viktime të seksit mashkull dhe këtë kokë e kishte marr me vete, e kishte zier për tre ditë radhazi dhe nga ajo kafkë kishte nxjerr tre dhëmbë prej ari dhe e mban si trofe. Pas disa ditësh ky polic shkon me pushime në Serbi, kafkën e kishte marr me vete, dhe nga ajo kafkë kishte bërë një lambadar dhe e kishte vendosur tek koka e shtratit në dhomën e tij të gjumit. Por, gruaja i kishte mbetur keq pa një lambadar të tillë. Pas pushimit ishte kthyer prapë në Kosovë, kishte filluar prapë me krime të njëjta. Tani, ky kriminel pret një kokë femre shqiptare, të cilën e kishte prerë gjatë një operacioni policor. Nga koka e prerë e femrës kishte punuar edhe një lambadar për gruan e tij dhe i kishte vendosur krahas njëra tjetrës në dhomën e gjumit.



Figura 8. Llambadar nga kokat e shqiptarëve (Lampe od albanskih lobanja) (*Burimi i të dhënave: marr nga portali „e-novine” e Beogradit, datë 09.11.2013*)

Në intervistën e dhënë gazetarit Tonçiq, ish polici serb Slllobodan Stojanović kishte rrëfyer se si një koleg i tij, gjatë kohës së “pastrimit të terrenit” në zonën e Prizrenit, pa kurrfarë arsye e kishte therë një femijë 4 muajsh i cili ishte në djep, duke u krekosur se “me mirë një shqiptar i vdekur se një shqiptar i gjallë” (Toncic, 2013).

Kapitulli IV: Vrasjet në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës

4.1. Vrasjet në Kosovë me theks të veçantë në Rajonin e Pejës

Përkundër ndryshimeve politike në skenën kosovare dhe atë jugosllave, interesimi ynë ishte orientuar në hulumtimin e veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës edhe pas humbjes së autonomisë së Kosovës dhe rënies së saj nën tutelën serbe. Duke patur parasysh ndryshimet politike dhe aplikimin e legjislacionit për veprat e tilla penale, këtë periudhë kohore e kemi ndarë në dy etapa. Etapa e parë fillon nga data 23 mars 1989 dhe përfundon me 23 mars 1999, ndërsa etapa e dytë fillon nga 24 mars 1999 (fillimi i bombardimeve të NATO-së mbi caqet serbe në Serbi e Mal të Zi) dhe përfundon me 10 qershor 1999. Deri sa në pjesën e parë dëshmitë dhe dokumentacioni arkivor janë gjetur në arkivin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe në arkivin rajonal, pjesa e dytë është një çështje më vete që lidhet jo vetëm me shkeljet e ligjeve të brendshme por lidhet edhe me shkeljet e të drejtës ndërkombëtare siç janë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidi dhe shumica e dosjeve mungojnë. Sa i përket pjesës së parë, dëshmitë edhe pse mjaft të pakta, të sistemuara ashtu si janë gjetur në arkivin e gjykatës pas luftës dhe si të tilla janë dërguar në Arkivin Ndërkomunal në Pejë, janë të pjesshme, shumica prej çështjeve penale, përveç mbështjellësit nuk ka asnjë shkresë tjetër, mungojnë vendimet e gjykimit, ose janë gjetur ankesat drejtuar shkallës së dytë por nuk ka përgjigje (shkalla e dyte ishte Gjykata Supreme e Serbisë në Beograd). Edhe për një arsye tjetër duhet përmendur se në etapën e parë, mars - dhjetor 1989, në gjykatat e Kosovës është aplikuar ligji penal i Kosovës ndërsa me fillimin e vitit 1990 procedura penale dhe denimet janë shqiptuar në bazë të ligjeve të Serbisë sepse i tërë legjislacioni i Kosovës ishte abroguar bashkë me autonominë e saj.

Për zhvillimin dhe historiatin e kriminalitetit në Kosovë gjatë dekadave kur ajo ishte pjesë e federates jugosllave, kam përdorur të dhëna nga literatura kosoavre e cila përfshinë një periudhë që nga viti 1951 deri në vitin 1989. Sipas të dhënave që jep prof. Salihu del se në vitin 1951, në Kosovë ishin kryer 450 vrasje, në vitin 1952 ishin shënuar 501 vrasje ndërsa vetëm në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës, për tetë muaj ishin shënuar nëntë vrasje.

Bazuar në literaturën hulumtuese kosovare del se numri i përgjithshëm i vrasjeve në Kosovën e atëhershme ishte 372 vrasje, me një levizje nga 3.4 vrasje deri në 5.5 vrasje në 100.000 banorë. Sipas Salihut "...Kosova deri në vitin 1965 ka qenë një rajon me numër më të vogël të vrasjeve në krahasim me mesataren jugosllave që ishte me 3.6

vrasje në 100.000 banorë”. (Salihu, 1985, f:114-115).

Viti	Numri i banorëve	Numri i vrasjeve	1 Vrasje për banorë	Vrasjet në 100.000 banorë	Viti	Numri i banorëve	Numri i vrasjeve	1 Vrasje për banorë	Vrasjet në 100.000 banorë*
1957	873.000	45	19.400	5.1	1966	1.101.000	59	18.661	5.3
1958	890.000	31	28.709	3.4	1967	1.131.000	60	18.850	3.3
1959	921.000	33	27.909	3.5	1968	1.159.000	96	12.072	8.2
1960	944.000	52	18.153	5.5	1969	1.189.000	78	15.243	6.5
1961	972.000	42	23.142	4.3	1970	1.220.000	105	11.619	8.6
1962	997.000	52	19.173	5.2	1971	1.254.000	82	15.292	6.5
1963	1.021.000	33	29.171	3.4	1972	1.291.000	72	17.930	5.5
1964	1.046.000	41	25.512	3.9	1973	1.328.000	68	19.529	5.1
1965	1.075.000	41	26.219	3.8	1974	1.366.000	100	13.660	7.3
					1975	1.406.000	85	16.541	6.0
					1976	1.446.000	69	20.956	4.7
					1977	1.486.000	77	19.298	5.1
9		370		4.2	12		951		6.0

Tabela 2. Numri i vrasjeve në Kosovë nga viti 1957-1977 (*Burimi i të dhënave: Salihu, 1985*)

Gjatë periudhës 1966-1977 në Kosovë ishin kryer 951 vrasje, mesatarisht 79.2 vrasje në vit ose me pjesmarrje nga më e ulta nga 4.7 vrasje tek më e larta në 8.8 vrasje në 100.000 banorë. Sipas profesor Salihut, si shkak i rritjes kaq të madhe të vrasjeve në Kosovë kanë qenë ndryshimet politike që ndodhën pas Plenumit IV-të të Brioneve (1966) dhe zgjidhja e problemeve të së kaluarës përmes vetgjyqësisë dhe përdorimit të forcës fizike e cils kishte quar deri në vrasje. (Salihu, 1985a, f:116-117).

Gjatë periudhës 1975-1977 në territorin e Gjykatës së Qarkut në Pejë kishin ndodhur mesatarisht 16.5 vrasje në vit ose 6.1 vrasje në 100.000 banorë, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kishin ndodhur mesatarisht 39.8 vrasje në vit ose 9.9 vrasje në 100.000 banorë.

Në Gjykatën e Gjilanit kishin ndodhur mesatarisht 12.8 vrasje në vit ose 8.3 vrasje në 100.000 banorë, në Gjykatën e Prizrenit kishin ndodhur mesatarisht 9.5 vrasje në vit ose 4.3 vrasje në 100.000 banorë dhe në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kishin ndodhur

mesatarisht 8.3 vrasje në vit ose 4.2 vrasje në 100.000 banorë.

Ky trend i rritjes së veprave penale të vrasjes në Kosovë pason një rënje të vogël në vitet në vazhdim.

Viti	Numri i banorëve	Numri i vrasjeve	1 Vrasje në numër të banorëve	Vrasjet në 100.000 banorë
1978	1.487.000	83	17.915	5.5
1979	1.520.000	61	24.918	4.0
1980	1.556.000	75	20.746	4.8
1981	1.594.000	62	25.709	3.8
1982	1.636.000	67	24.417	4.0
1983	1.676.000	66	25.393	3.9

Tabela 3. Numri i vrasjeve në Kosovë nga viti 1978-1983 (*Burimi i të dhënave: Salihu, 1985*)

Dinamika e rënies së kriminalitetit dhe pjesmarrja e saj në kriminalitetin e përgjithshëm që ishte tre herë më e vogël se ajo e Jugosllavisë, ishte rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve në nivel vendi dhe ngritjes edukative arsimore. (Salihu, 1985b, f:120).

Në Kosovë, pas Luftës së Dytë Botërore, ishin kryer 370 vrasje. Në vitin 1960 kishin ndodhur me së shumti 52 vrasje, ose 5.5 vrasje në 100.000 banorë, mesatarisht 46.25 vrasje në vit, ose mesatarisht 3.78 vrasje në 100.000 banorë. Gjatë kësaj periudhe, më pak vrasje kishin ndodhur në vitin 1963 me vetëm 33 vrasje ose 3.4 vrasje në 100.000 banorë. Gjatë periudhës së dytë 1966-1977 (pas rënjes së ministrit serb të punëve të brendshme të Jugosllavisë, Plenumi i Brionëve, 1966), ishin kryer 951 vrasje, mesatarisht 79.2 vrasje në vit ose 6.17 vrasje në 100.000 banorë. Numri më i madh i vrasjeve kishte ndodhur në vitin 1970, me gjithsej 105 vrasje ose 8.6 vrasje në 100.000 banorë, ndërsa numri më i vogël i vrasjeve në këtë periudhë kishte ndodhur në vitin 1976 me gjithsej 69 vrasje ose 4.7 vrasje në 100.000 banorë.

Gjatë periudhës pesëvjeçare 1978-1983, në Kosovë ishin kryer gjithsej 414 vrasje, mesatarisht 69 vrasje në vit ose 4.33 vrasje në 100.000 banorë.

Në studimin e tij për „deliktet e gjakut” në Kosovë gjatë periudhës 1984-1987, autori Rexhep Gashi shkruan se kishin ndodhur 3.436 vepra penale kundër jetës dhe trupit. Me qëllim që të mos krijojmë paqartësi terminologjike, mendoj se duhet përdorur terminologjia e përcaktuar sipas Kodit Penal sepse përdorimi i termit “deliktet e gjakut” ka

një kuptim më specifik, i përdorur në terminologjinë kriminologjike jugosllave ku përfshihen posaçërisht veprat penale të vrasjes, vrasjet e mbetura në tentativë ose dëmtimet e rënda trupore me pasojë vdekjen.

Dinamika dhe vëllimi i “delikteve të gjakut” gjatë kësaj periudhe sipas autori Gashi përfshinë llojet e veprave penale, numrin e veprave penale në vit që sipas këtij autori korrespondojnë me numrin e personave të dënuar.

Llojet e delikteve të gjakut	Numri i personave të dënuar madhor sipas delikteve të gjakut									
	1980	1981	1982	1983	1984	1985	1986	1987	Σ	%
Vraje e rëndomtë (n.30.al 1)	97	122	44	73	51	45	94	60	587	17.0
Vrasje e kualifikuar (n.30 al 2)	25	24	9	9	18	22	25	21	153	4.5
Vrasje e shumëfishtë (n.30 al 3)	3	-	-	2	1	1	1	-	8	0.2
Vrasje në afekt (n. 33)	4	9	2	7	4	7	8	14	55	1.6
Vrasje nga pakujdesia (34 34)	4	4	3	-	2	5	-	8	26	0.8
Vr. e foshnj. gjate lindjes (n.35)	4	4	1	-	1	3	2	2	17	0.5
Shtytje në vetvrasje (n. 36)	-	-	-	-	-	-	2	1	3	0.09
Lëndim i rëndë trupor (n.38)	92	114	61	79	98	55	122	91	712	20.7
Lëndim i lehtë trupor (n.39)	244	326	189	292	215	206	214	190	1876	54.6
Gjithsej	473	603	309	462	390	344	468	387	3436	100.00

Tabela 4. Numri i personave të dënuar madhor sipas delikteve të gjakut (*Burimi i të dhënave: Gashi, 2003*)

Rreth strukturës së vrasjeve gjatë kësaj periudhe rezulton se 17% të totalit merrnin pjesë vrasjet e rëndomta, pastaj vinin vrasjet e kualifikuara me 4.5% dhe në fund, vrasjet në afekt merrnin pjesë me vetëm 1.6 %. Vrasje të rëndomta, më së tepërmi kishin ndodhur në vitin 1981, ku ishin kryer 122 vrasje ndërsa më së paku në vitin 1982 më 44 vrasje te tilla. Në kuadër të këtyre veprave më pak ishte paraqitur vepra penale e shtytjes në vetëvrasje dhe e dhëniës së ndihmës në vetëvrasje me vetëm 0.09%, ndërsa përqindjen më të lartë e zinte plagosja e lehtë me 54.6%. (Gashi, 2003, f:36).

Duke krahasuar të dhënat që kemi paraqitur në tabelat e mësipërme shihen ndryshime në vëllimin e veprave penale të vrasjeve në Kosovë pas vitit 1980. Sipas mendimit tonë ky ndryshim mund të jetë rezultat i të dhënave të ndryshme mes burimeve nga institucione të ndryshme federative dhe burimeve nga Enti i dikurshëm Krahinor i Kosovës.

Lidhur me vrasjet që kishin ndodhur në periudhën 1989-1999 në Rajonin e Gjykatës së Qarkut të Pejës, e cila kishte kompetenca territoriale në pesë komunat e Rrafshit të Dukagjinit, kemi një pasqyrë mjaft të mangët, për shkak se dosjet penale të cilat kanë qenë në këtë gjykatë ose janë shkatërruar ose janë tërhequr nga administra serbe mbas largimit nga Kosova në vitin 1999 dhe gjenden në Serbi. Për të arritur në këtë konstatim kemi disa arsye. E para, për disa nga “çështjet penale të ndjeshme” janë gjetur vetëm mbështjellësit e tyre dhe dosjet mungojnë. E dyta, gjenden dëshmi se palët kishin ndjekur procedurë ankimore në Gjykatën Supreme të Serbisë, por vendimi bashkë me dosjen nuk është në fashikull dhe e treta, me rastin e dorëzimit të dosjeve nga ana e Gjykatës së Qarkut të Pejës në arkivin Ndërkomunal në Pejë janë dorëzuar çështjet e përcjella me një regjister ku gjenden të evidentuara edhe ato çështje që iu mungon dosja.

Gjykuar sipas dosjeve të dorëzuara në Arkivin Ndërkomunal në Pejë, del se brenda periudhës 1989-1999, në Gjykatën e Qarkut në Pejë, ishin gjykuar 470 çështje të ndryshme penale nga të cilat 146 çështje penale kundër jetës dhe trupit. Duke u bazuar në të dhëna dytësore, forcohet bindja se në rajonin e Dukagjinit ka patur më shumë vepra penale të vrasjes, por mungojnë dosjet e tyre, sepse sipas autores Patiç- Simeunoviç vetëm në vitin 1998 ishin “paraqitur 49 fletëparaqitje për vepër penale të vrasjes”. (Patic-Simeunovic, 2003, f:35). (Savezno Javno Tuzilastvo Jugoslavije, 1965)

Sidoqoftë, në mungesë të dosjeve, edhe për një periudhë kohore, mbetet i paqartë numri i saktë i këtyre veprave penale, numri i personave të cilët kanë qenë të akuzuar dhe në pritje të vendimit (mbrojtja në liri), numri i personave të cilët kanë qenë në pritje të përgjigjes ankimore nga instancat e larta të gjyqësorit të Serbisë dhe të cilët për shkak të rrethanave të krijuara (luftës) nuk kanë marrë denimin e merituar.

Dyshimet tona rreth saktësisë së lëvizjes së kriminalitetit për periudhën që kemi në shqyrtim bazohen edhe në të dhënat kontradiktore nga vjetarët statistikor të Jugosllavisë së dikurshme dhe të Serbisë tani të cilat janë kontestuar edhe nga studiuesi kosovar profesor Ismet Salihu. Deri te të dhënat e dyshimta statistikore dhe “shkencore” të prezantuara në opinionin publik nga Enti Statistikor i Jugosllavisë, profesor Salihu kishte arritur duke i krahasuar të dhënat zyrtare mbi lëvizjen e kriminalitetit në Jugosllavi, me të dhënat e

Sekretariatit Federativ të Jurisprudencës për vitin 1963 sipas të cilit del se në këtë vit ishin vrarë 29.210 persona, ndërsa për vitin 1964 jep shifrën prej 28.244 persona të vrarë. (Salihu, 1985c, f:110). Se ky konstatim i profesor Salihut është i saktë del edhe nga tëdhenat krahasuese të statistikës zyrtare jugosllave dhe të dhenave zyrtare të Prokurorisë Publike Federative të Jugosllavisë. Sipas ketyre të dhenave del se, në vitin 1963 kishin ndodhur 28.954 vrasje ose 256 vrasje më pak, ndërsa në vitin 1964 kishin ndodhur 28.464 vrasje ose 220 vrasje më shumë sesa janë paraqitur në statistikat zyrtare. (Savezno Javno Tuzilastvo Jugoslavije, 1965a, f:31).

Sipas vjetarit statistikor të vitit 1997 në “Kosovë dhe Metohi” nga organet e ndjekjes ishin ushtruar 9.790 fletëparaqitje penale, nga të cilat 496 fletëparaqitje ishin ushtruar për veprat penale kundër jetës dhe trupit. Nga ky numër, 20 fletëparaqitje penale nuk ishin marrë në konsideratë nga organi i akuzës (Prokuroria), për 8-të kryes të kallëzuar në fletëparaqitje ishin ndërprerë hetimet ndërsa kundër 27-të të tjerëve ishin pushuar hetimet. Pra, nga 441 akuza sa ishin ngritur në Prokurorinë Publike Komunale dhe të Qarkut në Pejë, 132 ishin ngritur menjëherë pasi ishte kryer vepra penale, ndërsa 309 të tjera ishin ngritur pasi që ishin realizuar veprime hetimore paraprake. Nga ky numër i akuzave, në vitin 1997, gjykata kishte gjykuar vetëm 214 raste. Nga këto 214 çështje penale që lidhen me veprat penale të këtij kapitulli, gjykata kishte nxjerr 126 vendime dënimi dhe 88 vendime pafajësie. Nga këto 88 vendime pafajësie, 2 ishin padi subsidiare që ishin refuzuar, 5 çështje ishin pushuar, 17 autorë ishin shpallur të pafajshëm nga akuzat, kundër 2 të akuzuarve ishin caktuar masat e sigurimit personal ndërsa kundër 62 të akuzuarve gjykata e kishte refuzuar akuzën. (Republicki zavod Srbije, 1999, f:466, 469).

Nga 126 të akuzuarit për vepra të rënda penale janë dënuar me burgim 58 persona, 12 persona janë dënuar me gjobë, 55 persona janë dënuar me burgim me kusht, një është shpallur fajtor por është liruar nga dënimi. Ndërsa për numin e të akuzuarve sipas viteve: në vitin 1995 ishin 160 të akuzuar dhe në vitin 1996 për 197 të akuzuar nuk kemi të dhëna se si ka përfunduar çështja gjyqësore.

Sa i përket personave të mitur, kemi të dhëna se në vitin 1995, për vepra penale kundër jetës dhe trupit kanë qenë të akuzuar 14 të mitur, në vitin 1996 kanë qenë të akuzuar 22 të mitur ndërsa në vitin 1997 kanë qenë të akuzuar 12 të mitur. Nga këta 12 të mitur, 2 ishin të mitur të rinj ndërsa 10 ishin të mitur të vjetër. Nga ky numër, 8 janë dënuar ndërsa ndaj 4 të tjerëve janë caktuar masat e sigurisë. Përkundër kësaj statistike që i serviret

publikut zyrtarisht nga Serbia, të dhënat e tilla duhet marrë me rezervë për dy arsye: e para, duke iu referuar numrit të akuzuarve dhe atyre të gjykuar në Gjykatën e Qarkut të Pejës gjatë periudhës 1989-1999 e që janë gjetur në arkivin ndërkomunal në Pejë dhe të dhënave nga Enti i Statistikës nga Beogradi për këtë periudhë ka një dallim të madh si për nga numri i të akuzuarve ashtu edhe për nga lloji i veprave penale. Psh. sipas Entit të Statistikës së Serbisë (1997) ishin vetëm 11 të akuzuar (prej tyre vetëm 4 persona ishin shpallur fajtorë) madhor në territorin e Kosovës për veprat penale kundër Rregullimit shoqëror dhe sigurisë së RF Jugosllavise (Republicki zavod Srbije, 1999a, f:469, 471, 475, 479), që në fakt, sipas të dhënave nga Institucione kredobile ndërkombëtare (si HRW) numri i të arrestuarve dhe të dënuarve në Kosovë ishte shumë me i madh. E dyta, se të dhënat e paraqitura nga Enti Statistikor i Serbisë nuk janë të sakta dëshmojnë edhe dokumentacionet që janë gjetur në arkivin ndërkomunal në Pejë që i referohen kësaj periudhe kohore. Në arkivin ndërkomunal bashkë me 470 çështje të ndryshme penale të gjykuara, janë gjetur dy lista me emrat e qytetarëve pejan që ishin shpall në fletërreshtim nga SPB-ja e Pejës. Në listën e parë të datës 24.04.1998 nga SPB-ja në Pejë ishin shpallur në kërkim të 523 qytetar të Pejës me rrethinë, ndërsa në listën e dytë të datës 30.04.1998 ishin shpallur në kërkim policor 519 persona. Pra, nga SPB-ja në Pejë ishin shpallur në kërkim mbrenda 6 ditësh gjithsej 1.042 qytetar të Pejës pa shpjeguar arsyet. (Fondi: Burgu i Qarkut, 1988).

4.2. Vrasjet në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës – krahasimet dhe ngjashmëritë

Në bazë të Rezolutes 1244 të KS-së të OKB-së, pas 10 qeshorit 1999, UNMIK-u ishte i vetmi “administrator” në Kosovë (sipas nenit 19) “...për një periudhë fillestare prej 12 muajsh...” (United Nations S/RES/1244 (1999)). Me rregulloren mbi strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative të Kosovës, të datës 14 janar 2000, UNMIK-u përfundimisht i shuan institucionet e Republikës së Kosovës, edhe pse pse në nenin 1 pika (a) shkruante se “...forcat politike të Kosovës ndajnë udhëheqjen e përkohshme administrative me UNMIK-un”, menjëherë në vazhdim të kësaj frazë shkruan se “Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mban autorizimet ligjvënëse dhe ekzekutive”.(UNMIK/REG/2000/01)

Organogrami i pushtetit të UNMIK-ut në Kosovë ishte aprovuar nga OKB-ja në New Yorku (UN Security Council S Distr.General S/1999/779) dhe bazohej në katër Shtylla (I: Policia dhe Drejtësia, II: Administrata Civile, III: Demokratizimi dhe ndërtimi i Institucioneve dhe IV: Rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik) dhe 14 Departamente.

Departamenti i drejtësisë bënte pjesë në shtyllën e parë dhe bashkë me sektorin e sigurisë ishin e drejtë e rezervuar e UNMIK-ut, ku përfshihet i tërë sistemi të drejtësisë, mënyra dhe kompetencat e përzgjedhjes së prokurorëve, gjyqtarëve (neni 4), ndihmës gjyqtarëve (porotëve), mënyra e shkarkimit të tyre (UNMIK/REG/1999/18), mënyra e inicimit të procedurës penale (neni 1 dhe neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut nr 1999/7), përzgjedhja dhe angazhimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve ndërkombëtar (UNMIK/REG/2000/13), administrimi i gjykatave, prokurorive dhe i sistemit të penitenciar. (UNMIK/REG/2000/15). Me përzgjedhjen e gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe vendorë në raste të caktuara, fillon funksionalizimi i një “drejtësie hibride” (Bassiouni, 2003, f:557) e cila ishte në kompetencë të Kryeadministratorit të Kosovës. (UNMIK/REG/1999/6).

Krijimi i një sistemi të tillë “hibrid” të drejtësisë e ka zanafillën e saj në rregulloren e UNMIK-ut “Për ligjin në fuqi në Kosovë” sipas së cilës, ligjet në fuqi në Kosovë ishin rregulloret e UNMIK-ut dhe “instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe (b) legjislacioni në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989”. Sipas kësaj rregulloreje, nëse një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni në fuqi ,,... atëherë mund të përdoren edhe ligje të tjera që kanë qenë në fuqi në Kosovë pas datës 23 mars 1989 nëse “...nuk është diskriminues”. (UNMIK/REG/1999/24). Me këtë rregullore mbeten në fuqi edhe një mori ligjesh të cilat ishin nxjerrë nga pushteti i administrimit të dhunshëm të Serbisë mbi Kosovën që në fakt krijoi një defekt ligjor të pariparueshëm edhe një dekadë më pas.

Në fushën penale filloj aplikimi i ligjit penal të Kosovës, me përjashtim të nenit 30 par 2 sipas të cilit parashihej dënimi me vdekje. Me plotësimin e kësaj rregulloreje, në nenin 1.6 thuhej “Për çdo vepër penale për të cilën sipas ligjit në fuqi në Kosovë të datës 22 mars 1989 parashikohet dënim me vdekje, dënimi do të jetë me burgim ndërmjet minimumit që parashikohet për atë vepër dhe maksimumit prej dyzet (40) vitesh » dhe se ky nen mund të aplikohet vetëm për ato vepra të rënda penale të kryera pas datës 27 tetor 2000. (Për ndryshimin e Rregullores 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë, UNMIK/REG/2000/59, 27 tetor 2000). Mosaplikimi i ligjeve të Kosovës para vitit 1989, aplikimi i ligjeve të ndryshme të shtetit jugosllav në Kosovë dhe mënyra e nxjerrjes së rregulloreve jashtë çdo procedure kuvendore (ishte kompetencë ekskluzive e kryeadministratorit), kishte krijuar një problematikë të jashtëzakonshme në krijimin dhe forcimin e sistemit unik të drejtësisë në Kosovë duke i lënë hapësirë aplikimit të sistemit paralel serb në një territor që nuk kishte sovranitet. (OSCE, 2003b); (OSCE, 2007, f:18).

Funksionimi i këtyre institucioneve paralele të Serbisë (sistemi i gjyqësisë, sigurisë, shëndetësisë, postës kadastrit dhe gjeodezisë, etj.) nëpër lokalitete të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës i lejuar nga strukturat e UNMIK-ut, ka shkaktuar “diverzion juridik” dhe një pasiguri juridike në Kosovë. Disa nga këto organe paralele janë dislokuar dhe funksionojnë në emër të Kosovës, brenda territorit të Serbisë, në qytetet Leskovc, Kragujevc, Vranjë, Nish, Kralejë e gjetiu. Policia paralele serbe dhe prokuroritë paralele serbe, kanë iniciuar procedura penale kundër serbëve që kishin kryer vrasje të rënda në Kosovë. Kjo formë e paprecedentë e funksionimit të sistemit paralel të drejtësisë ka shkaktuar mosbesim dhe pasiguri te qytetarët sepse autorët e veprave të rënda penale në momentin që merrnin informacion se po kërkoheshin nga drejtësia në Kosovë, iknin në Sërbë me qëllim të ikjes nga drejtësia, ose edhe nëse hetoheshin, gjykatat paralele serbe që gjykonin në emër të Kosovës i dënonin më butë. (OSCE, 2007a).

Përveç sistemit të drejtësisë edhe sistemi i sigurisë ishte në kompetencën e UNMIK-ut. Pas rikonfigurimit të UNMIK-ut, policia e saj ishte vendosur në pesë qendra kryesore të Kosovës dhe në 35 stacione policore me mbi 4450 policë ndërkombëtar (CIVPOL) në krye të së cilës ishte emëruar një komisioner. (UNMIK, 2004, f:6). Detyrë e tyre ishte ruajtja e rendit dhe qetësisë e cila ndihmohej edhe nga KFOR-i dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

Përkunder ndihmës në organizimin dhe riformimin e policisë së Kosovës, përkunder ndihmës në ruajtjen e rendit dhe qetësisë që kanë ndihmuar shumë vende me policë profesionistë, UNMIK-u ka neglizhuar dhe ka lejuar funksionimin e strukturave paralele të policisë së Serbisë në territorin e Kosovës pas 10 qershorit 1999. Këto struktura paralele në fushën e sigurisë kanë ndikuar në mënyra të ndryshme në paqëndrueshmërinë e rendit publik në Kosovë, në rritjen e kriminalitetit në përgjithësi, krimit të organizuar, trafikimit të qenjeve njerëzore dhe në krijimin e një ambienti të pasigurtë dhe të paqëndrueshëm për pakicat kombëtare në Kosovë. (International Crisis Group, 2002); (OSCE, 2007b, f:30).

Pra, në një shoqëri të tillë me defekte në organizimin e drejtësisë dhe jofunksionale në aspektin e funksionimit të ruajtjes së rendit dhe ligjit, mungesa e hapsirës për banim, mungesa e vendeve të punës, numri i madh i armëve të cilat ishin si pasojë e daljes së shoqërisë kosovare nga lufta, ishin disa nga parakushtet e favorshme që kanë ndikuar në rritjen e kriminalitetit në përgjithësi dhe të rritjes së numrit të veprave penale kundër jetës dhe shëndetit në veçanti.

Sipas të dhënave të paraqitura në Qendren për Studime të Sigurisë në Bruksel nga ish shefi i shtyllës së parë të UNMIK-ut, Jean – Christian CADY (ish- shef në dikasterin e

Drejtësisë dhe Policisë në Administratën e UNMIK-ut), në Kosovë numri i vrasjeve kishte pësuar rënie “nga 500 vrasje në gjashtë muajt e parë të misionit 1999, ka rënë në 245 në vitin 2000 dhe në 68 në vitin 2002” (Cady, 2012, f:23). Përkundër këtyre të dhënave të këtij ish zyrtari të lartë të UNMIK-ut në Kosovë, të dhënat e OKB-së të vitit 2005 për vrasjet në Kosovë tregojnë të kundërtën.



Figura 9. Numri i vrasjeve në 100.000 banorë në Kosovë 2000-2005 (*Burimi i të dhënave: Legget, 2008*)

Duke i krahasuar të dhënat zyrtare të paraqitura nga OKB-ja, rreth numrit të vrasjeve për 100,000 banorë në Kosovë dhe të dhënave të ish – drejtorit të Departamentit të Drejtësisë në Kosovë, Cady, hasim në një mospërputhje për periudhën 1999-2000 e në vazhdim. Numrin prej 500 vrasjeve që përmend Cady, nuk janë kryer në Kosovë mbrenda periudhës 6 mujore, por janë kryer mbrenda një viti e gjysmë. Pra, sipas të dhënave të paraqitura nga OKB-ja, në vitin 2000 në Kosovë janë paraqitur 11.8 vrasje të kryera për 100.000 banorë, në vitin 2001 kishte 9.4 vrasje për 100.000 banorë, në vitin 2002 kishte 5.0 vrasje për 100.000 banorë, në vitin 2003 kishte 3.6 vrasje për 100.000 banorë, në vitin 2004 kishte 3.2 vrasje për 100.000 banorë ndërsa në vitin 2005 kishte 2.9 vrasje për 100.000 banorë.

Kjo pasaktësi del si rezultat i krahasimit mes të dhënave zyrtare të paraqitura nga zyra e OKB-së dhe të dhënave zyrtare nga Policia e Kosovës qoftë për nga numri qoftë për nga përqindja për 100.000 banorë. (Shih më poshtë figurën nr. 10)




Figura 10. Numri i përgjithshëm i vrasjeve sipas viteve 1999-2017 në Republikën e Kosovës (Burimi i të dhënave: Policia e Republikës së Kosovës (1999- 2017))

Duke e marr mesatarën e popullësisë së Kosovës (prej 2.400.000 banorësh në vitin 2001 (Legget, 2008:38-39) dhe numrit të regjistrimit të banorëve në regjistrimin zyrtar të popullësisë së Kosovës në vitin 2011 prej 1.739.825 banorë) prej 2.069.912 banorë, atëherë rezulton se në gjashtë mujorin e dytë të vitit 1999 janë regjistruar 245 vrasje ose 10.20 vrasje për 100.000 banorë, në vitin 2000 ishin 256 vrasje ose 10.70 vrasje për 100.000 banorë, në vitin 2001 ishin 185 vrasje ose 7.70 për 100.000 banorë, në vitin 2002 kishte 91 vrasje ose 3,79 vrasje për 100.000 banorë, në vitin 2003 kishte 72 vrasje ose 3 vrasje për 100.000 banorë, në vitin 2004 kishte 79 vrasje ose 3,29 vrasje për 100.000 banorë dhe në vitin 2005 kishte 69 vrasje ose 2,9 vrasje për 100.000 banorë. Duhet theksuar se nga viti 2005 e në vazhdim kemi një rënie të veprave penale të vrasjes. Në vitin 2016 janë regjistruar vetem 26 vrasje në nivel vendi ose me vetem 1.49 vrasje për 100.000 banorë. Ky trend i rënies së vrasjeve ka vazhduar edhe në gjashtë mujorin e parë të vitin 2017 ku janë regjistruar 13 vrasje ose 0.74 vrasje për 100.000 banorë. (Tabela 5).

Vrasjet në Kosovë (qershor 1999-qershor 2017)			
1999-2017		Sipas Legjet 2.400.000 banorë (2001)	sipas mesatarës së popullsisë prej 2.069,912 banorë (1999-2011)
Vitet	Vrasjet	100.000 banorë	100.000 banorë
1999	245	10.20	11.8
2000	256	10.70	12.36
2001	185	7.70	8.93
2002	91	3.79	4.39
2003	72	3.00	3.47
2004	79	3.29	3.81
2005	69	2.90	3.33
2006	61	2.54	2.94
2007	68	2.83	3.28
2008	57	2.37	2.75
2009	53	2.21	2.56
2010	61	2.54	2.94
2011	48	2,00	2.31
2012	55	2.29	2.65
2013	39	2.24	1.88
2014	35	2.01	1.69
2015	25	1.43	1.20
2016	26	1.49	1.25
2017*	13	0.74	0.62
Σ	1.538		
mesatare/vit	80.94	3.48	3.90

Tabela 5. Vrasjet në Kosovë gjatë periudhës qershor 1999-qershor 2017 (*Burimi i të dhënave: (Policia e Kosovës, (2013),(2014),(2015),(2016) fq:7); (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, 15 qeshor, 2017*)*)

Përafërsisht një trend i tillë vrasjeve është shënuar edhe në Slloveni, Kroaci dhe BiH, (njësoj si Kosova, ku ka patur luftë) dhe në Malin e Zi dhe Maqedoni ku nuk ka pasur luftë. Në Republikën e Kroacisë nga viti 1992 deri në vitin 1997 është shënuar një rënie e

vrasjeve, ku janë shënuar 7.38 vrasje për 100.000 banorë dhe 23.2 dëmtime të rënda trupore për 100.000 banorë; Sllovenia kishte 4.9 vrasje dhe 20.9 dëmtime trupore për 100.000 banorë; Hungaria 4.3 vrasje dhe 79.3 dëmtime të rënda trupore për 100.000 banorë; Italia me 4.7 vrasje dhe 36.7 dëmtime të rënda trupore për 100.000 banorë dhe Austria me 2.5 vrasje dhe me 2.5 dëmtime të rënda trupore për 100.000 banorë. (Dujmovic, 1997, fq.46). Në periudhën 1998-2010, kriminaliteti i përgjithshëm në Kroaci kishte shënuar një rritje nga 32.239 çështje penale sa kishte në vitin 1998 në 55.924 vepra penale në vitin 2010 ose 76,3% më shumë. Përkundër rritjes së kriminalitetit të përgjithshëm me 57,5% gjatë vitit 1998 në 76,3% në vitin 2010, veprat penale kundër jetës dhe trupit kishin shënuar rënie nga 105 vrasje në vitin 1998 në 49 vrasje në vitin 2010 ose 7,0% të pjesmarrjes së numrit të përgjithshëm të veprave penale, duke pësuar rënie në 2,2%. (Vukedin, 2011, fq.376-377). Sipas autores Semeunović – Patiç e cila duke u marr me fenomenin e vrasjeve në Serbi gjatë kohës së luftrave të fundit në ish Jugosllavi shkruan se “...vrasjet (...) definitivisht dhe para së gjithash mbeten një fenomen rural, posaçërisht problem i qyteteve të mëdha të Serbisë” mes të cilave ishte edhe Beogradi i cili kishte arritur nivelin 4.7 vrasje për 100.000 banorë. (Patic- Simeunovic, 2003a, :35). Sipas të dhënave nga viti 1997 në Serbi kishin ndodhur 297 vrasje që do të thotë se për çdo ditë ishin vrarë nga 0.8 persona. (Republicki Zavod za Statistiku, 2010, f:66).

4.3. Vrasjet në Kosovë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurt 2008), UNMIK-u nuk kishte më kompetenca ekzekutive, por në përputhje me Pakon e Ahtisarit ai kishte një rol mbikëqyrës. Institucionet e zbatimit të ligjit ishin pavarësuar (policia, gjykatat, doganat etj), por ishin nën monitorimin EULEX-it, një mision europian për zbatimin e ligjit. Pas Shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008 e deri më sot, në Republikën e Kosovës, është shënuar një rënie të kriminalitetit të vrasjeve dhe veprave të tjera kundër jetës dhe trupit.

Sipas burimeve zyrtare të Policisë së Kosovës, në Rajonin e Pejës, pas datës 10 qershor 1999 (vendosja e misionit të UNMIK-ut në Kosovë) deri në qershor të vitit 2017, me një dinamikë të ndryshueshme nga viti në vit, janë regjistruar 354 vrasje. Derisa në vitin 1999 në Pejë janë regjistruar 22 vrasje ose 6.98 vrasje për 100.000 banorë, në vitin 2000 në Pejë kishte 53 vrasje në vit ose 16.83 persona të vrarë për 100.000 banorë, 4.4 persona të vrarë në muaj, ose llogaritur në ditë, del se në çdo ditë të vitit Peja kishte 0.87 persona më pak. Në vitin 2016, Peja kishte vetem 2 persona të vrarë në vit ose 0.56 persona të vrarë për 100.000 banorë. Derisa vrasjet kishin shënuar rënie, vrasjet e mbetura në tentativë, pas vitit 2009 deri në vitin 2015 kishin shënuar rritje. Gjatë kësaj periudhe janë

regjistruar gjithsej 148 vrasje të mbetura në tentativë ose me 7.78 vepra të tilla në vit.

Kjo rënie e kriminalitetit të vrasjeve mund të shpjegohet me faktin se që nga viti 2005 në vazhdim efektshmëria e policisë në zbulimin e autorëve të vrasjeve sa vjen e rritet.

Gjatë kësaj periudhe janë zbuluar 354 vepra penale të vrasjes dhe vrasjes së mbetur në tentativë, nga të cilat 214 janë vepra penale të vrasjes dhe 96 janë vrasje të mbetura në tentativë. Para organeve të drejtësisë janë nxjerr 245 autorë të vrasjes nga të cilët 231 ishin meshkuj dhe 14 ishin femra. Nga 148 vepra penale të vrasjes të mbetura në tentativë janë zbuluar 96 vrasje të mbetura në tentativë me 80 autorë të kësaj vepre penale që të gjithë meshkuj. (Tabela 6)

Vëllimi dhe dinamika e zbulimit të veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës (1999-2017)												
Vitet	Vrasjet			Vrasje në tentativë			autorët e njohur të v.p. të vrasjes		autorët e njohur të v.p. të vrasjes në tentativë		zbulueshmëria e v.p. të vrasjes	zbulueshmëria e tentim vrasjes
	Σ	Zbuluar	Nën hetim	Σ	Zbuluar	Nën hetim	M	F	M	F	%	%
1999	22	5	17	4	2	2	7	/	2	/	22,72	50,00
2000	53	15	38	1	1	/	16	/	1	/	28,30	100,00
2001	26	16	10	9	5	4	16	/	5	/	61,54	55,55
2002	32	12	20	9	5	4	12	1	5	/	37,50	55,55
2003	29	15	14	5	4	1	15	1	4	/	51,72	80,00
2004	23	11	12	5	/	5	9	2	/	/	47,83	0,00
2005	15	7	8	2	/	2	6	1	/	/	46,67	0,00
2006	20	13	7	8	3	5	6	1	2	/	65,00	37,50
2007	21	17	4	5	3	2	18	2	3	/	80,95	60,00
2008	11	11	/	5	4	1	10	1	4	/	100,00	80,00
2009	14	14	/	4	2	2	13	2	2	/	100,00	50,00
2010	20	18	2	11	9	2	17	2	/	/	90,00	81,82
2011	11	11	/	17	13	4	11	/	13	/	100,00	76,47

2012	21	17	4	11	9	2	18	/	9	/	80,95	81,82
2013	18	16	2	11	11	/	21	1	17	/	88,89	100,00
2014	11	9	2	15	9	6	11	/	13	/	81,82	60,00
2015	3	3	/	15	10	5	15	/	/	/	100,00	66,67
2016	2	2	/	6	4	2	6	/	/	/	100,00	66,67
2017	2	2	/	5	2	3	4	/	/	/	100,00	40,00
Gjithsej	354	214	140	148	96	52	231	14	80	/	60,45	64,86

Tabela 6. Vëllimi dhe dinamika e zbulimit të veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës (1999-2017) (*Burimi i të dhënave: Zyra për informim e DPP-së në Pejë, datë 15.06.2017*)




Figura 11. Numri i përgjithshëm i vrasjeve sipas viteve 1999-2017 në Gjykatën e Qarkut të Pejës (*Burimi i të dhënave: Zyra për informim e DPP-së në Pejë*)

Kapitulli V: Fenomenologjia e vrasjeve në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës (1989-2017)

Në aspektin penal juridik, vrasja është humbja e një jetë e shkaktuar me përdorimin e dhunës, me dashje ose edhe nga pakujdesia e personit tjetër. (Herring, 2013, fq.288) Rreth formave, strukturës dhe dinamikës së kriminalitetit në përgjithësi dhe paraqitjes së fenomenologjisë kriminale janë marrë shumë autorë. Duke analizuar fenomenologjinë kriminale, disa autorë mendojnë se ajo duhet të merret me simptoma të jashtme (Hugo Gros), përshkrimin e formave të paraqitjes dhe të kryerjes së krimit (Selig), ndikimi i tij në botën e jashtme (Roland Grasberger) studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit dhe të autorëve të tyre (Zhan Pintal). Sipas autorit Halili “fenomenologjia kriminale duhet të koncentrohet në studimin e statikës, dinamikës dhe tipologjisë së formave të manifestimit të krimit dhe sjelljeve delikuede”. (Halili, 2016a, f:115). Ndërsa sipas autores Vasilika Hysi, në kriminologjinë teorike studiohen përveç të tjerash fenomenologjia kriminale “d.m.th. format e shfaqjes së kriminalitetit, struktura e tij dhe faktorët sociale dhe individuale që ndikojnë në kriminalitet”. (Hysi, 2000a, f:12). Autorët Luan dhe Genci Gjonçaj me të drejtë konstatojnë se fenomenologjia kriminale “studion në tërësi format e veprimeve kriminale, ndikimin e faktorëve të jashtëm mbi mënyrat e sjelljeve të jetesës së autorëve të veprave penale si dhe dinamikat përkatëse në kohë dhe hapësirë”. (Gjonçaj & Gjonçaj, 2013, f:124). Ndërsa autori Millutinoviç mendon se fenomenologjia kriminale studion “format paraqitëse, strukturën, ndryshimet strukturale dhe dinamikën e kriminalitetit”. (Millutinoviç, 1981, f:193). Ndërsa sipas autorit Demolli, fenomenologjia merret me studimin e aspektit të jashtëm të krimit përgjithësisht formave përmes të cilave manifestohet duke përfshirë vendin, dinamikën dhe vëllimin e kriminalitetit në një periudhë të caktuar. (Demolli, 2006, f:46).

Lidhur me vëllimin, strukturën, dinamikën e kriminalitetit dhe zbardhjen e fenomenologjisë kriminale, është e pashmangshme ndihma e statistikës e cila më së miri pasqyron lëvizjen e tij qoftë në nivel lokal, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar. Falë të dhënave statistikore, kemi paraqitur vëllimin, dinamikën dhe strukturën e vrasjeve dhe veprave të tjera kundër jetës dhe shëndetit në Kosovë dhe veçanërisht në Rajonin e Pejës gjatë periudhës 28 vjeçare (1989-2017), brenda dy periudhave të ndryshme (dekada e fundit e shek. XX-të dhe dekada e parë e shek. XXI-të), nën regjimin e dy shteteve të ndryshme dhe një administrate ndërkombëtare.

Vëllimi dhe dinamika e veprave penale kundër jetës dhe shëndetit sipas ligjit penal të Kosovës (1977) dhe LPS gjatë periudhës 1989-1999											
Viti	Vrasje (neni 30)	Vrasje ne tentative neni 30-19 LPJ	Vrasje e çastit (neni 34)	Pakujdesia (neni 34)	V. foshnj. gj. Lindjes	Shty. ne vetvrasje	Lendim i rende (neni 38)	Lendim i lehte (neni 38)	Gjakmarrja neni 30 par 4)	Hakmarrja (neni 30 par.3)	Gjithsej vepra
1989	7	3		1			4	1		1	17
1990	13	4					1	1			19
1991	11	6					2	1			20
1992	6	6						1			13
1993	6	3		1				3			13
1994	6	5						1			12
1995	6	4			1		1	1		1	14
1996	11	2					1	1			15
1997	14	6					1	1			22
1998	2	1								1	4
1999	1	1									2
Gjiths ej	83	41	/	2	1	/	10	11	/	3	151
	neni 47	neni 47- 19 LPJ	neni 48	neni 49	neni 50	neni 51	neni 53	neni 54		nen 47/4	
Veprat penale kundër jetës dhe shëndetit sipas ligjit penal të Serbisë (1990 i aplikuar pas suprimimit antikushtetues të autonomisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës											

Tabela 7. Vëllimi dhe dinamika e veprave penale kundër jetës dhe shëndetit sipas ligjit penal të Kosovës (1989-1999) (*Burimi i të dhënave: Agjensioni shtetëror i Arkivave të Kosovës – Arkivi Regjinal Pejë, Fondi: Gjykata e Qarkut (1989-1998)*)

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme del se në periudhën kohore 1989-qeshor 1999, në Rajonin e Pejës kanë ndodhur gjithsej 151 vepra penale kundër jetës dhe trupit. Prej këtyre kemi 83 vrasje, tre vrasje që janë kryer me qëllimin e hakmarrjes, dy vrasje nga pakujdesia, një vrasje të foshnjës gjatë lindjes, 41 vrasje të mbetura në tentativë, 10 dëmtime të rënda trupore dhe 11 dëmtime të lehta trupore.

Vëllimi i vrasjeve në Rajonin e Pejës					
Mars 1989 – 09 qershor 1999			Nga 10 qershor 1999 – qershor 2017		
Vitet	Vrasjet	100.000 banorë	Vitet	Vrasjet	100.000 banorë
1989	7	1.69	07.1999	22	7.12
1990	13	3.13	2000	53	17.16
1991	11	2.65	2001	26	8.41
1992	6	1.44	2002	32	10.36
1993	6	1.44	2003	29	9.40
1994	6	1.44	2004	23	7.45
1995	6	1.44	2005	15	4.85
1996	11	2.65	2006	20	6.48
1997	14	3.38	2007	21	6.80
1998	2	0.48	2008	11	3.56
1999**	1	0.24	2009	14	4.53
			2010	20	6.48
			2011*	11	3.56
			2012	21	6.80
			2013	18	5.82
			2014	11	3.56
			2015	3	0.97
			2016	2	0.64
			2017	2	0.64
Σ	83	1.98		354	5.88

Tabela 8. Skema krahasimore e vëllimit të vrasjeve në Rajonin e Pejës në periudhat 1989 – 09 qershor 1999 dhe 10 qershor 1999 – qershor 2017 (*Burimi i të dhënave: Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore, Prishtinë*)

*Sipas ASK-së në regjistrimin e fundit (2011) Rajoni i Pejës kishte 308.810 banorë.

***(Enti republikan i Serbisë, 1999, fq:29) (Статистички годишњак Србије), Rajoni i Pejës në vitin 1991 kishte 414.187 banorë.*

Pavarësisht ndryshimeve në kohë, në dy periudha të ndryshme historike, në dy regjime shtetërore të huaja dhe diktatoriale, nën një regjim të përzier (UNMIK-u, IPVQ-ja) dhe në periudhën e Pavarësisë (pas 17 shkurtit 2008), krahasimet kanë dhënë rezultate interesante. Edhe pse me të dhëna të kufizuara, rezultatet që kanë dalë nga ky studim

dëshmojnë se nën regjimin antidemokratik Serbisë, veprat penale të vrasjes dhe veprat e tjera kundër jetës dhe trupit kanë shënuar rënie të vazhdueshme e cila përfundon në vitin 1999. Duke iu referuar statistikave zyrtare të kohës del se në Rajonin e Pejës gjatë vitit 1991 janë kryer 0.24 vrasje për 100.000 banorë.

Siç shihet nga tabela e mëposhtme, gjatë periudhës 1999-2014, në Kosovë janë regjistruar 1.447 vrasje. Shikuar në aspektin kumulativ, në Kosovë, mesatarisht ka patur 96 vrasje në vit, me 8.04 vrasje në muaj. Sipas statistikave zyrtare, nivelin me të lartë të vrasjeve e kishte Rajoni i Prishtinës me 465 vrasje në vit, Rajoni i Pejës ishte në vendin e dytë me 330 vrasje. Në vend të tretë vjen Prizreni me 226 vrasje, Mitrovica me 189 vrasje në vit, Mitrovica e Veriut me 42 vrasje në vit, Gjilani me 103 vrasje dhe Ferizaj me 92 vrasje në vit.




Figura 12. Numri i vrasjeve sipas ndarjes rajonale në Kosovë (1999-2014) *(Burimi i të dhënave: Policia e Republikës së Kosovës)*

Që nga viti 1999-2002, në Kosovë, trendi i vrasjeve ishte në rritje, ndërsa në vitet në vazhdim vrasjet kishin shënuar një rënie të ndjeshme në nivel vendi dhe në nivel rajonal. Një trend i tillë i uljes së kriminalitetit të vrasjeve nuk e ka shoqëruar Rajonin e Pejës sepse në vitin 2012 kishte 21 vrasje ose 10 vrasje më shumë se në vitin paraprak.

Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me dy periudha kohore, në tabelën e mëposhtme po paraqesim të dhënat mbi dinamikën e vrasjeve për periudhën 23 mars 1989 - 09 qershor 1999 dhe 10 qershor 1999 – 2017 të cilat kanë ndodhur në Rajonin e Pejës.




Figura 13. Veprat penale të vrasjes në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës (1989 – qeshor 1999)

Duke shikuar nga figura më sipër shohim se në territorin e Gjykatës së Pejës në periudhën 1989 – qeshor 1999 janë regjistruar gjithsej 151 çështje penale nga kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe trupit të gjykuara nga të cilat vetëm 83 janë vepra penale të vrasjes.




Figura 14. Vëllimi dhe struktura e veprave penale të vrasjes të gjykuara në Gjykatën e Qarkut në Pejë (1989-1999)

Në krahasim me periudhën paraprake, në periudhën qeshor 1999-2017 numri i çështjeve të gjykuara për veprat penale të vrasjes është gjithsej 354.




Figura 15. Vëllimi i veprave penale të vrasjes të gjykuara në Gjykatën e Qarkut në Pejë, qeshor 1999-2017

Duke u bazuar në të dhënat e lartëshënuara del se gjatë periudhës së pushtimit serb të Kosovës, në vitet 1989-1999, veprat penale kundër jetës dhe shëndetit kanë shënuar rënie, ndërsa në periudhën e dytë (1999-2017) 1999- 2000 kemi një rritje e që më pas siç shihet edhe në diagrama kemi një rënie të numrit të vrasjeve. Gjatë kësaj periudhe, vetëm në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës janë regjistruar gjithsej 354 vrasje nga të cilat 214 raste janë zbuluar dhe gjykuar në këtë gjykatën e Qarkut të Pejës.

Bazuar në dosjet e krimeve të kryera nga ky kapitull të cilat i takojnë dy periudhave të ndryshme kohore pas krahasimit të tyre kanë dhënë rezultatet të ndryshme.

E para, karakterizohet me një regjim policor ushtarak okupues dhe të huaj ndërsa periudha e dytë karakterizohet me një administrim “shumë ngjyrësh” ndërkombëtar dhe me një “sistem hibrid” të drejtësisë dhe sigurisë.

Për nga struktura e veprave penale edhe Kodi i Përkohëshëm Penal ((UNMIK/RREG/2003/25), në kuadër të veprave penale kundër jetës dhe trupit, përveç disa ndryshimeve të vogla, pothuaj kishte të njejtën strukturë të veprave penale që ishin të parashikuara edhe në ligjin penal të Kosovës.




Figura 16. Struktura dhe vëllimi i veprave penale të gjykuara në Gjykatën e Qarkut të Pejës 1999-2017

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme del se gjatë periudhës 1999-2017 kemi 354 vrasje nga të cilat 245 vrasje kanë qenë vrasje për motive të dobëta. Në kuadër të vrasjeve të cilësuar 76 vrasje janë kryer nga motive të ndryshme, 2 vrasje të kryera për shkak të gjakmarrjes, 15 vrasje të kryera nga motivi i hakmarrjes dhe 11 vrasje të kryera ndaj fëmijëve. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 3 vrasje të kryera në gjendje të tronditjes psikike (neni 148 i KPPK-së), një vrasje e kryer nga pakujdesia dhe një vrasje e foshnjës gjatë lindjes. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur 27 vepra penale të plagosjes së lehtë (neni 189 KPK) dhe 23 vepra penale të plagosjes së rëndë (neni 188 KPK).

Gjatë periudhës 1989 – qeshor 1999, po të shikohet sipas përqindjes, atëherë, nga totali i veprave penale kemi 52% vepra penale të vrasjes, 28% të totalit janë vrasje të mbetura në tentativë, 1% vrasje të rënda, 1% vrasje nga pakujdesia, 1% kemi vrasje të dyfishta, 1% kemi vrasje të fëmijëve 2% vrasje nga hakmarrja, 7% plagosje të rënda dhe 7% plagosje të lehta.




Figura 17. Vepra penale kundër jetës dhe trupit gjatë periudhës 1989-1999

Parë për nga struktura e llojeve të veprave penale të kryera kundër jetës dhe trupit në periudhën 1989 – qeshor 1999 mund të themi se kemi të bëjmë me një llojshmëri të këtyre veprave penale.

Me miratimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, veprat penale kundër jetës dhe trupit ishin parashikuar në kapitullin e XV-të. Ky kod ka sjell disa vepra të reja penale dhe janë hequr disa që kanë qenë të parashikuara në ligjin penal të Kosovës (dhënia ndihmë e të miturit në kryerjen e veprës penale të vrasjes), kishte ashpërsuar masat e dënimit edhe pse dënimi me vdekje ishte hequr që në fillim të administrimit të Kosovës nga ana e UNMIK-ut. Tani vrasjet klasifikohen në vrasje dhe vrasje e rëndë. Për vrasje parashikohej dënimi jo më pak se pesë vjet, ndërsa për vrasje të rëndë (neni 147) parashihej dënimi më “se paku 10 vjet”. Pas Shpalljes së Pavarsisë, Kodi Penal nuk është më i “përkohshëm”, edhe pse pothuajse inkriminimet e veprave penale janë të njejta, me ndryshime të vogla dhe të pa rëndësishme. Në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër jetës dhe trupit bëjnë pjesë vrasja e fëmijës, gruas shtatëzënë, vrasja në mënyrë mizore apo dinake, vrasja duke vënë në rrezik persona të tjerë, vrasje e kryer mizorisht, vrasja për motive racore, fetare dhe kombëtare, vrasja për përfitim pasuror, vrasja me qëllim fshehjen e veprës penale, vrasja nga hakmarrja e paskrupullt apo për motive të dobëta, vrasja e personave zyrtarë, vrasja e disa personave, përsëritja e veprës penale të vrasjes, vrasje në kushtet e tronditjes psikike, vrasje nga pakujdesia, vrasja e foshnjës gjatë lindjes, shtytja në vetëvrasje, ndërprerja e palejuar e shtatëzanisë, plagosja e lehtë, plagosja e rëndë, pjesëmarrja në rrahje, mosdhënia e ndihmës dhe

braktisja e personave të paaftë.




Figura 18. Vepra penale kundër jetës dhe trupit gjatë periudhës 1999-2017

Në krahasim me llojin e veprave penale të kryera kundër jetës dhe trupit të periudhës paraprahe, në krahasim me periudhën 1999-2017 pjesën më të madhe në këtë periudhë e zë ajo e vrasjes me 43% të totalit. Vrasjet e mbetura në tentativë përfshijnë 26% të totalit, vrasja e rëndë përfshinë 14% të totalit, 1% e totalit janë vrasjet e kryera në gjëndjen e tronditjes psikike, një vrasje ka ndodhur nga pakujdesia, vrasjet e foshnjës gjatë lindjes në përqindje paraqiten nën 0.5%, 1% e totalit të vrasjeve kanë ndodhur për gjakmarrje, 3% të vrasjeve kanë ndodhur për hakmarrje, 2% të vrasjeve e zënë vrasja e fëmijës, vepra penale plagosja e rëndë ze afërsisht 5% të totalit ndërsa 4% të totalit janë veprat penale të plagosjes së lehtë.

5.1.1 Struktura gjinore e autorëve të dënuar të veprave penale kundër jetës dhe shëndetit (1989-2017)

Pra, shikuar për nga struktura e gjinisë e të dënuarve gjatë periudhës kohore (1989-qeshor 1999) vërejmë se numri i autorëve femra të denuar për këto vepra penale, në krahasim me numrin e autorëve të dënuar meshkuj është shumë më i vogël. Në vitet 1992, 1996, 1998 dhe 1999 nuk kemi asnjë autor të akuzuar të gjinisë femërore për veprat penale të vrasjes. Pjesmarrja e autorëve të dënuara të vrasjes të gjinisë femërore në vitin 1989 është 13% ndërsa autorët e dënuar për vrasje të gjinisë mashkullore zënë rreth 87%. Në vitin 1990 pjesmarrja e femrave të dënuara është 18% ndërsa ajo e

meshkujve është 82%. Në vitin 1991 kemi 6% të femra të dënuara kundrejt 94% të meshkujve të dënuar, në vitin 1993 pjesmarrja e femrave të dënuara është 15%, ndërsa autorët meshkuj zënë 85%; në vitin 1994 pjesmarrja e femrave të dënuara është 5% kundrejt 95% të autorëve të dënuar që janë meshkuj; në vitin 1995 pjesmarrja e femrave të dënuara është 11% kundrejt 89% të autorëve të dënuar që janë meshkuj; në vitin 1997 pjesmarrja e femrave të dënuara është 10% ndërsa ajo e autorëve meshkuj është 90%. Në dy vitet (1998-1999) nuk kemi asnjë femër të dënuar.




Figura 19. Të dënuarit sipas gjinisë për veprat penale kundër jetës dhe trupit në Gjykatën e Qarkut të Pejës (1989-1999)

Vrasjet e kryera nga femrat kryesisht janë vrasje që ndodhin brenda familjes (vrasje e fëmijës të sapolindur, vrasja e burrit, dashnorit apo të fejuarit) dhe më rrallë jashtë familjes (në raste kur janë të përfshirë anëtarët e familjes së saj me ndonjë palë tjetër aty për aty ose në raste të gjakmarrjes). Pra, edhe pse femrat konsiderohen më “frikacake” “që nuk ka zemër të shoh as hekur” por “... kur i’a prekin shtratin e kurorës zemër më të egër nuk mund të gjesh” shkruante Euripidi në tragjedin greke Medea. Hakmarrja e Medeas kundër burrit të saj Jasonit ishte mjaft mizore, sepse ajo i vret fëmijët e saj që i kishte me Jasonin për të vetmin shkak se ai, e kishte braktisur për një femër tjetër dhe ishte larguar nga vendi. (Euripidi, 1973:21)

Në Jugosllavinë e dikurshme, gjatë periudhës 1960-1966, femrat si autore të veprës penale të vrasjes zënë 12.7%, ndërsa në nivel të republikave, printe Sllovenia me 16.5%, Bosnja e Hercegovina me 11.6%, Kroacia me 11.3%, ndërsa në Serbi gjatë periudhës 1973-1980 pjesmarrja e gjinisë femrore në kryerejen e veprave penale kundër jetës dhe trupit arrinte në 18.68%. Sipas autores Konstantinovic, në vitin 1979 në ish- Jugosllavi

më shumë femra të dënuara për veprat penale kundër jetës dhe trupit në 100.000 banorë kishte Maqedonia me 44%, pastaj vjen BiH me 32.6%, Serbia kishte 32.4%, Kroacia me 23.8 %, Vojvodina me 16.3%, Kosova me 8.9% dhe Mali i Zi me 8.1%. (Konstantinovic-Vilic, 1986, f:66-67, 86-87).

Duke u bazuar në të dhënat statistikore që i kemi paraqitur në grafikun e mëposhtëm, del se në vitet 2000, 2004, 2005, 2006, 2012, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 kemi vetëm pjesmarrje të meshkujve të dënuar për krimet e kryera. Në vitin 2001 pjesmarrja e femrave të dënuara është 4% kundrejt 96% të të dënuarve të gjinisë mashkullore; në vitin 2002 kemi 2% të autorëve femra të dënuara kundrejt 98% të të dënuarve të gjinisë mashkullore; në vitin 2003 pjesmarrja e femrave të dënuara është 10% kundrejt 90% të të dënuarve të gjinisë mashkullore; në vitin 2007 pjesmarrja e femrave të dënuara është 2% kundrejt 98% të të dënuarve të gjinisë mashkullore; në vitin 2008 kemi vetëm 1% të të dënuarve të gjinisë femërore kundrejt 99% të të dënuarve të gjinisë mashkullore; në vitin 2009 kemi vetëm 4% të të dënuarve të gjinisë femërore kundrejt 96% të të dënuarve të gjinisë mashkullore; në vitin 2010 kemi vetëm 7% të të dënuarve të gjinisë femërore kundrejt 93% të të dënuarve të gjinisë mashkullore; në vitin 2011 pjesmarrja e femrave të dënuara është 1% kundrejt 99% të të dënuarve të gjinisë mashkullore; ndërsa në vitin 2013 kemi 5% femra të dënuara për vepër penale të vrasjes, kurse 95% të autorëve të dënuar janë të gjinisë mashkullore.




Figura 20. Të dënuarit sipas gjinisë për veprat penale kundër jetës dhe trupit në Gjykatën e Qarkut të Pejës (2000-2017)

Në bazë të një analize të strukturës së gjinisë së të dënuarëve për vepra penale kundër jetës dhe shëndetit në mes të periudhës 1989-1999 dhe 2000-2017 siç mund të shihet edhe nga të dhënat e mësipërme në figurë, mund të konkludojmë se në të dy periudhat kohore kemi një përqindje më të madhe të pjesëmarrjes së gjinisë mashkullore në kryerjen e veprave penale të vrasjes. Por, nëse krahasojmë dy periudhat me njëra tjetrën mund të vërejmë se në periudhën 2000-2017 kemi numër më të lartë të autorëve të dënuar të gjinisë mashkullore në kryerjen e veprave penale të vrasjes sesa në periudhën 1989-1999. Po të krahasojmë periudhën 1989-1999 me periudhën 2000-2017 kemi një rënie të pjesëmarrjes së autorëve të gjinisë femrore të dënuara për kryerjen e veprave penale të vrasjes.

5.1.2. Struktura gjinore e viktimave të veprave penale kundër jetës dhe shëndetit (1989-2017)

Ashtu sikurse të dënuarit për vepra penale edhe viktimat e këtyre veprave përbëhen nga numëri më i lartë i meshkujve sesa i femrave dhe këtë mund ta shohim tek struktura e gjinisë së viktimave të veprave penale kundër jetës dhe trupit gjatë periudhës 1989-1999. Siç shihet nga figura e mësipërme në vitin 1989, 94% e viktimave janë të gjinisë mashkullore ndërsa 6% janë viktimat të gjinisë femrore; në vitin 1990 kemi 95% të viktimave të gjinisë mashkullore dhe 5% të viktimave të gjinisë femërore; në vitin 1991 82% janë viktimat të gjinisë mashkullore dhe 18% janë viktimat të gjinisë femërore; në vitin 1992, 85% janë viktimat të gjinisë mashkullore dhe 15% janë viktimat të gjinisë femërore; në vitin 1994 viktimat të gjinisë mashkullore janë 83% ndërsa ato të gjinisë femërore janë 17%; në vitin 1995 viktimat të gjinisë mashkullore janë 86% ndërsa ato të gjinisë femërore janë 14%; në vitin 1996 viktimat të gjinisë mashkullore janë 71% ndërsa ato të gjinisë femërore janë 29%; në vitin 1997 viktimat të gjinisë mashkullore janë 79% ndërsa ato të gjinisë femërore janë 21%; në vitin 1998 viktimat të gjinisë mashkullore janë 80% ndërsa ato të gjinisë femërore janë 20%. Në vitin 1993 dhe 1999 nuk kemi viktimat të gjinisë femërore dhe 100% të viktimave janë të gjinisë mashkullore.




Figura 21. Viktimat e veprave penale kundër jetës dhe trupit sipas gjinisë (1989-1999)

Nga të dhënat e paraqitura më sipër del se numri më i madh i viktimave femra në Rajonin e Pejës, ishte shënuar në vitin 1996 me 29%, ndërsa viti 1993 dhe viti 1999 kishte kaluar pa asnjë viktimë të gjinisë femërore. Duke iu referuar të dhënave zyrtare serbe gjatë periudhës 1997-2007, në kuadër të viktimave të krimit, 14% i takonin gjinisë femërore. (Republicki Zavod za Statitiku, 2010a, f:62).

Bazuar në të dhënat që kanë dal nga ky studim mund të konkludojmë se gjinia mashkullore merr pjesë me një përqindje të lartë qoftë si viktimë qoftë si autorë të krimit të vrasjes në Rajonin e Pejës. Sipas studimeve që janë bërë në Australi, pjesëmarrja e meshkujve viktimë të vepres penale të vrasjes është 85.4%, kundrejt 7.2% viktimë të gjinisë femërore (Makkai & Payne, 2003). Gjinia femërore merr pjesë me një përqindje të vogël, ndërsa shkalla prej 5.9% është shifra ku autorë dhe viktimë paraqiten femrat, pra femrat kanë vrarë femrat.

Nga të gjitha vrasjet e ndodhura rreth 55.1 % janë persona që janë njohur me njëri-tjetrin (shokë e shoqe) të tjerët janë pjestarë të familjës etj.




Figura 22. Viktimat e veprave penale kundër jetës dhe trupit sipas gjinisë (2000-2017)

Nga figura e mësipërme shohim se në vitin 2000, në 87% të rasteve meshkujt janë viktimat të krimit të vrasjes, ndërsa femrat në 13% të rasteve, në vitin 2001 viktimat meshkuj zënë 92%, ndërsa ato femra 8%, kurse në vitin 2002 viktimat meshkuj janë 93%, ndërsa ato femra 7%, në vitin 2003 viktimat meshkuj janë 81% ndërsa ato femra 19%, në vitin 2004 viktimat meshkuj janë 73% ndërsa ato femra 27%, në vitin 2005 viktimat meshkuj janë 79% ndërsa ato femra 21%, në vitin 2006 viktimat meshkuj janë 94% ndërsa ato femra 6%, në vitin 2007 viktimat meshkuj janë 89% ndërsa ato femra 11%, në vitin 2008 viktimat meshkuj janë 92% ndërsa ato femra 8%, në vitin 2009 viktimat meshkuj janë 78%, ndërsa ato femra 22%, në vitin 2010 viktimat meshkuj janë 92% ndërsa ato femra 8%, në vitin 2011 viktimat meshkuj janë 92% ndërsa ato femra 8%, kurse në vitin 2012, 2016 dhe 2017 kemi vetëm viktimat meshkuj, në vitin 2013 viktimat meshkuj janë 95% ndërsa ato femra 5%, në vitin 2014 viktimat meshkuj janë 86% ndërsa ato femra 14%, kurse në vitin 2015 viktimat meshkuj janë 67% ndërsa femrat janë 33% e totalit. Bazuar në të dhënat e paraqitura më lartë del se në vitin 2015 kemi përqindjen më të madhe të viktimave femra me 33%, kurse për vitet 2012, 2016 dhe 2017 nuk është regjistruar asnjë viktimë e gjinisë femërore. Ndërsa pjesa i përket viktimave të gjinisë mashkullore, në vitet 2012, 2016 dhe 2017 viktimat të krimit, 100% kanë qenë vetëm gjinia mashkullore. Sipas të dhënave zyrtare në Serbi, nga viti 1997-2007 kishin ndodhur 200 vrasje në vit, gjerësisht rreth 3 vrasje në 100.000 mijë banorë.

Pra, në këtë dhjetëvjeçar, në Serbi ishin vrarë mbi 2.000 persona prej të cilëve 1/3 e viktimave ishin femra. (Republicki Zavod za Statistiku, 2010b, f:58, 62).

5.1.3. Struktura kombëtare e të dënuarëve(1989-2017)

Kosova si njësi e veçantë gjeografike, politike dhe territoriale në ish-Jugosllavi përbëhej nga një strukturë shumë kombëtare në të cilën jetonin shqiptarët, serbët, malazezët, romët dhe grupe të tjera etnike me një përqindje mjaftë të vogël. Sipas statistikave zyrtare serbe, Kosova në vitin 1991 (edhe pse popullsia shqiptare e kishte bojkotuar këtë regjistrim) kishte 1.967.000 banorë. (Republicki Zavod za Statistiku, 2012, f:217). Nga ky numër 81.6% ishin shqiptarë, 9.9 5 serb, 1.0% malazez, 3.4% boshnjak, 0,5% turq, 2,3% rom, 0,4% kroatë, 0.2% jugosllav dhe 0.6 % të tjerë. (Islami, 2012, f:251). Përkundër represionit të shtetit jugosllav kundër shqiptarëve, vrasjet mes kombësive në Kosovë kanë qenë të rralla ashtu siç kanë qenë të rralla edhe vrasjet mes besimeve të ndryshme. Në bazë të kësaj mund të konkludojmë se vrasjet janë kryer “mbrenda sojit” të vet gjë që dëshmohet edhe nga të dhënat që kanë dalë gjatë këtij studimi.




Figura 23. Struktura kombëtare e të dënuarve për veprat penale kundër jetës dhe trupit në gjykatën e Qarkut të Pejës (1989-1999)

Nga struktura e kombësisë së të dënuarve, gjatë periudhës 1989-1999, 83% e totalit i përket kombësisë shqiptare, 2% e totalit janë të kombësisë malazeze, 3% e totalit janë anëtarë të komunitetit romë, ndërsa 12% e totalit janë serb. Gjatë kësaj periudhe nuk kemi hasur në vrasje mes kombësive të ndryshme. Është interesante, se në këtë periudhe, kemi një rritje të vrasjeve mes personave të kombësive serb dhe atij malazez.




Figura 24. Struktura kombëtare e të dënuarve për veprat penale kundër jetës dhe trupit në gjykatën e Qarkut të Pejës (2000-2017)

Ndërsa nga struktura kombëtare e të dënuarve gjatë periudhës 2000-2017 shohim se 99% e totalit i përket personave që janë të kombësisë shqiptare, 0.5% janë egjiptianë ndërsa 0.5% janë romë. Ky raport i të dënuarve për vepra penale të kësaj kategorie “brenda llojit” nuk është specifik vetëm në Kosovë, sepse një pasqyrë të tillë e kemi edhe në Serbi.

Sipas strukturës kombëtare del se në Serbi mbi 80% e vrasjeve kryhen nga vetë serbët, në vendin e dytë vijnë hungarezët me 4.7%, romët me 2% dhe shqiptarët me 1% etj. (Republicki Zavod za Statistiku, 2010c, f:65).

5.1.4. Struktura kombëtare e viktimave të krimit (1989-2017)

Edhe struktura kombëtare e viktimave të këtyre veprave penale është pothuajse e përafërt për nga përqindja me përqindjen e të dënuarve në rajonin tonë. Viktimat në numrin më të madhë ishin shqiptarët, pas të cilëve vinin serbët, romët dhe boshnjakët. Rritja e numrit të vrasjeve dhe viktimave të kombësisë serbe, rome dhe boshnjake ishte një dukuri në rritje pas humbjes së autonomisë së Kosovës.




Figura 25. Kombësia e viktimave të veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës (1989-1999)

Pjesëmarrjen më të madhe në strukturën kombëtare të viktimave në periudhën 1989-1999 e zënë personat që janë të kombësisë shqiptare me 83% e totalit, 13% e totalit përbëhet nga persona të kombësisë serbe, 3% e totalit përbëhet nga romët ndërsa 1% e totalit janë të kombësisë boshnjake.

Pas luftës së fundit, struktura e popullsisë së Kosovës ka ndryshuar, sepse banorët e Pejës të kombësisë serbe dhe malazeze janë larguar nga Kosova bashkë me trupat serbe. Për këtë arsye edhe numri i vrasjeve dhe viktimave nga këto persona që i përkasin kësaj kombësie nuk është regjistruar.




Figura 26. Kombësia e viktimave të veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës (2000-2017)

Siç shihet edhe në figurën e mësipërme, struktura e popullsisë shqiptare në Kosovë e në veçanti në Rajonin e Pejës ishte pothuajse monoetnike me përjashtim të disa enklavave ku jetonte popullësia serbe. Sipas autorit Salihu, edhe në vitet 70 të shekullit të kaluar,

ishite karakteristikë se vrasjet kryheshin mbrenda të njejtit komb dhe kjo përqindje përfshinte 99% të rasteve. Ndërsa përsa i përket përqindjes së vrasjeve brenda kombit, shqiptarët zinin pjesën më të madhe 86.8%, serbët me 11.7% dhe të tjerët me 1.5%. (Salihu, 1985d, f:141).

Gjatë hulumtimit tonë nuk kemi gjetur ndonjë rast kur viktimat dhe autorët të kenë kombësi të ndryshme, edhe pse shtypi dhe politikanët flasin për vrasje me motive kombëtare. Ç'është e vërteta ka patur gjykime dhe ka të dënuar kur viktimat dhe autorët nuk janë të të njëjtës kombësi por në raste të tilla bëhet fjalë për vepra të tjera penale që lidhen me krime të luftës ose që janë në hetim e sipër.

5.1.5. Gjeografia kriminale dhe shtrirja e saj fshat-qytet(1989-2017)

Është mjaft me rëndësi njohja e gjeografisë kriminale apo e shtrirjes së saj në relacion fshat-qytet. Raportet e tilla dhe njohuritë rreth kësaj dukurie ndihmojnë organet e rendit në ndërmarrjen e masave dhe kryerjen e detyrave të tyre ligjore në mbrojtjen e jetës dhe pronës, rendit dhe qetësisë. Gjatë periudhës 1989-1999 kjo shtrirje e kriminalitetit ishte në “favor të fshatit” e në “dëm” të qytetit. Pra, më tepër vepra penale të kësaj natyre kishin ndodhur në fshat sesa në qytet.




Figura 27. Vëllimi i vrasjeve dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit në relacionin fshat-qytet (1989-1999)

Dinamika e vrasjeve dhe veprave të tjera kundër jetës dhe trupit gjatë periudhës 1989-1999, ishte më e lartë në fshat sesa në qytet, që do të thotë tre herë më e lartë në fshat se në qytet ose 74% e totalit të këtyre veprave, kundrejt 26% të këtyre veprave që kishin ndodhur në qytet. Përqindja kaq e lartë e krimit në fshat mund të shpjegohet me faktin se shumica e popullsisë jeton në vendet rurale, me probleme të pazgjidhura që lidhen

me pronat, të cilat janë produkt i një lënie pasdore nga vet ana e pushtetit. Moszgjidhja e këtyre problemeve në mënyrë institucionale ndihmon në fuqizimin e zgjidhjes së po këtyre problemeve në bazë të së drejtës tradicionale që shpesh herë është në kundërshtim me të drejtën pozitive. Lënia pasdore e problemeve në zonat rurale ku shumica e popullsisë të vetmin burim e ka bujqësinë ndikon në nxitjen e konflikteve të cilat fatkeqësisht përfundojnë jo rrallë me vrasje ose lëndime të rënda trupore.




Figura 28. Vëllimi i vrasjeve dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit në relacion fshat-qytet (2000-2017)

Edhe pse veprat penale të kryera në qytet në periudhën kohore 2000-2017 kanë shënuar një rritje krahasuar me periudhën 1989-1999, fshati prapë është vendi ku kryhen me shumë vepra penale se sa në qytet. Sipas të dhënave të mësipërme del se 56% e totalit janë vepra të cilat ishin kryer në fshat dhe 44% e totalit janë vepra të cilat ishin kryer në qytet. Rritja e numrit të vrasjeve dhe veprave të tjera kundër jetës dhe trupit në qytet është 44% kundrejt 26% sa ishte paraluftës, kjo lidhet me lëvizjen e qytetarëve në periudhën e pasluftës në relacionin fshat qytet. Përveç kësaj, në këtë dukuri ka ndikuar edhe mungesa e banimit, mungesa e punës, uzurpime të ndryshme në pronat e paluajtshme dhe probleme të tjera të cilat si rezultat i „trashiguar” i mosmarrëveshjeve dhe ngatërresave të ndryshme nga kohë të kaluara.

5.1.6. Vendi i kryerjes së vepres penale (1989-2017)

Vendi i kryerjes së vepres penale ka një rendësi domethënëse përmes të cilit shumë lehtë mund të kuptohet lëvizja e krimit. Bazuar në të dhënat që i përkasin periudhës

1989-1999 kemi arritur të kuptojmë se në të shumtën e rasteve krimi kishte ndodhur në ambiente të hapura, në natyrë, në rrugë, vende publike shikuar në përqindje arrin në mbi 42%, ndërsa pjesa tjetër kishte ndodhur në objekte të mbyllura, zyra publike, kafene dhe në shtëpi private. Gjatë kësaj periudhe janë shënuar vrasje edhe në sallën e Gjykatës së Qarkut të Pejës ku ishte vrarë ish-gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës i cili në momentin e vrasjes ishte duke ushtruar detyrën e avokatit mbrojtës në një proces gjyqësor.




Figura 29. Vendi i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (1989-1999)

Po të shikojmë strukturën e vendit të kryerjes së veprës penale kundër jetës dhe trupit në periudhën 1989-1999 vërejmë se vendi në të cilën janë kryer më shumë vepra penale është në rrugë e cila zë 28% të totalit, 24% e veprave penale ishin kryer në shtëpi, 9% e veprave penale ishin kryer në oborr, 1% e veprave penale ishin kryer në dyqan, 1% e veprave penale ishin kryer në kamping, 3% e veprave penale ishin kryer në hapsirat e institucioneve publike, 4% e veprave penale ishin kryer në vende publike, 0.5% e veprave penale ishin kryer në hapësira të fabrikave, 3% e veprave penale ishin kryer në pyll, 14% e veprave penale ishin kryer në arë, 0.5% e veprave penale ishin kryer në zyrë, ndërsa 9% e veprave penale ishin kryer në kafene.

Edhe në periudhën e pasluftës (2000-2017), vendi i kryerjes së veprave penale tregon hartën e shtrirjes së kriminalitetit gjë që krahasuar me periudhën e mëparshme (1989-1999) ka pësuar pak ndryshime. Kështu vendi ku ishin kryer më shumë krime kundër jetës dhe shëndetit me mbi 50% ishin vendet publike, ndërsa pjesa tjetër ishte kryer në objekte të mbyllura. Krimet e kryera brenda shtëpisë kanë shënuar një rënie, ndërsa kemi një rritje të vrasjeve të kryera në oborr. Edhe vrasjet e kryera në arë, në fusha, që

lidhen me të drejtën e shfrytëzimit të servitutit, të drejtën e pronësisë, ujitjes, dëmeve në fushë etj., kishin shënuar rënie. Kjo për faktin se në periudhën e pasluftës, shoqëria kosovare u ballafaqua me një migrim të madh në relacionin fshat-qytet dhe pothuajse të gjitha fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit ishin të djegura gjatë luftës dhe pak prej tyre merreshin me bujqësi.




Figura 30. Vendi i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (2000-2017)

Sipas të dhënave vërejmë se gjatë periudhës 2000-2017 vendi në të cilën janë kryer më shumë vepra penale është në rrugë e cila zë 37% të totalit, me nga 12% e veprave penale ishin kryer në shtëpi dhe në kafene, 2% e veprave penale ishin kryer në automjete (veturë), 11% e veprave penale ishin kryer në oborr, 1% e veprave penale ishin kryer në dyqan, 2% e veprave penale ishin kryer në hapësirat e institucioneve publike, 2% e veprave penale ishin kryer në lokale bixhozi, 11% e veprave penale ishin kryer në vende publike, 1% e veprave penale ishin kryer në vendin e punës (në fabrikë), 1% e veprave penale ishin kryer në treg, 2% e veprave penale ishin kryer në pyll, 5% e veprave penale ishin kryer në arë, ndërsa 1% e veprave penale ishin kryer në zyrë. Në Australi, 50.8% e vrasjeve ishin kryer në shtëpi, 19% në vende të ndryshme rekreative, ndërsa 30.3% në vende të tjera. (Carcash & Conroy, 2001).

5.1.7. Koha e kryerjes së veprave penale gjatë ditës (1989-2017)

Koha është faktori kryesor i cili është përcaktues dhe çelës i zgjidhjes së shumë enigmave me rastin e kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit. Për këtë jemi

përcaktuar që të shënojmë orën e kryerjes së krimit. Dhe në këtë kontest kemi të bëjmë me kohën e kryerjes së krimit brenda periudhës 24 orëshe. Gjithashtu është me rëndësi për çështjen që kemi në shqyrtim të dihet edhe lëvizja e kriminalitetit gjatë muajve dhe stinëve të vitit. Duke i paraqitur këto të dhëna kuptojmë se në cilën fazë të ditës, javës, muajit apo të vitit kemi më tepër ose më pak vepra të kundërligjshme që kushtojnë jetë njerëzish. Gjatë periudhës 1989-1999 më shumë veprat penale ishin kryer gjatë 8 orëve duke filluar nga ora 12:00 e ditës deri në ora 20:00 e darkës me gjithsej 44% të veprave penale kundër jetës dhe trupit. Më pak vepra të tilla kishin ndodhur mes orës 02:00 të mëngjesit deri në ora 06:00 me vetëm 2%, ndërsa më shumë krime nga ky kapitull, me 16% te totalit, kishin ndodhur mes orës 14:01 mbasdite deri në ora 16:00.




Figura 31. Koha e kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (1989-1999)

Koha në të cilën janë kryer më shumë vepra penale kundër jetës dhe trupit në periudhën 1989-1999 është ajo prej 14:01-16:00 e cila zë 16% të totalit, 9% e veprave penale ishin kryer në kohën prej 16:01-18:00, 11% e veprave penale të vrasjes ishin kryer në kohën prej 18:01-20:00, 15% e veprave penale ishin kryer në kohën prej 20:01-22:00, 13% e veprave penale ishin kryer në kohën prej 02:01-04:00, 1% e veprave penale ishin kryer në kohën prej 04:01-06:00, 7% e veprave penale ishin kryer në kohën prej 06:01-08:00, 7% e veprave penale ishin kryer në kohën prej 08:01-10:00, 6% e veprave penale ishin kryer në kohën prej 10:01-12:00 ndërsa 10% e veprave penale ishin kryer në kohën prej 12:01-14:00.

Në periudhën e pasluftës (2000-2017) koha më e rrezikshme kur ishin kryer vrasje dhe

vepra të tjera kundër jetës dhe trupit ishte koha midis orës 10:01 deri në ora 12:00 dhe 14:01 deri në ora 16:00 me nga 14% të totalit secila, ndërsa më pak krime te vrasjes kishin ndodhur nga ora 04:01 deri në orën 06:00 e mëngjesit me vetëm 1% të totalit. Edhe në këtë periudhë kemi 62% të këtyre krimeve që kishin ndodhur nga ora 12:01 deri në orën 20:00 të darkës. Ndërsa gjatë periudhës së paraditës nga ora 08:01-12:00 ishin kryer 22% të totalit të veprave penale.




Figura 32. Koha e kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (qershor 1999-qershor 2017)

Koha në të cilën janë kryer më shumë vepra penale kundër jetës dhe trupit është nga ora 10:01 deri në orën 12:00 dhe 14:01 deri në orën 16:00 me nga 14% të totalit secila, me nga 11% secilën kemi veprat që ishin kryer në kohën prej orës 12:01-14:00 dhe 20:01-22:00, me nga 13% secila kemi kohën prej orës 16:01-18:00 dhe kohën prej orës 18:01-20:00, 7% e veprave ishin kryer në kohën prej orës 22:01-24:00, 4% e veprave ishin kryer prej orës 00:01-02:00, me nga 2% secila e veprave ishin kryer prej orës 02:01-04:00 dhe prej orës 06:01-08:00, 1% e veprave ishin kryer prej orës 04:01-06:00 ndërsa 8% e veprave ishin kryer në orën 08:01-10:00. Sipas këtyre të dhënave del se më shumë këto veprava penale janë kryer nga ora 10:01-12:00 e paraditës dhe 14:01-16:00 e pasditës (14%) dhe më pak kemi vrasje të kryera pas mesnatës.

Sipas autorëve Carcach dhe Conroy, 31.8% të vrasjeve të kryera nën ndikimin e alkoolit në Australi ishin kryer nga 00:00- 06:00 të mëngjesit, 2.3% të vrasjeve ishin

kryer nga ora 06 e mëngjesit deri në orën 12:00 të mesditës, 14.1% të vrasjeve ishin kryer pas orës 12:00 të mesditës deri në orën 06:00 të mbrëmjes, 49% të vrasjeve ishin kryer nga ora 06:00 e mbrëmjes deri në ora 24:00 (mesnatë) ndërsa 2.8% të vrasjeve ishin kryer në kohë të pacaktuar. Po të shikojmë këtë dukuri në kuadër të ditëve të javës, këta autorë kanë vërtetuar se 15.1% të vrasjeve kishin ndodhur ditën e enjte, 18.7% të vrasjeve kishin ndodhur ditën e premte, 21.3% të vrasjeve kishin ndodhur ditën e shtunë, 15.6% të vrasjeve kishin ndodhur ditën e diel dhe 29.2% të vrasjeve kishin ndodhur në ditë të tjera (Carcash & Conroy, 2001a).

5.1.8. Veprat penale të kryera sipas muajve të vitit (1989-2017)

Duke pasur parasysh se kriminelët kryejnë vepra penale në çdo ditë të javës, në çdo muaj dhe në çdo stinë të vitit, atëherë del se edhe në Rajonin e Pejës kjo dukuri nuk është përjashtim. Pra, sipas të dhënave që po i prezantojmë më poshtë del se veprat penale ishin kryer pothuajse në çdo muaj të vitit.




Figura 33. Muaji në të cilin është kryer vepra penale kundër jetës dhe trupit 1989- qershor 1999

Duke shikur në figurë mund të vërejmë shtrirjen e kryerjes së veprave penale të vrasjes në periudhën 1989-1999 në bazë të muajve. Muajt në të cilën janë kryer më shumë vepra të tilla penale, janë muaji maj, shtator dhe tetor, të cilët përfshijnë me nga 11% të totalit. Muaji qershor, korrik dhe ai nëntor përfshijnë 9% të totalit, muaji mars përfshinë 8% totalit, muaji gusht përfshinë 7% të totalit, muaji prill përfshinë 12% të totalit, muaji janar përfshinë 5% të totalit ndërsa muaji shkurt dhe ai dhjetor përfshijnë 4% të totalit.

Krahasuar me vrasjet e kryera në Serbi del se, atje më shumë vrasje ishin kryer në muajin

qershor, korrik dhe nëntor ndërsa brenda javës më tepër kishin ndodhur vrasje në ditën e marte (51), ditën e hënë (47), ditën e shtunë (42) dhe të dielën (40). (Republicki Zavod za Statitiku, 2010d, f:66).




Figura 34. Muaji në të cilin është kryer vepra penale kundër jetës dhe trupit (qershor 1999-qershor 2017)

Muajt në të cilin ishin kryer më shumë vepra penale nga ky kapitull e që përfshinë periudhën 2000-2017 ishin muaji prill, qeshor dhe nëntor të cilët përfshijnë 10% të totalit secili, muaji mars, maj, korrik dhe ai dhjetor përfshijnë 9% të totalit secili, muaji shtator përfshinë 8% të totalit, muaji janar, gusht dhe ai tetor përfshijnë 7% të totalit secili ndërsa muaji shkurt përfshinë 5% të totalit.

5.1.9. Mjetet e kryerjes së veprave penale (1989-2017)

Mjetet të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale kundër jetës dhe trupit gjatë periudhës 1989-1999 ishin nga më të ndryshmet mirëpo ajo që zë pjesën më të madhe është revolja me 43% të totalit, 20% nga veprat penale ishin kryer me thikë, 9% nga veprat penale ishin kryer me sopatë, 5% nga veprat penale ishin kryer me pushkë gjyëtie, 4% nga veprat penale ishin kryer me shufer metali, me nga 3% secila ishin veprat të cilat janë kryer me brisk, me hu dhe ato me mjete bujqësore, me nga 2% secila ishin veprat të cilat janë kryer me AK 47 dhe ato me mjete të tjera ndërsa me nga 1% secila ishin veprat të cilat janë kryer me grushta, me pushkë, me automjet, me korent, dhe duke e hedhur në greminë.




Figura 35. Mjeti i kryerjes së vepres penale kundër jetës dhe trupit 1989-1999

Përdorimi i armës në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit nuk është karakteristikë vetëm në Kosovë dhe nuk është karakteristikë vetëm e kësaj periudhe kohore. Përdorimi i armës në kryerjen e vrasjeve gjatë periudhës 1968-1974 merrte pjesë në 42% të rasteve, 15.4% ishin përdorur sende të ndryshme, 14,9 % ishin përdorur vegla pune, 6.5 % ishin përdorur sopata dhe thika. (Latifi, 1984, f:361)




Figura 36. Mjetet e kryerjes së vepres penale kundër jetës dhe trupit 1999-2017

Mjetet të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale kundër jetës dhe trupit gjatë periudhës 2000-2017 janë pothuajse të njëjta me ato të periudhës 1989-1999, me përjashtim se në këtë periudhë kemi një rritje të përdorimit të armëve të zjarrit. Revolja ishte mjeti me të cilin është kryer vrasja në 49% të rasteve, 15% nga veprat penale ishin kryer me thikë, 15% të vrasjeve ishin kryer me AK 47, me nga 3% janë kryer vrasjet me sopatë, me hu dhe me pushkë (gjysmë automatike), me nga 2% secila janë kryer vrasjet me pushkë gjyëtie, me grushta dhe me brisk, me nga 1% secila janë kryer vrasjet me shufër metalike, me mjete bujqësore dhe me automjet (veturë) ndërsa me nga 0.5% secila janë veprat e kryera me kompresor dhe armë automatike (skorpion). Sipas disa studiuesve, në Kosovë në 100 persona gjenden 1.7 armë, në Mal të Zi në 100 persona gjenden 13.2 armë, në Serbi në 100 persona gjenden 14.7 armë, në Maqedoni në 100 persona gjenden 7.7 armë, në Kroaci në 100 persona gjenden 8.4 armë, në Bosnje e Hercegovinë në 100 persona gjenden 9.3 armë. (Sokolova, Richards, & Rynn, 2006, f:5). Bazuar në këtë fakt, mund të konkludoj se

prezenca e madhe e armëve në duar të qytetarëve kosovar është indikator që rrit përqindjen të lartë të përdorimit të armëve të zjarrit në kryerjen e vepres penale të vrasjes.

Sipas të dhënave studimore, në vitin 2002 në Serbi, në 100.000 banorë ishin kryer 2.44 vrasje nga të cilat, 1.14 vrasje në 100.000 banorë ishin kryer me armë zjarri. Në kuadër të mjeteve të përdorura në kryerjen e vrasjeve në Serbi në 49% është përdorur revolja, në 32% është përdorur pushka, në 4% është përdorur revolveri, në 1% është përdorur pushka gjysmëautomatike, në 5% është përdorur karabina (armë e veçantë e gjyëtisë) dhe 9% e vrasjeve janë kryer me armë të tjera. Sipas këtij studimi ka rezultuar se revolja përdoret shumë shpesh në rastet e vrasjes, vetëvrasjes, vrasje e mbetur në tentativë, kanosja, dhe plagosja. (Taylor & Philips, 2005, f:31-32).

Në vendin e dytë të viktimave të krimit të vrasjeve renditen viktimat të cilat janë vrarë me mjete të mprehta (thika, brisqe, etj). Nga 55 vrasje me mjete të tilla, 21% ishin meshkuj dhe 38% prej tyre ishin femra. Viktimat e vrara me mjete të mprehta dhe të përfshinin moshën prej 15-19 dhe 20-24 vjet që përbënin 15% të viktimave të gjinisë mashkullore dhe grupmoshat 45-49 vjet me 18%. Grupmoshat e viktimave prej 65-69 të gjinisë femrore përbënin 21% të vrasjeve. Edhe personat e gjinisë femërore të moshës 75 e lartë ishin cak i këtyre krimeve në Serbi. (Republicki Zavod za Statitiku, 2010dh, f:58, 62).

5.1.10. Motivi i kryerjes së veprave penale (1989-2017)

Vrasjet në përgjithësi kryhen në kushte dhe rrethana të caktuara nga autorë të ndryshëm tek të cilët ndikojnë edhe motive të ndryshme. Këto motive, në varësi nga rrethanat edhe politika ndikojnë në kryesin potencial dhe e nxisin që të kryejë vrasjen. Këto motive mund të jenë të nxitura nga hakmarrja, probleme të pazgjidhura pronësore juridike, xhelozia, gjakmarrja, zënka të ndryshme, probleme martesore dhe familjare dhe motive të tjera.




Figura 37. Motivi i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit. (1989-1999)

Gjatë periudhës 1989-1999 kemi një llojllojshmëri të motiveve përmes të cilave mund të shpjegojnë se pse ka ardhur deri tek kryerja e një veprave penale kundër jetës dhe trupit. Duke shikur figurën mund të vërejmë se motivi i cili zë pjesën më të madhe janë ngatërresat që zënë 23% të totalit, 20% të totalit e zënë çështjet pronësore, 11% të totalit e zënë problemet familjare, 9% e totalit e zënë zënkat, 8% të totalit e zënë xhelozia, 6% të totalit e zënë hakmarrja, 5% të totalit e zënë motivet e dobëta apo të ulëta, me nga 4% të totalit secila e zënë alkooli dhe përfitimi pasuror, me nga 2% të totalit secila e zënë dhuna në familje, borxhi, gjakmarrja dhe ato vepra të kryera ku motivi nuk dihet ndërsa me nga 1% e totalit secila e zënë problemet martesore, problemet mendore dhe motivi për të fshehur krimin.




Figura 38. Motivi i kryerjes së veprave penale kundër jetës dhe trupit (2000-2017)

Sikurse në periudhën paraprake edhe në periudhën 2000-2017 janë kryer vrasje dhe vepra tjera penale kundër jetës dhe trupit me motive të ndryshme. Sikurse në periudhën paraprake edhe në periudhën 2000-2017 shkaqet kryesore janë çështje të ndryshme që përfundojnë me ngatërresa të cilat zënë 37% të totalit, 10% të totalit e zënë çështjet pronësore, me nga 7% të totalit e zënë përfitimet pasurore dhe fjalosjet, me nga 6% të totalit secila e zënë motive të dobëta dhe vrasjet për probleme familjare, 5% të totalit e zënë vrasjet e kryera për hakmarrje. Duhet përmendur se gjatë kësaj periudhe kemi vetëm një vepër të kryer kundër jetës dhe trupit e cila është kryer për motive politike, 3% të totalit e zë borxhi, me nga 2% të totalit secila e zënë vrasjet e kryera për gjakmarrje, problemet martesore dhe alkooli. Veprat e kryera si rezultat i dhunës në familje dhe nga xhelozia përfshijnë 1% të totalit secila. Në këtë grup është përfshirë edhe një vrasje e cila ka ndodhur aksidentalisht gjatë një ahengu. Duhet theksuar fakti se për 11% të vrasjeve të kryera nuk dihen motivet.

Pra, sipas këtyre të dhënave del se ngatërresat përfshijnë përqindjen më të madhe e këtyre veprave me 37%. Me ngatërresa i kemi përfshirë të gjitha sjelljet që kishin ndodhur përpara se të ndodhte rasti konkret siç janë: fyerjet, sharjet, përgojimet e ndryshme, fjalosje mes fëmijesh etj. Edhe numri prej 17% i çështjeve të pazgjidhura pronësore dhe ato pasurore është mjaft i lartë dhe mjaft ndikues. Kjo për faktin se në Kosovë, e para, që nga viti 1933 e në vazhdim nuk janë bërë matje tokash dhe kufinj të kuptohen duke u nisur nga një pemë a një gur kufiri që nuk di askush se kur është

vendosur e që në fakt nuk përputhet me kufirin kadastral. Dhe e dyta, që nga ajo kohë, (1933) e deri më sot, familjet janë rritur dhe toka është zvogëluar duke u përcjell me ndarje vetëm sipas të drejtës zakonore që do të thotë se shumica e popullsisë së Kosovës juridikisht, nuk janë pronarë ligjor. Për pasojë të kësaj situate, gjykatat sot janë të tejmbushura me çështje të ndryshme civile, procedura e cila zgjatë me vite të tëra. Për shkaqe të tilla dhe të ngjashme (psh e drejta e posedimit që sipas traditës fare nuk njihet), burimi i konflikteve është i hapur. Me 7% të vrasjeve marrin pjesë vrasjet për motive të dobëta në të cilat kanë ardhur nga pasojat e veprimeve të mëparshme siç janë rrahjet, lëndimet e ndryshme trupore, fyerja e nderit dhe autoritetit etj. Me pas, 6% e totalit të vrasjeve shkaktohen si pasojë e hakmarrjes. Ky numër kaq i madh dëshmon se prokuroria dhe gjyqësori nuk e kanë kryer punën si duhet dhe se mosveprimi i tyre ka risjell deri te vetëgjyqësia dhe si rrjedhojë tek hakmarrja. Edhe vepra penale e kryer për shkak të mosmarrëveshjeve të ndryshme familjare (bashkëshortëve, bashkëjetuesëve, prindërve dhe fëmijëve të tyre, antarëve të tjerë të familjes, dhëndurëve dhe familjës së nusës) kap një përqindje të lartë me 6% të totalit të veprave të kryera të vrasjes. Kjo do të thotë se familja sot gjendet në udhëkryqet e ndikimit bashkëkohor dhe atij patriarkal, viktimë e të cilit mentalitet nuk janë vetëm femrat, fëmijët por edhe burrat. Si pasojë e këtyre çrregullimeve në marrëdhënjet familjare, në vitin 1993 kemi një vrasje mizore (pas një martesë 24 vjeçare) e kryer nga bashkëshortja në bashkëpunim me djalin e saj, ku viktimë e kësaj vrasje ishte burri, përkatësisht babai i cili vritet në gjumë. Pas vrasjes, autorët e coptojnë me thikë në 14 pjesë, e fusin në një qese plastike dhe e hedhin në lumin Drin me qëllim që t'ia humbin edhe kufomën. Për këtë krim, Gjykata e Qarkut të Pejës, autorët e këtij krimi i dënon për veprën penale vrasje në bashkëpunim sipas nenit 47 par. 2 pika i LPS-së, duke i caktuar dënimin prej 8 vjet për gruan dhe 7 vjet për djalin. (vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë P.nr.8/94 e datës 07.06.1996).

Nga totali i këtyre veprave, 5% e tyre janë si pasojë e fjalosjeve të mëparshme, në kuadër të së cilit grup kemi regjistruar edhe një veper penale për motive politike (dhe të vetmen të regjistruar në regjistrat e Gjykatës) si pasojë e së cilës kemi edhe të vetmen vepër penale për motive politike. Më pas vijnë veprat penale të kryera për shkak të borxheve të papaguara të cilat zënë 3%, pastaj me 2% të totalit zënë problemet nga sfera e të drejtës familjare, përgjithësisht nga fejesat dhe martesat e pasuksesshme. Në numrin më të vogël të vrasjeve, me vetëm 1% të totalit, bëjnë pjesë vrasjet nga gjakmarrja, vrasjet e kryera nën ndikimin e alkoolit dhe vrasjet e shkaktuara nga xhelozia. Edhe pse në Kosovë nuk kemi shumë vepra penale të kryera nën ndikimin e alkoolit në vende të

tjera ky faktor është mjaft determinues. Përveq kësaj duhet cekur se në Kosovë nuk janë regjistruar vepra penale të vrasjes me motive raciale, etnike dhe relegjioze siç ndodh në disa vende europiane duke përfshirë dhe Gjermaninë. (Glet, 2009). Sipas një studimi dhjetë vjeçar nga Instituti për Kriminologji i Australisë del se gjatë periudhës 1989-1999 janë vrarë 3386 viktima nga 3481 të kryes kësaj veprë penale. Sipas të njejtit studim, në Welsin jugor gjatë vitit 1993, 62% e incidenteve të ndryshme ishin shkaktuar nën ndikimin e alkoolit, ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar, 64% të incidenteve të kësaj natyre janë të kryera nën ndikimin e alkoolit. (Carcash & Conroy, 2001b, f:188, 204). Edhe autorët Toni Makkai dhe Jason Payne e shohin një lidhshmëri mjaft të ngushtë mes përdorimit/tregtimit të drogës dhe alkoolit dhe kriminalitetit në Australi. (Makkai & Payne, 2003a)

5.1.11. Shkalla e arsimimit të autorëve të veprave penale(1989-2017)

Në shkencën e kriminologjisë ka mendime të ndryshme lidhur me raportin e arsimit me kriminalitetin. Disa mendojnë se arsimi nuk ka ndonjë impakt në rritjen e kriminalitetit, të tjerët mendojnë se niveli arsimor ka një ndikim të lartë në rritjen e tij. Dihet se njeriu nuk është robot dhe mbasi që ai nuk është i tillë, ndikimet e jashtme dhe të brendshme ndikojnë në botën e tij dhe si rezultat i këtij ndikimi, ai vepron shpeshherë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga shoqëria të cilat janë cilësuar si krim. Pavarsisht opinioneve të ndryshme, niveli arsimor ka një ndikim në paraqitjen e kriminalitetit. Sipas të dhënave që kemi në dispozicion, mund të konkludojmë se niveli i arsimit ndikon në paraqitjen e një kategorie të veprave penale të cilat janë paraqitur në të dhënat e mëposhtme për periudhën 1989-1999.




Figura 39. Niveli arsimor i autorëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit

1989- 1999

Të dhënat e paraqitura më lartë që i takojnë periudhës 1989-1999 pjesën më të madhe të autorëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit e përbëjnë autorët të cilët kishin kryer shkollën fillore me 56% të totalit, kurse ata me shkollë të mesme përbëjnë 24% të autorëve, autorët e veprave penale që janë analfabetë zënë 3% të totalit, me tetë klasë fillore zënë 3% të autorëve, me katër klasë fillore zënë 5% të autorëve, me shkollë të lartë, pesë klasë fillore, gjashtë klasë fillore dhe nxënësit e shkolles së mesme zënë 2% të totalit secila, ndërsa me tre klasë fillore zënë 1% të totalit.




Figura 40. Niveli arsimor i autorëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 2000-2017

Në periudhën 2000-2017 pjesën më të madhe e zënë autorët e veprave penale që kishin të kryer shkollën fillore me 39%, me shkollë të mesme 51% prej tyre, me tetë klasë fillore të kryer janë me nga 2%, ndërsa me shkollë të lartë, fakultet, tre klasë fillore, katër klasë fillore, gjashtë klasë fillore, student dhe analfabet marrin pjesë me 1% të tyre. Duke krahasuar këto dy periudha kohore, vërejmë se në periudhën e pas luftës ka rezultuar se kemi zvogëlim të autorëve të veprave penale me shkollë fillore dhe ngritje të autorëve të veprave penale me shkollë të mesme. Gjithashtu kemi një pjesëmarrje të zvogëluar nga 2% sa ishte paraluftës, në 1% në periudhën e pasluftës të autorëve të veprave penale me fakultet, shkollë të lartë, por kemi edhe 1% të autorëve të cilët janë student.

Duke iu referuar të dhënave lidhur me nivelin arsimor të autorëve në Serbi del se në këtë vend, struktura e autorëve të krimit sipas përgatitjes shkollore tregon se gjysma e tyre ishin persona të pashkolluar, me shkollë të pakryer fillore ose me shkollë fillore. Më pas vinin autorët me shkollë të mesme, me shkollë të lartë dhe me fakultet. Nga viti 1997-2007 sipas statistikave serbe vjen deri te rritja e autorëve të veprave penale të vrasjes me shkollë të mesme dhe shkollë të lartë prej 10% dhe zvogëlim prej 5% të numrit të atyre me shkollë fillore dhe pa shkollë fillore të kryer. Ndër autorët e krimit shumica prej tyre ishin persona të punësuar, por në vitet e fundit pjesëmarrja e tyre vjen duke rënë dhe rritet pjesëmarrja e autorëve të krimit të vrasjes nga kontigjenti i të vetëpunësuarve dhe pensionistëve. Në vitin 2007 shënohet një numër më i madh i vrasjeve nga të moshuarit që tregon se fenomeni i vrasjeve ndërlidhet me problemet sociale dhe ekonomike. (Republicki Zavod za Statistiku, 2010e, f:64).

5.1.12. Struktura sociale e autorëve të veprave penale të vrasjes (1989-2017)

Në studimet e deritanishme mbizotëron mendimi (Salihu, 1985e) se shtresat e ulta shoqërore janë kontigjenti më i madh dhe potencial i cili i ndikuar nga motive të ndryshme përfshihet në krim qoftë si autor apo edhe si viktimë. Sipas autorit Salihu, bujqit përbënin 57% të autorëve të veprave penale dhe 71% e viktimave të këtyre veprave. Pas tyre vinin puntorët, shtëpiaket, nxënësit, nënpunësit, studentët, zejtarët, të pa punët, pensionistët, fëmijët dhe të tjerë. (Salihu, 1985dh, f:143).

Gjatë hulumtimit tonë, gjatë periudhës 1989-1999, ka rezultuar se në përqindjen më të madhe të autorëve të veprave penale e zënë bujqit (43%) dhe të papunët (24%) ndërsa me përqindjen më të vogël marrin pjesë arsimtarët, automekanikët, kamarieret, bukëpjekësit dhe mekanikët me vetëm 0.5%.




Figura 41. Profesioni i autorëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 1989- 1999 Shikuar për nga struktura e profesionit në periudhën 1989-1999 shohim se pjesën më të madhe të totalit e zë profesioni i bujkut me 43% të totalit, 24% e totalit janë të papunët, 19% e totalit janë puntorët, 6% e totalit janë shtëpiakët, me 2% të totalit secili, marrin pjesë policët, pensionistët dhe mësuesit ndërsa me nga 0.5% të totalit secili marrin pjesë arsimtarët, mekanikët, bukëpjekësit dhe automekanikët.

Duke krahasuar të dhënat e lartë përmendura me të dhënat për periudhën qershor 1999-2017, rezulton se të papunët janë të parët me 55% të pjesëmarrjes në kryerjen e veprave penale të vrasjes, pas të cilëve vijnë bujqit me 16% dhe punëtorët që marrin pjesë me 12% në kryerjen e krimeve nga ky kapitull. Sipas këtyre të dhënave shihet se ka një rënie të pjesëmarrjes së bujqve në kryerjen e krimit të vrasjes, por ka një rritje të përqindjes së pjesëmarrjes së punëtorëve në këto krime.




Figura 42. Profesioni i autorëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 2000-2017 Po të shikojmë strukturën e profesionit në periudhën 2000-2017 shohim se pjesa më e madhe ishin të papunë me 55% të totalit, 16% e totalit ishin bujq, 12% e totalit ishin punëtorë, 5% e totalit ishin të dënuar, 1% të totalit secili, ishin shofer, tregtar, polic, mekanik, hotelier dhe kamarier ndërsa me nga 0.5% të totalit secili, ishin profesor dhe pensionist, me nga 0.2% të totalit secili, ishin bodyguard, argjentar, biznesmen dhe zejtari ndërsa me 0.3% e totalit ishin marangoz.

5.1.13. Mosha e autorëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit (1989-2017)

Mosha e autorëve të veprave penale ka një rëndësi të jashtëzakonshme kur dihet se përcaktimi i saktë i saj përcakton edhe aplikimin e normave ligjore në rastin konkret.

Ishte e njohur dukuria e shtytjes së personave të mitur në kryerjen e veprës penale të gjakmarrjes në Kosovë, sepse me përfshirjen e tyre në këto vepra të rënda kriminale, mendohej shmangia nga përgjegjësisia penale e cila ndaj të rriturve mund të ishte dënim kapital (me vdekje). Sipas të dhënave zyrtare pjesëmarrja e të miturve në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe shëndetit gjatë periudhës 1960-1977 në Jugosllavi ishte mjaft e lartë dhe varironte nga 5.1% (1971) në 10.3% (1977). (Latifi, 1982, f:214-215). Gjatë periudhës 1968-1974 autorët e përfshirë në kryerjen e vrasjes i takonin grupmoshave prej 20-50 vjeç që përfshinin rreth 67.9% të tyre, ndërsa grupmosha prej 14-18 vjeç kishte kryer 46 vrasje. (Latifi, 1984a, f:357).

Për periudhën 1989-1999 grupmoshat e përfshira nën 18 vjeç në kryerjen e veprave penale merrnin pjesë 6 persona të mitur ose vetëm 2% të totalit, ndërsa me 70% të të përfshirëve në krime e përbënin grupmoshat prej 20-40 vjeç.




Figura 43. Mosha e autorëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 1989-1999

Mosha e autorëve të veprës penale në periudhën 1989-1999 është e strukturuar në këtë mënyrë, 26% të totalit e përbëjnë mosha prej 31-40 vjeç, 12% e totalit përbëhet nga mosha 41-50 vjeç, 7% e totalit përbëhet nga 51-60 vjeç, 3% e totalit përbëhet nga mosha 61-70 vjeç, 1% e totalit përbëhet nga 71-80 vjeç, 3% e totalit përbëhet nga mosha nën 18 vjeç, 4% e totalit përbëhet nga mosha 18-19 vjeç ndërsa mosha e cila ka përqindjen më të lartë është ajo e moshës 20-30 vjeç e cila përbënë 44% të totalit.

Shikuar sipas moshës, në Serbi mosha më e rrezikuar nga krimi i vrasjes i perket moshës prej 20-39 vjeç që përfshin rreth 26,4% të popullsisë, ndërsa personat me kombësi të huaj, përqindja e viktimave që i takojnë kësaj moshe është e ndryshme, psh., tek romët viktimat e kësaj moshe përbëjnë 30.5% të popullsisë, tek shqiparët 29,9% ndërsa tek hungarezët është 24,3%. (Republicki Zavod za Statitiku, 2010f, f:62).

Në periudhën qershor 1999-dhjetor 2017, në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit janë shënuar 16 autorë të mitur (nën 18 vjeç). Shumica prej tyre ishin të pëfshirë në kryerjen e vepres penale të vrasjes dhe vrasjes së mbetur në tentativë, ndërsa mes tyre ishin kryer edhe dy vrasje me motive të hakmarrjes. Përfshirja e të miturve në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit ishte me e theksuar në rajonin e Prishtinës . (Hajdari, 2004, f:118-125)




Figura 44. Moshë e autorëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit 2000-2017

Moshë e autorëve të veprës penale në periudhën 2000-2017 është e strukturuar në këtë mënyrë, 23% të totalit e përbëjnë personat që kanë moshën 31-40 vjeç, me nga 9% secila janë të moshës 41-50 vjeç dhe 61-70 vjeç, 3% e totalit përbëhet nga personat e moshës 51-60 vjeç, 1% e totalit përbëhet nga personat e moshës 71-80 vjeç, 2% e totalit përbëhet nga personat moshës nën 18 vjeç, 6% e totalit përbëhet nga moshë 18-19 vjeç ndërsa përqindjen më të lartë është zënë personat e moshës 20-30 vjeç e cila përbënë 47% të totalit.

Sipas të dhënave të Institutit Australian të Kriminologjisë del se viktimat më të sulmuara nga krimi janë personat e moshës nga 18-49 vjeç, që do të thotë se personat e moshës 18-24 vjeç janë viktimat të krimit në 23.1% të rasteve, ata mes moshës 25-34 vjet marrin pjesë me 31.5% të rasteve dhe ata të moshës 35-49 vjeç, marrin pjesë me 13.6% të rasteve. Ndërsa moshë e të dyshuarve nuk ndryshon shumë nga moshatarët e viktimave të krimit, kështu që moshë e të dyshuarve nga 18-24 vjeç përfshinë 31.3% të totalit të krimeve të kryera, ata të moshës 25-34 vjeç marrin pjesë me 33.8% dhe ata të moshës 35-49 vjeç marrin pjesë me 22.3%. (Carcash & Conroy, 2001c, f:190). Pjesëmarrja e grupëmoshave të reja (21-24 vjeç) në kryerjen e krimeve, në Gjermani ishte e madhe sepse 100 në 100.000 banorë ishin të dyshuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit. (Jehle, 2015, f:15).

5.1.14. Llojet e dënimeve të caktuara nga Gjykata e Qarkut të Pejës (1989-2017)

Nga tërësia e çështjeve të cilat janë gjykuar në periudhën 1989-1999 shihet se kemi masë të ndryshme dënimi që gjykata iu ka caktuar autorëve të veprave penale në raport

me llojin e veprës së kryer. Nga figura shohim se 74% të autorëve iu është caktuar dënimi me burgim, 13% të tyre janë liruar nga akuza, 9% të tyre ishin dënuar me kusht, 3% prej tyre u është caktuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndërsa 1% prej tyre u është caktuar masa edukative.




Figura 45. Llojet e dënimeve të shqiptuara nga Gjykata e Qarkut të Pejës (1989-1999)

Në periudhën 2000-2017 autorëve të veprave penale kundër jetës dhe shëndetit iu janë caktuar masa të ndryshme në varsi nga lloji i veprës së kryer. Nga figura e mësipërme shohim se 69% e autorëve janë dënuar me burgim, 8% e tyre janë dënuar me gjobë, 7% e tyre janë në fazën e hetimit ose gjykitimit, me nga 6% secili janë liruar nga akuza dhe janë dënuar me dënim me kusht, 3% të tyre u është caktuar masa edukative ndërsa me nga 0.5% prej tyre u është caktuar trajtim i detyrueshëm psikiatrik dhe janë çështje që janë në rishikim.




Figura 46. Llojet e dënimeve të shqiptuara në Gjykatën e Qarkut të Pejës (2000-2017)

5.1.15. Lartësia e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e Qarkut të Pejës (1989-2017)

Masat e dënimit për çështjet e gjykuara për veprat penale të kryera kundër jetës dhe trupit në periudhën 1989-1999 janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Në figurën e më poshtme kemi të bëjmë me përcaktimin e masës-lartësisë së dënimit me burgim në bazë të viteve e duke analizuar këtë kemi arritur në këto rezultate: për 28% të totalit të veprave të kryera është caktuar dënimi nga 2 vjet deri në 5 vjet burgim, për 22% të totalit të veprave të kryera është caktuar dënimi nga 6 muaj deri në 1 vit burgim, për 23% të totalit të veprave të kryera është caktuar dënimi nga 6 vjet deri në 10 vjet burgim, për 17% e totalit të veprave të kryera është caktuar dënimi me 11 vjet deri në 15 vjet burgim, 7% përfshijnë dënime deri në 6 muaj burgim, 2% përfshijnë dënime të caktuara nga 16 vjet deri në 20 vjet burgim dhe me 1% kemi dënimet e caktuara me 21 vjet deri në 25 vjet burgim.




Figura 47. Kohëzgjatja e dënimit me burgim 1989-1999

Në periudhën 2000-2017 mund të vërejmë se masa e caktuar me burgim nga ana e gjykatës në pjesën më të madhe zë ato çështje apo vepra të kryera për të cilat është caktuar dënimi nga 6 muaj deri në 1 vit burgim të cilat zënë 28% të totalit, 25% e totalit të veprave e zënë dënimet nga 2 vjet deri në 5 vjet burgim, 20% janë ato vepra për të cilat është caktuar dënimi me 6 vjet deri në 10 vjet burgim, për 12% të totalit të veprave është caktuar dënimi me 11 deri në 15 vjet burgim, për 8% të totalit të veprave është caktuar dënimi me 6 muaj burgim, 3% të totalit e zënë veprat me dënime nga 16 deri në 20 vjet burgim, 2% të totalit të veprave e zënë dënimet me 21 deri në 25 vjet burgim ndërsa me nga 1% secila e zënë dënimet me 26 deri në 20 vjet burgim dhe 31 deri në 40 vjet burgim.




Figura 48. Kohëzgjatja e dënimit me burg 2000-2017

5.1.16. Lidhja midis autorit dhe viktimës (1989-2017)

Njerëzit në raportet e tyre njerëzore krijojnë marrëdhënie me njeri-tjetrin në forma të ndryshme. Këto marrëdhënie mund të jenë shoqërore, miqësore, profesionale, biznesi, familjare, martesore e kështu me rradhë. Krijimi i këtyre raporteve njerëzore është një domosdoshmëri për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore. Mirëpo, jo rrallë, ndodh që në këto raporte njerëzore, familjare e bashkëshortore, etj., të krijohen mosmarrëveshje të cilat çojnë në acarime mes tyre e që përfundojnë me përdorimin e dhunës.




Figura 49. Relacioni i autorit dhe viktimës 1989-1999

Jo rrallë, zbardhja e këtyre raporteve mes palëve, mes viktimës dhe autorit të veprës penale sqaron edhe motivin se përse ka ndodhur një krim i caktuar. Gjatë studimit të çështjeve gjyqësore kemi arritur të gjejmë disa të dhëna të cilat kanë dëshmuar lidhjet

midis autorit dhe viktimës në periudhën 1989-1999. Përqindja më e madhe e vrasjeve të kryera gjatë kësaj periudhe janë vrasje ku i akuzuari dhe viktimë e tij kanë pasur marrëdhënie fqinjësore me njëri tjetrin e cila zë 37% të totalit, 21% prej tyre kanë qenë të njohur, 26% prej tyre kanë pasur marrëdhënie familjare, 7% prej tyre kanë pasur marrëdhënie miqësore, 4% prej tyre kanë qenë shokë dhe 5% prej veprave të kryera i akuzuari dhe viktimë nuk njiheshin me njëri-tjetrin.

Për dallim nga periudha paraprake në periudhën 2000-2017 përqindja më e madhe e veprave të kryera janë vepra ku i akuzuari dhe viktimë kanë qenë të njohur e kjo zë 48% të totalit, 24% e tyre kanë pasur marrëdhënie fqinjësore, 10% e tyre kanë pasur marrëdhënie familjare, 8% prej tyre kanë qenë të panjohur, me nga 5% secili prej tyre kanë pasur marrëdhënie miqësore dhe kanë qenë shokë.




Figura 50. Relacioni midis autorit dhe viktimes 2000-2017

5.1.17. Recidivizmi

Siç dihet, fjala “Recidivizm” vjen nga gjuha latine që do të thotë re- pas dhe caedere-kthim që do të thotë kthim në të kaluarën që në rastin tonë do të thotë kthim në të kaluarën kriminale. Sipas prof. Gjoncaj “për kriminologjinë recidivisti nuk shikohet në këndin e institutit të dënimit, (...) por me recidivist kuptohet kryerja me përsëritje e krimeve” (Gjoncaj & Gjoncaj, 2013a, :418). Gjatë studimit të kësaj dukurie, pjesëmarrjes së recidivistëve në kuadër të kriminalitetit në përgjithësi, në literaturën kriminologjike në vend, rajon dhe gjetkë ka të dhëna të mjaftueshme. Të dhënat për këtë kategori në vendimet që kemi patur në shqyrtim mungojnë. Për këtë arsye, këto të dhëna janë mjaft të disponueshme nga gjykatat përveç nëse kërkohen me emër dhe mbiemër.

Kjo praktikë e mosevidentimit në vendim e të qenit recidivist, ka qenë dhe është një praktikë që është duke vazhduar po thuajse që nga vitet e 80 e në vazhdim. Recidivizmi, si kategori e personave që kanë qenë të dënuar më parë i duhet kushtuar kujdes i posaçëm, sepse ata përbëjnë një tipologji të tipit kriminel do të thoja të shkolluar. Ata vijnë nga intitucione të ndryshme penitenciare, disa nga të cilët e kanë të vështirë të përshtaten në botën e lirë. Më të drejtë prof. Salihu konstaton "...se përqindja e recidivizmit në vendet e caktuara është rreth 30 dhe 35 përqind" dhe se "...çështja e recidivizmit në përpjestime nacionale dhe ndërnacionale është mjaft aktuale dhe paraqet një dukuri që brengos". (Salihu, 1985e, :138). Së pari, kjo brengosje vjen për shkak së në njërën anë kemi pjesëmarrje në krim të një personi i cili ka qenë i dënuar më parë dhe së dyti, për shkak se masa e caktuar nga ana e gjykatës nuk e ka arritur qëllimin e vet edukativ përmirësues dhe së treti, pjesëmarrja e tyre në aktivitete kriminale krijon një pasiguri dhe një shembull negativ në mjedisin ku ai jeton. Sipas të dhënave në Kosovë, në vitit 70, recidivistët zinin një shifër të lartë në kriminalitetin e përgjithshëm, ndërsa në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit pjesëmarrja e tyre arrinte shifrën 30 %.

Me qëllim të mbrojtjes juridiko penale, neni 79 i Kodit Penal të Kosovës ka parashikuar ashpërsim të dënimit për përsëritësit e veprave penale (recidivistet) me kusht që përsëritja e krimit të ketë ndodhur brenda periudhës prej 5 vjetësh nga moment i kryerjes së krimit.

Sic e trajtuam më lartë, në vendimet e Gjykatës së Qarkut të Pejës që kemi analizuar, askund nuk evidentohet se personi i akuzuar është recidivist por, në bazë të të dhënave nga regjistri i gjykatës kemi vërejtur se edhe për këtë kategori të veprave penale ka patur recidivistë kundër të cilëve nuk janë aplikuar masat e parashikuara sipas Kodit Penal. Përkundrazi, çështjet e këtyre recidivistëve, (pa asnjë arsye) janë zgjatur, qoftë në gjykim qoftë gjatë procedurave ankimore. (Aktakuza sipas lëndës PP-nr 429/08 e datës 13.01.2010). Në këtë çështje bëhet fjalë për vrasje e mbetur në tentativë e cila kishte ndodhur më datën 24.11.2008 në orën 22:30min ku të përfshirë në cilësin e të dyshuarve ishin disa persona me të shkuar kriminale të kësaj natyre. Në mungesë të përgjegjësisë dhe vullnetit të dobët të institucioneve përgjegjëse (për 7 vjet e tetë muaj e 12 ditë), më datën 24 gusht, në një vend publik ekzekutohen me armë të tre të dyshuarit e çështjes, në shenjë hakmarrje për veprat penale që kishin ndodhur më herët midis autorit të tanishëm (dikur viktimë) dhe viktimave të tanishme (dikur autorë të veprës penale). (Gjergjaj, 2016).

Pra, çështja e recidivizmit, përkundër masave që janë marrë ishte, është dhe do jetë problem në të ardhmen jo vetëm në vendin tonë por edhe në nivel ndërkombëtar. Sipas studimeve të fundit në Australi del se 82% e meshkujve janë të përfshirë për të dytën herë e më tepër në krim, pra, janë shëndërruar në recidivistë, që do të thotë se prej kësaj perqindje, 67% janë madhorë. Në SHBA pjesëmarrja e femrave recidiviste është mjaft e lartë, ndërsa në Kanada, 62% e meshkujve mund të jenë përsëritës potencial (recidivist).

Sa i përket veprave penale të kryera nga recidivistë, sipas këtij studimi del se në rradhë të parë bëjnë pjesë veprat penale kundër pasurisë. Në Kanada, recidivistet ishin më të prirur të kryenin veprën penale të vjedhjes, ndërsa në Australi recidivistet ishin të prirur të kryenin veprën penale të grabitjes dhe shitja të lëndëve narkotike. Edhe në SHBA, personat e arrestuar (recidivistët) ishin autorë të veprës penale kundër pasurisë.

Faktorët që kishin ndikuar në “riaktivizimin e tyre në krim” në këto vende përmenden shkalla e ulët e edukimit (arsimimi), përdorimi i drogës, papunësia dhe statusi martesor. (Makkai, Ratcliffe, Veraar, & Collins, 2004, f:15,17,18,20).

Përkunder masave që janë marrë në kontrollimin e kriminalitetit në përgjithsi si dhe në zbatimin e masave post-penitenciare, përsëri personat të cilët një herë kanë patur probleme me ligjin dhe kanë qenë të dënuar, pas daljes nga burgu prapë janë përfshirë në përsëritjen e veprës penale. Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit Shtetëror të SHBA-së, të vitit 2006, në këtë vend pjesëmarrja e të arrestuarëve që ishin përfshirë sërish në kryerjen e krimeve të ndryshme është sipas shkallës së përqindjes së mëposhtme. Në kryerjen e veprës penale të vrasjes ishin 1,35 %, në sulme fizike ishin 23,3%, në shitjen e drogës 11,5% dhe prishje e rendit publik 15,5%. Sa i përket moshës, mbi 70% janë të moshës nën 21 vjeç. Sipas gjinisë, recidivistët meshkuj përbënin 52.2% dhe 36.4% ishin femra. Nga të gjithë përsëritësit e veprave penale të bardhët merrnin pjesë me 41.7%, zezakët me 59.1%, hispanikët me 49.1% dhe të tjerë me 49.4%. Sa i përket shkallës së shkollimit të recidivistëve, të paraqitur në këtë studim, 60.4% prej tyre kishin më pak se shkollën e mesme të kryer, 50.7% me shkollë të mesme, 39.3 % me diplomë kolegji dhe pa diplomë kolegji ishin 19.1%. (Hunt & Dumville, 2006, f:17, 23-24).

Sipas të dhënave nga autori serb, në vitin 2012 në katër burgjet e Serbisë (Valeve, Padinska Skela Pozharevc dhe ne Pançeve) 58.3% ishin të dënuar për herë të parë ndërsa 41.7% ishin recidivistë. Pra, sipas këtij autori numri i recidivistëve në Serbi është 29.5% i tyre. (Jovanic, 2014, f:155).

Ky trend relativisht i lartë i pjesëmarrjes së recidivistëve në kriminalitetin e përgjithshëm dhe në veprat penale kundër jetës dhe trupit në veçanti, sot, pothuajse është i pranishëm në çdo shoqëri moderne. Personat e moshës nga 21-49 vjeç janë të përfshirë në grupmoshat me një përqindje të lartë në “krime të reja” edhe pse me kalimin e moshës 40 vjeçare, fillon dobësimi i organizmit në kuptimin fizik të fjalës dhe këta persona nuk janë më të prirur të kryejnë vepra ku kërkohet përdorimi i forcës fizike, por më tepër orientohen në kryerjen e krimeve nga të cilat mund të ketë përfitim ekonomik. (Gjoncaj & Gjoncaj, 2013c, f:423).

Kapitulli VI: Faktorët dhe teoritë e kriminalitetit (etiologjia kriminale)

Që në fillet e shoqërisë njerëzore, e posaçërisht pas krijimit të shoqërisë së organizuar, kriminaliteti është shfaqur si një e keqe e cila e percjell dhe bashkëjeton me shoqërinë njerëzore që nga fillimi i saj deri më sot. Se përse është shfaqur krimi, rrethanat e shfaqjes së tij, format e paraqitjes së tij, rrënjet të cilat e ushqejnë këtë të keqe e cila është prezente në çdo shoqëri njerëzore i studion Etiologjia Kriminale e cila është pjesë e lëndës së kriminologjisë. Pra, që nga themelimi i shteteve të para, vrasja ishte dhe mbetet vepra më e rëndë penale e cila konsiston me humbjen e një jete njeriu e shkaktuar po nga vet njeriu. Rreth shfaqjes, formave të shfaqjes, rrethanave të shfaqjes janë marr shumë autorë që nga antikiteti e deri më sot.

Ndër mendimtaret e parë antikë mbi kriminalitetin janë, Platoni dhe Aristoteli. Sipas Platonit, shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit ishin të karakterit psikologjik, i një “shpirti të sëmurë”, të paditur dhe të pangopur nga kërkesat e tija; se “krimi kryhet për shkak të ndikimit të instiktit, epsheve të pa mposhtura, mosdijes dhe shpirtit të sëmurë të kriminelëve”. Sipas mendimit të Aristotelit, rrënjet e kriminalitetit janë si produkt i shprehive dhe varfërisë, se ato kryhen “për shkak të ndikimit të motiveve dhe shprehive kriminale”. Në periudhën e mesjetës, paraqiten studiuesit Shen Augustini dhe Thoma Akuini, të cilët shfaqjen e kriminalitetit e paraqesin si shkelje të së drejtës hyjnore, shkelje e rregullave të “shtetit të shenjtë të kishës” dhe “shtetit tokësor” por “Të këqijat e kësaj bote nuk i vijnë njeriut nga zoti, por nga mënyra që zgjedh njeriu për të jetuar” shkruan autori Gjonçaj. (Gjonçaj & Gjonçaj, 2013d, f:68). Më pas lidhur me kriminalitetin na paraqiten mendimet e periudhes humaniste të përfaqësuar nga Tomas Mor, Tomas Kompanella, Monteskje dhe Zhan Zhak Ruso. Sipas tyre shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit burojnë nga rrethanat shoqërore, sistemi juridik, kushtet e jetesës së njerëzve, mjedisi social, politik dhe ekonomik. Edhe Cezare Bekario më vonë, shkaqet e kriminalitetit i sheh në mjedisin ekonomik, shoqëror dhe familjar. Në gjysmën e shek. XIX-të, paraqiten teori të ndryshme (antropologjike, sociologjike, biologjike, endokrinologjike, teoria e kromosomeve, e racës, psikologjike, psikoanalitike, e papërshtatshmerisë, e inteligjencës dhe teoria e frustrimeve psikike etj.) të cilat mundohen të shpjegojnë në menyrë të pavarur shkaqet e shfaqjes së kriminalitetit në përgjithsi. Shkaqet e shfaqjes së kriminalitetit fillimisht janë paraqitur nga italianii Lombrozo i cili njëherësh është edhe përfaqësues i teorisë antropologjike.

Sipas kësaj teorie, njeriu lind kriminel, veprimet kriminale i lidh me zhvillimet

anatomike dhe fiziologjike duke përshkruar në detaje format e kafkës, nofullave, shpatullave, veshëve, thonjëve etj. Duke i përshkruar tiparet e tij, Lombroso, i ndanë autorët e veprave penale “në kriminel të sëmurë psikikë, kriminel nga pasioni, kriminel të rastit dhe kriminel nga shprehitë”. (Millutinoviq, 1981a, f:113-114). Përkundër kritikave të kohës, kjo teori e tij mbi kriminalitetin ka patur një jehonë në Europë. Si kundërvënie e kësaj teorie mbi njeriun e lindur kriminel edhe pse nuk mund të shpëriten plotësisht nga ndikimi i kësaj teorie, paraqitet teoria sociologjike e Enrico Ferit dhe Garafallos të cilët shkakët e paraqitjes së kriminalitetit i shohin të lidhur me faktorë social. Sipas teorisë biologjike, rrethi shoqëror i jep formën e krimit ndërsa shkakët e krimit duhet kërkuar individualisht në çdo person. Sipas Hooton, njëri ndër shkakët e paraqitjes së kriminalitetit është inferioriteti biologjik i përcjell me vetitë fizike dhe mentale të cilat lidhen me trashigiminë. Teoria lombroziene e kombinuar me mendimin e teorisë biologjike në shfaqjen e kriminalitetit na sjell deri te teoria e trashëgimit dhe shprehive të lindura e përfaqësuar nga Benito Di Tullio, Oto Kinberg, etj. Sipas tyre ekziston një korelacion mes “prirjes kriminale” dhe “trashëgimisë kriminale” të cilin e kishin bazuar gjatë një studimi për “familjet kriminale” për një periudhë 200 vjeçare duke konstatuar se “mbi gjysma e më tepër e anëtarëve kishin qenë kriminelë ...”. (Millutinoviq, 1981b, f:120). Më pas në shpjegimin e kriminalitetit paraqitet teoria e endokrinologjike e përfaqësuar nga Schalpi dhe Berman, të cilët shkakët e paraqitjes së kriminalitetit i shpjegojnë me pengesat në funksionimin e sistemit endokrin i cili sjell çrregullime mentale që përfundojnë me veprime të dhunshme kriminale. Në kohët e fundit është paraqitur edhe teoria e kromozomeve e bazuar në kërkimet gjenetike sipas të cilit personat të cilët kanë ç’rregullime në strukturën e kromozomeve janë më të prirur të kryejnë krime. Më pas, në kuadër të këtyre hulumtimeve mbi shfaqjen e kriminalitetit, paraqitet edhe teoria e racës e cila ka gjetur ithtarë sidomos në SHBA dhe në Europë. Meqenëse njeriu është qenie shoqërore, disa autorë, kriminalitetin e kundrojnë nga këndi psikologjik duke krijuar teorinë psikologjike (Gabriel Tard), i cili shfaqjen e kriminalitetit e lidh me teorinë e imitimit të ngjarjeve, dukurive, idhujve etj. Në kuadër të teorisë psikologjike, më të njohurat janë teoria e papërshtatshmërisë, teoria e inteligjencës, teoria psikoanalitike dhe teoria e frustrimeve psikike. Sipas përfaqësuesve të teorisë së papërshtatshmërisë, krimi dhe paraqitja e tij është si produkt i mospërshtatjes në një ambient shoqëror, është rezultat i mungesës së edukatës së duhur dhe mungesës së aftësisë për t’iu përshtatur një rrethi të caktuar shoqëror. Sipas teorisë së inteligjencës, shkakët e krimit duhet kërkuar në

shkallën e ultë të inteligjences të individëve që janë të përfshirë në kriminalitet. Ndërsa, sipas teorisë psikoanalitike (S. Frojd) shfaqja e kriminalitetit shpjegohet në bazë të shumë faktorëve psikikë të brendshëm dhe nga motive seksuale. Moszhvillimi normal i fëmijëve, sipas tij sjell agresivitet. Pra, sipas kësaj teorie, kemi një luftë mes Idit-, egos dhe super egos, ose një luftë mes mosplotësimit të kërkesave, instikteve dhe realizimit të idealeve. Sipas teorisë së frustrimeve psikike, kriminaliteti është një rezultat i një agresioni të njeriut delikuent në një fazë të caktuar i cili për shkaqe të ndryshme nuk ka arritur të realizojë dëshirat e tij. Sipas teorisë sociologjike, shfaqja e kriminalitetit është rrjedhojë e zhvillimeve sociale ekonomike dhe shoqërore në përgjithësi. Në kuadër të kësaj teorie janë paraqitur mendime të ndryshme të sociologut G. Tarde, Durkhem dhe Franc Von List. Sipas Tarde, prezenca e kriminalitetit në shoqëri i ka rrënjët në zhvillimet shoqërore dhe në kushtet e mosadoptimit të delikuentit në një ambient të caktuar shoqëror. Sipas Emil Dyrkem-it, shkaqet e kriminalitetit duhen kërkuar në vet shoqërinë njerëzore, duke pranuar se disa “veprime kriminale” janë të “shëndetshme për shoqërinë”. Sipas List, kriminaliteti është një dukuri e ndikuar nga faktorë socialë dhe psikikë. Përveç mendimeve të tilla për shfaqjen e kriminalitetit, List shkon dhe më tutje dhe i ndanë kriminelët në katër grupe të cilët kryejnë krime të cilët sipas tij, kryesisht janë të ndikuar nga rrethanat e jashtme. (Halili, 2016b, f:97). Pas luftës së dytë botërore paraqitet Shkolla e Mbrojtjes Shoqërore e përfaqësuar nga Gramatika dhe Mark Anselm. Sipas kësaj shkolle, shkaqet e kriminalitetit i kanë rrënjët në zhvillimet e përgjithshme shoqërore duke i kushtuar rendësi personalitetit të autorit të veprave penale dhe parandalimit të kriminalitetit. Më pas na paraqiten teoritë e reja siç janë: teoria e grupit ose e sjelljes devijante në SHBA, teoria e dezorganizimit shoqëror, teoria e konflikteve kulturore, teoria e Anomisë, teoria e interaksionit dhe etiketimit. Sipas përfaqësuesëve të teorisë së grupit, kriminaliteti dhe lindja e tij është pasojë e ndarjes së shoqërisë në aspektin fetar, etnik, kulturor, racial, social etj. Sipas përfaqësuesëve të teorisë së dezorganizimit (Edvin Suterland), shkaqet e kriminalitetit i sheh tek dezorganizimi shoqëror i cili në mënyrë zingjyrore ndikon dhe nxit deorganizimin individual. Shpjegimi i tillë i kriminalitetit bazohet në ndryshimet e mëdha politike dhe në lëvizjen e popullsisë, dyndjet dhe vendosja e tyre në zona të caktuara, lufta për

mbijetesë, pasuri dhe “pushtet”. Sipas teorisë Kulturore, shkaqet e kriminalitetit shpjegohen në qëndrimin përçmues dhe fyes në mjedise të ndryshme me popullësi etnikisht dhe kulturalisht të përzierë. Sipas teorisë se Anomisë (Robert Morton), shkaqet e kriminalitetit paraqiten si “tronditje”, “kaos shoqëror” ku secili e ka proritë shkeljen e ligjit për shkak të një pasigurie juridike shoqërore. Sipas teorisë së interaksionit dhe etiketimit, shfaqja e kriminalitetit është si rezultat i raporteve mes delikuentëve dhe institucioneve shtetërore që kanë për obligim luftimin e kriminalitetit. Duhet përmendur se përveç teorive të përmendura më lartë është edhe teoria viktimologjike e përfaqësuar nga kriminologu amerikan Hans Von Henting sipas të cilit shkaqet e kriminalitetit nuk mund të kuptohen saktë nëse nuk e njohim saktë personalitetin e viktimës, pa veprimet e të cilit do mungonte lidhshmëria mes krimit të kryer dhe autorit.

Në këtë konglomerat teorishë mbi kriminalitetin duhet përmendur edhe teoria marksiste e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj Marks dhe Engelsi. Sipas tyre kriminaliteti “...në instancë të fundit e ka gjenezën e vet në kushtet e saj jetësore, në raportet shoqërore dhe pronësore në të cilën mbështetet ajo shoqëri, të cilat lindin papunësinë, varfërinë, skamjen familjare, prostitucionin, prirjet dhe shprehjet kriminale dhe vetitë e ndikimet e tjera negative të cilat janë drejtëpërdrejtë të lidhura me kriminalitetin”. (Millutinoviç, 1981c, f:181); (Marks & Engels, 1980, f:40-45). Dhe për çudi, me gjithë këto shkrime, me një dyzinë teorishë të ndryshme të përfaqësuara nga studiues të fushave të ndryshme, më shumë ligje, hetime dhe burgime, kriminaliteti në përgjithsi ka shënuar rritje, duke ndryshuar format e paraqitjes dhe fal zhvillimeve teknologjike, sa vjen dhe perfeksionohet. As argumentet dhe kundërgargumentet e përfaqësuesve të ndryshëm të këtyre teorive, (se cila është më frytëdhënëse) nuk kanë arritur qëllimin e dëshiruar për shkak se, kriminaliteti sikur po sfidon mbi të gjitha teoritë dhe po shton prezencën e tij në të gjitha shtetet qofshin të pasura apo të varfëra, pa marr parasysh format e regjimit (demokraci apo diktaturë).

6.1.1. Krimi i vrasjes dhe tipologjia e kriminelit

Vrasja është akt i marrjes së jetës me veprim ose mosveprim në mënyrë të kundërligjshme me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia (Elezi, 2014, f:35). Duke analizuar statistikën krimnologjike të vrasjeve na del se kemi të bëjmë me dy ndarje të mëdha të tyre. Vrasjet që ndodhin brenda familjes dhe vrasjet që ndodhin jashtë saj. Vrasjet që ndodhin mbrenda familjes janë ato vrasje që kryhen nga njëri nga anëtarët e saj. Këto vrasje mund të jenë individuale dhe mund të

jenë vrasje të tërë familjes që në disa raste na bie të dëgjojmë së në familjen X është kryer një masakër, pra, janë vrarë të gjithë anëtarët e familjes. Në aspektin kriminologjik, disa studiues këtë lloj të vrasjes e kategorizojnë si vrasje masive. Vrasja e disa anëtarëve të familjes, shokëve në shkollë, kolegëve të punës, është një masakër por nuk mund të jetë vrasje masive, sepse këtu bëhet fjalë për vrasje e cila kryhet nga një person i frustruar i cili së paku njeh njërin nga viktimat, ndërsa në rastin e vrasjeve masive, autori i këtij krimi nuk ka afërsi me viktimat e tij. Pra, vrasësit e tillë kryejnë vrasje të disa personave duke u ndikuar nga motive jo personale por janë të shtyrë nga “motive të larta” kombëtare, racore, fetare, politike, etj., me qëllim të përcjelljes së një mesazhi të urrejtjes, frikës dhe pasigurisë tek një grup, fe, racë apo kombi tjetër. Pra, kemi të bëjmë me mesazhe, qëllime dhe motive të ndryshme. Duhet thënë se brenda familjes mund të jenë vrasje për çështje trashëgimie, urrejtje individuale, fyerje, sëmundjeje, gjendje të vështirë sociale apo shpirtërore e deri të pakënaqësitë e ndryshme. Duke patur parasysh motivet e vrasjes ato mund të jenë edhe vrasje për nder (honor killing) e cila kryhet kundër anëtarit të familjes, për shkak të thyerjes së rregullave tradicionale, fetare apo familjare, (refuzimi i martesës sipas traditës, marrëdhëniet seksuale jashtë martesore, fejesat jashtë traditës etj), vrasja e fëmijëve të porsalindur të gjinisë femërore (Kinë dhe Indi).

Rreth tipologjisë së vrasjeve, në SHBA ekziston një manual unik i veprave penale të vrasjeve i cili quhet “Raporti Unik i Krimit” (*Uniform Crime Reports* (UCR)). Në këtë manual janë paraqitur të gjitha llojet e vrasjeve të kryera qoftë brenda familjes apo jashtë saj, vrasje të ndryshme me pagesë qoftë nga individë apo organizata kriminale e deri te vrasjet nga terrorizmi. (Douglas, Burgess, Burgess, & Ressler, 2006, f:93-260).

Në vrasjet që ndodhin jashtë familjes janë të gjitha ato vrasje që kryhen nga persona që nuk kanë një lidhje gjaku a krushqie me familjen por kryhen për qëllime dhe motive ndër më të ndryshmet. Në këtë ndarje bëjnë pjesë edhe vrasjet që kryhen nga grupe të caktuara me pagesë. Edhe në KLD-në njihet kjo kategori e personave që kryejnë vrasje me pagesë dhe njihet me emrin Simahor (Gjeçovi, 2015, f:82). Ndërsa në botë njihen grupe, shoqata dhe individë që vrasjen e kanë profesion dhe të cilën e kryejnë për para. (Wikipedia, 2014).

Në vazhdim po përmendim vetëm disa nga llojet e vrasjeve me të cilat po përballlet sot bota bashkëkohore. Në këtë kuadër po përmendim vetëm disa forma të vrasjeve ku bënë pjesë vrasja e kontraktuar me pagesë nga një person, grup apo organizatë, të cilët kryejnë vrasje të një individi të caktuar ose një grup të një populli të caktuar, të një grupi

etnik apo fetar të caktuar.

Vrasjet nga kriminel individual ndryshe quhen edhe vrasje nga pasioni (crime of passion). Vrasësi individual, duke patur për qëllim ngarkesat e tija ideologjike, fetare a kombëtare, në një kohë të caktuar mund të kryej vrasjen e shumë personave dhe me këtë rast kemi të bëjmë me vrasje masive. Disa kriminologë, vrasësit individual i kategorizonin në vrasës masiv dhe serial. Duke iu referuar autorit David Lester, që nga viti 1950 deri në vitin 2002 janë zbuluar 594 vrasës serialë që ky autor i quan edhe “solo killers” (vrasës të vetëm) prej të cilëve 559 ishin meshkuj, 31 femra dhe 4 veta të gjinisë asnjënjëse. Për nga ngjyra e lëkurës 395 ishin të bardhë, 95 afrikan-amerikan, 38 hispanik, (spanjoll), 5 të tjerë dhe 64 nuk dihen. Nga 594 vrasës serialë, 26 kishin kryer vetëvrasje, 67 ishin ekzekutuar, 481 ishin arrestuar nga forcat e rendit, 8 ishin vrarë nga policia, 6 ishin vrarë dhe 6 ishin zhdukur pa lënë asnjë gjurmë. Duke patur parasysh se ata kishin lëvizur gjatë tërë kohës sa kishin kryer krime, ata ishin kategorizuar në vrasës nomadë (246 vrasës), vrasës të lidhur për një territor (317 vrasës), 27 vrasës ishin “vendor” dhe për katër prej tyre nuk kishin të dhëna. (Lester, 2010).

Sipas literaturës serbe në Serbi, ekzistonin vrasje të motivuara nga normat zakonore serbe siç ishte vrasja e anëtarëve të familjes të cilët kishin mbushur 60 vjeç. Vrasja e tyre kryhej nga një anëtar i familjes, i gjinisë mashkull. Për këto vrasje “tradicionale” në Serbi, kanë shkruar autorët serb Sima Trojanoviq “Lapot i Prokletije Srba” (1898). Për këtë dukuri kanë shkruar edhe autorët V.Radovanoviq në librin e tij “Narodna predanja o obijanju starih ljudi” (1929), Dushan Bandiq në librin e tij “Narodna religija u 100 pojmovu” (1991). Lidhur me vrasjet e pleqëve në Serbi, etnografi serb Veselin Çajkanoviq, edhe pse ka dilema rreth disa konkluzioneve të kolegëve të tij, konstaton se: “të parët tanë i kanë vrarë pleqtë për shkak se ata vetëm harxhojnë ushqimin dhe nuk vlenin për asgjë”. (Cajkanovic, 1973, f:57). Ky fenomen i vrasjes së 60 vjeçarëve që dikur ka qenë prezente në shoqërinë serbe, viteve të fundit ka zgjuar interesim të madh te gazetarët dhe studiuesit e rinj në Serbi. (Mitrovic, et al., 2015). Gazeta serbe “Kurir” e Beogradit e datës 6 prill 2014 në artikullin e saj me titull “7 tradita popullore në Serbi” e njofton publikun për traditën serbe të vrasjes së pleqëve në Serbi, traditën e marrëdhënieve seksuale të vjehrrit me nusen e djalit (Snahocestvo) dhe disa tradita të tjera popullore. (Petrovic, 2015). Lidhur me këto vrasje “tradicionale” serbe gazeta “Telegraf” e Beogradit, në artikullin e saj me titull “Vrasje e vrazhdtë: Në Serbi para 11 shekujsh i vrisnin prindërit që i kishin mbush 60 vjeç” ajo njofton opinionin publik për “për disa tradita shokuese që dikur kanë ndodhur në Serbi”. (Vukovic, 2014).

Siç u tha më lartë, individë, grupe të caktuara dhe për motive nga më të ndryshmet kryejnë vepra (me veprim ose mosveprim) të kundërligjshme që kryhen me dashje ose nga pakujdesia të cilat janë të dënueshme sipas legjislacionit penal dhe konsiderohen veprime kriminale. (Elezi, 2014a, f:81). Prandaj, duke pasur parasysh autorizimet që shteti i ka rezervuar për vete, rezulton se shteti kryen dy lloje vrasjesh. Vrasje të cilat janë të bazuara në një vendim të formës së prerë të cilën gjykata ia cakton një autori “për kryerjen e një krimi të rendë” (Elezi, Kapuçi, & Maksim, 2014, f:227) dhe vrasje të kryera në mënyrë të kundërligjshme nga institucione shtetërore (demokratike ose diktatoriale), pavarësisht nga dinamika e tyre, përmes instrumenteve të veta legale (policisë, policisë sekrete) dhe gjysmë legale (grupeve kriminale, atentatorëve etj).

Përkundër problemeve shtet-shtetas, shteti ka obligim kushtetues mbrojtjen e jetës, lirisë, pronës dhe personalitetit dhe autoritetit të shtetasve të tij. (Muçi, 2012, f:58-59) dhe marrja e jetës së individit në mënyrë kundërligjore nga shteti shkakton terrorizëm shtetëror të kryer kundër shtetasve të vet. Në këtë drejtim, shteti dhe pushteti janë të angazhuar në ruajtjen e rendit dhe sigurisë kundër kriminalitetit. Në këtë drejtim edhe roli ndihmës i shkencës juridike është i pazëvendësueshëm sepse studimi i krimit dhe i tipologjisë së kriminelëve ndihmon institucionet ligjzbatuese në ruajtjen e rendit dhe sigurisë. Sipas autorit Halili, studimi i tipologjisë së kriminelit ka një rëndësi të madhe, por qasja duhet bazuar në “studime të mirëfillta kriminologjike, sepse klasifikimet dhe ndarjet parciale, të bazuara në disa aspekte, nuk mund të jenë të qëndrueshme dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë në luftimin dhe pengimin e kriminalitetit në shoqëri” (Halili, 2016, f:393). Në këtë drejtim, autorja Vasilika Hysi, përqafon ndarjet e shkollës pozitiviste italiane të Enrico Ferrit dhe tipologjinë e kësaj shkolle e cila kriminelët i ndanë në pesë tipe, në kriminel të lindur, kriminel të sëmur mendërisht, kriminel të rastit, kriminel të zakonshëm dhe kriminel pasionantë. (Hysi, 2000, f:28-29). Ndërsa autori Luan Gjonçaj, kriminelët i ndanë në 5 grupe.

Në grupin e parë, duke pasur parasysh personalitetin e kriminelit, ai i ndanë në tre tipe. Tipi kriminogjen i qëndrueshëm në përbërje të kriminelëve profesional, recidivistë dhe “të regjur” që janë ajka e krimit të organizuar. Tipi kriminogjen i momentit ku bëjnë pjesë kriminel të “ligës së dytë” duke përfshirë edhe të miturit. Tipat kriminogjenë të situatës apo të rastit të cilët në rrethana të caktuara kanë hyrë në rrugën e krimit.

Në grupin e dytë, hyjnë kriminelët sipas motivimit të cilët kryejnë vepra penale

për interes, nga egoizmi apo dhuna, për bajraktarizëm apo bazuar në të drejtën kanunore, nga mendjelehtësia dhe papërgjegjshmëria, nga motivimi politik dhe bindje ekstreme fetare.

Në grupin e tretë, vijnë kriminelët sipas karakterit të krimit ku hyjnë kriminelët e rrezikshëm, kriminelët e dhunshëm, vrasësit, grabitësit, vjedhësit dhe mashtruesit dhe kriminelët që kryejnë krime nga pakujdesia.

Në grupin e katërt, vijnë kriminelët që kryejnë krime sipas qëllimit, të cilët kryejnë krime kundër pasurisë, në sferën ekonomike-financiare, kriminel të prestigjit që synojnë majat e shtetit dhe pushtetit me qëllim plaçkitjen e pasurisë shoqërore dhe kombëtare, kriminelët dhunues ku bëjnë pjesë vrasësit, dhunuesit dhe kriminelët e dhunës seksuale të cilët kryejnë vepra penale kundër shëndetit, nderit dhe personalitetit.

Në grupin e pestë, bëjnë pjesë kriminelët sipas orientimit social ku bëjnë pjesë tipi profesionist i kriminelit i cili është mjaft i rrezikshëm dhe i shtyrë nga arroganca dhe padija (është i pa arsimuar), kriminelët me deformim moralo-psikologjik, injorues dhe jorespektues i ligjit, kriminel me personalitet të paqëndrueshëm, kriminel neglizhent i cili nga pakujdesia shpesh bie ndesh me ligjin dhe kriminel të rastit që mund të jetë çdo person që raste të paparashikuara mund të bie ndesh me ligjin. (Gjonçaj, 2013, f:230-234).Pra, duke pasur parasysh këtë tipologji të personalitetit të kriminelit, është më lehtë të përcaktohen masat dhe të caktohen dënimet, apo të ekzekutohen ato në sistemin penitenciar.

Kriminologu Ignjatoviq, tipologjinë e veprave penale dhe autorëve të veprave penale i ndanë sipas kriteriumit të autorit italian Ponti i cili kishte bërë një ndarje në katër grupe duke e shtuar edhe një grup që përfshijnë krimet nga urrejtja. Pra, sipas tij, tipologjinë e kriminalitetit e ndanë në aspektin juridik, shoqëror – ambiental, klinik dhe psikologjik dhe krime nga urrejtja. Sipas tij, tipologjia juridike e veprave penale dhe e autorëve të këtyre veprave është e përcaktuar qartë në kodet penale të vendeve të ndryshme. Edhe përgjegjësia e autorit të këtyre veprave penale është përcaktuar qartë në këto kode dhe i ndanë në autorë të përgjegjshëm të veprave penale, autorë me përgjegjësi të kufizuar dhe autorë të papërgjegjshëm. Pastaj autorët e përgjegjshëm i ndanë në madhor dhe në të mitur. Në grupin e dytë, ai përfshin të gjithë tipat të cilët ndikohen nga rrethi, tradita dhe zakonet, bandat dhe narkomanët, krimin e organizuar dhe kriminelët e jakës së bardhë, politikanët që keqpërdorin pushtetin dhe autorizimet dhe autorët e veprave penale brenda familjes. Në grupin e tretë të klasifikimit klinik ai përmend procedurat

mjeko-ligjore, psikologjike dhe sociologjike që duhen ndjekur për zbardhjen e krimeve në shoqërinë bashkëkohore. Në grupin e katërt, benë klasifikimin sipas motivit duke përfshirë veprat penale për përfitim pasuror, krimet seksuale, krimet politike. Në grupin e pestë ai vendos krimet nga urrejtja të kryera nga grupe të caktuara për qëllime fetare, racore, kombëtare (nga grupe si skinhaeds, Ku Klux Klan, homofobizmi, antisemitizmi etj). Në këtë drejtim, prof. Ignjatovic nuk përmend fare krimet e urrejtjes ndaj shqiptarëve të Kosovës (1989-1999) për të cilën edhe ai ka qenë dëshmitar i gjallë, por flet dhe shkruan për krimet nga urrejtja që ndodhin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. (Ignjatovic, 2015, f:108-110). Sa i përket tipologjisë së personalitetit të kriminelit, ai bazohet në faktorë biologjik dhe psikologjik duke i ndërlidhur këta faktorë me zhvillimin psikologjik dhe gjenetik të personit të caktuar. Agresivitetin e kriminelit e ndërlidh edhe me mjedisin subkulturor përmes të cilave mundohet të shpjegojë shkaqet e vrasjeve nga hakmarrja ose vrasjet për nder (honour killing). Lidhur me format e kriminalitetit, ai përmend dy lloje: kriminaliteti tradicional dhe format e reja të kriminalitetit, kriminalitetin brenda familjes ose dhunën në familje. Në tipologjinë e autorëve të veprave penale ai radhit vrasësit serialë, vrasësit që kryejnë vrasje masive, dhunuesit seksual dhe grabitësit. Në grupin e dytë ai vendos “formen e re të kriminalitetit”, dhunën në familje në përgjithësi, dhunën kundër gruas, fëmijëve dhe të moshuarve nga vet anëtarët e familjes, kriminalitetin ekonomik, kriminalitetin politik, terrorizmin etj. Dhuna e shkaktuar ndaj fëmijëve ka marr përmasa të mëdha duke filluar nga ndëshkimi fizik, keqpërdorimi seksual (brenda familjes dhe në shkollë) e deri të eliminimi fizik - vrasjet e tyre. Në këtë drejtim, duhej të thuhet se tashmë shprehja “dhunë kundër grave” duhet të zëvendësohet me shprehjen “dhunë mes partnerëve” sepse në statistikën policore dhe gjyqësore çdo ditë e më shumë ka të dhëna të raportuara për dhunën e ushtruar kundër burrave. “Barazinë” e gruas me burrin edhe në kuptimin e viktimizimit, tek disa autorë ka ende dilema se a duhet të merret në konsideratë apo jo ky fenomen i ri, me shpjegimin se dhuna e shkaktuar nga gratë është një përjashtim dhe se mbrojtja më e mirë ndaj kësaj dhune është “eliminimi i dhunës kundër grave”. (Ignjatovic, 2015a, f:109-130).

Po të shikojmë të gjitha teoritë në aspektin kumulativ dhe tipet e kriminelëve, mund të konkludojmë se qendrimi i prof. I.Salihut është i pranueshëm kur thotë se “në gjenezën e kriminalitetit ndikojnë faktorë të shumtë, të cilët në mes vete janë të lidhur dhe ndikojnë në njëri tjetrin” (Salihu, 1985f, f:189). Pra, në lindjen dhe zhvillimin e kriminalitetit ndikojnë një mori faktorësh të brendshëm (endogjenë) dhe të jashtëm

(ekzogjenë). Si rezultat i ndërvlarshmërisë së këtyre faktorëve, në kriminologji paraqiten tre teori të cilat shpjegojnë secila në mënyrën e saj shkaktarët kriminogjenë. Teoria e faktorit (pluraliste), teoria funksionaliste dhe teoria e kauzalitetit. Sipas teorisë së faktorit, shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit në shoqëri janë të lidhura me paraqitjen e një (monofaktori) faktori kryesor (të cilat janë të lidhura me teoritë e përmendura më lartë) dhe multifaktorëve (familja, kushtet ekonomike sociale etj). Sipas teorisë funksionaliste kriminaliteti shpjegohet si një raport jofunksional mes institucioneve të ndryshme shtetërore. Sipas teorisë së kauzalitetit kriminaliteti ushqehet nga shumë faktorë por që duhet të kuptohen lidhja e tyre kauzale mes veprimit dhe pasojës. Sipas kësaj teorie, shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit duhet lidhur me shkaqet e paraqitjes së tij, kushtet që gjenerojnë në lindjen dhe rritjen e tij. Ndër shkaqet që përmenden në shkencën kriminologjike janë rrethanat shoqërore ekonomike, konfliktet politike, familja, arsimi, etj. Në kuadër të kushteve dhe sjelljes kriminale, autorë të ndryshëm përmendin mungesën e kontrollit institucional, papunësinë, krizën ekonomike, etj. Ndërsa në kuadër të shkaqeve, kërkohet ndërlidhja e fijeve mes veprimit dhe pasojës e cila mund të jetë ndonjë fyerje, ofendim që “aktivizon” veprimin i cili më pas lind pasojën. Sipas kësaj teorie të cilën e kemi përvetësuar mund të konkludojmë se kriminaliteti në përgjithsi dhe veprat penale kundër jetës dhe trupit në veçanti ndikohen nga faktorë të ndryshëm të cilët autori Ismet Salihu i ndanë në dy grupe, në faktorë individual dhe në faktorë të posaçëm. Në grupin e parë janë përfshirë të gjitha vrasjet të cilat janë kryer si pasojë e mosmarrëveshjeve të mëparshme (grindjeve, fyerjeve, xhelozisë, borxhit, problemeve që lidhen me pronësinë, martesës, hakmarrjes, gjakmarrjes, etj). Ndërsa në grupin e dytë përfshihen “të metat e jurisprudencës, joefikasiteti i gjykatave, etj.)

Duke i'u referuar grupit të parë, për çështjet dhe periudhën që kemi në studim pak a shumë janë të njëjtët faktorë dhe të njëjtat shkaqe që kanë ndikuar në strukturën e vrasjeve në Rajonin e Pejës.

Gjatë analizimit të çështjeve penale të gjykuara në Gjykatën e Qarkut të Pejës në periudhën 1989-1999 kam radhitur disa nga faktorët që kanë ndikuar në kryerjen e veprave penale të këtij kapitulli. Sipas të dhënave del se vrasjet të cilat kanë ndodhur në rajonin e Pejës janë ndikuar nga faktorë të ndryshëm, që në fakt i takojnë kategorisë së faktorëve të jashtëm kriminogjen. Në rradhë të parë duhet theksuar se numri më i madh i veprave penale të vrasjeve ka një histori e cila nuk është e momentit, fillon nga një histori që në fakt duket e parëndësishme (fyerje, ngacmime, ngatërresa të ndryshme rreth

problemeve të pronësisë, dëmeve në fushë, rrahja e fëmijëve mes tyre, etj.) dhe përfundon në vrasje. Sipas statistikave që i kemi nxjerr del se 6% e vrasjeve kanë ndodhur për shkak të hakmarrjes, 2% e vrasjeve kanë ndodhur për shkak të gjakmarrjes, 9% e vrasjeve janë si rezultat i fyerjeve të ndryshme, 23% e vrasjeve janë kryer si rezultat i ngatërresave të ndryshme që kishin ndodhur më parë, 11% e vrasjeve të kryera kanë në gjenezë problemet familjare konfliktuale (shkurorëzimeve, martesave të paqendryeshme), 1% e vrasjeve ka ndodhur si rezultat i fejesave të prishura, 20% e vrasjeve janë si rezultat i problemeve të pronësisë të pazgjidhura (mezhdave-kufijve kadastrale të pronës, të drejtës së servitutit, të drejtës së posedimit, etj.), 4% e vrasjeve janë të karakterit pasuror (shitëblerje të ndryshme, përfitimit), 2% e vrasjeve kanë ndodhur si rezultat i dhunës në familje, 8% e vrasjeve kanë ndodhur për shkak të xhelozisë (duhet përmendur se autorët e tillë janë pothuajse në moshë të moshuar) ndërsa 4% e vrasjeve kanë ndodhur nën ndikimin e alkoolit. Duhet theksuar se edhe fajdeja është paraqitur si shkak i vrasjeve duke rritur atë në kuotën prej 2%. 1% e vrasjeve janë kryer nga të sëmurë psikikë, 1 % e vrasjeve kanë ndodhur me qëllim të fshehjes së krimit ndërsa 5% e vrasjeve kanë ndodhur për shkaqe që nuk dihen.

Bazuar në rezultatet e këtij studimi, mund të konkludojmë se veprat penale të kryera në Kosovë brenda dy dekadash, për nga natyra janë pothuaj të njëjta. Është interesant e dhena se gjatë sundimit të regjimeve antipopullore të ish-Jugosllavisë dhe në fund gjatë sundimit të Millosheviçit, veprat penale kundër jetës dhe shëndetit kanë shënuar rënie në çdo vit, ndërsa gjatë kohës së autonomisë së Kosovës dhe pas çlirimit të saj nga Serbia (1999) këto vepra kanë shënuar rritje.

Pas largimit të Serbisë nga Kosova dhe vendsojen e saj nën pushtetin e OKB (UNMIK-ut) kemi një rritje të madhe të këtyre veprave penale dhe kemi një “përparim” në mënyrën e ekzekutimit të vrasjeve „jotradicionale” përmes vrasësve me pagesë, që në fakt siç përshkruhet në paragrafin 850 të KLD është ai person „...që i jep dorë dorasësit” dhe quhet „Simahor”. (Gjecovi, 2015a, f:82). Po i quajmë vrasje jo tradicionale, jo konform Kanunit sepse shpesh dëgjojmë se viktimat të krimit janë fëmijët, gratë, të moshuarit dhe udhëheqësit fetarë (prifti). Në fakt paragrafi 835 i KLD-së ndalon këtë dukuri të shëmtuar, dhe çfarëdo veprimi hakmarrës nga kushdoqoftë dhe sanksionohej nga flamuri sipas paragrafit 836 i KLD-së ku thuhet se, “Po qiti pushkë mbë gra, fimi, shpi a mbë bagëti, punon kundra kanunit...”. (Gjecovi, 2015b, paragrafi 836). Janë vrasje jo tradicionale sepse, vrasjet janë kryer në mënyrë të fshehtë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale dhe kanunore. Në fakt, sipas të drejtës zakonore, marrja

e hakut, marrja e gjakut, bëhej në mënyrë publike dhe familja e viktimës duhej ta dinte se kush i'a kishte vrarë një anëtarë të familjes. Me qëllim që të mos krijoheshin dyshime se kush mund të jetë vrasësi, familja e vrasësit ose vet ai, kishte detyrimin t'a njoftonte familjen e të vrarit konform paragrafit 844 të KLD-së i cili në mënyrë eksplicite kërkon që “Dorëyasi , posa t'a vrasë njerin, do të çojë fjalë se e vrau aj e mos të hutojn mendsh prindja e të vramit”.

Sidoqoftë, vrasjet “gjysmë tradicionale” me elemente mafioze edhe pse janë më të pakta në numër, kanë një efekt tejet negativ në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror për çka do shkruhet më poshtë për vrasjet nga gjakmarrja në veçanti. Në vrasjet e ndodhura në periudhen 1999-2012, pothuajse shkaqet që kanë sjell deri tek vrasjet dhe veprat e tjera penale kundër jetës dhe trupit janë përafërsisht të njëjta ose të ndikuara shumë pak nga faktorë të tjerë.

Përqindjet e vrasjeve që janë kryer në këtë periudhë ndryshojnë pak a shumë nga periudha e kaluar, kështu që në këtë kuadër 6% e tyre janë kryer nga hakmarrja, 2% e vrasjeve janë kryer nga gjakmarrja, 5% të këtyre vrasjeve janë si rezultat i konflikteve të mëparshme, 40% e vrasjeve janë si rezultat i mosmarrëveshjeve, ngatërresave të ndryshme (dëmë në fushë, çështje servituti, posedimi, fjalosje, për rrahje në mes të fëmijëve). Për probleme familjare janë kryer 6% të vrasjeve, për çështje martesore (martesat dhe fejesat) janë kryer 2% e vrasjeve, për çështje pronësie janë kryer 11% e vrasjeve, për përfitim pasuror janë kryer 8% e vrasjeve dhe për dhunë familjare janë kryer vetëm 1% e vrasjeve. Xhelozia merr pjesë në 1% të numrit të totalit të vrasjeve, veprat e kryera nën ndikimin e alkoolit përfshijnë 1% të totalit, borxhet marrin pjesë me 3% të totalit të vrasjeve, motivet e dobëta përfshijnë 7% të totalit të vrasjeve të kryera, ndërsa vrasjet e kryera të cilave nuk i'u dihen shkaqet përfshijnë 4% të totalit, për çështje politike kemi 0,25% (pra kemi vetëm një të dënuar për veprën e vrasjes së mbetur në tentativë me motive politike dhe se ky akt kishte ndodhur në Komunën e Klinës).

6.2. Faktorët e jashtëm (egzogjenë) të vrasjeve në Rajonin e Pejës

6.2.1. Ndikimi i luftës dhe kriminaliteti

Që të flitet për luftën së pari duhet të flitet për periudhën e paraluftës, gjatë luftës dhe më pas kohën e pas luftës. Në rrethana të tilla regresioni, kur tërë shoqëria është e përfshirë në atë se çfarë do të ndodh, kur gjithë prodhimtaria kombëtare është në rënie ose në regresion, kur militarizimi i shoqërisë shkon drejtë masave të piramidës, kur

ligjet dhe institucionet e zbatimit të ligjit janë të dobësuar apo nuk reagojnë në masen që duhet reaguar, kriminalet janë në veprim, se kush të gjejë format dhe mënyrat më të lehta për pasurim material. Në rrethana të tilla të “militarizimit shoqëror”, trafikimi i meqenie njerëzore, prostitucioni, tregtia e ndaluar, kontrabanda me njerëz, me armë, me medikamente, me mallrat e akcizës (duhan, derivate të naftës, ari, drogë, etj) janë në nivele të larta të zhvillimit. Këto veprimtari, përkundër se “heronjtë bëjnë luftën” për një qëllim të caktuar, në kushte dhe rrethana të tilla sa vijnë duke u shtuar dhe për fat të keq, këto aktivitete vazhdojnë të zhvillohen edhe pas përfundimit të luftës. Kjo për faktin se kriminelet gjatë kohës së luftës dhe anarkisë ligjore sundohen nga “ligji i të fortit” dhe me të njejtën forcë dhe motiv, ata vazhdojnë dhe pas përfundimit të saj sepse pas përfundimit të luftës, gjithë aparati shtetëror është i pa konsoliduar, armë ka me bollëk në masat e gjëra dhe popullata ka nevojë për gjëra me elementare e deri të gjerat e lluksit të cilat janë në duar të grupeve të organizuara kriminale të cilat jo rrallë për ta ruajtur “tregun” kryejnë edhe vrasje. Në këto rrethana kemi edhe një rritje të kriminalitetit duke përfshirë edhe vrasjet dhe veprat e tjera kundër jetës dhe trupit. Sipas shumë autorëve, pas të gjitha luftimeve ndodh e njehta gjë dhe e njehta situatë. Kjo për faktin se mungon çdo gjë, që nga shtëpitë e djegura, të shkatërruara, ndërmarrjet e djegura ose të plaçkitura, infrastruktura e shkatërruar, me fjalë të tjera e gjithë baza ekonomike është e shkatërruar. Në një situatë të tillë është gjetur edhe Kosova në periudhën pas luftës e cila duhet pranuar se edhe në kohën e okupimit klasik dhe kundërkushtetues serb ka përjetuar një situatë të tillë për çka kemi shkruar më lartë. Pra, sipas asaj që shoqëria përjeton në situatë të tilla, lufta është njëri ndër faktorët sociogjenë të kriminalitetit. Meqenëse edhe vendi ynë ka kaluar nëpër një luftë të tmerrshme me Serbinë, rastet e vrasjeve kanë shënuar një rritje të madhe në vitet e para të pas luftës. Karakteristikë tjetër e kësaj periudhe na paraqitet se vrasjet janë kryer në vende publike, në mënyrë mjaft profesionale, janë kryer në të shumtën e rasteve nëpër qytetet kryesore dhe pothuajse gjithnjë në periudhën e ditës. Në një situatë të tillë të një klime “kriminale” dhe pasigurie ekonomike dhe politike, policia është e pafuqishme dhe me një efikasitet dhe performancë të dobët në luftimin e kriminalitetit. Për këto arsye, periudha e pas luftës sjell edhe pasanikë të rinj dhe forca “të reja në pushtet” të cilat gjithashtu janë të prirura për presione të ndryshme ndaj kundërshtarëve të tyre e deri në likuidime politike.

6.2.2. Varfëria dhe kriminaliteti

Ndër faktorët që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit është edhe varfëria e cila sipas disa autorëve, është njëri ndër faktorët më “energjik të kriminalitetit”. Varfëria, është njëri ndër faktorët që degradon më së tepërmi njeriun, familjen dhe shoqërinë. Njeriu i varfër shpesh herë ndihet i padobishëm, shpresë humbur, i përbuzur dhe i fyer. Një rrethanë e tillë, e shëndërron atë, shpeshherë në subjekt talljeje dhe fyerjeje nga mjedisi shoqëror, rrethanë kjo që më vonë sjell kundër reagimin fizik i cili mund të çojë edhe deri te vrasjet. Sipas statistikave zyrtare, varfëria si dhe arsimi janë dy faktorët që në çdo rast janë prezent dhe prezentohen nga aktorë të ndryshëm dhe agjenci të ndryshme që merren me hulumtimin e krimit në përgjithsi. Pra, njerëzit në pamundësi të sigurimit të ekzistencës së tyre dhe familjes së tyre janë të dedikuar të veprojnë dhe shpesh këto veprime të tyre janë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara shoqërore. Si rezultat i kësaj dukurie, sot pothuajse në çdo qytet të botës, janë krijuar paralagjet e të varfërve të cilët janë “burim i kriminalitetit”. Në fakt, gjendja e tyre nuk është për shkak se ata kanë zgjedhur një jetë të tillë, por për shkak se klasa sunduese i’a ka imponuar një gjendje të tillë. Në një situatë të tillë, varfëria “flirton me krimin” sidomos në veprat penale kundër pasurisë, por nuk përjashtohen edhe vrasjet dhe veprat e tjera penale. Si rezultat i varfërisë është krijuar shtresa e ulët shoqërore, por a janë vetëm të varfërit ata që për shkak të pozitës së tyre sociale prodhojnë krim apo janë edhe të pasurit ata që merren me veprimtari kriminale. Sigurisht se edhe të pasurit, ata të klasës së lartë shoqërore janë një me krimin, bile me një krim shumë të rrezikshëm që sot në shkencën e kriminologjisë njihet si krimi i jakës së bardhë dhe krimi i organizuar.

Por duhet pranuar, se sipas të dhënave statistikore në Kosovë personat e papunë, të pashkolluar, të pakualifikuar, me një gjendje të rëndë sociale janë të përfshirë në një përqindje më të madhe në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit në Rajonin e Pejës.

6.3. Faktorët socio-ekonomik që ndikojnë në dukurinë e vrasjes

6.3.1 Problemet sociale- papunësia dhe kriminaliteti

Sipas statistikave zyrtare të Republikës së Kosovës, shkalla e papunësisë te gjinia mashkullore në Kosovë është 28.1%, tek ajo femrore arrin shkallën 40.0% ose në total kjo shkallë arrin në 30.9%. Sipas hulumtimit tonë ka rezultuar se në kriminalitet janë të përfshirë persona që janë me moshë mesatare (...) që në fakt rezulton se kjo moshë, pra, mes 15-24 vjeç përbën korpusin më të madh të papunëve në Kosovë me 52.0%

meshkuj, 63.8% femra ose në numër të përgjithshëm është 55,3% (ASK, 2013, f:93). Bazuar në të dhënat zyrtare statistikore del se shkalla e papunësisë pas vitit 2001 është shumë e lartë. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është si rezultat i shkatërrimit të ekonomisë së Kosovës që nga viti 1990 e në vazhdim për t'u shkatërruar plotësisht nga lufta e vitit 1998-1999. Mendoj se kjo shkallë e lartë e papunësisë në vit duke filluar nga 57.1 % e cila është regjistruar në vitin 2001 nga të cilët 51.8 % e gjinisë mashkullore dhe 69.9% e gjinisë femrore, e cila shkallë e papunësisë, edhe pse në vitet pasuese shënon një rënie të lehtë, ndikimi i këtij fenomeni në kriminalitet është i madh. Sipas të dhënave zyrtare shkalla më e madhe e të papunëve në Kosovë përfshin grupmoshat nga 19-40 vjeç. Shikuar sipas shkallës së kualifikimit shkollor në korpusin e atyre që janë në kërkim të një vendi pune del se më tepër në kërkim të vendit të punës janë personat e pakualifikuar, që do të thotë me shkollë fillore ose me disa klasë të fillores, pas të cilëve vijnë personat që kanë kryer shkollën e mesme, të cilët pasohen nga ata që kanë kryer një shkollë të lartë dhe ata me universitet. (shih tabelën e mëposhtme)

Vetëm në rajonin e Pejës në çdo vit shkon në rënie nga lufta e shumë ndërmarrjeve sipas viteve.

Viti	Gjithsej	Të pakualifikuar	Gjysmë të kualifikuar	Të kualifikuar	Shkollë mesme	Të lartë	Fakulteti
2008	6.535	2.116	346	389	2.577	293	814
2009	6.937	2.698	174	300	2.538	233	994
2010	8.037	3.287	293	274	3.012	58	1.113
2011	9.776	3.675	274	445	3.630	129	1.423
2012	9.384	4.165	262	374	3.848	20	765
2012	6.980	2.090	919	539	2.890	37	805

Tabela 9. Punëkërkesit e regjistruar në qendrat e punësimit në bazë të kualifikimit në Kosovë gjatë periudhës 2008-2012 (*Burimi i të dhënave: ASK, 2013*)

Sipas këtyre të dhënave vetëm në rajonin e Pejës në vitin 2008, në listën e punëkërkesve ishin 79.022 qytetar.

Nga ky korpus i madh i të papunëve të pakualifikuar, të kualifikuar me ndonjë zanat dhe ata me shkollë të mesme janë edhe personat të cilët kanë marrë pjesë në përqindjen më të madhe të vrasjeve. Gjatë periudhës 1989-1999 në veprat penale të vrasjes ishin të përfshirë si autorë të vrasjes 2% e totalit të veprave të studiuara, autorë të vrasjeve me shkollë fillore të kryer zinin rreth 56%, me shkollë të mesme ishin 24%, me shkollë të

lartë ishin 2%, me fakultet ishin 1%, 1% ishin student ndërsa 14% të personave të përfshirë në vrasje ishin ndarë mes atyre autorëve të veprave penale që kishin kryer tre klase, katër klasë, pesë klasë, gjashtë klasë dhe tetë klasë të filltores duke përfshirë edhe 3% të atyre që ishin nxënës në shkollat e mesme.

Pjesëmarrja e personave në strukturën kriminale në periudhën 1999-2017 ka një lëvizje të vogël apo përmirësim të vogël të një kategorie në bazë të kategorisë tjetër sipas shkallëve të arsimit. Kështu me 1% të vrasjeve merrnin pjesë autorët që ishin analfabet, me 40% të vrasjeve merrnin pjesë autorët që kishin shkollën fillore të kryer, në 50% të vrasjeve merrnin pjesë autorët e vrasjeve që kishin të kryer shkollën e mesme, me 1% të kryesve merrnin pjesë ata që kishin kryer një shkollë të lartë, me 1% të rasteve të vrasjes merrnin pjesë autorët e vrasjeve që kishin një fakultet të kryer. Në kuadër të autorëve të vrasjeve dhe veprave të tjera nga ky kapitull bëjnë pjesë edhe 4% prej tyre që kishin nga 3,4,5,6 klasë të fillorës të kryer dhe 2% ishin nxënës.

6.3.2 Marrëdhëniet pronësore juridike

Marrëdhëniet e pronësisë kanë qenë njëri ndër faktorët kriminogjen në Kosovën e pasluftës. Ardhja e UNMIK-ut në Kosovë, i gjeti strukturat qendrore dhe lokale të pushtetit, por ajo i transformoi që të dyja dhe vendosi në nivel lokal administratorët të cilët përjashtuan nga pozitat vendimmarrëse gjithë faktorin vendor. Përveç të tjerash, administratori komunal ndërmori masa edhe për kufizimin dhe ndalimin e shitblerjeve të pasurive të paluajtshme (shtëpive, tokave, banesave) pa pëlqimin e tij, bile edhe nëse ata kishin një kontratë shitblerjeje dhe të legalizuar në Gjykatë!

Ishte menduar se autorizimet e tilla të administratorit rajonal të UNMIK-ut (që sfidonin edhe punën e gjyqësorit në Kosovë) të krijonin një siguri dhe jetë të qëndrueshme edhe për pakicat. Ky autorizim i administratorit rajonal ishte bazuar në një rregullore të UNMIK-ut i cili siç u tha me lartë, kishte autoritet të zhvlerësonte punët e gjykatave dhe u interferua edhe në vullnetin e palëve në marrëdhëniet kontraktuale. Sipas nenit 9.1 të kësaj Rregulloreje, parashihej një komision rajonal i cili kryesohej nga Administratori rajonal të UNMIK-ut, përfaqësuesit e komunës, drejtorisë për çështje banesore, OSBE-së dhe të Policisë së UNMIK-ut i cili duhej të shqyrtonte çdo kërkesë për blerje të pasurive të paluajtshme (tokës, shtëpisë, banesës) në një zonë të caktuar gjeografike (bëhej fjalë për prona të serbëve dhe malazëve). Të gjitha kontaktat e shitblerjes duhet të kalonin përmes zyrës së administratorit komunal, para se ato të vërtetohen në gjykatë (neni 1.1). Përmes kësaj rregulloreje, UNMIK-u, vuri pengesa në qarkullimin juridik të

pasurive të paluajtshme në Kosovë dhe posaçërisht vuri pengesa në qarkullimin juridik të pasurive të paluajtshme mes kombësive të ndryshme me preteks se po bëhej spastrim etnik i zonave të caktuara gjeografike të Kosovës nga pakica serbe e malazeze. Dhe nën këtë preteks, administratori komunal kishte fuqi juridike, të mos e pranonte kontratën e shitblerjes edhe nëse ajo ishte nënshkruar dhe vërtetuar në gjykatë konform ligjeve në fuqi dhe nëse çmimi i shitblerjes i dukej i ulët, nuk lejonte tjetërsimin në pronarin e ri! Pra, përveç rolit të të parit të Komunës, ai luante rolin e agjentit të pasurive të paluajtshme (realestate agent) kërkonte prejardhjen e parave (luante rolin e organit të ndjekjes penale, neni 2.3) në rastin e shitblerjeve të ndryshme mes palëve. Pra, sipas kësaj rregulloreje “Gjykata kompetente në rajonin ku gjendet prona do të verifikojë vetëm ato kontrata të shitëblerjes së pasurive të paluajtshme, në pajtim me ligjin në fuqi, atëherë kur të jetë siguruar dëshmia se Administratori rajonal i ka regjistruar ato në pajtim me nenin 2.7”. Ndërhyrjet e tilla të tepërta dhe të pakuptimta kanë shkaktuar probleme mjaft të mëdha me pasoja vdekjeprurëse, sepse kjo rregullore në nenin 10.1 ka shkaktuar pasiguri juridike në tregun e pasurive të paluajtshme për shkak se edhe kur paguhej çmimi i pasurisë të paluajtshme, edhe kur pajtohej administratori dhe komisioni i tij, pala e pakënaqur shfrytëzonte nenin 10.1 i cili shitësit i’a njihte të drejtën për të kërkuar kompensim ose rikthim të pronës (neni 10.2). (UNMIK/REG/2001/17).

Në këtë konglomerat rregullash, institucionesh dhe pushtetesh është vështirë të kuptohet se si në nivel lokal OSBE-ja përkrahte administratorin rajonal, ndërsa në raportet e saja zyrtare konstatonte shkelje pikërisht në transaksionet e pasurive të paluajtshme në përgjithsi, e në qytetin e Pejës në veçanti. Përkundër asaj që administratori dhe aparati i UNMIK-ut kontrollonte çdo sferë të jetës publike të Kosovës dhe në çdo moment pengonte zhvillimin e ekonomisë së tregut të pasurive të paluajtshme, në raportet e saja, kjo organizatë konstatonte shkelje të ndryshme, jo vetëm të natyrës administrative! Në raportet e saja OSBE-ja konstatonte se shitblerjet ishin bërë me dokumente të falsifikuara, me autorizime të falsifikuara në gjykatat jashtë Kosovës, se kontratat e nënshkruara dhe të vërtetuara jashtë Kosovës ishin të vërtetuara me vula false, se ishin shitur nga jopronarët, se bartja e pasurive të paluajtshme ishte kryer me vendim të falsifikuar, se fotografitë dhe kartat e identitetit të shitësit ishin të falsifikuara por me vulë origjinale të gjykatës e të tjera konstatime. Njëri ndër problemet më të mëdha që ishte paraqitur me këtë rast ka qenë shitja e dyfishtë e pasurive të paluajtshme dhe në këto raste, palët kanë përdorur dhunën fizike me pasojë vdekjen e tyre. Konstatime të tilla për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme me dokumente të

falsifikuara e që këto dokumente të falsifikuara kryheshin në gjykatat jashtë Kosovës, OSBE-ja i pranonte si të tilla dhe raportonte në raportet e saja vjetore. Në një raport të saj kjo organizatë ndërkombëtare konstaton: “Në tetë raste të verifikuara nga OSBE-ja, supozohej që autorizimi ishte vulosur në një gjykatë në Tivar. Paditësit i kanë paraqitur si dëshmi autorizimet të cilat e kishin vulën e gjykatës së Mitrovicës, Beogradit, Kragujevcit, Smederevës, Beranës, Podgoricës, Rozhajës dhe Ulqit”. (OSCE, 2009, f:5). Edhe privatizimi i ish-ndërmarrjeve shtetërore i cili ishte në kompetencë të UNMIK-ut dhe drejtohej nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, ka shkaktuar probleme në fushën e rendit dhe sigurisë. (Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”). Sipas Rregullores 2002/14, kjo agjenci, i “menaxhonte” dhe i “administronte” këto ish-ndërmarrje, por në fakt, ky „menaxhim” dhe „administrim” i tyre nga ana e saj vetëm sa e futi ekonominë kosovare në kollaps. Në anën tjetër, ky privatizim i egër i cili jo rrallë ka sjellë pasoja negative jo vetëm në aspektin e përgjithshëm ekonomik, por ka sjell konflike të cilat kanë përfunduar me gjakderdhje. Ligjerisht ishte shkruar se privatizimi i shpallur në Kosovë i këtyre ndërmarrjeve bëhej në mënyrë publike dhe secili kishte të drejtë të konkuroj, procedura për blerjen e një pronë të caktuar bëhej duke konkuruar në dy raunde dhe në mënyrë të fshehtë. Megjithatë, koha mes raundit të parë dhe të dytë ishte më rreth 2 orë, atëherë çdo gjë dihej dhe asgjë më nuk ishte sekret. Procedura e konkurimit dhe shpallja e fituesve të tenderit bëhej në mënyrë publike, por objekti i kontratës nuk dorëzohej nga shitësi tek blerësi. Si rezultat i kësaj anomalie nga viti 2002-2014 ishin shitur 368 objekte të ndryshme me vlerë prej 105.640,992 euro të cilat nuk u janë dorëzuar blerësve të ligjshëm dhe se këto objekte janë mbajtur nga persona të ndryshëm deri në vitin 2016 kur janë nxjerrë me forcë nga policia dhe iu janë dorëzuar blerësve të ligjshëm. Nga 368 objektet e uzurpuara, 34 % e tyre kanë qenë në territorin e Rajonit të Pejës të cilat në disa raste kanë përfunduar me përleshje fizike dhe me përdorimin e armëve. (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2017:1-17).

6.3.3. Arsimi dhe kriminaliteti

Tomazo Campanella në veprën e tij “Qyteti i Diellit” ose mbi idenë e Republikës Filozofike shkruante se foshnjen në qytetin e Diellit e ushqejnë me qumështin e gjirit të nënës për dy vjet dhe më pas “foshnjes, pasi ia ndërpresin qumështin e gjirit, po që se është femër, ia japin ta ruajë mësuesja, kurse, po të jetë mashkull ia japin mësuesit”. (Campanella, 1990, f:28). Është për t’u admiruar ky mendim i filozofit italian, sepse

nëse fëmijët i ushqejmë me qumështin e gjirit të nënës dhe i edukojmë me mësues të ditur, gjërat devijante shoqërore siç mund të jetë krimi mund të shfaqen më pak në mjedisin tonë. Në literaturën kriminologjike mbizotëron ideja se të paarsimuarit janë autorë të mundshëm të krimit sepse tek ata mungon shkalla e qytetërimit? Duhet pranuar se ekziston një raport i drejtëpërdrejtë mes arsimit dhe kriminalitetit, por në të dy kahet. Edhe personat e paarsimuar dhe ata të arsimuar janë autorë të mundshëm të kryerjes së veprave penale, por dallojnë vetëm përsa i përket “fushës së specializimit”. Derisa personat e paarsimuar ose gjysmë të arsimuar mund të jenë autorë të veprave penale kundër jetës dhe shëndetit ose kundër pasurisë, të shkolluarit janë autorë të mundshëm të veprave penale të një kategorie me superior të që mund të çojë edhe në falimentimin e gjigantëve të ekonomisë (banka të ndryshme, gjigantë të ndryshëm të industrisë, etj.). Pra, fusha e tyre e specializuar janë financat (taksat, tatimet, falimentimi i subjekteve të ndryshme ekonomike, pastrimi i parave, sistemi bankar, etj.).

6.3.4. Familja dhe kriminaliteti

Është e njohur se familja është celula bazë e shoqërisë dhe si e tillë ajo është baza mbi të cilën qëndron i gjithë zhvillimi i shoqërisë njerëzore. Ajo krijohet nga raportet bashkëshortore dhe ky raport më pas manifestohet tek pasardhësit e tyre. Pra, nga raportet e kijuara mes tyre dhe fëmijëve të tyre, lindin dhe marrëdhënie të tjera të cilat mund të jenë të dobishme ose devijante për shoqërinë në përgjithsi. Ky devijim së pari paraqitet tek të miturit përmes formave të ndryshme të sjelljeve kriminale në familje, e pastaj fillojnë ngadalë të merren me ushtrimin e aktiviteteve (me rritjen e tyre edhe jashtë familjes) të ndryshme kriminale (vjedhje, vrasje, prostitucion, bixhoz, etj.). Në fakt, kur shqyrtojmë situata të tilla, atëherë thuhet se bëhet fjalë për familje të degraduara të cilat jo rrallë herë janë probleme mes qifteve të cilat ndikojnë jashtëzakonisht shumë tek fëmijet dhe marrjen e rruges së tyre drejtë delikuencës. Shkakët që çojnë në degradimin familjar janë shkurorëzimi, martesë e dështuar, vdekja e njërit prind, burgosja e njërit prej prindërve dhe mbetja e fëmijëve pa përkujdesje dhe pa disiplinë familjare. Sipas autorit malazez Vukoman Golubović është një numër i madh i delikuentëve të mitur të përfshirë në veprat penale të vrasjes të cilët janë rritur me dy prindër (79%), me nënën (njërin prind) 8.5%, me prindër të shkurorëzuar 8%, me babain 2.5%, fëmijë të lindur jashtë martesës 0.5% dhe pa të dhëna 1.5%. Më poshtë ky autor jep të dhëna mbi bashkësinë familjare ku këta të mitur delikuentë kanë jetuar.

Sipas të dhënave të prezentuara del se 79% të delikuentëve të mitur jetojnë në shtëpinë e prindërve bashkë me prindërit, 13% prej tyre jetojnë në shtëpi me nënën, 3% prej tyre jetojnë në shtëpi vetëm me babain, 0.5% prej tyre jetojnë në shtëpi me nënën dhe thjeshtin, 1% prej tyre jeton me njerikën, 0.5% jeton në shtëpinë e familjarëve të tij, 1% prej tyre jetojnë vetëm, 2% prej tyre nuk kanë dhënë të dhëna se ku jetojnë. (Goluboviq, 2000, f:231,233). Ky shembull është sa për ilustrim i cili dëshmon se të miturit që janë e ardhmja e shoqërisë, nëse mbesin pa një ngrohtësi familjare, shumë lehtë hyjnë në rrugën e kriminalitetit.

Nga dhuna në familje sipas raportit të progresit të vitit 2012 për Kosovën rezulton se është ushtruar dhunë në familje dhe krahasuar me statistikat del se kanë qenë 410 femra, 228 të rritura dhe 182 të mitura të cilave iu është ofruar ndihmë dhe strehim në shtëpitë e sigurta në Pejë, Gjakovë, Prizren, Prishtinë, Gjilan dhe në Mitrovicë. Sipas strukturës etnike, dhunë është ushtruar ndaj 74 grave të përkatësisë shqiptare, duke përfshirë një grua nga Shqipëria, 2 gra të komunitetit ashkali, 2 gra serbe, një grua malazeze dhe një shtetase e huaj (daneze). Për nga struktura gjeografike, më shumë vijnë nga zonat urbane se nga ato rurale. (Zyra e Koordinatorit Nacional Kunder Dhunes ne Familje, 2013:37). Sipas këtij raporti zyrtar të Qeverisë së Kosovës, organi i akuzës në Kosovë gjatë vitit 2012 kishte pranuar 477 kallëzime penale kundër të dyshuarve për dhunë në familje duke përfshirë edhe 120 kallëzime të vitit paraprak.

6.3.5 Bixhozi dhe kriminaliteti

Ndër faktorët e jashtëm që ushtron një ndikim jo të vogël në sjellje devijante të cilat mund të përfundojnë në dhunë kundër të tjerëve ose kundër vetëvetes është edhe bixhozi ose lojërat e fatit. Bixhozi si lojë dhe si veprimtari ka një histori të lashtë. Në shoqëritë e kaluara socialiste bixhozi në kuptimin e sotëm të fjalës ishte i ndaluar, ishte e lejuar llotaria klasike, e cila ishte nën kontrollin e shtetit, llotaria e prognozave të ndryshme sportive, ndonjë lojë e lehtë e cila merrej si argëtuese. Bixhozi në shoqërinë njerëzore ka një histori të lashtë dhe e shoqëron historinë njerëzore deri në ditët e sotme. Bixhozi gjatë zhvillimit të tij ka kaluar nëpër fazat e paorganizuara, në format e ushtruara nga persona të caktuar dhe me kalimin e kohës ka ardhur duke u perfeksionuar si veprimtari ekonomike mjaft fitimprurëse dhe kalon në një formë të organizuar. Është një aktivitet joshës, rrallë fitimprurës dhe në fund dekurajues. Bixhozi është i zhvilluar shumë në SHBA, por edhe në nivele botërore është një biznes mjaft fitimprurës. Fillimisht, secili fillestar që merret me këtë “lojë” fillon me pak para, humbet, luan

përsëri me shpresë se do rifitojë paratë që ka humbur por humbja bëhet më e thellë. Me humbjen e njëpasnjëshme, detyrohet të shes, së pari gjërat e vlefshme që posedon në shtëpi, ose të shes rroba, orendi, veturën ose stolitë e familjes ose gruas së tij. Mvarësia e tij ndaj bixhozit shkakton trauma jo vetëm tek ai që luan por edhe te familja e tij e cila për shkak të varfërimit çdo ditë e më tepër, sjell mosmarrëveshje dhe dhunë në familje, e cila përfundon edhe me vrasje. Loja e bixhozit krijon një varësi e cila për shkak të nevojës për para, nxit në veprime të kundërligjshme siç janë grabitjet, vjedhjet, vrasjet dhe në fund mund të përfundoj me vetëvrasje.

Në Kosovën e pas luftës (1999) janë regjistruar shumë kompani të cilat janë marr me veprimtarinë e bixhozit dhe lojërave të tjera të fatit. Megjithëse ekziston kuadri ligjor që parashikon disa kushte se ku mund të ushtrohet kjo veprimtari, ndalesat për shtresa të caktuara (për të mitur), largësia nga institucionet shkollore, kontrollin e drejtëpërdrejtë nga administrata tatimore e Kosovës, duhet theksuar se prapseprap ka paligjshmëri në formën dhe organizimin e këtyre lojërave të fatit. Pavarësisht se kjo veprimtari është e lejuar në Kosovë, pasojat në ndikimin e rritjes së varfërisë dhe problemeve në familjet kosovare janë të mëdha. Meqenëse “hyrja” në këtë “biznes” bëhet për të realizuar fitim të shpejtë monetar dhe pa mund, humbjet në këtë “lojë” kanë nxitur shpeshherë përdorimin e dhunës, fillimisht duke shkatërruar aparatet e lojërave të fatit dhe më tej edhe ndaj të punësuarve në këto biznese e cila ka sjellë edhe vrasje. Përveç kësaj të keqeje, organizimi i këtyre veprimtarive sjell edhe përfshirjen e institucioneve të ndryshme në veprime korruptive (policisë, nënpunësve të tjerë publikë dhe zyrtarëve të tjerë të zbatimit të ligjit).

6.3.6 Trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni dhe kriminaliteti

Ndryshimet shoqërore që ndodhën në fillim të viteve 90-ta në Europën lindore shkatërruan iluzionet e fillim shekullit të XX –të për krijimin e barazisë shoqërore në sistemin socialist. Ndryshimet shoqërore të shoqëruara me dhunë dhe luftra ndër etnike (luftrat në ish Jugosllavi), krijuan parakushtet për lëvizje të mëdha migratore në drejtim të vendeve të Bashkimit Evropian.

Në një situatë të tillë amullie dhe të pashpresë të masave të gjera të cilët të shtyrë nga skamja dhe konfliktet etnike, kërkonin të largoheshin nga vendi me çdo kusht, pa marrë parasysh rreziqet. Në një situatë të tillë, të fituar ishin vetëm disa individë a grupe kriminale të cilët merreshin me kontrabandimin dhe trafikimin e tyre. Si rezultat i kësaj veprimtarie kriminale qindra e mijëra qytetarë, vajza, gra dhe fëmijë që ishin

shëndërruar në pozitë skllavërie nga trafikantë të ndryshëm të cilët ishin të lidhur edhe me zyrtarë të institucioneve të ndryshme shtetërore “...ku secili njerëzve të vet, doganiervë ose policëve kufitarë të cilët lejojnë kalimin e vajzave në pikën kufitare gjatë ndërrimit të tyre” u paguanin para të majme. (Nikolic-Ristanovic, Caplic, Milivojeviq, Patic-Simeunovic, & Mihiq, 2003:73). (Maljeviq, Datzner, Muratbegovic, & Budimlic, 2006).

Në kuadër të trafikimit të qenieve njerëzore, ishin specifike rastet e shitjeve të fëmijëve dhe të foshnjëve të cilat ende ishin të pa lindura. Trafikimi i foshnjëve të palindura realizohej lehtësisht, përmes kalimit legal të kufirit të grave shtatëzëna vetëm disa ditë para lindjes. Mbas kalimit në vendin e huaj, ato lindnin atje, i shisnin foshnjët e tyre dhe ktheheshin përsëri në vend pa u hetuar fare në kufi. Veprime të tilla kishin ndodhur me gra shtatëzëna, me shtetësi rumune të cilat kishin hyrë legalisht në Serbi ku kishin qendruar disa ditë pas lindjes, i kishin shitur foshnjat dhe ishin kthyer prap në vendin e tyre pa u pikasur nga policia kufitare. (Micevic & Radonjic, 2004). Sipas studiuesve serb, në Serbi gjerësisht në Jugosllavi, vjedhja e foshnjëve të porsalindura dhe shitja e tyre ka qenë një veprimtari që daton nga vitet 1970 e këndej. Kjo e formë e shitjes së foshnjeve bëhej me dijeninë e stafit mjeksor gjinokologjik dhe të institucioneve shtetërore. Dhe forma e organizimit të kësaj “tregtie” ishte shumë e thjeshtë, shtatëzëna shtrohej në spital, lindte dhe që në natën e parë foshnja i vidhej dhe i jepej familjes apo individëve të interesuar që paguanin shumën të majme parash, ndërsa të nesërmen, prindërit e foshnjës njoftoheshin zyrtarisht nga drejtorja e spitalit për vdekjen e foshnjës së tyre të cilëve as nuk ua dorëzonin kufomën. Sipas autorit Ristoviq, mjekët i paguanin prindërit e foshnjave të “vdekura” me nga 100 DM dhe një derr të pjekur”, ndërsa në anën tjetër, këto foshnje adoptoheshin nga familje apo individë në shtetet e perëndimit, në Zvicërr dhe Gjermani. Gjatë vitit 1967, numri i foshnjeve të lindura jashtëmartese dhe të adoptuar në këtë vend, sipas të dhënave të Konsullatës Jugosllave në Shtutgart të Gjermanisë arrinte në 1.300 të tillë, 150 fëmijë nga Zenica ishin adoptuar në Holandë. Është bafasuese e dhena se edhe Suedia kishte kërkuar 150 fëmijë nga qendra për punë sociale nga Prishtina për t'i adoptuar, ndërsa fëmijët nga Bosnja dhe Hercegovina ishin dërguar në Itali për adoptim. Mbase kjo dukuri duhet shpjeguar pak sepse, nuk po flasim për procedura ligjore të adoptimit, por po flasim për procedura kriminale të tregtisë me fëmijë ku kanë qenë të përfshirë institucione të larta të shtetit, të përfshirë edhe misionet diplomatike. Kjo tregëti me fëmijë ka vazhduar sipas autorit edhe gjatë luftërave në Jugosllavi. Nga janari 1992 deri në vitin 2003 në Itali nga BiH

ishin dërguar mbi 5000 fëmijë çmimi i të cilëve kishte arritur deri në 200.000 MK (marka konvertibile-valutë e Bosnjës). Duhet theksuar se nuk bëhet fjalë për raste të veçuara, por bëhet fjalë për rreth 3.000 foshnje, nënat e të cilëve, në vitin 2005, zyrtarisht kanë kërkuar shpjegim për këtë fenomen nga Kuvendi i Serbisë. (Ristovic, 2006, :16, 63, 192, 196). Po të shikojmë fitimin dhe rrezikshmërinë e këtij “biznesi” del se në këtë veprimtari janë ortake institucionet shtetërore dhe individë të caktuar të nomenklaturës shtetërore të cilët bashkë me kriminelë realizojnë fitime të mëdha. (Mendelson, 2006, f:29).

Sipas të dhënave nga shtypi i kohës, për trafikimin e qenieve njerëzore ishte biseduar edhe në takimin zyrtar të vitit 1973 në Washington midis udhëheqësit kinez Mao Ce Dun dhe bashkëbiseduesit të tij Henri Kisingjer. Në këtë takim, Mao i kishte ofruar Kisingjerit 10 milion gra kineze të cilat do ndikonin shumë në shtimin e popullsisë sepse ato lindin shumë fëmijë! (The Age Newspaper, 2008).

Fenomeni i trafikimit dhe prostitucionit zhvillohet shumë gjatë kohës së krizës ekonomike apo në kohën e luftës dhe menjëherë pas saj. Në këtë drejtim, edhe në Kosovë, pas viteve të 90-ta të shekullit të kaluar dhe në fillimin e këtij shekulli prezenca e trafikimit dhe prostitucionit ishte njëri ndër bashkëshoqëruesit e krizës kosovare. Në periudhën e parafillimit të luftës në Kosovë si dhe në tërë Serbinë ishte i përhapur trafikimi qenieve njerëzore, prostitucioni dhe kontrabandimi i cili ishte në duar të bosëve të krimit. (Trajanovic, 1927); (The Kvinna till Kvinna Foundation, 2001:20).

Në periudhën e pas luftës si në të gjitha vendet e ish Jugosllavisë të cilat ishin nën mbikëqyrjen e forcave ndërkombëtare, në Bosnjë, në Kroaci dhe në Kosovë, prostitucioni ishte një veprimtari “gjysmë legale” dhe mjaft fitimprurëse e udhëhequr nga grupe të ndryshme kriminale dhe me një klientelë edhe ndërkombëtare. (Shabani, Bojaniq, & Obradoviq, 2007, f:92)

Prezenca ndërkombëtare në Kosovë, ishte njëri ndër faktorët kryesor të paraqitjes dhe rritjes së prezencës së prostitucionit e cila deri në vitet e para të pavarësisë ishte njëri ndër vendet e destinimit të viktimave të trafikimit. Sipas raporteve zyrtare, mbi 50% të femrave të trafikuar për qëllime prostitucioni në Kosovë, vinin nga vendet e lindjes të cilat kishin hyrë në Kosovë ilegalisht përmes kufirit verior të Kosovës me Serbinë. (IOM, 2002, f:7).

Nga 379 raste të viktimave të trafikuar që ka asistuar IOM-i në Kosovë 10.6 % kanë qenë fëmijë nën moshën 14 vjeçare. Nga ky numër 14% e viktimave kanë qenë të keqtrajtuara seksualisht në familjet e tyre para se të vijnë në Kosovë. Vetëm 2.21 % e

tyre ushtronin prostitucionin çka do të thotë se ato, tani më, ishin përfshirë në prostitucion. Më pak se 55% prej tyre kishin pasaportë, ndërsa pjesa tjetër kishin hyrë në Kosovë pa dokumente udhëtimi. (UNICEF, 2004:20-21). Është interesant të përmendet se përkundër që dihej se në Kosovë funksiononin 137 lokale të tilla ku dyshohej se ushtrohej prostitucioni i detyruar, zyrtarët e policisë së UNMIK-ut nuk ndërmorën asgjë për t'a ndaluar këtë veprimtari. Ata vetëm kishin nxjerrë një urdhëresë "off limits" me të cilën ua kishin ndaluar hyrjen dhe prezencën policisë së Kosovës dhe atë të UNMIK-ut në këto objekte. (UNICEF, 2004a, f:35).

Përveç trafikimit i cili si fenomen shoqëror me rrezikshmëri të lartë që ndikon shumë në vëllimin dhe dinamikën e vrasjeve, edhe prostitucioni ishte njëri ndër burimet potenciale të sjelljeve kriminale që paraqitet në forma të ndryshme. (Moroli & Sibona, 2000).

Me përhapjen e këtij fenomeni "gjysmë legal" në Kosovën e pasluftës, sipas të dhënave nga arkivi i Gjykatës së Pejës, kemi një vrasje të një femre, shtetase e Bullgarisë. Po themi se ishte një veprimtari gjysmëlegale, sepse nga institucionet për zbatimin e ligjit nuk ndërpritej edhe pse, sipas ligjit, ushtrimi i prostitucionit ishte i ndaluar (edhe pse ky veprim konsiderohej kundërvajtje) dhe dënohej deri në 60 ditë (Ligji mbi Rendin dhe Qetësinë Publike, i KSAK-së, 1981), ndërsa sipas dispozitave të KPPK-së (2004), marrja me prostitucion ishte vepër penale dhe e dënueshme deri në tre vjet burgim. Përveç të tjerash, ushtrimi i prostitucionit të tillë të pakontrolluar në Kosovë ishte burim potencial i veprave penale kundër pasurisë (vjedhjeve, grabitjeve), shitjes së drogës, nxitjen e dhunës në familje e deri te vrasjet e ndryshme dhe misterioze ose janë viktimat të vrasësve serial. (Schmalz, 1989); (Edwards, 2015).

6.3.7 Alkooli dhe kriminaliteti

Alkooli si njëri ndër faktorët kriminogjene, ka një rëndësi të madhe në paraqitjen e kriminalitetit. Studiuesit e ndryshëm i kushtojnë rëndësi të madhe raporteve mes alkoolit dhe kriminalitetit. Dukuria e shfaqjes së kriminalitetit e lidhur me alkoolin varet shumë nga shumë faktorë të tjerë, siç janë tradita, relegjioni, zona të caktuara qoftë edhe brenda një rajoni apo edhe brenda një shteti. Përdorimi i tij është njësoj sikur është fillimi marrjes së mësimi në ndezjen e cigarës e cila fillon rastësisht, në fshehtësi nga prindërit e familja dhe pastaj del publikisht. Edhe përdorimi i alkoolit ka një trend të tillë zhvillimi ku fillohet me pirjen e alkoolit për kënaqësi (alkoolofia) dhe kur kjo fazë e kënaqësisë kalohet dhe alkooli pihet si rezultat i varfërisë atëherë kemi të bëjmë me

alkoolist kronik (alkoolomania). Përdorimi i tepërt i alkoolit shkakton ndikim negativ në sjelljet e njeriut, pra, zvogëlon aftësitë psikike të individit dhe si rezultat i këtij “paralizimi” psikik kalon nga sjellja normale në sjellje devijante dhe të rrezikshme për rrethin shoqëror. Si rezultat i ndikimit të alkoolit, njeriu nuk mund t’i kontrollojë sjelljet e veta të cilat e çojnë drejt një agresiviteti të menjëhershëm, kundrejt anëtarëve të familjes dhe rrethit në të cilin jeton. Një agresivitet i tillë i njeriut i shfaqur nën ndikimin e alkoolit, sjell pasoja të dhunshme, të kundërligjshme qoftë në kuadër të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, aksidenteve të ndryshme në trafik, rrahje dhe vrasje. Edhe pse, Kosova, tradicionalisht është “joalkoolike”, konsumimi i alkoolit pihet në një përqindje të vogël nga popullata e saj, prapseprap, alkooli si faktorë kriminogjenë, konsiderohet si një shkaktar i drejtëpërdrejtë me një përqindje solide në shfaqjen e kriminalitetit. Edhe pse, pjesëmarrja e tij si faktor në rritjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit është e vogël, ai zë një vënd mjaft të lartë në klasifikimin e shkaqeve të vdekjeve që kanë të bëjnë me shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor.

6.3.8 Mediat dhe kriminaliteti

Mediat e shkruara dhe elektronike, revistat e ndryshme, librat, filmi dhe teatri janë faktorë edukativ dhe me ndikim pozitiv në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe një indikator që tregon shkallën e emancipimit të një shoqërie të caktuar. Por, në anën tjetër, sa i përket fushës për të cilën po flasim, mediat bëjnë pjesë në njërin ndër faktorët do të thoja kryesor në “edukimin kriminal” të opinionit të caktuar me sjellje patologjike. Posaçërisht, viktimat të mediave shpeshherë janë të miturit të cilët të frymëzuar nga ndonjë film, ndonjë informacion i nxjerr në televizion apo në shtyp shndërrohet në “aktor” pa gjykuar fare se veprimet e tija janë të dënueshme. Edhe publikimi i rasteve të caktuara kriminale përmes shtypit, raportimi i drejtëpërdrejtë i rasteve kriminale në televizion, i ndjekjeve të kriminelëve të ndryshëm të cilet bëjnë “heroin” gjatë ikjes nga ndjekja e organeve të rendit.

Edhe pse ka autorë që kundërshtojnë “edukimin kriminal” të mediave, ajo ka ndikim në “shkollimin” e njerëzve me sjellje kriminale, në dhënien e ideve rreth kryerjes së krimeve të caktuara, në dhënien e ideve rreth zhdukjes së gjurmëve, mjeteve me të cilat kryhet krimi dhe të kufomave. Një “shkollë” e tillë e mësuar përmes mediave është paraqitja e shpeshtë e informatave se autori, NN, i vepres penale të vrasjes, grabitjes, etj., është larguar nga vendi i ngjarjes me veturën model XY dhe i njejtë automjet është gjetur i djegur në një vend të caktuar. Raste të ngjashme të një “edukimi të medias në

sjelljen kriminale” kemi edhe në rastin kur mediat flasin se në objektin e caktuar janë gjetur vijat papilare të autorit të vepres penale që do të thotë se, pavarësisht zhvillimit të shkencës forenzike në shumicën e rasteve sot, autorët e veprave penale krimet i kryejnë duke përdorur dorashkat apo maska të ndryshme në kokë me qëllim që të mos realizohet identifikimi nga ndonjë dëshmitar i rastit apo përmes incizimit dixhital.

6.4. Vrasjet nga hakmarrja dhe pasojat e këtyre vrasjeve në shoqërinë kosovare

6.4.1. Hakmarrja dhe gjakmarrja, pasojat e saj në shoqërinë kosovare

Hakmarrja si formë e reagimit privat për dëmin fizik ose material të shkaktuar nga dikush tjetër ka shoqëruar shoqërinë njerëzore që nga fillimi i organizimit të saj e deri më sot. Sipas autorit Ismet Elezi, në mungesë të shtetit dhe ligjit “gjakmarrja ishte mjet mbrojtës” dhe se forma e tillë e reagimit në rrethana të tilla nuk mund të karakterizohet si” barbari e kombit shqiptar. (Elezi, 2000, f:10-12). Përkundër ashpërsisë së reagimit në raste konkrete, në rregullativën kanunore shqiptare, Kanunin e Lekë Dukagjinit, Kanunin e Skenderbeut, Kanunin e Labërisë ishin vendosur rregulla lidhur me objektin e gjakmarrjes dhe hakmarrjes.

Sipas autorit Luan Gjoncaj, “Hakmarrja është shkaktimi i dëmit ndaj një personi apo pronës së tij si reagim ndaj dëmtimit që ka pësuar prej tij. Ndërsa gjakmarrja është lloj hakmarrje që konsiston në “larjen e gjakut” për personin e vrarë, që do të thotë vrasjen e tij apo pjesëtarve të familjes së tij” (Gjoncaj & Gjoncaj, 2009, f:65). Sipas autorit Ismet Salihu “vrasja nga hakmarrja është kryer ndaj atij personi, i cili më parë autorit ose të afërmëve të tij të ngushtë u ka cënuar nderin dhe autoritetin, u ka shkatuar dëm material...”), ndërsa “gjakmarrja rezulton se hakmarrja bëhet për shkak se më parë është derdhur gjaku dhe se hakmarrja gjithashtu bëhet me anë të gjakderdhjes, gjerësisht me vrasje” (Salihu, 1985g, fq.220, 225). Në trojet shqiptare janë përdorur shumë Kanune, por më i njohuri dhe më i përdoruri në marrëdhëniet juridike civile dhe penale ishte Kanuni i Lekë Dukagjinit (Gjeqovi, 1999), Kanuni i Skënderbeut (Ilia, 1993) dhe Kanuni i Labërisë. (Elezi, 2006). Rreth autorësisë së këtyre Kanuneve të cilët paraqesin një rregullator të jetës së shoqërisë shqiptare nën kushte të pushtuesve të ndryshëm romak, bizantin dhe sllav nuk kemi të dhëna. Të dhënat ekzistojnë lidhur me ata autorë që i kanë mbledhur dhe përshkruar këto norma zakonore që paraqesin një përmbledhje normash juridike të cilat rregullonin marrëdhënie të ndryshme civile, familjare, reale, trashëgimore, detyrimore si dhe çështje juridike penale duke i cilësuar të gjithë të barabartë para tij”. (Pupovci, 1971:14) Kanuni i Lekë Dukagjinit, është njëri ndër ligjet

e shkruara i cili ka një jetë të gjatë të aplikimit në trojet shqiptare sidomos ato që kanë mbetur nën qeverisjen serbe – jugosllave për gati një shekull (nga data 25 VIII.1913 kur Kosova dhe Maqedonia e Vardarit i aneksohen Serbisë me dekret të Mbretit Peter në Kuvendin e Serbisë. (Popovic-Obradovic, 2008).

Sipas studiueses Barbara Hanel “Kanuni i Lekë Dukagjinit, Ligji i Zakoneve Shqiptare të vjetra me shekuj përfaqëson një sistem të vlerave që përmban rregulla detale për sjelljen e “duhur” si dhe gjykim të kundërvajtësve....kode të sjelljes për të parandaluar joarmoninë dhe për të pararendur rendin në fisin e tyre”. (Hanel, 2004, f:68)

Në aspektin juridik, sipas normave të KLD “...të gjithë njerëzit janë të barabartë, madje edhe në pikëpamje të gjakut”. (Pupovci, 1971a, f:14). Para Kanunit të gjithë njerëzit janë të barabartë, si për të mirin si për të keqin, si për fëmijun “ferishte djepi” si për djalë si për cucë, si për të pasurin si për të vobektin, si për të bukurin si për të shemtuarin (në pamje fizike) “ndeshkimi është një doret” thuhet në paragrafin e 887 dhe 892 të KLD. Në asnjë paragraf të këtij Kanuni nuk mund të gjinden norma të cilat e përlligjin figurën e gruas shqiptare përveç në dy raste, në kurvni dhe për mik të prem. (nye tridhjetëeparë). Sipas paragrafit 836 të KLD, ishte e ndaluar të vritet dikush në prezencën e gruas ose nën përcjelljen e saj sepse kanuni thotë: “Prita do të fillojë mbë burra e jo mbë gra, fmi, mbë shtëpi e mbë bagëti...” përndryshe “...do hijë pushka shpi mbë shpi, mandej fis mbë fis, katund me katund e së mbrami flamur me flamur”. Paragrafi 767 pika a) i KLD-së thotë: për të hikun të grave bjen në gjak e 500 grosh do t’i jap katundit për giobë”. Gruaja shqiptare sipas KLD-së edhe nëse vretë dikë nuk bje në gjak thuhet në kreun e 28 të tij. Sipas kreut (Nye) 31, nëse nusja e cila martohet nuk është si duhet (e virgjër) burri ka të drejtë t’ia presë thekun a flokun a me lshue por nëse burri pajtohet me gjendjen e saj Kanuni ia lejon jetesën me të por asnjë rast t’a shes ose t’a vras. Studiues që nuk e kanë lexuar kurrë Kanunin, dhunën ndaj femrës në familjen shqiptare e bazojnë pikërisht në normat e tij, ndërsa në fakt dhuna ndaj gruas është sjellje kundër kanunit. Paragrafi 61 (a) i KLD-së thotë “Burri nuk ka tagër mbi jetën e gruas”; c) me e vra i biri t’amën bje n’gjak me prindërit e t’amës”; d) me e rrahë me plyrë në gjak, a me e vra gruen e burrit dora e huaj nderen ia kërkon burri, varrën e gjakun prindja”; e) me rrahë kunetija gruan e burrit prindja e grues ia lypin nderen në mos i raftë mbrapa i shoqi”. Pra, siç po shihet KLD-ja në mënyrë institucionale e mbron gruan nga dhuna që mund të ushtrohet qoftë edhe nga djali i saj, burri apo kunati dhe asnjëri nga këta nuk ka të drejtë të ushtrojë dhunë mbi të.

Gruaja sipas KLD-së ka të drejtë të ndërmjetësojë mes personave në ngatërresë të aty

për atyshme dhe fjala e saj duhet të respektohet, pushka duhet të ndalet. (Gjeqovi, 1999a, f:123). Kështu sipas të drejtës zakonore shqiptare, nga e drejta për të marrë gjakun ishin të përjashtuar fëmijët, të moshuarit, të sëmurët, të çmendurit dhe gratë. (Elezi, 1994, f:164-165).

Dhunimi i gruas apo grabitja e saj konsiderohet si nder që i merret burrit të saj dhe ai nder i nëpërkëmbur kërkon hakmarrje sipas paragrafit 601 dhe 597 të KLD-së por mund ta falë dhunuesin fisnikisht dhe pa dëmshpërblim konform paragrafit 598 të KLD-së. Përkundër normave mjaft të qarta kanunore, ka pasur vrasje të cilat kanë shënuar anën më të errët të historisë kombëtare.

Dihet se gjatë tërë kohës së sundimit serb dhe jugosllav mbi Kosovën, në territorin e Kosovës është aplikuar një dualizëm juridik ku të drejtën pozitive e ka shoqëruar edhe e drejta zakonore shqiptare posaçërisht në ushtrimin e “të drejtës së hakmarrjes dhe gjakmarrjes”.

Për eliminimin e dukurisë së hakmarrjes dhe gjakmarrjes, ligjëvënsi kosovar, në ligjin penal të vitit 1977 kishte parashikuar dënime të ashpra jo më pak se pesë vjet (vrasje nga motivet e hakmarrjes, neni 30 par 3, ose gjakmarrjes nga neni 30 par 4, LPK, 1977). Në këtë ligj, ishte parashikuar një nen i veçantë i cili kishte për qëllim që t’ia mohonte të drejtën e hakmarrjes kujtdo që tenton që tjetrit t’ia kufizojë lirinë e lëvizjes. Pra, sipas nenit 47 par 1 të LPK-së “Kush autorit të veprës penale ose të afërmëve të tij ua kufizon lirinë e lëvizjes, duke shprehur qëllimin se do të hakmerret, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet”. Por, mjerisht duhet pranuar se as normat kushtetuese as neni 47 i ligji penal të Kosovës nuk është zbatuar ose është zbatuar vetëm në katër raste. Si pasojë e mosrespektimit të këtij neni, shumë familje kosovare ishin mbyllur në burgjet shtëpiake nga frika e hakmarrjes dhe gjakmarrjes. Sipas të dhënave në vitin 1976, 1360 familjeve kosovare, me 15.459 anëtarë, ishin të privuar nga e drejta e lirisë së lëvizjes dhe ishin të detyruara të respektonin normat dokësore dhe të mbylleshin në shtëpi nga frika e hakmarrjes. Nga ky numër, 184 familje me 2.258 anëtarë ishin të ngujuar në shtëpi dhe nuk lëviznin fare nga frika e gjakmarrjes. Kjo do të thotë se e drejta zakonore ishte më e fortë se e drejta pozitive e cila të drejtën e lëvizjes së lirë e garantonte vetëm në letër. (Salihu, 1981c, f:156-157, 160). Përveç normave kushtetuese federative dhe krahinore të asaj kohe, përveç normimit si veper penale të kufizimit të lirisë së lëvizjes, duhet theksur se në aspektin ligjor, kjo fushë ishte e mbuluar edhe me një ligj të veçantë të Kosovës i cili quhej Ligji për Këshillat e Pajtimit. (Ligji për Këshillat e Pajtimit, 1973). Sipas këtij ligji (kishte 16 nene), këshillat e pajtimit ishin të

themeluara dhe funksiononin në çdo fshat e qytet, në çdo bashkësi lokale siç quheshin atëherë (dy a më shumë fshatra) organizatat shoqërore politike (Lidhja Socialiste), në organizatat e punës së bashkuar, me qëllim që të ndikojnë në rregullimin e jetës në çdo mjedis dhe ndërhyrjen me qëllim pajtimi në raste se vinte deri te ngatërresat mes tyre. Në këtë këshill merrnin pjesë njerëz me autoritet. Veprimi i tyre dhe procedura e ndjekur ishte publike dhe në raste të arritjes së marrëveshjes, përpilohej një dokument me shkrim i cili ishte i vlefshëm. Përkunder qëllimit të mirë të ligjëvënësit, ndoshta edhe me ndërhyrjen e politikës së atëhershme në këto çështje, Këshillat e Pajtimit nuk kanë pasur sukses, gjë që nuk mund të thuhet për Këshillat e Pajtimit të krijuara sipas të drejtës zakonore dhe të udhehequra nga prof Anton Çetta në vitet 90.

Sipas të dhënave zyrtare, pas vitit 1999, pas largimit të Serbisë nga Kosova kemi një rritje të madhe të kriminalitetit në përgjithsi e të vrasjeve në veçanti. Dhe si pasojë e këtyre vrasjeve, prapë hakmarrja dhe gjakmarrja ka ngritur krye. Disa nga këto gjaqe zgjasin prej disa dekadave dhe të tjerat janë të pas luftës. Përkundër përpjekjeve të shoqërisë kosovare edhe pse nën administrimin e një pushteti të “përzier” të UNMIK-ut, me rregulla të “përziera lindje- perëndim, veri-jug”, me një aparat burokratik dhe të paaftë për t’u përballur me sfidat e një vendi të djegur dhe të shkatërruar nga lufta, me një strukturë shtetërore të përçarë, të paaftë dhe pa vizion dhe me perceptime të ndryshme politike. Sipas të dhënave zyrtare në Rrafshin e Dukagjinit, pra, në Rajonin e Gjykatës së Qarkut të Pejës, 122 familje nga të cilat disa i nënshtrohen regjimit të rreptë të “burgut shtëpiak” për shkak të frikës nga fenomeni i hakmarrjes dhe gjakmarrjes. (tabela 10)

Familje të mbyllura në shtëpi nga frika e gjakmarrjes						
Peja	Istogu	Klina	Deçani	Gjakova	Gjithsej	Pajtuar
18	14	22	30	38	122	4

Tabela 10. Numri i familjeve të cilat jetojnë nga frika e gjakmarrjes në Rajonin e Pejës (*Burimi i të dhënave: Policia e Kosovës-Zyra Rajonale e Policisë së Komunitetit të Pejës*)

Sipas këtij hulumtimi është vërtetuar se në mungesë të reagimit të shpejtë dhe efikas të institucioneve shtetërore, familjet që relativisht janë ende të mëdha në fshat, të frikësuar nga ndjenja e hakmarrjes janë të detyruar ose të shpërngulen ose të mbyllën në shtëpi. Mbyllja e tyre në shtëpi, si masë parandalimi për një vrasje të re, ka shkaktuar dhe shkakton pasoja të paparashikueshme te brezi i ri i cili është i detyruar të

ndërpresë shkollimin, studimin, punën ose të marrin botën në sy dhe të largohen nga vendi drejt perëndimit. Për çudi, fenomeni i hakmarrjes edhe në këtë fillim shekull të ri po na përcjell si ogur i zi. Edhe shkaqet që e shkaktojnë atë janë ende prezente në shoqërinë shqiptare në përgjithësi e që disa nga autorët tanë dhe të huaj e lidhin edhe me zhvillimin shoqëror dhe ekonomik ndërsa të tjerë e kanë shtjelluar nga pozita gjeopolitike dhe strategjike duke dhënë edhe konkludime joshkencore dhe shoviniste. Autori francez Ami Bue, hakmarrjen të shqiptarët e konsideronte si “...një detyrë dhe zëvendëson tek ai ligjet tanë të policisë penale dhe të drejtësisë kriminale” (Bue, 2011, f:28). Ambasadori amerikan duke iu referuar gjëndjes në Shqipëri, lidhur me gjakmarrjen shkruan: “Gjakmarrja në Shqipëri është një institucion i cili rregullohet me doke, zakone dhe përbënë një kod për ndëshkimin vetjak të vrasësit, ku shteti nuk ndërhyr fare” duke e shpjeguar shkakun e aplikimit të saj si mjet mbrojtës të familjes, fisit dhe mbrojtjes së nderit të tyre. (Williams, 2003, f:18). Lidhur me traditën e shqiptarëve dhe gjakmarrjen, prifti boshnjak Atë Lovro Mihaceviq kishte shkruar “Përveç virtyteve, shqiptarët kanë edhe veset apo të metat e tyre, më të zeza prej të cilave është mospajtimi dhe sherri me njëri-tjetrin që i ka përçarë gjithmonë. Se sa mirë ka ditur Turqia të luajë me letrën e përçarjes më së miri e dëshmon vetë historia e Shqipërisë”. (Mihaceviq, 2006,:109). Enografi hungarez Nopça lidhur me shqiptarët dhe doket e tyre shkruan: “Me qëllim kam përdorur pak literaturë sllave, duke marrë parasysh paragjykimet që i njeh bota, të sllavëve kundër shqiptarëve”. (Nopça, 2013:19). Sipas tij “Kanuni i malësorëve të Shqipërisë së Veriut rregullon tërë jetën publike të këtyre njerëzve, derisa zhvillohet jashtë familjes. Brenda familjes të gjitha grindjet e pjestarëve të familjes, bile edhe vrasjet, që ndodhin brenda në familje, vendosen prej “patria potesta”. (Nopça, 2013a f:291).

Duke i përshkruar të tjerët çfarë kanë thënë për shqiptarët, Nopça i karakterizon shqiptarët si anarkistë, gjakënxehtë, të rrëmbyer, dyshues, zemërbardhë, trima, të qeshur, hatërlinj, mikëpritës, hakmarrës dhe jo fetar. Duke shkruar për qeverisjen e një shoqërie pa pushtet, hakmarrjen e cilëson si një “institucion mirëbërës”. (Nopça, 2013b, f:319). Ky fenomen, në një fazë të caktuar të zhvillimit shoqëror ka qenë formë e reagimit në çdo popull, por vetëm forma e këtij reagimi ka qenë e ndryshme nga reagimi në shoqërinë shqiptare. (Zurl, 1978 f:111); (Nopça, 2013c, f:417-457). Ndër dallimet që i karakterizojnë vrasjet ndërmjet shqiptarëve, ka qenë ajo se shqiptarët në ish-jugosllavi kanë qenë fëmijë bonjak dhe se e vetmja forcë e mbijetesës nga zhdukja dhe asimilimi

ka qenë familja, fshati e fisi dhe mbështetja në traditën dhe Kanunin e Lekë Dukagjinit. (Hasluck, 2005:19-26). Aplikimi mbrenda një kohe relativisht të gjatë të normave zakonore dhe aplikimi i këtyre normave në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme familjare, civile juridike dhe probleme të tjera të përditshmërisë, ka qenë (mos)reagimi i regjimeve pushtuese në rimëkëmbjen e ekonomisë, zhvillimit dhe sundimit të ligjit në shekuj në këto treva. Prandaj, disa nga “studiuesit” e këtij “fenomeni” e lidhin me “genin e egër shqiptar”, duke nxjerr përfundime se “...nuk janë një komb ...por disa fise të një gjinie ... pa gjuhë të përbashkët kombëtare..., ndonjë fare kulture s’kanë”. Sipas teorive të tyre racore ata shkojnë me tutje duke u thirrur sipas “...parimevet sociologjike e mbas teorive të së drejtës shoqërore, shqiptarët nuk mund të quhen sot si popull” (Gjorgjevic, 2012, :50,181), se në mes të “shqiptareve duket se deri në të XIX-tin shekull ka pasun edhe njerëz me bisht”, se janë popull pa moral, se “Nga 100 nuse natën e martesës vetëm 50 dalin vajza”, se “në ma të shumtën e fiseve të Shqipnis, nusja blehet” , se „N’Toplanë vriten si thijt”, se “70% nga të gjithë meshkujt e vdekur shkojnë prej gjaqesh” dhe përmend shifren prej 5000 gjaqesh që duhen pajtuar në Shqipëri (Gjorgjevic, 2012a, f:24,71,141,155). Njësoj si Gjorgjeviq, autori tjetër serb, Sima Trojanoviq, kishte shpikur një ide përmes së cilës shpjegonte aftësitë dhe të metat e kombëve të caktuara në bazë të masës së “Republikës Borsalino” duke u bazuar në kokën e madhe të tyre dhe sipas kokës ai kishte caktuar edhe inteligjencën e kombeve. Sipas tij, gjermanet janë në radhë të parë, Italianët, francezët dhe me pas vijnë serbët. Ndërsa kur flet për madhësinë e kokës për shqiptarët, ai thotë “Arnautet kanë kokën edhe më të vogël se ciganët” dhe shkon më tutje duke dezinformuar opinionin serb dhe më gjerë se “madhësia e kokës së shqiptarëve mes Lumit Shkumbin dhe Mat është vetëm 449 milimetra” duke i cilësuar si pjestarë që vijnë nga “raca me zhvillim të vonuar psikik dhe kanë një tru të lehtë (lakshi mozak) dhe kuptohet kokë më të vogël se popujt e kulturuar”. (Trajanovic, 1927a, f:44). Konstatimet e tilla të Trojanoviqit dhe të Gjorgjeviqit i demaskon vetë historia serbe e cila ka regjistruar dukuritë dhe fenomenet e saja mbrenda vetë shoqërisë serbe. Sipas autorit Ilija M. Jeliq, “Gjakmarrja ka qenë dhe është e drejtë zakonore e cila ka ekzistuar dhe është aplikuar te të gjithë popujt në një fazë të caktuar të zhvillimit të tyre shoqëror e kulturor” dhe se janë “të paskata disa teza të disa autorëve se ky ose ai popull i ka pranuar ato zakone prej këtij ose atij populli fqinj”. (Jeliq, 1927, f:72-80). Sipas autorit serb Çajkanoviq, hakmarrja ka ekzistuar edhe te serbët të cilët së pari “bënin fjalë, pastaj merrnin armët, pastaj kërkohej ndërmjetësimi i zotit: Jo me gjak. Pashë zotin dhe të shenjtin Jovan”. (Cajkanovic, 1973a,:165). Sipas

besimit të shoqërisë serbe që e paraqet ky autor, vrasësi ndiqej nga shpirti i të vrarit dhe me qëllim që të largohet pa problem nga vendi i ngjarjes, ai e lëpinte (lizne krv ubijenoga) gjakun e të vrarit ose e linte ndonjë pjesë të veshjes së tij afër kufomës së të vdekurit me qëllim që të lirohej nga ndjekja e shpirtit të viktimës. Sipas këtij autori, ky akt e qetësonte shpirtin e viktimës dhe i krijonte një ndjesi si në rastin e vëllazërisë ku dy persona betohen me njëri-tjetrin dhe pijnë gjakun e njëri-tjetrit. (Cajkanovic, 1973b:167). Sipas këtij autori, edhe faktorët që kanë çuar deri tek vrasjet dhe tek hakmarrja tek serbët, pothuajse janë të njejtë me popujt tjerë. Dhuna e ushtruar nga të tjerët, çështja e pronës, marrja e nderit në raste kur i grabitej vajza apo gruaja ishin disa nga shkaqet kryesore të vrasjeve. Vrasjet nuk kursenin as gjininë femërore. (Gjorgevic, 1900:448). Grabitjet e femrave (otmica), ikja e tyre nga shtëpia (dobegovanje), blerja e grave për martesë (kupovina) dhe martesat e lidhura nëpërmjet dhunës (silnih brakova) ishin shndërruar në dukuri dhe se kjo dukuri ishte shkak i shumë vrasjeve. Sipas këtij autori, kishte raste kur shtetasit kishin shkuar t'a marrin me dhunë vajzën me qëllim që ta martonin, por kur vajza kishte kundërshtuar, ata e vrisnin dhe largoheshin nga vendi i krimit. Edhe ikja e vajzave të fejuara ne Serbi kishte pasoja për babain e vajzës i cili duhej të përgjigjej para familjes së të fejuarit. Problemet e kësaj natyre çonin deri në larje hesapesh me armë, që mjerisht, femrat ishin viktimat të rastit. Për vrasje, autori duhej të paguante “paratë e gjakut” që quhej “krvnina” dhe paguhej në 200 groshë. (Gjorgevic, 1900a:416-449). Ndërsa sipas Vuk Karaxhiqit shuma e parave të gjakut në Serbi ishte 1001 groshë. (Karadzic, 1867:226). Me qëllim të ndalimit të hakmarrjes në Serbi, problemet e shitjes së femrave për martesë, martesat me dy gra (dvoženstvo) dhe lindjet e fëmijëve pa prindër (kopiladi) që ishin të pranishme në Serbi në atë kohë, ishte njoftuar Knjaz Milloshi. Knjaz Milloshi kishte nxjerr një rregullore që ishte e detyrueshëm për të gjithë e që i referohej fejesës, martesës dhe ndalimit të grabitjes së femrave. Me datën 10 gusht 1821, Knjaz Milloshi i shkruan një letër vasalit të tij në Çaçak dhe nga i njëjti kërkon të ndalohej “Hakmarrja sipas traditës shqiptare mos të lejohej në asnjë mënyrë”. (Gjorgevic, 1900b, f:448). Përkundër masave që kishte ndërmar Knjaz Milloshi, në Serbi, ishin aktuale martesat me dallime të mëdha në moshë. Djali i mitur, nën 12 vjeç martohej me vajza të rritura mbi 22 vjeç. Sipas traditës serbe, mes saj (resë) dhe vjehrrit krijoheshin raporte “bashkëjetese” që tek serbët quhet “Snahočestvo”. Nga kjo marrëdhënie, ata lindnin edhe fëmijë. Kjo formë e “bashkëjetesës mes vjehrrit dhe nuses” sipas autorit serb Tihomir Gjorgjeviq, ishte krijuar për shkak të “nevojës për ndihmë ekonomike”. Si rezultat i kësaj “bashkëjetese” lindte fëmija i cili ishte vëllai i burrit të

nënës dhe quhej “babovic”, djali i babait. (Trojanovic, 1901, f:159).

Sa i përket mbrojtjes juridike të femrës në Serbi, ajo ishte e pambrojtur, nuk kishte të drejtë të trashëgonte pasurinë e prindit, as të burrit, ajo ishte një mjet pune me detyra që të lindte dhe t’i shërbente burrit. Burri kishte të drejtë t’a keqtrajtonte deri në një masë me kusht që mos t’i shkaktonte dëmtime të rënda trupore. Në rast se e rrihte në mënyrë “të pashpirtë” atëherë, ai sipas nenit 349 të Kodit Penal të Knajzhevines të Serbisë të vitit 1860 dënohej me burgim deri në 30 ditë . Sipas Mladenoviq, burri kishte të drejtë të martohej me dy gra nëse nuk kishin fëmijë dhe kishte të drejtë t’a keqtrajtonte dhe t’a përzinte nga shtëpia. (Mladenovic, 2006:88, 94).

Shikuar nga ky aspekt, autori Gjorgjeviq nuk kishte të drejtë që shqiptarët i cilësonte si njerëz me bisht, njerëz të egër të organizuar në fise dhe pa kulturë, sepse edhe në shtetin ku ai ishte kryeministër (1897-1900), Serbia, ishte e zhytur në “mjerim moral” dhe shoqëror ku e drejta e përdorimit të dhunës në familje ishte e ligjëruar dhe e drejta e përdorimit të dhunës fizike e deri në likuidim fizik kishte një bazë juridike që përcillej që nga Kodi i Car Dushanit. (Jankovic, 2012). Duke u bazuar në shkrimet e autorëve të huaj, në mendimet dhe qëndrimet e tyre që ata mbajnë për dukurinë e vrasjeve të shqiptarëve, na del i pranueshëm konstatimi i profesor Ismet Elezit kur shkruan se “...ata japin të dhëna statistikore të pjesshme të vrasjeve në malsitë e veriut, ndërsa nxjerrin përfundime përgjithësuese për tërë Shqipërinë, çka nuk janë në baza shkencore dhe shpeshherë marrin karakter tendencioz dhe antishqiptar, duke i mohuar popullit tonë aftësinë shtetformuese dhe vetëqeverisëse.” (Elezi, 2000a, :20).

6.5. Disa nga faktorët e brendshëm (endogjen) dhe ndikimi i tyre tek veprat penale kundër jetës dhe trupit

Sipas autorës Vasilika Hysi “Çdo veprim kriminal ose jokriminal është rezultat i veprimit dhe ndërthurjes së dy faktorëve: personalitetit të personit dhe mjedisit në të cilin gjendet ky personalitet”. (Hysi, 2010:379). Pra, mjedisi, mjedisi familjar, kulturor, shoqëror, ndikojnë drejtpërdrejtë në psikologjinë e personit, në temperamentin e tij agresiv dhe shpërthyes, i cili duke mos qenë në gjendje të kontrollojë emocionet e veta të brendshme mund të shkaktojë pasoja të rënda në jetën dhe trupin e tjetrit. Historikisht, sidomos në mjediset tona familjare kanë qenë dhe janë të freskëta ndikimet që me çdo kusht, të nxiten emocione, të ndikohet në temperamentin e një anëtarit të familjes që të hakmerret për anëtarin e vvarë. Kjo është bërë duke i’a përkujtuar anëtarëve të rritur të familjes detyrat “kanunore të nxjerrjes së gjakut”, çdo herë kur janë

ulur rreth sofrës, sepse buka dhe gjella përveç që i'u ndahej atyre që ishin prezentë në sofër i ndahej edhe anëtarit të vrarë të familjes etj. Pra, në një mjedis të tillë, rritet ndjenja e hakmarrjes dhe zvogëlohet arsyeja e të gjykuarit në mënyrë drejtë që çon deri tek vrasja. Edhe mjedisi kulturor i një shoqërie të caktuar ndikon në “përzierjen e ndjenjave të personalitetit” sa që shkohet deri atje sa edhe vrasjet më makbare i quajnë vrasje për nder, siç janë vrasjet në disa vende te botë edhe sot, kur prindi, vëllai ose burri vrasin vajzën, motrën apo gruan për tradhëti bashkëshortore ose “veprime të pamoralshme”. (Araji, 2000).

Edhe pse çdo njeri ka një personalitet të vetin, ai nuk mund t'iu rezistojë ndikimeve të botës së jashtme të cilat kanë efekt të jashtëzakonshëm jo vetëm në shprehitë e tij por edhe në sjelljet e tij. Nën ndikimin e këtyre faktorëve të jashtëm, sjelljet e tij mund të jenë mjaft produktive dhe pozitive, por njëkohësisht ato mund të reflektojnë edhe negativitet i cili prodhon krim. Të gjitha këto sjellje ndikohen nga emocionet, nga karakteri, motivet, shprehitë dhe inteligjenca. Temperamenti i personit lidhet ngushtë me ndikimet emocionale që aktivizojnë tërë energjinë e njeriut në një drejtim të caktuar. Temperamenti nuk është i njëtrajtshëm dhe nuk është i njëjtë të gjithë personat, tek disa persona reagimi është shumë i shpejtë, janë shpërthyes, reagues dhe nuk peshojnë shumë pasojat (temperament sanguine), tek disa persona reagimet janë të ngadalta (temperamenti flegmatik), nuk “janë të ngutshëm” thotë populli, i ikin ngatërresave të atypëratyshme, tek të tjerët, reagimet janë të forta të cilat vijnë si rezultat i një zemërimi të madh (persona me temperament kolerik). Tek disa persona të tjerë, reagimet janë më të vonshme por pasojat janë mjaft të rënda (persona me temperament melankolik), janë urrejtës dhe tipa hakmarrës. Përveç ndikimit të temperamentit në personalitetin e tij ndikojnë shumë edhe emocionet si pjesë e pandashme e karakterit të individit e cila e përcjell gjatë tërë jetës së tij në gëzimet dhe në hidhërimet e përditshme të jetës. Emocionet janë një promotor i cili ngacmon ndjenjat e tija dhe shkakton veprime të cilat në rrethana të caktuara përbëjnë elemente të veprës penale. Edhe shprehitë të cilat janë pjesë përbërëse e secilit person janë të ndërlidhura me ambientin jetësor ku banon. Nën një “ambient të inkriminuar” shprehitë janë faktorë shtytës drejt veprimeve kriminale të marrjes me prostitucion, drogë dhe me veprime të tjera kriminale e deri te shtytja në kryerjen e veprës penale të vrasjes.

6.5.1 Inteligjenca dhe kriminaliteti

Sipas psikologut Terry Pettijohn – “Inteligjenca përkufizohet si aftësi për të mësuar dhe

për t'u sjellë në mënyrë adoptive” (Pettijohn, 1996:268) në një ambient të caktuar. Nisur nga kjo, është vështirë të thuhet me siguri se personat të cilët janë inteligjentë janë më pak të prirur për të kryer krime ose janë më pak të atakuar nga nxitje të cilat ndikojnë në veprime kriminale. Krimi dhe kriminelët, shikuar sipas tiplogjisë së tyre, janë të ndëlidhur me tyre dhe për të arritur atje ku duan, ata nuk kursejnë asgjë dhe asnjë person me të vetmin qëllim realizimin e përfitimit pasuror ose jo pasuror. Mendoj se intelegjenca e një personi dhe kriminaliteti kanë një lidhshmëri të caktuar, por nuk është determinues, me përjashtim të aplikimit të aftësive të veta profesionale kur bëhet fjalë për dekodimin apo plaçkitjet e bankave të mëdha të cilat janë të ruajtura me sistemet më bashkohore të sigurisë. Sigurisht se inteligjenca ndihmon në drejtimin dhe aplikimin e metodave të ndryshme “konvencionale” që lidhen me aftësinë e përdorimit të presionit dhe korrupsionit në raste të caktuara. Studiues të ndryshëm janë marrë me matjen e inteligjencës së personave të dënuar dhe personave që nuk janë të dënuar dhe sipas tyre, nuk ka ndonjë dallim mes këtyre dy grupeve sa i përket shkallës së inteligjencës. Nga kjo mund të konkludohet se personat e përfshirë në krim në raste të caktuara, fal inteligjencës së tyre arrijnë të fshehin krimin, arrijnë t’iu ikin organeve të rendit duke krijuar edhe spektakle të veçanta dhe në këtë mënyrë arrijnë edhe t’iu shpëtojnë organeve të drejtësisë për një kohë të caktuar.

6.5.2. Motivet dhe kriminaliteti

Edhe motivet janë elemente të rendësishme të cilat jo vetëm që përcaktojnë kahjen dhe ndikimin e veprimit kriminal, por përcaktojnë edhe shkallen e vetëdijes në raste konkrete. Nëse njeriu normal, i ndikuar nga motive personale, pasurore, familjare, racore, fetare, etj., kryen një veper penale të caktuar atëherë është e lehtë të dihet arsyeja, qëllimi, shkaqet që e kanë shtyrë deri te kryerja e veprës penale. Në të kundërtën, nëse njeriu nuk arrin të kontrollojë veprimet e veta, nuk ka një motiv të caktuar, apo veprimi i tij është instinktiv, atëherë bëhet fjalë për autor të veprës penale të pamotivuar e cila paraqet dilema edhe rreth përgjegjshmerisë dhe përgjegjësisë penale. Shikuar në aspektin psikologjik dhe sociologjik, motivi është një raport i njeriut me tjetrin dhe me rrethin shoqëror që e rrethon. Në këtë drejtim secili në vetëvete ka një perceptim rreth asaj që e rrethon dhe raportin e tij kundrejt një dukurie a fenomeni. Nga mungesa e një perceptimi të drejtë dhe të arsyeshëm, racional dhe të drejtë, vjen deri te pasoja. Psh. krizat ekonomike dhe mungesa e mjeteve për jetesë, është një ndër faktorët socialë të vjedhjes së pronës, ose nxitjes që të merret me krime të rënda, siç janë

trafikimi, prostitucioni, droga e deri te vrasjet. Motivi gjithmonë është i kushtëzuar nga elemente subjektive dhe objektive të cilat ndërlidhen edhe me faktorë të tjerë dhe me vepra të caktuara penale. Psh. motivet për hakmarrje janë të karakterit psikologjik dhe ndikohen nga raportet shoqërore duke filluar nga ndjenja e inferioritetit, caktimi i paarsyeshëm i dënimit, humbja e krenarisë në rrethin shoqëror, etj.

Motivi dhe të kuptuarit e motivit të vërtetë janë njëri ndër faktorët kryesor mbi të cilin mbështetet vendimi i gjykatës.

6.6. Faktorët e tjerë dhe kriminaliteti

Në kuadër të faktorëve specifikë kemi radhitur disa nga faktorët që janë determinues të zhvillimit pozitiv në një shoqëri të barabartë ku sundon rendi dhe ligji. Siç dihet tashmë, historia e Kosovës në ecjen e saj drejtë pavarësisë ishte shumë e gjatë, me shumë peripeci dhe me shumë pengesa për të cilat nuk duam të ndalemi këtu. Rruga e saj drejtë konsolidimit shtetëror dhe politik ishte mjaft specifike, për ndërtimin e institucioneve shtetërore, kanë ndikuar shumë faktorë sidomos ai politik. Edhe pse Kosova, si pjesë e dikurshme e federatës jugosllave, kishte një legjislacion mjaft të avancuar, administrata e UNMIK-ut e “përfashtoi” nga aplikimi i saj duke e zëvendësuar me rregullore, udhëzime dhe urdhëresa administrative të cilat kishin fuqi ligjore. Në një situatë të tillë politike të pasluftës, me një “militarizim” të popullsisë që ishte si pasojë e gjendjes së krijuar nga lufta, në mungesë të funksionimit të institucioneve në zbatimin e ruajtjes së rendit dhe ligjit, kriminaliteti kishte shënuar një rritje marramendëse. Rritja e madhe e veprave të ndryshme penale ishte si rezultat i një joserioziteti dhe joprofesionalizmi të organeve të ndjekjes, i një gjyqësori eksperimental (drejtësia hibride) dhe jo efikas dhe i mungesës së llogaridhënjës janë vetëm disa nga faktorët specifik të paraqitjes së kriminalitetit të pasluftës në Kosovë. Pra, disa nga faktorët specifik që i kemi përmendur e të cilët kishin dhe kanë ndikim në rritjen e mosbesimit në sistemin legal shtetëror dhe në rritjen e kriminalitetit dhe të vrasjeve të rënda dhe të motivuara nga hakmarrja janë: joserioziteti dhe joprofesionalizmi i organeve të ndjekjes penale, joefikasiteti i gjyqësorit dhe instituti i faljes dhe efekti dekurajues i opinionit publik.

6.6.1. Joserioziteti dhe joprofesionalizmi i organeve të ndjekjes penale në luftimin e krimeve të rënda

Siç dihet, pas largimit të Serbisë nga Kosova, erdhi UNMIK-u në cilësinë e një “qeverie” ndërkombëtare e cila mori nën administrim territorin e saj, e cila transformon të gjithë trupat për sundimin e ligjit dhe deri në muajin tetor të vitit 1999 nëpër rrugët e

Kosovës shiheshin vetëm policia e saj me emblema të OKB-së. Kthimi i shpejtë i refugjatëve të dëbuar me dhunë nga regjimi serb, mungesa e strehimit (për shkak se i tërë Rrafshi i Dukagjinit ishte djegur dhe shkatërruar) dhe ushqimit të popullsisë, numri i madh i armëve në duar të popullsisë, mungesa e një vizioni të faktorëve përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe ligjit në periudhën e pasluftës kanë ndikuar në rritjen e kriminalitetit e cila paraqitej në formën e uzurpimit të pronës private dhe publike, plaçkitjes, vjedhjes, grabitjes e deri te vrasjet e ndryshme. Periudha më e rëndë ishte gjashtëmujori i dytë i vitit 1999, që sipas të dhënave zyrtare të UNMIK-ut vetëm në periudhën qershor- dhjetor 1999, ishin “regjistruar 500 vrasje”, ndërsa në vazhdim ishin regjistruar (..), 245 (vrasje) në vitin 2000, 136 (vrasje) në vitin 2001, 68 (vrasje) në vitin 2002 dhe 37 vrasje gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2003”. (Kosovar Stability Initiative, 2007, fq:47). Numri prej 500 vrasjesh në gjysmëvjetorin e dytë të vitit 1999, nuk është i vërtetë, sepse të dhënat zyrtare nga Policia e Kosovës që i referohen asaj periudhe tregojnë se në Kosovë kishin ndodhur vetëm 245 vrasje gjatë vitit 1999. Edhe pse ky numër prej 500 personash të vrarë në Kosovë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1999 nuk është i saktë, duhet pranuar se në këtë periudhë në Kosovë dhe në Rajonin e Pejës mbizotëronte një pasiguri e madhe, kishte dhunë, vrasje, krime të llojeve të ndryshme për të cilat qytetarët kishin nevojë për institucionet e rendit të cilëve shpeshherë edhe iu drejtoheshin për ndihmë. Qytetarë dhe organizata të ndryshme kallëzonin autorët në polici dhe në prokurori, por rezultatet mungonin përkundër një numri të madh policësh ndërkombëtarë dhe vendorë në detyrë të cilët po i paraqesim në tabelën e mëposhtme. (tabela 11)

Muaji/Viti	Policia e UNMIK-ut (UN Police)	Shërbimi Policor i Kosovës (KPS)	Totali
Qershor 2000	3.629	1.600	5.229
Qershor 2001	4.387	3.847	8.234
Qershor 2002	4.524	4.770	9.294
Qershor 2003	4.067	5.207	9.274
Qershor 2004	3.524	5.983	9.507
Qershor 2005	3.083	6.238	8.932
Qershor 2006	2.106	6.826	8.932
Qershor 2007	1.997	7.215	9.212

Tabela 11. Pjesëmarrja e policëve të UNMIK-ut dhe të Shërbimit Policor të Kosovës
(Burimi i të dhënave: Knutsen, 2008)

Ndër rastet e shumta të cilat janë kallëzuar nga KMDLNJ-ja në Pejë, që janë dërguar në Prokurorinë e Qarkut të Pejës në fund të vitit 1999 janë 22 kallëzime penale, kundër 11 ish-zyrtarëve të dyshuar të Komunës së Pejës, të cilët në bashkëpunim me 376 autorë të tjerë nga qyteti i Pejës, kishin kryer veprën penale të vrasjes së 677 personave dhe plagosjen e 289 qytetarëve të Pejës dhe të fshatrave përreth gjatë periudhës mars-qershor 1999. (Këshilli për mbrojtjen e të drejtave të lirive të njeriut, 2002, f:12-14). Këto kallëzime penale, nuk ishin shqyrtuar asnjëherë as nga Prokuroria Publike e Qarkut të Pejës, as nga prokurorët ndërkombëtar të UNMIK-ut, as nga ata të EULEX-it. Këto kallëzime penale janë edhe sot e kësaj dite duke pritur epilogun zyrtar.




Figura 51. Lista me emrat e personave përgjegjës për krime kundër popullsisë civile në Komunën e Pejës (Burimi i të dhënave: Human Rights Watch, 2001)

Joefikasiteti i organeve të ndjekjes penale në zbulimin e krimit dhe kapjen e autorëve të ndryshëm të veprave penale në atë periudhë dhe joefikasiteti i gjyqësorit në zgjidhjen e çështjeve dëshmohej edhe nga numri i madh i çështjeve të pa zbuluara dhe të atyre të pazgjidhura në gjykata të cilat në vitin 2007 kishin arritur në 160.238 çështje. (Knutsen, 2008, f:13). (shih diagramin e mëposhtëm)




Figura 52. Numri i çështjeve të pazbuluara në Kosovë gjatë periudhës 2000 - mars 2007
(Burimi i të dhënave: Raporti i Auditorit të Brendshëm i UNMIK-ut)

Sipas një auditimi të brendshëm të kryer nga vet UNMIK-u në vitin 2008 (11 ditë pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës) vrasjet e marsit të vitit 2004 kishin mbetur pa u zbuluar. Sipas këtij auditimi i cili i është dorëzuar kryeadministratorit Rucker "... bëhej fjalë për 1526 çështje, 754 çështje janë nën vlerësim, 177 të hapura, 315 të mbyllura (were closed), 120 çështje nën hetim aktiv dhe 160 çështje ishin nën hetim nga Shërbimi Policor i Kosovës". (Knutsen, 2008a, f:11).

6.6.2. Joefikasiteti i gjykatës

Organizimi i gjykatave „hibride”. Edhe pse me plotë vështirësi, UNMIK-u në mbështetjen e trupave të NATO-s dhe fillon riorganizimin e gjykatave, prokurorisë dhe policisë të cilat në fillimet e tyre kishin një numër të vogël të gjyqtarëve, prokurorëve dhe policëve ndërkombëtarë dhe bashkë me vendorët krijuan një “hibridizim” të tërë sistemit të sigurisë dhe atij gjyqësor në Kosovë. (Bassiouni, 2003, f:557) (UNMIK/REG/2000/64).

Sipas Rregullorës së UNMIK-ut Nr.1999/5 e datës 4 shtator 1999, PSSP-ja themelon Gjykatën Supreme si “Gjykata e Instancës së Fundit” dhe tërë sistemin e drejtësisë në Kosovë me përjashtim të Gjykatës Kushtetuese (me pretekst se kjo gjykatë implikon UNMIK-un në paragjykimin e statusit final të Kosovës!) Sipas skemës qeverisëse , UNMIK-u përmes shtyllës së parë menaxhonte sistemin e drejtësisë në Kosovë (UNMIK/REG/2000/15), ndërsa përzgjedhja dhe shkarkimi i gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve (poroteve) dhe stafit ndihmës vendor dhe ndërkombëtar ishte e drejtë e rezervuar e Kryeadministratorit të Kosovës. (UNMIK/REG/1999/18;

UNMIK/REG/2000/13).

Përkundër ndihmës që i është ofruar Kosovës nga UNMIK-u, pas vitit 1999 e deri në shpalljen e Pavarsisë (2008), kjo administratë ka patur edhe të metat e veta që janë reflektuar në fushën e sundimit të ligjit. Së pari, ky mision ishte “një protektorat i shekullit të XXI-të”, ku zyrtarët e tij gëzonin një imunitet të pakufizuar. Sipas organogramës, në krye të institucioneve emëroheshin drejtorët që i përgjigjeshin drejtëpërdrejtë vetëm kryeadministratorit. Sipas raportit të Auditit të brendshëm, nga data 01.11.1999 deri me datën 14.05.2007, në Departamentin e Drejtësisë ishin emëruar 10 drejtorë, nga të cilët, pesë prej tyre kishin përfunduar mandatin para kohe duke dhënë dorëheqje. Meqënëse në Kosovë kishte mungesë të gjyqtarëve ndërkombëtar dhe për shkak të mungesës së besimit në gjyqtarët e Kosovës, UNMIK-u krijoi “drejtësinë hibride”, që do të thotë një përzierje e kolegjit gjyqësor vendor e ndërkombëtar i cili gjithmonë kryesohej nga gjyqtari ndërkombëtar.

Ndër shkaqet që kanë penguar zhvillimin dhe forcimin dhe transparencën në sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe kanë ndikuar në rritjen e kriminalitetit në përgjithsi janë:

- aplikimi i “drejtësisë hibride” në Kosovë i njohur si “paneli 64” (kolegji me një gjyqtar vendor, dy gjyqtar ndërkombëtar njeri nga të cilët duhej të ishte relator i çështjes; (UNMIK/REG/2000/64, neni 2.1)

- ndërrhyrjet e “ndërkombëtarëve” në çështje të caktuara në të gjitha fazat e procesit penal apo çështje në gjykim nga drejtori i departamentit të drejtësisë; (Hartmann, 2003, :7).

- jotransparenca në ngjarjet e marsit 2004, ku humbën jetën 19 qytetarë të Kosovës;

- numri i madh i çështjeve penale të pazgjidhura; dhe

- mos funksionimi i sistemit unik të drejtësisë në gjithë territorin e Kosovës dhe lejimi i sistemit paralel të drejtësisë të Serbisë në territorin e Kosovës.

Edhe përqëndrimi i skajshëm i kompetencave vitale shtetërore në duart e një personi, siç ishte në këtë rast, tek ai i PSSP-së “...paraqet kërcënim serioz për pavarësinë e gjyqësorit, duke ngritur dyshime për vlerësimin e njëjtë të gjyqësorit, ekzekutivit dhe legjislativit”. (Kosovar Stability Initiative, 2007a, f:23, 41, 43).

Tendencat e tilla të forcimit autokratik të UNMIK-ut, kanë rezultuar me një dështim në shumë fusha e posaçërisht në fushën e drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë e cila ka kulmuar me ngjarjet e vitit 2004. Pas shpalljes se Pavarsisë, rikonfigurohet pozita e UNMIK-ut dhe në Kosovë paraqitet misioni i BE-së i quajtur EULEX. Në vitin 2009, UNMIK-u i kishte dorëzuar misionit të EULEX-it, 1009 çështje të rënda penale (vrasje të rënda dhe çështje për krime lufte) të pazgjidhura. Nga këto çështje, vetëm “50 çështje

janë aktive, 158 çështje ishin pushuar për arsye të ndryshme...në total 851 çështje të cilat nuk ishin aktive do të hetohen” –shkruan Yves De Kermabon. (Kermabon, 2009) Pra, sipas këtyre të dhënave del se 1.009 viktimat prisnin drejtësinë për një dekadë të tërë, 1009 të dyshuar lëvizin lirshëm pa patur frikë se do kapen e ndëshkohen nga organet e rendit dhe ligjit.

6.6.3. Sistemi gjyqësor paralel i Serbisë në Kosovë

Përveç tendencave të UNMIK-ut për reformimin dhe rifunksionimin funksional të sistemit të drejtësisë në Kosovë, organizimi teritorial i gjykatave dhe prokurorive nuk ka ndryshuar, sistemi i gjyqësorit mbeti ai i para luftës – gjashtë qarqe në të gjithë Kosovën, në secilin nga këto gjashtë qarqe funksiononte një Gjykatë e Qarkut, Gjykata Komunale dhe ajo për kundërvajtje. Ligji i zbatueshëm në Kosovë ishte Ligji Penal i Kosovës, Ligji Penal dhe Ligji i Procedurës Penale i RSFJ-së dhe ligjet e tjera „ që nuk janë diskriminuese” –thoshte UNMIK-u! Në fakt këtu kemi një diçka të çuditshme sepse UNMIK-u i pranonte ligjet e Serbisë të cilat ishin nxjerrë duke dhunuar themelet e drejtësisë dhe parimet themelore të kushtetutës së ish-RSFJ-së.

Duke mbajtur një qëndrim të „ndërmjetëm politik”, administrata e UNMIK-ut asnjëherë nuk ka arritur të shtrijë administrimin e sistemit të drejtësisë në veri të Mitrovicës, i cili përkundër obligimeve ligjore kishte lejuar funksionimin e sistemit paralel të Serbisë në këtë pjesë të Kosovës.

Përkundër përpjekjeve politike dhe diplomatike që ndërmori UNMIK-u nën drejtimin e krijimit të sistemit unik të drejtësisë në Kosovë, përkundër marrëveshjeve që i nënshkruante me Serbinë, ajo nuk arriti ta shpërbëjë sistemin paralel serb në teritorin e Kosovës. Ky sistem paralel funksionon edhe sot e kësaj dite në fushën e drejtësisë, sigurisë, posttelekomit, shëndetësisë, arsimit, gjeodezisë, etj. Organizimi dhe funksionimi i këtyre institucioneve paralele të Kosovës, drejtohet nga pjesa e veriut të Kosovës edhe pse selitë e tyre gjenden të shpërndara nëpër qytetet juglindore të Serbisë, Leskovc, Kragujevc, Vranje, Nish, Surdulicë e gjetiu. (Zakonom o sedištima i područjima sudova i javnih tužilaštava, 2002). Pas vitit 2008, Serbia nxjerr një ligj të ri për selitë e gjykatave dhe prokurorive në Serbi në bazë të të cilit organizimi i këtyre institucioneve pushon në dhjetor të vitit 2013 (Zakon o sedištima i područjima sudova i javnih tužilaštva Srbije, 2008). Sipas këtij ligji në Mitrovicën veriore ishin koncentruar disa institucione të sistemit të drejtësisë dhe sigurisë. Aty ishte vendosur selia e gjykatës themelore me kompetencë për disa lokalitë të Rrafshit të Kosovës dhe Dukagjinit (neni

3 pika 11), selia e Gjykatës së Lartë si gjykatë e shkallës së dytë (neni 4 pika 7), selia e Prokurorisë Themelore (neni 9 pika 11), selia e Prokurorisë së Lartë (neni 10 pika 7), selia e një dege të Gjykatës së Lartë të Nishit (neni 7 pika 2). Për ankimimin për çështje ekonomike për territorin e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë ishte përcaktuar Gjykata ekonomike në Nish (neni 5 pika 8). Gjykata e Apelit në Nish ishte kompetente për shqyrtimin e çështjeve në shkallë të dytë nga territori i Kosovës (neni 6 pika 3) ku ishte edhe selia e Prokurorisë së Apelit (neni 11 pika 3). Më pas Serbia nxori edhe një ligj i cili vetëm sa e forcoi pozitën e funksionimit të sistemit paralel të gjykatave dhe prokurorive të Kosovës. (Zakon o sedištima i područjima sudova i javnih tužilaštva Srbije, 2013)

Sipas nenit 13, posaçërisht nenit 12 pika 2 e ligjit mbi selitë dhe territorin e gjykatave dhe prokurorive, çështjet gjyqësore të gjykatave komunale të Kosovës kalojnë në kompetencë të gjykatave të Serbisë si në Vranje, Krallëvë, Krushevc, Nish, Prokuplë, Pozharevc. Çështjet e gjykatave komunale të Gjakovës, Istogut, Klinës, Pejës, Suha Rekës dhe Ferizajit i merr gjykata themelore në Leskovc, ndërsa çështjet e gjykatës së qarkut të Pejës i kalojnë gjykatës së Lartë në Leskovc. Krijimi dhe funksionimi i një sistemi të tillë paralel dhe heshtja e administratës së UNMIK-ut e cila kishte detyrim menaxhimit dhe administrimit të territorit të Kosovës, ka shkaktuar probleme të jashtëzakonshme në realizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe të sigurisë tek të gjithë qytetarët e saj.

Realisht, pritshmëritë nga ky mision kanë lënë për të dëshiruar, veprat e rënda penale të kryera pas luftës njohin një rritje. Kjo ka ndodhur për shumë arsye, e njëra ndër to ka qenë injorimi i faktorit vendor, arroganca që individë të caktuar të këtij misioni tregonin ndaj realitetit të krijuar, ndërrimet e shpeshta të personave zyrtarë të misionit, mospasja e përvojës e faktorit vendor që t'i përshtatet rrethanave të reja, e deri te mosinteresimi i individëve të caktuar në UNMIK që të krijojnë kushte sigurie në Kosovë.

6.6.4 Në kontkëstin e mosaplikimit korrekt të ligjit

Aplikimi praktik i ligjit në procedurat gjyqësore, administrative dhe përmbarimore (ekzekutive) ka një rëndësi të madhe sepse kjo do të thotë se institucionet që merren me sundimin e ligjit respektojnë parimin e ligjshmërisë dhe të drejtat e individëve të përcaktuara në Kushtetutë. Sipas hulumtimit në teren, ka patur anashkalim të aplikimit të ligjeve që do të thotë se nuk është vepruar sipas zgjidhjeve ligjore duke filluar nga

mosrespektimi i afateve në mbajtjen e seancave kryesore, e deri në zgjatje të paarsyeshme të proceseve gjyqësore. Sipas nenit 279 par 1 i LPP-së të Jugosllavisë, kryetari i kolegjit cakton seancë kryesore jo më vonë se brenda dy muajsh nga dita që dosja ka arritur në gjykatë dhe nëse ka ndonjë pengesë, ai ka për detyrë ta njoftojë kryetarin e gjykatës me qëllim marrjen e masave për eliminimin e shkaqeve dhe pengesave që pengojnë në caktimin e seancës. Neni 319 (1) Kryetari i trupit gjykues me urdhër cakton ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të gjyqit. (2) Kryetari i gjykatës, nëse është e nevojshme, merr masa për caktimin e shqyrtimit gjyqësor. Zgjidhje e përafërt parashikohet edhe në nenin 319 par 2 të KPPP-së të Kosovës i cili thotë: “Nëse brenda një muaji nga forma e prerë e aktakuzës nuk caktohet shqyrtimi gjyqësor, kryetari i trupit gjykues njofton kryetarin e gjykatës për shkaqet e moscaktimit të seancës”. Nga praktika e gjyqësorit në Kosovë përfshirë edhe praktikën e ndjekura në Gjykatën e Pejës, rezulton se ky afat nuk është respektuar gjë që ka sjellë jo vetëm shkeljen e të drejtës së gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm, por ka ndikuar në besueshmërinë e gjykatës dhe të sistemit të drejtësisë në përgjithësi. Sipas raportit të OSBE-së, në Gjykatën Komuale të Pejës, prokuroria kishte ngritur akuzë kundër një personi për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve “ në janar të vitit 2002, por dita e seancës së parë nuk është caktuar deri më 20 qershor 2003, (18 muaj më vonë). Në Gjykatën Komunale në Kaçanik në janar të vitit 2002 nga Prokuroria Publike ishte ngritur akuzë për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, ndërsa seanca kryesore ishte mbajtur në korrik të 2003, (17 muaj më vonë). E njehta gjë kishte ndodhur në një rast në Gjykatën Komunale në Gjiilan, ku Prokuroria Publike në akuzën e saj të shtatorit 2000 kundër një të akuzuari për kryerjen e një veprë penale është caktuar dita e zhvillimit të seancës në tetor të vitit 2001 (13 muaj më vonë) ndërsa arrestimi i tij ishte urdhëruar nga ana e Gjykatës në qershor të vitit 2003 (32 muaj më vonë). (OSCE, 2009a,14).

6.6.5 Në kontkëstin e heqjes dorë në mënyrë të heshtur nga ndjekja penale - procedura e parashkrimit

Instituti i parashkrimit të veprave penale dhe parashkrimit të ekzekutimit të vendimeve janë të rregulluara në ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Ky institut ishte parashikuar në Kodin e vjetër Penal (neni 90 par 3 dhe parashihet në Kodin e Ri Penal të Kosovës në nenin 107 të KPK-së paragrafi 5 i cili shprehimisht thotë “Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer” dhe a janë ndërmarr këto veprime?

Sipas raporteve zyrtare dhe atyre nga shoqëria civile është paraqitur një shqetësim i

madh lidhur me procedurën e parashkrimit të ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të dënimeve. Në Kodin e Procedurës Penale afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve parashikohet në nenin 110 paragrafi 4 i cili shprehimisht thotë: “Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit”. Në këtë drejtim nuk bëhet fjalë vetëm për vepra të caktuara penale por në përgjithësi ky trend ka shënuar një praktikë jo të mirë e për pasojë ka sjellë pasoja të paparashikueshme në rritjen e kriminalitetit në përgjithësi, sepse njerëzit duke mos i besuar drejtësisë tentojnë që problemet dhe pakënaqësitë mes tyre t’i zgjidhin përmes forcës, përmes vetëgjyqësisë. Sipas të dhënave zyrtare në vitin 2011 në disa gjykata të Kosovës janë parashkruar qindra çështje penale. Kështu në Gjykatën e Pejës janë parashkruar 456 çështje, në Ferizaj 116 çështje, në Gjiilan 190 çështje, në Gjykatën e Rahovecit 90 çështje, në Gjykatën e Kamenicës janë parashkruar 17 çështje dhe në Gjykatën e Vitisë, 249 çështje. (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN, 2011, f:32). Ndërsa, sipas hulumtimit të shoqërisë civile, në 14 gjykatat Komunale të Kosovës, (jo ato të qarkut) nga viti 2001-2011 janë parashkruar 4197 çështje penale. (Demhasaj, Bajrami, & Kalaja, 2012, f:6). Nisur nga kjo del se askush nuk është fajtor pse çështjet të cilat janë dorëzuar në zyrën e prokurorit me qëllim fillimin e procedurave ligjore dhe nxjerrjen e autorëve të këtyre veprave penale para gjykatës, janë parashkruar pa u marr asnjë veprim i vetëmligjor.

Sipas Raportit zyrtar për vitin 2013 në gjykatat e Kosovës janë pranuar për t’u shqyrtuar 885, 677 çështje me të cilat duhet të merren 321 gjyqtarë (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2013, f:39). Nga kjo del se secili nga këta gjyqtarë është i ngarkuar me 2759 çështje që do të thotë se gjyqtari duhet të zgjidhi 7.55 lëndë brënda ditës. Çështje të gatshme për ekzekutim kanë qenë 108,657. Në këtë raport thuhet se “në Gjykatën Supreme të Kosovës, Dhoma e Posaçme ka pesë kolegje të specializuara, si dhe një Kolegj Apeli. Secili kolegji i specializuar përbëhet nga një gjykatës ndërkombëtar dhe dy gjykatës vendorë. Kryesues të Kolegjeve të Specializuara janë gjyqtarët ndërkombëtarë. Kolegji i apelit përbëhet nga pesë gjykatës, tre nga të cilët janë gjykatës ndërkombëtarë dhe dy janë gjyqtarë vendorë” të cilët janë të ngarkuar me 16.424 çështje që do të thotë se ata duhet të zgjidhin 3.285 çështje brenda 365 ditësh (pa llogaritur pushimet, ditët e javës etj) që i bie se brenda ditës ata duhet të zgjidhin nga 9 çështje. (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2013a, :42). Gjykata Themelore e Pejës me degët e saja në Istog, Klinë dhe Deçan për vitin 2013 ishte e ngarkuar me 41,605 çështje ku punojnë 38 gjyqtarë. (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2013b, fq.49).

Edhe largimi i gjyqtarëve të UNMIK-ut nga Kosova ka lënë qindra e mijëra çështje civile të pa zgjidhura në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës të cilat janë mbartur në misionin e EULEX-it. Dhoma e Veçantë është kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile juridike mes Agjensisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Agjensisë Kosovare të Pronës (ish Habitat-i) dhe subjekteve fizike dhe juridike. Në Dhomën e Posaçme të kësaj Gjykate, gjatë vitit 2014 janë dorëzuar 13.189 çështje ndërsa ky numër është rritur me 33% duke u ngritur në 20.460 çështje në vitin 2015. Për tre vite (2012-2015) kjo gjykatë ka vendosur në mënyrë efikase për 2742 çështje. Nëse analizojmë dinamikën e punës së tyre mund të konkludojmë se për zgjidhjen e këtyre 20.460 çështjeve, kërkohej 7 vjet e katër muaj (pa llogaritur se çdo ditë paraqiten çështje të reja). (EULEX, 2015, f:27).

6.6.6 Caktimi në minimumin ligjor të dënimit nga ana e gjykatës

Gjatë hulumtimit të veprave penale kundër jetës dhe trupit në periudhat që kemi studiuar, kemi hasur një larmi në dhënien e dënimeve për vepra të ndryshme penale gjë që sipas mendimit tonë ka ndikuar dhe ndikon në natyrën e viktimës dhe familjarëve e tij. Përveç se kemi të bëjmë me procedura të tejzgjatura nga momenti i kryerjes së veprës penale e deri tek caktimi i dënimit, kemi hasur në dënime të cilat nuk përkojnë me kërkesat e dënimeve që parashikon Kodi Penal. Në disa raste, dënimet janë mjaft të rënda, ndërsa në disa të tjera janë mjaft të ulta, jo sipas normave të parashikruara nga ligjvënësi. Kemi vendime ku autorët janë dënuar me kusht për veprën penale plagosje e rëndë ose vrasje e mbetur në tentativë; ose janë hasur vendime me dënime me gjoba shumë të ulta kundër autorëve të veprave penale të cilët në raste konkrete kanë përdorur edhe armët; ose për veprën penale plagosje të rënda apo të lehta ka patur ricilësim të këtyre verpave nga ana e gjykatës në vepra penale armbajtje pa leje dhe se në raste të tilla kryesisht ishin dënuar me dënim me gjobë prej 200-300 euro. (Gashi & Musliu, 2012:15) Duhet cekur se sipas nenit 328 paragrafi 1 i Kodit të Përkohshëm Penal “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar” është veper penale dhe “Kushdo që përdor apo vringëllon armët me frikësim...dënohet me gjobë deri në 10,000 euro ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet”. Përveç caktimit të dënimeve të ulta për këto vepra, kemi hasur edhe çështje për të cilat fare nuk është ngritur akuzë për kryerjen e veprës penale, edhe pse “Përdorimi apo vringëllimi i çfarëdo arme” pa leje, konform nenit 8.5 të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/7 apo nenit 328 të KPPK-së dënohej me burgim deri në dhjetë vjet ose me gjobë deri në 20.000

marka gjermane. Kjo dukuri e mosndëshkimit për veprën e kryer është përcjellë që nga fillimi e deri më sot në praktikën e Gjykatës së Qarkut të Pejës. Në ato raste kur autorëve të veprës penale i'u është caktuar dënimi edhe për këtë veprë (armëmbajtje pa leje), dënimet kanë qenë mjaft të ulta, nga një vit me burgim ose me gjobë nga 200 euro deri në 1700 euro dënim me gjobë. Në disa raste, krahas masës së dënimit me burgim, gjykata kishte shqiptuar edhe masën e sigurisë- konfiskimin e armës. Kjo praktikë e pandëshkueshmërisë për veprat penale të cilat parashikohen me ligj është aplikuar në shumë raste nga drejtësia hibride edhe në gjykatën e Qarkut të Pejës.

Është interesant të përmendet rasti P.nr.70/2002 i cili ka të bëjë me një vrasje të kryer nga shefi i policisë hetimore të Stacionit të Policisë të Pejës. Viktimë e kësaj vrasjeje ishte asistentja dhe përkthyesja e tij kosovare. Me datën 31 tetor 2002, Prokuroria Publike e Qarkut të Pejës kishte ngritur akuzën e ndryshuar PP.Nr.08/2002 e cila ishte dorëzuar në Gjykatën e Qarkut të Pejës më datën 07.11.2002 sipas së cilës ish-kapiteni i policisë së UNMIK-ut me detyrë në Kosovë nga kontigjenti egjiptian ishte akuzuar për veprat penale të vjedhjes sipas nenit 134 i LPK-së dhe veprën penale të vrasjes sipas nenit 30 paragrafi 1 i LPK-së. Ky ish-polic i CIVPOL-it, në vitin 2001 ishte caktuar me detyrë në Stacionin e Policisë në Istog. Në korrik të vitit 2001, policia e Istogut kishte bastisur një shtëpi të një qytetari nga i cili kishin konfiskuar disa municione dhe një revole. Me urdhërin e këtij oficeri, kjo revole nuk ishte dorëzuar tek laborator i kriminalistikës për ekzaminim, por ishte përvetësuar nga ai. Pas kalimit të tij me detyrë në Pejë, revolën e sekuestruar e kishte marrë me vete me të cilën më vonë e kishte kryer edhe veprën e vrasjes. Ky ish-komandant policie, duke shfrytëzuar poziten e shefit të hetimeve, kishte arritur të gënjente edhe viktimen e këtij rasti, një vajzë pejane e moshës 23 vjeçare e cila ishte e punësuar në këtë stacion policor në cilësinë e përkthyeses dhe së cilës i kishte premtuar martesë. Me datën 5 janar 2002, ai kishte vajtur në punë dhe pas kafesë së mëngjesit, ai ishte larguar nga zyra e tij bashkë me viktimën dhe kishin shkuar në banesën e tij, (rreth 3 km larg Stacionit të Policisë) dhe pas një zënke mes tyre, për motive xhelozie, nxjerr nga sirtari revolen e vjedhur dhe gjuan tre herë në drejtim të viktimës e cila nga plagët e marrura vdes në vend. Pas këtij akti, ai gjoja kishte tentuar të vriste veten, por siç shkruhet në vendim “në vend të zemrës së tij, plumbi qëlloi humerusin e majtë (pjesën e sipërme të kockës së krahut) duke shkaktuar disa fraktura në të”. Pas këtij akti, ai ishte drejtuar tek një kasolle jashtë shtëpisë, e pastron revolen duke i fshirë gjurmët e gishtërinjëve e fsheh armën dhe pastaj e njofton policinë.

Për këtë akt makabër, prokurori publik ndërkombëtar ngrit akuzë, vetëm për dy vepra

penale të përmendura më lartë, por nuk e sheh të arsyeshme ta akuzojë për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare (neni 210 par 1 i LPK-së) edhe pse, ai në cilësinë e shefit të hetimeve, armën e konfiskuar gjatë një bastisjeje policore, nuk e kishte dorëzuar tek zyrtarët e KFOR-it për shkatërrim. Ai nuk u akuzua as për armëbajtje pa leje të cilën një oficer i lartë (shefi i stacionit të Policisë) e kishte transportuar, poseduar dhe mbajtur pa leje dhe në kundërshtim me rregulloren e UNMIK-ut, ku parashihej dënimi deri në 10 vjet ose me gjobë deri në 20.000 marka gjermane. (UNMIK/REG/2001/7, neni 8.5). Në fund, gjykata kishte shpallur verdiktin e saj dhe e kishte dënuar autorin e kësaj vepre penale me 12 vjet për veprën penale të vrasjes dhe 1 vit për veprën penale të vjedhjes. Nga të dhënat që janë përshkruar në këtë vendim, shihet se tek ky autor i vepres penale, janë gërshetuar elemente xhelozie, një vepër penale e kryer nga një zyrtar me një gradë të lartë policore i cili kishte ardhur me mision të ndihmonte një popull dhe një shtet që sapo kishte dalë nga lufta. Në këtë vendim përmendën rrethanat lehtësuese e ndër të cilat përmenden se i akuzuari “nuk ishte dënuar më parë”, se krimi ishte kryer në “një mjedis dhe mbrenda një kulture të çuditshme për të akuzuarin”, se vepra penale “nuk ishte e paramenduar por spontane”, se krimi është kryer “në një gjendje të vështirë mendore”, se i “akuzuari në njëfarë mënyre është ndëshkuar tashmë për shkak të dëmtimit të krahut të majtë”. Si rrethanë rënduese, përmendet vrasja e një vajze të re, motivet dhe veprimet e tija “në kundërshtim me detyrat e tij profesionale për të cilat ishte përgatitur dhe përzgjedhur”, se kishte “shpërdoruar pozitën e tij si shef i hetimeve” Sipas gjykatës, dënimi prej 13 vjetësh ishte i mjaftueshëm “për shlyerjen e “mëkatit”(…) duke patur parasysh rrethanat (...) për plagosjen e tij dhe ekzekutimin e dënimit në një vend të panjohur”. Një arsyetim i tillë në këtë vendim nuk ndikon as në bindjen e fajtorit as tek pala e dëmtuar dhe as tek opinioni i gjërë, sepse siç thotë autori Gashi “..nga arsyetimi i vendimit të dënimit duhet të bindet jo vetëm fajtori por edhe pala e dëmtuar dhe opinioni i gjërë”. (Gashi, 2003a, f:132)

Në tabelën e mëposhtme, shihen çështjet e përzgjedhura sipas viteve, nga të cilat shihet maksimumi i dënimit të aplikuar për vepra të caktuara penale nga trupi gjykues i gjyqtarëve vendorë dhe i atyre ndërkombëtarë (drejtësia hibride).

Lënda	Vrasje	Trupi gjykues Vendor	Trupi gjykues Hibrid	Dënimi unik	Dënimi për armëmbajtje
Pnr.106/2000	146		Hibrid	8 vjet	-
Pnr. 78/2000	30/1-19 LPJ	Vendor		Denim me kusht	-
Pnr. 46/2001	30/2		Hibrid	17+17 (dy kryes)	-
Pnr. 76/2001	30/2	Vendor		40+15 vjet	3 vjet
Pnr. 70/2002	30/1, 134/1		Hibrid	13 vjet	Pol.Egjiptian
Pnr.201/2002	30/1-19 LPJ	Vendor		1.6 + 1.3 vjet	6+5 muaj
Pnr. 77/2002	30/1	Vendor		8 vjet	-
Pnr. 32/2002	30/1	Vendor		12 vjet	-
Pnr. 79/2002	30/1-19 LPJ	Vendor		3.6 vjet	-
Pnr. 31/2002	30/2		Hibrid	16 vjet	-
Pnr.243/2002	30/2	Vendor		13.6 vjet	3 muaj
Pnr.247/2002	30/1 - 19 LPJ, 8.3 2001/7	Vendor		Lirohet nga aktakuza	1.6 vjet
Pnr.195/2002	30/1-19 LPJ, 8.3 2001/7	Vendor		Lirohet nga aktakuza	2 vjet
Pnr.384/2003	30/1	Vendor		10 vjet	5 muaj
Pnr. 55/2003	30/1, 8.3 2001/7	Vendor		4 vjet	4 muaj
Pnr. 7/2003	34 8.3 2001/7	Vendor		4.6 vjet	-
Pnr. 16/2004	30/1-19 LPJ	Vendor		4.8 vjet	-
Pnr. 22/2005	147/1-20 KPK	Vendor		2 vjet	6 muaj
Pnr. 04/2006	146/1-20	Vendor		Lirohet nga aktakuza	1665 euro
Pnr. 76/2006	30/1-19 LPJ, 328/2	Vendor		Lirohet nga aktakuza	3 muaj
Pnr. 38/2007	147/4	Vendor		Lirohet nga aktakuza	1.4 vjet
Pnr. 25/2008	147/ 328/2	Vendor		13 vjet	1 vjet
Pnr.268/2008	30/1		Hibrid	20+15 vjet	-
Pnr. 39/2008	146/	Vendor		13.6 vjet	1 vit
Pnr. 38/2008	148/ 328/2	Vendor		5+3 vjet	7 muaj
Pnr. 78/2008	30/2		Hibrid	33 vjet	-

Pnr. 58/2009	146/1-20	Vendor		4 vjet	-
Pnr. 61/2009	146/1-20	Vendor		1 vjet	500 euro
Pnr.145/2009	146/		Hibrid	10 vjet	-
Pnr. 8/2010	146/ 328/2	Vendor		19.6 vjet	1 vit
Pnr. 59/2011	146/20, 328/2		Hibrid	1 vjet e 4 muaj	-
Pnr.473/2011	147/3, 328/2	Vendor		27 +27+15 vjet	-
Pnr.328/2012	146/	Vendor		7.6 vjet	1 vit
Pnr. 68/2012	147/4		Hibrid	16 vjet	1 vjet
Pnr. 30/2012	154/1-2	Vendor		Me kusht - me gjobe	-

Tabela 12. Maksimumi i dënimit për vepra të caktuara penale të aplikuara nga trupi gjykues i gjyqtarëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë (2000-2012)

Edhe në rastin e dytë që i takon periudhës së parë të këtij studimi, vendimi i Gjykatës së Qarkut të Pejës lë për të dëshiruar. Me datën 21.11.1993, në një fshat të rrethit të Pejës kishte ndodhur një vrasje e rëndë brenda familjes, dhe pas kryerjes së këtij akti, autorët, gruaja dhe djali e kishin hedhur viktimën në Lumin Dri me qëllim të fshehjes së veprës penale të vrasjes. Duke patur parasysh situatën të cilën mbretëronte në atë kohë në Kosovë dhe shqetësimin që kjo vrasje kishte përhapur tek qytetarët, duke patur parasysh natyrën e krimit, motivin, mjetin e kryerjes dhe kohën kur ai është kryer (derisa ai ishte në gjumë), plotësoheshin të gjithë elementet e figurës së veprës penale që ky për këtë krim të jepej dënimi maksimal sipas nenit 30 paragrafi 2 pika 3 i LPK- së për vrasje mizore dhe e paskrupullt, por në fakt kjo vepër ishte cilësuar si vrasje në bashkëpunim sipas nenit 47 par 2 pika 1 LPS-së, duke e dënuar gruan me dënimin 8 vjet burgim dhe djalin e viktimës me dënimin 7 vjet burgim.

6.6.7. Tejzgjatja e procedurave gjyqësore

Sipas hulumtimit tonë ka rezultuar se procedurat gjyqësore janë shumë të gjata dhe se kjo praktikë, e para ka shkaktuar dilema dhe mosbesim në sistemin e drejtësisë sepse në fillim janë dhënë dënime me burgime aftagjata, ndërsa në rigjykim apo në procedura të tjera ankimimi, dënimet janë zbutur aq shumë sa që te familjet e viktimave janë krijuar pakënaqësi të mëdha dhe e dyta këto stërzgjatje të proceseve gjyqësore kanë ndikuar në shkeljen e të drejtës së autorit të veprës penale për një gjykim në afat të arsyeshëm. Gjatë hulumtimit tonë, kemi vërtetuar se gjatë periudhës 1989-1999, gjykata nuk kishte respektuar të drejtën për një gjykim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm ashtu siç e parashikon neni 6 i Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku thuhet

se çdo person ka të drejtë për një proces të rregullt gjyqësor i cili duhet të shqyrtohet “publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. (Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore Romë, neni 6). Edhe pse kjo konvente aplikohet edhe për Jugosllavinë si nënshkruese e kësaj Konvente, ajo ka rezultuar si njëri ndër shtetet e rralla që ka abuzuar shpesh me shkeljen e këtyre konventave që garantonin liritë dhe të drejtat e njeriut. Megjithatë, shikuar nga të dhënat që dalin nga ky studim, edhe në këtë drejtim, shteti si garantues i të drejtave dhe lirive të qytetarit të garantuara është abuzuesi më i madhë dhe i vetëm i shkeljes së të drejtave të njeriut. Ky abuzim me këtë të drejtë, i cili ka shkaktuar edhe mosbesim në institucionet e drejtësisë në Kosovë, edhe pas ardhjes së UNMIK-ut nuk ka ndryshuar.

Mosrespektimi i nenit 6-të të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut nga gjykatat në Kosovë (edhe pas vendosjes së administrimit të dhunshëm të Kosovës nga Serbia) ishte një praktikë e keqe. Mosrespektimi i kësaj konvente nuk kishte të bënte vetëm me çështjet penale por edhe me çështjet civile, administrative, etj., pothuajse për gjatë tërë periudhës që kemi në studim.




Figura 53. Diferenca kohore mes kohës kur kishte ndodhur krimi dhe kohës kur është caktuar vendimi përfundimtar 1989-1999

Gjatë analizimit të të dhënave për periudhën 1989-1999, kemi vërejtur se diferenca kohore në mes kryerjes së veprës penale dhe kohës së nxjerjes së vendimit ndryshon nga njëra çështje në tjetrën. Sipas të dhënave që posedojmë del se vepra kishte ndodhur shumë kohë para vitit 1989 dhe se vendimi përfundimtar (pas një procedure të gjatë

ankimore të përdorimit të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme) ishte nxjerur pas 16 vitesh. Në këtë kategori bënin pjesë 22% e totalit që përfshinin diferencën kohore mes 12 e deri në 16 vjet. Pjesa më e madhe e çështjeve të gjykuara në kohë, përfshijnë kohën prej 6 muaj deri në 1 vit ose 58% të totalit, 17% e totalit i takon diferencës kohore prej 2 deri në 6 vjet ndërsa 3% e totalit i takon diferencës kohore prej 7 deri në 11 vjet.




Figura 54. Diferenca kohore mes kohës kur kishte ndodhur krimi dhe kohës kur është shpallur vendimi përfundimtar 2000-2017

Edhe pas vendosjes së administratës së UNMIK-ut, kjo praktikë e “shkeljes së afateve të arsyeshme” në gjykatat e Kosovës kishte vazhduar, edhe pse në këto gjykata tani kishte edhe gjyqtarë ndërkombëtarë. Pra, po të shikojmë periudhën prej 2000-2017 në krahasim me atë paraprake kemi disa ndryshime të vogla siç mund t’i vërejmë edhe nga figura, kjo sepse deri në periudhën 1989-1999 diferenca më e largët kohore në përgjithësi ishte ajo prej 7 deri në 11 vjet ndërsa në periudhën 2000-2017 kjo diferencë shkon nga 12 vjet deri në 16 vjet. Nga figura mund të themi se pjesa më e madhe e çështjeve të gjykuara kanë 6 muaj deri në 1 vit diferencë kohore nga kyerja e veprës dhe dhënies së vendimit dhe kjo zë 59% të totalit, me 19% janë ato çështje me diferenca kohore të cilat arrijnë 2 vjet deri në 6 vjet, 18% e totalit janë ato të cilat kanë diferencë kohore deri në 5 muaj, 3% e totalit janë ato të cilat kanë diferencë kohore prej 7 deri në 11 vjet ndërsa me 1% janë ato çështje të cilat kanë 12 deri në 16 vjet diferencë kohore.

6.6.8. Instituti i faljes dhe kriminaliteti

Në kuadër të legjislacionit pozitiv të Kosovës, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin për Falje i cili në rastin e institutit të faljes ka përcaktuar procedurën që duhet ndjekur, veprat penale dhe autorët e këtyre veprave që përfitojnë faljen e dënimit, lirimin e plotë

apo të pjesshëm nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimin e tij me një dënim më të butë apo aplikimin e dënimit me kusht. Sipas këtij ligji, vlerësimi dhe selektimi i përfituesve të mundshëm është në kompetencë të panelit për lirim me kusht. Në zyrën e Presidentit për falje, dërgohen vetëm ata emra që janë përzgjedhur nga ky komision. (Ligji për falje i Kosovës, neni 112). Pavarsisht se kjo është e drejtë e Presidentit të Republikës që të shpallë “përfituesit” e kësaj të drejte, ligji i ka përcaktuar disa kufizime që duhet të shqyrtohen para se të nxirret vendimi për faljen. Ndër kriteret që duhet të plotësojë një i dënuar para se të bëjë aplikimin janë pesha e krimit, rreziku i përsëritjes së veprës penale, pendimi dhe sjelljet e tij gjatë vuajtjes së dënimit në institucionin e ekzekutimit të dënimit. Nga përfitimi i benefiteve që jep ligji për falje i Kosovës janë të përjashtuar autorët e veprave penale që kanë kryer veprat penale të përfshira në kapitullin XIV-të veprat penale kundër rendit kushtetues dhe të sigurisë së Republikës së Kosovës dhe të kapitullit XIV-të veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare. Megjithatë, përkundër zgjidhjeve që parashikon ky ligj, praktikisht aplikimi i tij ka sjellë dilema në opinionin publik. Këto dilema kanë qenë bazë për të krijuar dyshimin në punën e panelit i cili ishte formuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Fillimisht, dyshimet janë krijuar nga forma e procedimit e deri te personat e falur nga presidentët e Kosovës gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2012. Këto parregullsi janë krijuar për shumë arsye.

Së pari, përzgjedhja e të dënuarve ka qenë në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, së dyti, ka patur raste që personat që janë refuzuar nga paneli për lirim me kusht janë falur nga presidenti dhe

së treti, janë falur të dënuar për vepra penale që janë të përjashtuar nga kjo e drejtë me ligjin për faljen. Sipas dekretit të Presidentit të Republikës (Nr. i Dekretit DF-002-2009 i datës 17 shkurt 2009) në vitin 2010 janë falur nga presidenti i Kosovës, 62 të dënuar, disa prej të cilëve kanë kryer vepra të rënda penale dhe që ligjërisht kanë qenë të përjashtuar nga kjo e drejtë si psh. personat e dënuar për veprën penale të trafikimit. Përveç kësaj, në listën e të falurve kanë qenë 14 të dënuar për veprën penale të vrasjes dhe dy të dënuar për vrasje të cilësuar, një për dhunim, 5 në lidhje me veprat në fushën e lëndëve narkotike, 3 për krim të organizuar dhe një i dënuar për veprën penale trafikim i qenieve njerëzore. (Gashi & Musliu, 2012a).

Lidhur me këto falje dënimi, për disa autorë të veprave penale të rënda, kishte reaguar edhe Zyra e Brukselit të cilët këtë çështje e kanë përmendur edhe në raportin e progresit. “Pas dekretimit të ligjit për amnistinë, gjashtëdhjetë e dy të burgosur janë falur nga

Presidenti i Kosovës. Kjo ka përfshirë edhe disa dënime për krime serioze...” (Bashkimi Evropian, 2010:12).

Përkundër dyshimeve të arsyeshme në procedimin e faljeve në Kosovë, kjo procedurë ka vazhduar edhe në vijim nga ushtruesi i detyrës së Presidentit. Nga ushtruesi i detyrës së Presidentit të Kosovës, në vitin 2011 ishin falur 103 të dënuar. (Nr.i Dekretit DF 001-2011 i datës 14 shkurt 2011)

Në vitin 2012 ishin falur 15 persona të dënuar (Nr Dekretit DF-002-2012 i datës 16 shkurt 2012). Gjatë këtyre dy viteve, faljet e tilla nga presidentët janë përcjellë me dyshime nga shoqëria civile, nga familjarët e viktimave të vrara dhe nga opinionioni publik. Në vitin 2007 Policia e Kosovës kishte filluar hetimet kundër disa zyrtarëve, shtetas të huaj përfshirë edhe kryetarin e panelit për lirim me kusht i cili ishte njëkohësisht edhe zyrtar i lartë në departamentin e drejtësisë së UNMIK-ut. (Kosova Press, 2007). Ky zyrtar i lartë, në vitin 2009 ishte dënuar me 8 vjet burgim për disa akuza, mes të cilave edhe për veprën penale të marrjes së ryshfetit në shumën prej 80.000 euro për t’i liruar tre shtetas të huaj të cilët ishin duke vuajtur dënimin në Kosovë. (Gazeta Koha, 2009). Sipas të dhënave që janë shfaqur publikisht në mediat kombëtare në Kosovë, nga të falurit e 242 të burgosurve, 67% prej tyre kanë qenë të refuzuar nga paneli për lirim me kusht. (Gashi K. , 2012).

Rreth pakënaqësisë së veprimeve të tilla që janë shfaqur pas shpalljes së listës së përfituesve po sjellin një reagim publik të një qytetari nga Prishtina të cilit para disa vitesh, dy persona i kishin vrarë vëllain. Që të dy ishin dënuar me burgim afatgjatë, por, pas disa vitesh, njëri prej tyre ishte falur nga Presidenti, ndërsa i dyti një vit më pas ishte falur nga ushtruesi i detyrës së Presidentit. Pas marrjes së lajmit për lirimin e vrasësve nga burgju, qytetari që kishte humbur vëllain kishte deklaruar “Nëse qysh ja kanë nisë me falë, atëherë krejt të burgosurit që kanë bërë vrasje duhet me u falë, dhe njerëzit shkojnë gjithë tu kry vrasje” dhe kjo sipas tij do ndikoj në shtimin e tyre. Ndërsa një shtetas tjetër i cili kishte humbur vajzën nga dhëndrri vrasës, të cilin e kishte fal presidenti, ishte deklaruar: “Presidentët, nëse falin qësi njerëz, kemi me u mbushë krime sa të dush. Presidenti duhet me e shoshitë mirë kënd po e falë”. (Gashi K. , 2012a).

Në fund, nëse dikush duhet të mendojë për qetësinë dhe prosperitetin e këtij populli, është shteti, pushteti dhe liderët që kanë marr përgjegjësinë para popullit të ndikojnë në zvogëlimin e vrasjeve e jo t’i nxisin ato në forma indirekte duke përfshirë edhe këtë formë të faljes. Ne duhet të mësohemi të sillemi si popull dhe si elitë politike, por

gjithmonë duke patur parasysh edhe atë se kush mund të falet dhe amnistohet përndryshe, hakmarrja gjerësisht gjakmarrja do trokasë në derën e kosovarëve edhe në këtë shekull të ri.

Kapitulli VII: Vrasjet dhe hetimi i tyre sipas të drejtës pozitive në Kosovë

Derisa e drejta penale përfshin mbrojtjen e interesave individuale dhe publike të shoqërisë në përgjithësi duke përcaktuar se çfarë është e lejuar dhe çfarë jo dhe duke përcaktuar edhe sanksionet ndaj atyre që i shkelin këto rregulla, e drejta e procedurës penale përfshinë në vetvete tërë veprimtarinë operationale të subjekteve të ndryshme që marrin pjesë në procedurë me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm dhe individual sipas ligjit. Për të filluar procesi penal duhet të ekzistojë vepra penale. Sipas Kodit Penal të Kosovës, procedura penale fillon zyrtarisht (ex officio) dhe ndahet në tre fazadhe janë të ndëlidhura ngusht mes vete: faza e parë, procedura paraprake, faza e dytë, procedura penale dhe faza e tretë, procedura sipas mjetit juridik.

Në fazën paraprake përfshihen të gjitha veprimet e subjekteve që marrin pjesë në procedurë (prokurori i shtetit, policia dhe gjyqtari i procedurës paraprake) të cilët janë të ngarkuar me zbulimin, hetimin dhe kapjen e autorit të veprës penale në rastin tonë, në kapjen e autorit të veprës penale të vrasjes. Ndërsa procedura penale përfshinë tërë procesin që zhvillohet në gjykatë duke filluar që nga fazat përgatitore e deri te shpallja e vendimit.

Meqenëse ndjekja e veprave penale bëhet sipas detyrës zyrtare, procedura penale e ndjekur gjatë viteve është bazuar në ligjet dhe kodet të cilat janë zbatuar deri me sot të cilat kanë pësuar ndryshime rrënjësore. Sipas LPP të ish Jugosllavisë, (është aplikuar deri ne vitin 2004 në Kosovë) procedura penale fillonte vetëm me Aktvendim të gjyqtarit hetues për fillimin e hetimeve dhe zbatohet nga ai (neni 161 pika 1, dhe 3). Prokurorit Publik i mundësohet asistimi gjatë procedurës hetimore (neni 162 pika 2), ndërsa zbatimi i urdhërave të lëshuara nga ai i ekzekutonte organi i punëve të brendshme (neni 162 pika 3). Në bazë të autorizimeve të gjyqtarit hetues, hetuesit policor, mund të ndërmernin edhe veprime të tjera hetimore siç ishin këqyrja e vendit të ngjarjes (neni 238 I LPPJ), rikonstrukcioni i vendit të ngjarjes (neni 239) marrja e shenjave të gishtave (neni 162 pika 4 dhe 5) etj. Gjyqtari hetues kishte detyrimin të hetonte deri në detaje jo vetem veprën penale por edhe shkaqet dhe rrethanat që kanë sjellë deri tek kryerja e asaj vepre, të hetonte të kaluarën e të pandehurit, të kaluarën shëndetësore, të kaluarën e tij kriminale (neni 172 pika 1). Gjyqtari hetues kishte detyrim ligjor që ta njoftonte të pandehurin dhe mbrojtësin e tij me provat dhe deshmitë e mbledhura kundër tij dhe i lejonte të ofronte propozimet e tyre për administrimin e

provave të reja për llogari të tij duke i caktuar edhe afatin kohor deri kur duhej të jepej pergjigja (neni 173 pika 1).

Sipas këtij ligji, hetimi i kryer nga gjyqtari hetues përfundonte kur ai konsideronte se kishte prova të mjaftueshme me të cilat mund të ngritet akuza (neni 174 pika 1). Pas përfundimit të hetimeve shkresat e çështjes ia kalonte Prokurorit Publik i cili pas shqyrtimit kishte të drejtë që brenda 15 ditësh të propozonte zgjerimin e hetimeve ose të ngrinte akuzën (neni 261). Nëse ngritja e akuzës nuk bëhej brenda afatit prej 6 muajsh ai duhej t'i drejtohej gjyqtarit hetues me kërkesë duke e njoftuar për shkaqet e vonesës dhe kërkonte një afat shtesë. Nëse arsyet e shtyrjes se këtij afati nuk ishin të arsyeshme apo nëse ky afat kishte kaluar, gjyqtari hetues e njoftonte kryetarin e gjykatës për shkaqet e mospërfundimit dhe mosdërgimit të akuzës në gjykatë. Kryetari i gjykatës kishte të drejtë të aprovonte edhe një afat shtesë në të kundërtën procedura hetimore nuk mund të vazhdonte më tutje dhe hetimi konsiderohej i përfunduar (neni 175 pika 1 dhe 2).

Ky ligj është aplikuar deri në vitin 2004, i cili zëvendësohet me Kodin e Përkohëshëm të Procedurës Penale të Kosovës. (UNMIK/REG/2003/26). Sipas nenit Neni 46 (1) të këtij Kodi, Prokuroria Publike „...është organ i pavarur dhe përgjegjës për hetimin e veprave penale...”. Me këtë kod rriten kompetencat e Prokurorisë Publike, ndersa roli i gjyqtarit të procedurës paraprake (në vend të gjyqtarit hetues) është me i zbehtë.

Me Kodin e ri të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) hetimi i vepres penale është kompetencë eskluzive e prokurorit të shtetit.

Me qëllim të eliminimit të parregullsive dhe vendosjes së një rregulli formal juridik, procedura e fillimit të një hetimi penal është e rregulluar në nenin 104 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas këtij neni, procedura e hetimit fillon me vendim të prokurorit të shtetit i cili bazohet në kallzimin penal e referuar nga ana e policisë gjyqësore apo nga ndonjë agjenci tjetër qeveritare apo ndonjë person tjetër fizik. Në çështjet hetimore roli i policisë gjyqësore është i varur nga prokuroria e shtetit e cila ka të drejtë t'a autorizojë atë të kryejë veprime të caktuara por gjithmonë nën drejtimin dhe mbikqyrjen e saj (Latifi & Beka, 2013, fq.160). Policia, si çdo organ tjetër publik, qytetarët dhe nëpunësit publikë kanë detyrimin që të referojnë veprat penale në zyrën e prokurorit të shtetit në prokurorinë kompetente përmes kallzimit penal (KPPK, 2013, neni 78); (Latifi, 2011a,:45). Mbas pranimit të kallzimit penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë prova shtesë nga personi që depoziton kallzimin penal (Sahiti & Murati, 2013:308-309), dhe në momentin që ai bindet se ekzistojnë deshmi se është kryer një veper penale, ai nxjerr vendimin për fillimin e hetimeve, në të kundërtën, ai nuk e mer

në konsideratë atë. Me këtë kod, tani më nuk lejohet padia subsidiare, padia kjo që ju lejohej personave të dëmtuar për të cilët prokurori publik kishte hequr dorë nga ndjekja e mëtejshme penale kundër personave të dyshuar.

Prokurori i shtetit, thuhet në këtë kod, duhet të jetë i paanshëm dhe të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit (KPPK, 2013, neni 48) dhe se pozita e tij dhe e të pandehurit në procesin penal është e barabartë (KPPK, 2013, neni 9)

Në raste të caktura kur kërkohet një hetim shpejtë, prokurori i shtetit ka të drejtë të urdhërojë aplikimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit dhe më pas ta njoftojë gjyqtarin e procedurës paraprake.

7.1. Hetimi i veprës penale të vrasjes

Veprat penale kundër jetës dhe trupit kanë qenë dhe janë në fokus të studiuesve të ndryshëm sepse veprat penale nga ky kapitull e posaçërisht vepra penale e vrasjes konsiderohet njera ndër veprat më të rënda penale sepse këtu bëhet fjalë për humbjen e jetës njera ndër vlerat më themelore të njeriut. Shikuar nga aspekti penal, vrasja konsiderohet si njera ndër veprat më të rënda penale e cila është rezultat i marrjes së jetës nga tjetri në mënyrë të kundërligjshme pa mar parasysh se a kryhet me dashje apo nga pakujdesia. (Latifi, 2011b, f:224-226). Shikuar në aspektin kriminalistik, çdo humbje e jetës në rrethana të dyshimta është objekt hetimi i cili duhet të fillohet “ex officio”. Arsyeja se përse ligjvënësi e ka vendosur që një kategori e tillë e veprave të rënda të fillohet kryesisht ka për qëllim mbrojtjen e jetës dhe njëkohësisht konsiderohet edhe mbrojtje e interes publik. Vdekja si proces natyror shpesh herë shkakton paqartësi e cila duhet të sqarohet përmes shkencës së kriminalistikës. Vdekjet të cilat janë si rezultat i përdorimit të dhunës njerëzore përbëjnë vepër penale dhe duhet të hetohet. Janë me qindra e mijëra raste individuale të vdekjeve të dyshimta të cilat ndodhin në shtëpi, fushë, në rrugë, miniera, në kantiere ndërtimi, gjatë pushimeve të ndryshme dhe në vende të ndryshme të cilat juridikisht konsiderohen të dyshimta dhe për to kërkohet hetim penal. Edhe vetëvrasjet janë një kategori jo e vogël të cilat përfundojnë me vdekje e që jo rrallë kanë rezultuar si vdekje e kryer në mënyrë të dhunshme por që është raportuar si vetëvrasje. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar që për çdo vdekje të dyshimtë të fillojnë hetimet të cilat pas një ekspertimi të veçantë të vendit të ngjarjes dhe kufomës dhe pas një autopsie mjekoligjore mund të konstatohet zyrtarisht se a bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes, për vdekje natyrore apo vetëvrasje. (Latifi & Beka, 2013a, f:27-78).

Për fillimin e hetimit duhet të plotësohen tre elemente, elementi objektiv (të ekzistojë viktimë) elementi subjektiv (të ekzistojë autori) dhe me plotësimin e elementit subjektiv është konfirmuar edhe pasoja (është shkaktuar vdekja). Verifikimi i disa prej këtyre elementeve është mjaft i vështirë sepse shpesh herë vdekjet e dhunshme kamuflohen si vdekje natyrore ose vdekjet e dhunshme paraqiten si vetvrasje e kështu me radhë. Këto dhe çështje tjera, siç janë mënyra e kryerjes, mjetet e kryerjes, koha e kryerjes, motivet që kanë sjellë deri te vdekja e dhunshme janë çështje të rëndësishme të shqyrtimit kriminalistik të vrasjes. Është mjaft e rëndësishme që në aspektin teorik dhe praktik hetuesi të ketë njohuri të mjaftueshme lidhur me nocionin, llojet dhe mënyrat e kryerjes së vetvrasjeve më qëllim të eliminimit të kësaj kategorie që në momentet e para të shikimit të kufomës në vendin e ngjarjes. Pas kësaj është mjaft me rëndësi që të identifikohet viktimë e vrasjes, sepse shpesh herë ndodh që viktimë është e panjohur dhe kjo situatë vështirëson procesin e hetimit, vështirëson marrjen e masave adekuata dhe mund të krijojë vështirësi në drejtimin adekuat të procesit të hetimit. Megjithatë, në raste të tilla duhet të meren të gjitha masat rreth identifikimit të viktimës e cila bashkë me të dhënat e fituara nga vendi i ngjarjes dhe nga të dhënat e ekspertit mjekoligjor dhe me lejen e prokurorit të shtetit mund të identifikohet duke përdorur edhe ndihmën e publikut të cilët pas publikimit të informacionit për rastin konkret edhe mund t'i ofrojnë ndihmë organeve kompetente. Për identifikimin e viktimës duhet që në detaje që nga pozita e viktimës së vrasjes, koha e kryerjes së vrasjes, vendi i kryerjes së vrasjes, kontrolli i hapësirës ku është gjetur viktimë, sendet dhe mjetet që janë gjetur rreth saj, të bëhet kontrollimi i jashtëm i viktimës dhe të evidentohen gjurmët, veshja, ora e dorës, varsja, vathët nëse ka, unaza e fejesës ose unaza të tjera, të përshkruhen qartë gjurmët që mund të tregojnë ndonjë individualitet të viktimës (psh ndonjë gisht i prerë, ndonjë shenjë në fytyrë, hundë, nofull, etj. Të gjitha këto të dhëna të evidentohen me saktësi. Më vonë viktimë dërgohet në institutin e mjeksisë ligjore ku duhet të kryhet autopsia nga ekspertët mjeko-ligjor. Më këtë rast edhe një herë bëhet përshkrimi i trupit të viktimës, shenjat që mund ta ketë pasur në trup (tatuazhë) apo ndonjë shenjë të lindur (ngjyrë e zezë në lëkurë, fytyrë, dhëmbët etj). Ndërhyrjet kirurgjikale dhe dhëmbët janë të një rëndësie të veçantë sepse krahas listës së të zhdukurve që duhet konsultuar me qëllim identifikimi, ato japin një shans më shumë që të kërkohet në qendrat spitalore shtetërore apo private ku mund të jenë kryer ato ndërhyrje kirurgjikale dhe dentare. Pas identifikimit të viktimës pastaj duke u bazuar në teknikën dhe taktikën kriminalistike vazhdohet me zbardhjen e motiveve të vrasjes e cila më pas mund të sjellë edhe

identifikimin e autorit të vrasjes. Edhe në rastin kur viktimë e vrasjes është e njohur për policinë, duhet vazhduar me procedurën për përpunim kriminalistik të faktit se a kemi të bëjmë me vrasje, vetvrasje, fatkeqësi natyrore apo vdekje të natyrshme. Duke u mbështetur në teorinë dhe praktikën kriminalistike duhet që vendit të ngjarjes dhe kufomës së viktimës së vrasjes t'i kushtohet një vëmendje e posaçme gjatë tërë kohës së zgjatë kqyrja e vendit të ngjarjes. Në vendin e ngjarjes mund të jetë “çelësi” i cili zgjidh çështjen e vrasjes. Në vendngjarje duhet të ketë mikrogjurma të ndryshme për të cilat edhe autori më profesional nuk mund t'i eliminojë dhe shkatrojë. Aty mund të gjenden persona kurrështarë, por edhe persona që mund të japin të dhëna të mjaftueshme me të cilat mund të identifikohet autori i vrasjes. Nga personat e pranishëm në vendin e ngjarjes mund të merren të dhëna mbi motivin e kryerjes së vrasjes siç mund të jenë motivi i urrejtjes, problemet me pronat, servituti, problemet familjare, hakmarrja, xhelozia, fyerja, fshehja e ndonjë veprë tjetër penale, të dhëna mbi dhunën në familje, divorci, personat me probleme mendore, tradhtitë bashkëshortore, etj.

Pra, shikuar në aspektin kriminalistik, vrasja duhet trajtuar në mënyrë të veçantë dhe në këtë kuadër duhet trajtuar edhe vendi i ngjarjes aplikimi i një vargu masash teknike, taktike dhe metodike kriminalistike me qëllim që të identifikohet autori i veprës penale të vrasjes. Shikuar nga ky aspekt, aplikimi i një vargu masash dhe veprimesh që parashikon teoria dhe praktika kriminalistike dhe aplikimi i tyre me profesioanlizëm dhe korrektësi ligjore mund të çojë në rezultatin e pritur-identifikimin dhe kapjen e autorit të veprës penale të vrasjes. Meqenëse trajtimi i vrasjes është mjaft i ndërlikuar është e domosdoshme të identifikohen disa çështje parimore me rëndësi procedurale dhe kriminalistike siç janë: mënyra e kryerjes së veprës penale të vrasjes, koha e kryerjes së vrasjes, vendi i kryerjes, dinamika e vrasjeve, motivi i kryerjes, karakteristikat e viktimës së veprës penale, konkluzionet nga raporti mjeko-ligjor për shkaqet e vdekjes, gjurmët e gjakut dhe gjurmët e tjera, mjete të kryerjes së vrasjes, deklaratat e ndryshme që lidhen me kryerjen e vrasjes dhe të dhëna të tjera që duhet të sigurohen nga shërbime të tjera inteligjente, përgjimi, fotografimi, inçizimet e ndryshme audiovizuale etj. Konfigurimi praktik dhe teorik i të dhënave të mësipërme mundëson zgjidhjen e çështjes konkrete e cila përfundon me kapjen e autorit të veprës penale të vrasjes dhe dërgimin e tij në qendrën e paraburgimit.

Meqenëse marrja e jetës nga tjetri konsiderohet një akt i rëndë penal sepse me një veprim a mosveprim të autorit shuhet një jetë në mënyrë të kundërligjshme, hetimi dhe procedura hetimore është mjaft e ndërlikuar. Te vrasjet kemi pothuajse dy momente të

ndryshme të cilat varen nga rrethana të caktuara në bazë të së cilës duhet aplikuar teknika, taktika dhe metodika kriminalistike. Në rastin kur kemi të bëjmë me autorë të njohur fillimi i çështjes penale nis me një kallëzim penal të paraqitur nga qytetarët, institucionet e ndryshme shtetërore dhe policia gjyqësore. Në kallëzimin e parashtuar penal paraqiten të dhëna të përgjithshme mbi bazën e të cilave janë krijuar dyshimet se një person i caktuar ka kryer veprën penale. Përmes kallëzimit penal, prokurori i shtetit merr njohuritë e nevojshme mbi veprën e kryer të vrasjes. Dyshimi se një person ka kryer veprën penale të vrasjes duhet të mbështetet në dëshmi të pakontestuar nga vendi i ngjarjes, siç është edhe mjeti me të cilin është kryer vrasja, rrobat që janë gjetur në vendngjarje, plagët e shkaktuara, numrin e plagëve, skica nga vendi i ndodhjes së krimit, fotografite, dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët si dhe duhet të mbështetet nga deklarata e autorit i cili sipas Kodit të Procedurës Penale duhet të japi dëshminë në prezencën e mbrojtësit e tij. Edhe në rastin e tillë kur çështja konsiderohet e zgjidhur në aspektin hetimor, në aspektin procedural ai duhet patjetër t'i nënshtrohet rregullave të Kodit të Procedurës Penale sipas së cilës çdo vdekje e dyshimtë duhet t'i nënshtrohet ekspertizës mjeko-ligjore sepse vetëm ata janë të thirrur të japin mendimin e tyre profesional për shkaqet e vdekjes.

Në rastin kur kemi të bëjmë me autorë të panjohur, atëherë çështja e hetimit bëhet më komplekse, e ndjeshme (për shkak të presionit të opinionit publik i cili kërkon zbardhjen e vrasjes) dhe si rezultat i kësaj situatë, hetuesit duhet të kërkojnë ndihmën e teknikës dhe teknologjisë, pa lënë anash edhe burime të tjera. Pavarësisht se a kemi të bëjmë me vrasje me autor të njohur apo të panjohur, policia gjyqësore bashkë me prokurorin e shtetit janë të detyruar të rmarin një sërë masash operative të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e provave materiale.

7.1.2. Sigurimi i provave materiale

Me kryerjen e veprës penale të vrasjes çënohet jeta e njeriut por cenohet edhe rendi juridik i një vendi dhe për këtë ndaj autorit duhet të meren masa për identifikimin dhe arrestimin e tij. Që të kryhet ky proces procedural duhet që kundër një personi të ekzistojë dyshimi i bazuar se ka kryer një veprë penale konkretisht se ka kryer një vrasje. Dhe ky dyshim duhet të bazohet në prova materiale për të cilat, prokuroria mund të vendosë masën e arrestit dhe gjykata mund të vendosë më pas masën e paraburgimit. (Sahiti, 1993,:15-19). Provat mbi të cilat bazohet gjykata duhet të jenë të besueshme dhe të mbledhura sipas kërkesës së Kodit të Procedurës Penale të lejuara nga prokuroria

e shtetit dhe me urdhër të gjyqtarit të procedurës parapenale.

Procedura e marrjes së masave për mbledhjen e provave dhe dëshmive materiale kalon nëpër dy faza kohore.

- faza e parë përfshinë masat për administrimin dhe sigurimin e provave që nga njoftimi se ka ndodhur vepra penale e vrasjes e deri sa policia gjyqësore të lirojë vendin e ngjarjes dhe
- faza e dytë përfshinë masat për administrimin dhe sigurimin e provave materiale përmes urdhërit të gjykatës kompetente.

Administrimi i provave materiale nga policia gjyqësore e cila duhet t'i sigurojë gjatë kohës kur është kryer vrasja e deri sa ajo të lirojë vendin e ngjarjes janë: kqyerja e vendit të ngjarjes, arrestimi i të dyshuarit, kontrolli i banesës, shtëpisë dhe lokaleve të tjera ku mendohet se mund të gjënden prova apo mund të gjëndet i dyshuari, marrja në pyetje e dëshmitarëve, marrja në pyetje e të dyshuarit, sekuestrimi i sendeve përkohësisht, ekzaminimi fizik i të dyshuarit.

Administrimi i provave materiale më rëndësi për procedimin e metejshëm penal dhe sigurimi i tyre përmes urdhërit të gjykatës të cilat i dorëzohen prokurorit të shtetit qoftë me kallëzimin penal qoftë përmes plotësimit të kallëzimit penal (neni 81 par 1 dhe 3 i KPK). Provat të cilat policia gjyqësore i siguron përmes urdhërit të gjykatës janë: masat e fsheta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, ekspertimi, (autopsia, ekspertimi balistik, ekspertimi toksikologjik, ekspertimi psikologjik) ekzaminimi molekular dhe gjenetik, analizat kompjuterike, analizat financiare dhe rindërtimi i vendit të ngjarjes.

7.1.3 Marrja e provave materiale nga policia gjyqësore

Që nga momenti kur merren informacionet e para se ka ndodhur një veper penale e deri sa të ngritet akuza nga ana e prokurorit të shtetit kundër autorit të krimit, policia gjyqësore është në kërkim të dëshmive materiale të cilat janë shumë të rëndësishme në procedurën penale. Në kërkim të dëshmive të ndryshme dhe grumbullimin e provave materiale, policia gjyqësore është e detyruar gjatë tërë procesit hetimor dhe se provat e tilla t'ia dorëzojë sa më shpejtë prokurorit të çështjes. Provat dhe dëshmitë materiale të cilat policia gjyqësore i administron janë ato prova që gjënden në vendin e ngjarjes, rreth vendit të ngjarjes të cilat duhet t'i nënshtrohen një procedure të veçantë ligjore të marrjes dhe të siguruarit e provës në mënyrë të drejtëpërdrejtë të cilat i kemi listuar më poshtë.

7.1.4. Kqyrja e vendit të ngjarjes me rastin e vepres penale të vrasjes

Në rastet kur policia njohtohet se ka ndodhur një vrasje ata duhet sa më shpejt që të jetë e mundur të shkojnë në atë vend dhe të bëjnë rrethimin e vendit të ngjarjes me shiritat e policisë dhe askush nuk duhet të lejohet të hyjë brenda derisa të vijë policia gjyqësore. Pas sigurimit fizik të vendit të ngjarjes, ata duhet të marrin informatat shtesë për atë që ka ndodhur, të bëjnë ndalimin e autorit të vrasjes, dëshmitarëve, largimin nga vendi i ngjarjes së personave të cilët nuk kanë nevojë të jenë në vendngjarje si dhe largimin e mediave, të njohtojnë prokurorin e shtetit, policinë gjyqësore dhe autoambulancën. (Ademaj, 2003, :79-94).

Policia gjyqësore dhe ekipi i teknikës kriminalistike duhet që në fillim të mos krijojnë huti sepse në çdo rast të tillë bëhet fjalë për një vrasjeje të dyshimtë. Pas verifikimit të të dhënave nga vendi i ngjarjes që dalin nga vet kqyrja e kufomës, pozicionit të saj, plagët e shkaktuara duke patur parasysh gjithmonë numrin e plagëve dhe mundësinë se a ka patur mundësi që autori t'i shkaktojë ato plagë vetes apo jo dhe mund të konstatohet se a kemi të bëjë me vetvrasje apo me një vrasje. Psh. rasti paraqitet si vetvrasje, ndërsa plagët gjenden në pjesën e majtë të trupit të tij ndërsa ai është mengjarash. Ose e kundërta. Pra, fillimisht duhet të vertetohet se a kemi të bëjë me vetvrasje apo me një vrasje apo vetvrasje të kamufluar. Plaga e shkaktuar dhe numri i plagëve shpesh herë japin përgjigjen se a bëhet fjalë për vrasje apo vetvrasje. Psh nëse kemi një kufomë e cila gjendet në dhomë dhe nga shikimi i vendit të ngjarjes ka dalë se kemi edhe një armë afër saj dhe se në trupin e saj është një plagë e shkaktuar në kokë apo në zonën e zemrës atëherë duhet menduar se kjo është një vetvrasje edhe pse fjalën e fundit duhet ta japë gjithësesi eksperti mjeko-ligjor pas autopsisë. Megjithatë, pozita e kufomës, plaga e shkaktuar, forma e plagës në formë ylli e cila krijohet nga qitja me armë prej afërsisë të cilën autori Latifi e quan “qitja me puthitje” jep të kuptohet se kemi të bëjmë me vetvrasje. (Latifi & Beka, 2013b,:74). Autori Latifi në librin e tij duk u bazuar në disa karakteristika të pozitës së personit të vrasë, plagëve të shkaktuara në trupin e tij, vendin se ku është gjetur mjeti më të cilin janë shkaktuar plagët, numrin e plagëve të shkaktuara në pjesë të ndryshme të trupit ka bërë një ndarje duke dhënë karakteristikat e vrasjeve dhe vetvrasjeve. Sipas tij, tek vrasjet qitjet bëhen në distance të ndryshme, plagët shkaktohen nga mbrapa dhe mbi rroba, ka disa plagë të shkaktuara në trup, plaga e shkaktuar gjendet jashtë zones ku personi mund të arrijë me dorën e tij dhe plagët janë nga drejtime të ndryshme. Ndërsa karakteristikat e viktimave të vetvrasjes sipas tij janë: arma gjendet afër viktimës, dëmtimet janë në ballë, tëmth, zemër ose në gojë, gjurmët e

saj gjëndën në armën e përdorur. Vendi ku qëllohet zakonisht është i zhveshur, qitjet bëhen nga ana e majtë për ata që punojnë me dorën e djathtë dhe në të djathtë për ata që punojnë me dorën e majtë, se në të shumtën e rasteve ka një plagë të vetme në një pozicion ku mund t'a arrijë dora e tij.

Pra, këqyrja e vendit të ngjarjes ka një rëndësi të madhe në aspektin jo vetëm procedural por edhe në aspektin faktik sepse aty mund të vijmë deri tek mbledhja e dëshmive të rëndësishme. Meqenëse vendi i ngjarjes është burimi i dëshmive, ai ka një peshë të jashtëzakonshme në procedurën penale dhe për këtë duhet vepruar shpejtë, me kujdes e me gjakftohtësi profesionale. Është më rëndësi që këqyrja e vendit të ngjarjes të kryhet sipas kushteve të parashikuara sipas Kodit të Procedurës Penale sepse, procesverbali i cili shkruhet në këtë rast është një dëshmi e cila mund të prodhojë efekte të ndryshme pozitive dhe negative gjatë tërë rrjedhës së mëvonshme të procedurës penale të rastit konkret. Gjatë shikimit të vendit të ngjarjes duhet të shënohen të gjitha dëshmitë që janë gjetur në vendngjarje duke i përshkruar me numra nga numri një e deri në numrin e fundit të dëshmisë, të kryhen matjet e caktuara dhe ekzakte të secilës dëshmi se ku janë gjetur, të përshkruhet pozita dhe gjendja e kufomës, temperatura e trupit të viktimës, a është lëvizur kufoma nga vendi i ngjarjes, armët të cilat janë përdorur, gjurmët e tjera të cilat janë gjetur në vend ngjarje siç janë: arma, gëzhoja, flokët, pështyma, gjurmët e gjakut, pështymës, sekrecione të ndryshme, sperma, qime të ndryshme, rroba, pulla, ushqime të mbetura, shishe të pijeve të ndryshme, vjellje, dokumente, gazeta e mjete të tjera. Me fjalë të tjera, çdo objekt që gjëndet në vendin e ngjarjes është një thesar më vete i cili duhet shqyrtuar me gjakftohtësi sepse janë dëshmi “memece” të cilat flasin për një ngjarje që ka ndodhur. Secila prej këtyre gjerave të cilat gjënden në vendngjarje duhet shënuar në procesverbal i cili duhet të shkruhet në vendin e ngjarjes dhe të nënshkruhet nga personat zyrtarë dhe prokurori i shtetit. Ky procesverbal i vendit të ngjarjes duhet të jetë një „fotografi me ngjyra” sepse të dhënat që përshkruhen në këtë procesverbal nuk i mundësojnë asnjërës palë që të kontestojë një të vërtetë që ka rezultuar nga vendi i ngjarjes apo të kontestojë dëshmitë materiale të cilat mund të ndikojnë në rrjedhën e procesit penal. Të dhënat nga vendi i ngjarjes kanë edhe një rëndësi tjetër procedurale sepse ato përputhen ose duhet të përputhen me të dhënat e raportuara nga teknika kriminalistike e cila gjithashtu duhet të krijojë një dosje me fotografi dhe pak fjalë rreth asaj që gjëndet në vendin e ngjarjes.

Meqenëse vendi i ngjarjes mund të jetë i ndryshëm, kryerja e veprës penale mund të ketë nisur në një vend dhe të jetë përfundur në një vend tjetër dhe vendi ku është

shkaktuar vdekja e personit atëherë duhet që të gjitha këto vende të konsiderohen vende të ngjarjes dhe të gjitha dëshmitë relevante nga të gjitha këto vende të evdientohen në procesverbal. Kjo të bëhet me qëllim që hetuesit dhe prokuroria më vonë të bëjnë klasifikimin e të dhënave dhe të nxjerrin konkluzionet për dyshimet se kush mund të jetë autori, motivin e vrasjes dhe përcaktimin e vendndodhjes së tij. Gjurmët të cilat gjënden në vendin e ngjarjes duhet të merren me profesionalizëm dhe të vendosen për ruajtje sipas kërkesave të teknikës dhe metodikës kriminalistike në qese letrë. Kjo duhet të bëhet për arsye që të mos dëmtohen dhe si të tilla të dërgohen për ekspertizë laboratorike. Lidhur me marrjen dhe aplikimin e metodës dhe teknikës kriminalistike po japin një shembull të vrasjes e cila ka ndodhur në qershor të vitit 1999 në Pejë. Në mesin e dytë të muajit qershor të vitit 1999, tre persona, dy meshkuj dhe një femër kontaktojnë me një taksist pejan dhe kërkojnë nga ai që t'i dërgojë me automjetin e tij deri në një fshat të një komune tjetër rreth 50 km larg Pejës. Taksisti pranon t'a kryejë këtë shërbim dhe me tu afruar afër fshatit në fjalë, dy meshkujt, duke mos patur para që t'a paguajnë, ndalojnë taksistin e nxjerrin nga vetura dhe e vrasin ndërsa veturën ia marrin. Kjo vrasje raportohet në polici dhe policia del në vend ngjarje dhe bënë kqyrjen e vendit të ngjarjes dhe të kufomës. Në vendngjarje policia gjenë edhe disa gëzhoja të armës me të cilën ishte kryer vrasja. Gëzhajat merren nga ekspertët kriminalistë dhe dërgohen për ekzaminim balistik. Vjen raporti nga dhe ky raport i bashkangjitet dosjes sepse hetimet kishin mbetur në udhëkryq. Në vitin 2009, në stacionin policor të një qytezë tjetër paraqitet një rast i dhunës në familje. Policia reagon menjëherë duke e arrestuar të dyshuarin dhe gjatë kontrollit të shtëpisë së tyre familjare gjejnë një armë të cilën e konfiskojnë. Pas konfiskimit, arma dërgohet për ekzaminim balistik dhe rezultati i ekzaminimit tregon se ajo armë ishte përdorur në rastin e vrasjes së taksistit 10 vjet më parë. Pas rihapjes së hetimit të vrasjes së taksistit pejan, dhe duke u bazuar në rezultatin balistik zbulohen tre autorët e vrasjes të cilët ishin dy vëllëzër dhe e ish e fejuara e njërit prej tyre. Për rrjedhojë pas 10 vitesh, zbardhet vrasja dhe personat e përfshirë në kryerjen e kësaj veprë penale marrin dënimet e merituar.

7.1.5. Arrestimi i autorit dhe kontrolli i trupit të tij dhe personave tjerë të përfshirë në vrasje

Arrestimi i autorit, bashkëautorit, ndihmësit, shtytësit të veprës penale të vrasjes është një akt procedural i cili gjithashtu duhet të kryhet sipas procedurës penale duke ua bërë me dije arsyen e arrestimit dhe të drejtat që ua njeh Kodi i Procedurës Penale në këtë rast. Pas arrestimit të autorit dhe personave të tjerë (nëse ka) duhet doemos që të bëhet

kontrollimi i përkohshëm për siguri (neni 75 i KPPK). Në fakt kontrolli i të dyshuarit është veprim procedural dhe i domosdoshëm sepse në momente të tilla, në trupin e tyre mund të gjenden gjurmë dhe dëshmi (armë, drogë, gjak, pështymë, fije floku, fije tekstili, lëkurë e cila mund të mbetet mes thonjëve e cila tregon se para aktit të vrasjes mund të ketë patur edhe kacafytje), për të cilat është vështirë të sigurohen më vonë për vet faktin se autori në ato momente tronditëse gjithnjë kërkon ujë, kërkon të dërgohet në banjë etj. më qëllim që të lirohet nga gjurmët eventuale duke i pastruar duart dhe fytyrën. Sipas nenit 76 të KPP të Kosovës, në raste të jashtëzakonshme, policia me ndihmën e një mjeku apo infermieri mund të marrë mostra nga trupi i të dyshuarit dhe personave të tjerë të përfshirë në kryerjen e veprës penale dhe për këtë më pas të informohet prokurori i shtetit. Edhe marrja e gjakut dhe dëshmime të tjera është e lejuar dhe mund të merret nga ana e personave kompetentë me kusht që mos të demtohet shëndeti i tyre. Marrja e gjurmëve nuk mund të merret me detyrim nga i dyshuari dhe personat e tjerë të përfshirë në kryerjen e veprës penale të vrasjes. Në rast të kundërshtimit të një veprimi të tillë atëherë duhet që marrja e mostrave të behet me urdhër të gjykatës (neni 76 pika 5 e KPPK).

7.1.6. Kontrolli i banesës e cila kryhet për shkak të veprës penale të vrasjes

Pas marrjes së informacionit për për veprën penale të vrasjes duhet që sa më shpejt që të jetë e mundur të realizohet mbledhja e dëshmime materiale dhe sendeve që janë me interes për rastin konkret. Mendohet me të drejtë se dëshmitë dhe sendet materiale të cilat janë më rëndësi për procesin penal gjenden në shtëpi, banesën apo lokalin tjetër të të dyshuarit. Kontrolli i shtëpisë dhe objekteve të tjera në pronësi apo në posedim (mund të jetë objekt i dhënë me qira) të të dyshuarit bëhet për dy shkaqe: e para që të arrestohet i dyshuari nëse gjendet në shtëpi, banesë apo lokalin e tij dhe e dyta, që në mënyrë efikase të sigurohen dëshmi, prova dhe sende të cilat mund të gjenden tek ai e të cilat janë me rëndësi për veprën penale të kryer, në rastin konkret të vrasjes. Kontrolli i shtëpisë, banesës dhe objekteve është një veprim procedural dhe hetimor i cili parashikohet nga neni 36 dhe neni 105 -118 i KPPK-së dhe kryhet me urdhër të gjykatës e cila e lëshon me kërkesë të prokurorisë së shtetit dhe policisë gjyqësore dhe duhet të zbatohet sipas kushteve të parashikuara të Kodit të Procedurës Penale.

Procesi i marrjes së dëshmime bëhet në vendin e ngjarjes sepse mendohet se në ato vende mendohet se mund të gjenden dëshmi të cilat lidhen me krimin. Në shumicën e rasteve të vrasjes autori nuk gjendet në vendin e ngjarjes por dyshohet se mund të jetë në banesë dhe për këtë kërkohet të kontrollohet banesa e cila duhet të realizohet me

vendim të gjykatës. Kontrolli i banesës gjithashtu duhet të bëhet me qëllim që të gjënden fakte, dëshmi të cilat lidhen me veprën e kryer të vrasjes siç janë shkresa të ndryshme, fotografi, rroba me gjurmë gjaku, mjete me të cilin është kryervepra.

Ky veprim procedural kryhet nga policia gjyqësore gjatë së cilës duhet të respektohet Kodi i Procedurës Penale, sipas së cilit kërkohet prania e dy dëshmitarëve, prania e avokatit mbrojtës të cilët kanë detyrimin të vëzhgojnë zbatimin e procesit të kontrollit të banesës. Pronari i banesës ka detyrimin që të dorëzojë personin e kërkuar, të dorëzojë çdo send të kundërligjshëm të cilin mund ta ketë në shtëpi a banesë, të hapi çdo kuti a objekt të mbyllur me qëllim që të realizohet kontrolli përndryshe policia gjyqësore ka të drejtë ta hapi me dhunë. Kontrolli mund të shtyhet nëse pala kërkon prezencën e avokatit deri sa të vijë ai. Kontrolli i banesës mund të bëhet edhe pa vendim të gjykatës kur mendohet se autori mund t'i kundërvihet policisë me armë, kur mendohet se i dyshuari mund të shkatërrojë gjurmët dhe dëshmitë, etj. Gjatë të gjithë procesit të kontrollit të banesës apo shtëpisë, dëshmitarët duhet të jenë të pranishëm gjatë realizimit të kontrollit nga policia. Pas përfundimit të kontrollit nga ana e policisë të dyshuarit i jepet procesverbali në të cilin duhet të shkruhet të gjitha veprimet e policisë, gjërat që janë gjetur, objektet dhe dëshmitë që janë gjetur, emrat e personave që janë proceduar, nëse janë kapur autorët që kërkohen duhet të shkruhen edhe emrat e tyre e kështu me radhë. Në rast se janë gjetur prova që lidhen me rastin e vrasjes, siç janë arma, gjurmë gjaku, rroba, prova të tjera të shkruara, ato duhet të konfiskohen përkohësisht dhe për to lëshohet një vërtetim për konfiskim të përkohshëm që i jepet pronarit të banesës.

Kontrolli duhet të kryhet nga ora 6 e mëngjesit dhe mund të kryhet deri në orën 10 të darkës por pas kësaj kohe sipas Kodit të Procedurës Penale mund të vazhdohet nëse ai është nisur dhe mund të vazhdohet edhe pas orës 10. Kontrolli mund të bëhet edhe pa vendimin e gjykatës sidomos kur kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes në kushtet të cilat janë të parashikuara sipas Kodit të Procedurës Penale siç janë kontrolli me pëlqimin e autorit të veprës penale, me kërkesën e pronarit të shtëpisë i cili thërret policinë në ndihmë, kur mendohet se autori mund të dëmtojë a sulmojë dike nga brënda shtëpisë, kur mendohet se autori i veprës penale është brënda shtëpisë, kur ka të dhëna se brënda shtëpisë gjëndet personi i dënuar me vendim të gjykatës i cili ka ikur nga vendi i vuajtjes së dënimit. Procedura e ndjekur në këtë rast duhet të përshkruhet qartë dhe me një raport të detajuar duhet të njoftohet prokuroria e shtetit në afatin sa më të shpejtë të mundshëm por jo më vonë se 24 orë pas kontrollit.

7.1.7. Deklaratat e dëshmitarëve dhe dëshmitë e tjera të marrura nga vendi i ngjarjes

Në vendin e ngjarjes, hetuesit dhe policia mund të gjejnë persona të ndryshëm të cilët kanë njohuri lidhur me ngjarjen e zhvilluar apo kanë dëgjuar për atë që ka ndodhur. Marrja e dëshmimeve nga dëshmitarët që kanë parë ngjarjen është e një rëndësie primare dhe se ajo duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur sepse zgjatja e marrjes së dëshmimeve nga dëshmitarë të tillë vështirësohet nëse kalon një kohë e caktuar sepse ata mund të jenë të ndikuar nga rrethana të ndryshme më vonë. Ka raste ku dëshmitarë të caktuar japin të dhëna të çmueshme lidhur me vendndodhjen e autorit, për motivin e vrasjes etj. por nga shkaqe të caktuara (frika nga hakmarrja) nuk duan të deklarojnë publikisht. Personat e tillë duhen intervistuar dhe duhet krijuar besimi se ata nuk do dekonspirohen sepse në fakt, informacioni i tij i cili çon në kapjen e autorit nuk ka nevojë të dëshmohet në gjykatë dhe për këtë, deklarata e tij nuk duhet të jetë pjesë e dosjes së çështjes. Meqenëse vrasjet janë njëra ndër veprat më të rënda penale dhe më të kopmlikuara, edhe marrja e provave dhe dëshmimeve kërkon një seriozitet, profesionalizëm dhe korrektësi sepse disa dëshmi janë më të rëndësishme e disa të tjera kanë më pak rëndësi por të gjitha formojnë një bazë provuese dhe kanë një rëndësi të veçantë për procedurën penale. Në këtë rast duhet t'i kushtohet kujdes mbledhjes së dëshmimeve hap pas hapi duke filluar nga momenti i parë i marrjes së informacionit se ka ndodhur një vepër penale e vrasjes, dosja e shikimit të vendit të ngjarjes, deklaratat e dëshmitarëve që janë gjetur në vendin e ngjarjes, raporti nga teknika kriminalistike, raporti mjekoligjor, raportet e ndryshme të ekspertëve, deklaramet e dëshmitarëve të privilegjuar nëse duan të deklarojnë, skicat, fotografitë, letrat, email-et elektronike e dëshmi të tjera të cilat duhet t'i bashkangjiten dosjes së çështjes e cila me kallëzimin penal duhet të dorëzohet tek prokurori i shtetit për veprim të metejshmëm procedural.

7.1.8. Deklarimi i të dyshuarit në çështjen penale e cila zhvillohet për veprën penale të vrasjes

Sipas nenit 19 të KPP të Kosovës, autori i një veprë penale për të cilin policia dhe prokuroria kanë dyshime njihet me termin “i dyshuar”, ndërsa për ata kundër të cilëve ka filluar procedura hetimore njihen me termin “i pandehur”. Pra, sipas Kodit të Procedurës, i pandehuri është subjekt i procedurës penale i cili duhet të jetë më shumë se 14 vjeç. (Sahiti, 1999:217-232).

Përveç kushtit të moshës, sipas të drejtës penale materiale, gjëndja shëndetësore dhe shpirtërore e të dyshuarit në momentin e kryerjes së veprës penale të vrasjes dhe gjatë

zhvillimit të procedurës duhet të jetë e mirë. Nëse gjendja e të dyshuarit në kohën e kryerjes së veprës penale dhe pas fillimit të procedurës penale, nuk është e mirë, gjykata duhet zyrtarisht ta vërtetojë gjëndjen e tij shëndetësore dhe shpirtërore.

Nëse gjendja e tij shëndetësore lejon vazhdimin e procedurës penale, atëherë ai i nënshtrohet procedimit penal të marrjes në pyetje nga policia e cila duhet t'ia respektojë të gjitha të drejtat që janë të parashikuara në nenin 10 dhe 151 paragrafi 3 i KPP të Kosovës siç janë: e drejta që të njihet me veprën penale me të cilën akuzohet, të drejtën që të kërkojë prova për mbrojtjen e tij, të drejtën për të heshtur përveç asaj se duhet të japë të dhëna për identitetin e tij, për të drejtën e pasjes së përkthyesit dhe për të drejtën për të pasur ndihmën e një mbrojtësi me shpenzimet e mbuluara nga shteti nëse nuk ka të ardhura të mjaftueshme. Gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit duhen patur parasysh vetem ato fakte dhe dëshmi që janë me interes për zbardhjen e veprës penale të vrasjes dhe nuk duhet lejuar “manovrimi deklarativ” i tij përmes së cilit ai mundohet t'a mohojë aktin e vrasjes. Në procesin penal të udhëhequr nga policia gjyqësore, autori i veprës penale mund t'a pranojë ose mos t'a pranojë veprën e kryer të vrasjes, dhe kjo varet nga intensiteti dhe profesionalizmi i hetuesit të çështjes i cili duhet me korrektësi dhe me saktësi të nxjerri para tij provat bindëse të cilat provojnë fajësinë e tij. Pranimin e autorësisë së vrasjes, në shumicën e rasteve e pranojnë ata që e kanë kryer atë në mënyrë të rastësishme ose nga gjakmarrja (vrasja e kryer për shkak të gjakmarrjes tradicionalisht dihej në mënyrë publike dhe duhej pranuar publikisht), ndërsa për raste të tjera të vrasjes, shumica e autorëve e kundërshtojnë, nuk e pranojnë autorësinë. Mos pranimi i veprës ia veshtirëson punën organit të ndjekjes penale. Sipas Kodit Penal, i dyshuari ka të drejtë të japë dëshmi të cilat shkojnë në favor të tij, të japë alibi përmes së cilës mohon të jetë ai autor i krimit duke dëshmuar se në kohën dhe vendin ku është kryer krimi ai nuk ka qenë prezent, duke e dëshmuar me dëshmitar apo edhe në ndonjë mënyrë tjetër (përmes kamerave të cilat janë të vendosura gjithandej nëpër objekte, restorane, shtëpi, shtëpi pushimi) se ai ka qenë diku tjetër. Ose pranimi i autorësisë së vrasjes (pranimi i vrasjes nga frika ose përdorimi i dhunës fizike nga policia gjyqësore) që në fakt, më pas del se kryes është dikush tjetër.

Në rastet kur i dyshuari nuk pranon autorësinë, atëherë përmes teknikës, taktikës dhe metodikës kriminalistike duhet të argumentohet autorësia. Së pari duhet të ballafaqohet me deklaratimet e dëshmitarëve okularë dhe dëshmitarëve që kanë dëgjuar nga të tjerët që kanë qenë të pranishëm dhe ballafaqimet mes tyre. Më tej duhet të rrëzohet alibia e tij, të kërkohet raporti i autopsisë, balistikës, analizat toksikologjike, ekzaminimet e

lëngjeve trupore, ekzaminimet molekulare, analizat psikologjike, analizat financiare dhe aplikimi i masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, përdorimi i poligrafit e gjërave të ngjashme. Nga të dhënat që dalin nga raportet e ndryshme dhe nga institucione të ndryshme mund të gjëndet edhe motivi i vrasjes. Në vitin 2013 në një qytet të Kosovës ka ndodhur një vrasje e një mashkulli 40 vjeçar, kufoma e të cilit ishte fshehur në pyll dhe autorët e kësaj vrasjeje nuk dihehin. Pas disa ditësh një bari gjeti një kufomë dhe për këtë rast njoftohet policia. Për çudi tek i ndjeri kishte mbetur telefoni i cili për shkak se ishte shkarkuar bateria nuk funksiononte. Megjithatë, duke iu falenderuar teknikës dhe teknologjisë bashkohore, përmes numrit identifikues të telefonit mobil GSM “International Mobile Equipment Identity-IMEI” policia ka arritur t’u identifikojë përdoruesin e telefonit i cili kishte komunikuar për here të fundit. Përdoruesi dhe pronari i këtij telefoni ishte një femër e cila pas identifikimit dhe prezentimit të hartogarfisë së thirrjeve ka pranuar se ishte autore e vrasjes bashkë me shoqen e saj.

7.1.9. Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve

Gjatë kontrollit të banesës, të veturës apo kontrollit të të dyshuarit, policia mund të gjejë sende, mjete, dokumente apo dëshmi të tjera të cilat duhet t’i konfiskojë në cilësinë e provës. Objekt i sekuestrimit mund të jenë armët, dokumentet, sende të ndryshme që lidhen me krimin e kryer apo sende të cilat janë të ndaluara për disponim të lirë nga qytetarët (psh. droga). Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve është parashikuar në nenin 112 të KPPK-së, por në nenin 113 janë listuar edhe sende të cilat nuk lejohen të konfiskohen siç janë komunikimet me shkrim mes të dyshuarit dhe dëshmitarëve të privilegjuar, shënimet mes mbrojtësit dhe të dyshuarit, komunikimet midis të dyshuarit dhe të mjekut, punonjësit social ose komunikimet mes tij dhe përfaqësuesit të fesë. Në rastet kur kërkohet sekuestrimi i përkohshëm i sendeve, sipas nenit 112 paragrafi 2, së pari ato sende sipas urdhërit të prokurorit të shtetit mund t’i nënshtrohen kufizimit të përkohshëm i cili nuk mund të jetë me i gjatë se pesë ditë. Me kërkesën e tij, gjyqtari i procedurës paraprake mund të lëshojë urdhër për konfiskimin e përkohshëm të sendeve. Në fakt, sipas Kodit të Procedurës Penale, konfiskimit të përkohshëm të sendeve i nënshtrohen vetëm ato sende të cilat konsidrohen prova materiale në rastin konkret ndër të cilat janë armë të ndryshme me të cilat është kryer vepra penale e vrasjes, mjete të cilat janë gjetur gjurmë të veprës penale të vrasjes (sopata, sende të tjera , hu, shkop, rroba të gjakosura etj), paratë, dokumentet e ndryshme, prona, pasuria e vjedhur etj. Gjatë zhvillimit të procedurës penale i pandehuri mund të kërkojë veçimin apo vlerësimin e këtyre provave nga gjyqtari i

vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues para ngritjes së akuzës. Ky vlerësim i nënshtrohet procedurës së vlerësimit edhe para se vendimi të marrë formën e prerë. Nëse konstatohet se ka shkelje të procedurës gjatë marrjes së provave gjatë zbatimit të masave të fshehta atëherë gjykata nxjerr vendimin, me të cilin i shpallë të gjitha provat të papranueshme dhe tërë provat e tilla me procesverbal ia dërgon Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit të cilët përmes kryetarit të gjykatës themelore nxjerrin një vendim mbi kompensimin e palës. Kodi i Procedurës Penale në nenin 97 pika 4 e detyron gjykatën të vlerësojë dhe të shqyrtojë pranueshmërinë e provave gjatë tërë procesit gjyqësor në llogari të të pandehurit.

7.1.10. Dokumentet si provë të cilat lidhen me veprën penale të vrasjes

Pas kryerjes së vrasjes, pa marr parasysh a është kapur autori apo jo, është e domosdoshme kërkimi i provave materiale të cilat mund të sigurohen gjatë kontrollit të banesës, shtëpisë a lokaleve që janë në pronësi të të dyshuarit. Ndër provat që duhen kërkuar, bëjnë pjesë edhe dokumente të ndryshme që në një mënyrë a tjetër lidhen apo japin shpjegime rreth raportit të të dyshuarit me krimin e kryer të vrasjes. Dokumente si provë në procesin penal konsiderohen shkresa të ndryshme të shkruara me dorë, raporte financiare, çertifikata të ndryshme (të lindjes, vdekjes, familjare, të pronësisë, pasqyra të ndryshme financiare, bankare, fotografi të ndryshme, pasaporta, letërnjoftime, leje drejtimi, vendime të ndryshme noteriale, (akt trashëgimie), letra të dërguara përmes postës, letra elektronike dërguar përmes adresës elektronike, polica e sigurimit, kontrata e mbajtjes jetësore etj. Konfiskimi i këtyre dokumenteve ka një rëndësi të madhe në procedurën provuese gjyqësore dhe se konfiskimi i tyre kërkon një respektim strikt të procedurës ligjore sepse konsiderohen prova të cilat mund të përdoren si dëshmi materiale. Rëndësia e këtyre provave është jashtëzakonisht e madhe sepse përmes tyre mund të nxiren përfundime mbi motivin e vrasjes, e që mund të jenë vrasje për interes, vrasje nga xhelozia, vrasje për motive të dobta, vrasje e porositur (e paguar nga krimi i organizuar), vrasje që lidhet me ndonjë veprë tjetër penale ose vrasje për të fshehur gjurmët e ndonjë krimi (veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, shfrytëzim prostitucioni, trafikimi i lëndëve narkotike, trafikimi i armëve etj).

7.2. Masat për marrjen dhe sigurimin e provave përmes urdhërimit të gjykatës

7.2.1. Ekspertimi dhe llojet e ekspertimit për veprën penale të vrasjes

Gjatë procedurës parapenale dhe penale të hetimit të veprës penale të vrasjes dhe veprave të tjera penale kundër jetës dhe shëndetit, policia gjyqësore mbledhë dëshmi

dhe fakte të ndryshme për të cilat kërkohet njohuri e veçantë nga shkenca natyrore dhe teknike. (Ademaj, 2003a,:72).

Për këtë qëllim, gjykata kërkon që për dëshmi të caktuara të kërkojë mendimin e ekspertit të fushës dhe me këtë të vërtetoj një gjendje faktike. Mendimi profesional i ekspertit mjeko-ligjor i cili kryen autopsinë, ekspertit toksikologjik, ekspertit të balistikës, ekspertit të psikologjisë, ekspertit i cili kryen ekspertimet molekulare dhe gjenetike me analizat e AND-së, ekspertin për analiza kompjuterike dhe finaciare. Ekspertimi urdhërohet nga gjykata në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, mbrojtësit apo sipas detyrës zyrtare (neni 136, 137 dhe 139 par 1 KPPK) në rastet kur mendimi i tyre është i nevojshëm për vërtetimin e fakteve të caktuara për të cilat kërkohen njohuri profesionale. (Sahiti & Murati, 2013a, f:276-277). Mendimi i ekspertëve ndihmon gjykatën të nxjeri dhe të mbeshtesë mendimin e saj lidhur me shkaqet e vdekjes, mënyrën e vdekjes, plagët vdekjeprurëse, kohëzgjatja e aktit të vrasjes, mjetin me të cilin është kryer vepra penale, plagët vdekjeprurëse që kanë ndikuar në shuarjen e jetës së viktimës etj. ose gjykata kërkon ndihmën e ekspertit i cili ka njohuri për analiza toksikologjike dhe për rastin e caktuar të vrasjes i cili duhet të dëshmojë në gjykatë për efektin e një helmi të caktuar, mënyrën se si ka ardhur deri të helmimi, mënyrën e përdorimit të tij dhe ndikimi i tij në organizmin e njeriut. Gjukata në raste të caktura kërkon nga ekspertët raportin zyrtar përmes së cilit vërtetohet mënyra e kryerjes së veprës penale. Pra, gjykata duke u bazuar në dijen profesionale të ekspertëve të ndryshëm siç janë ekspertët mjekoligjore, ekspertët e balistikës, daktiloskopisë, ekspertët financiarë. Ekspertët mjekoligjorë ndihmojnë gjykatën në mënyrë profesionale duke përshkruar rastin e vrasjes, lëndimeve të ndryshme të rënda trupore, dhunimin dhe sëmundjet shpirtërore.

7.2.2. Kqyerja e kufomës dhe Autopsia

Pasi që nga mjeku në vendngjarje apo në spital (nese viktimja është dërguar në spital por rrugës ka vdekur apo në momentin kur ai ka mbërritur në spital) konstatohet vdekja e dyshimtë e një personi duhet patjetër të kërkohet autopsia me qëllim që të verifikohen shkaqet e vdekjes së dyshimtë. Ka raste kur personi i vdekur si pasojë e dhunës “vdekje e dyshimtë” edhe varroset. (Latifi, 2011c,:217-221). Në raste të tilla ligji parashikon zhvarrosjen e kufomës dhe dërgimin e tij në institutin e mjekësisë ligjore ku duhet të kryhet autopsia. Para se të kërkohet autopsia duhet të paraqiten të dhënat e sakta rreth identitetit të tij. Në rast se nuk kemi të dhëna të identitetit të tij, duhet të shënohen të

gjitha shenjat që ekzistojnë në trupin e tij, gjymtyrët e tij (psh gishti ose gishtat, dora apo këmba e këputur) dhëmbët dhe ndonjë shënjë karakteristike e tij dhe me të dhëna të tilla të evidentuara, kufoma dërgohet në institutin e mjeksësisë ligjore për identifikim. Identifikimi kërkohet nga ekspertë të cilët përmes metodës së AND-ës bëjnë identifikimin e kufomës ndërsa përmes autospsisë nxjerrin shkaqet e vdekjes, në veçanti shkaku e drejtpërdrejtë të vdekjes dhe kohën e vdekjes. Ekspertët janë të detyruar që mendimin e tyre t’ia dorëzojnë me shkrim gjykatës kompetente.

Konstatimi i ekspertit duhet të jetë i qartë, preciz dhe i padiskutueshëm. Në gjurmët e konstatuara në trupin e viktimës, eksperti mjekoligjor duhet të përshkruajë saktë plagët dhe mjetet me të cilat është kryer krimi, lloji i mjetit, largësia nga e cila është goditur dhe plaga vdekjeprurëse. Ai ka detyrimin që të paraqesë edhe dëmtimet trupore përmes të cilave mund të shpjegohet marrëdhënia e viktimës dhe autorit të vepres penale para se ai të vdesë. Gërvishjet, dëmtit trupore, goditjet e ndryshme tregojnë këtë raport jo vetëm mes autorit dhe viktimës por edhe midis autorit, viktimës dhe pjesëmarrësve të tjerë në kryerjen e vepres penale të vrasjes ose dëmtimeve të rënda trupore. Eksperti mjekoligjor dhe ekspertë të tjerë kanë detyrimin ligjor që të identifikojnë dhe evidentojnë çdo përbërës biologjik, kimik apo tjetër që është gjetur në trupin e viktimës me qëllim që të identifikohet se a bëhet fjalë për vetëvrasje apo për vrasje, apo pas vrasësit fshihet edhe dikush tjetër. Një rast i tillë kishte ndodhur në Kosovë ku një femër ishte argëtuar me të dashurin në shtëpinë e saj dhe mbas argëtimit, në orët e natës i dashuri largohet nga shtëpia. Ndërkohë hyn një grabitës në shtëpi e dhunon vajzën, dhe më pas e vret dhe largohet nga vendi i ngjarjes. Nga kqyrja e vendit të ngjarjes janë gjetur dy lloje të qimeve të trupit në shtratin e saj. Njëra ishte qime e zezë dhe tjetra ishte qime e kuqe. Pas hetimeve është konstatuar se i dashuri i saj kishte qime të zeza në trup ndërsa qimja e kuqe ishte e dikujt tjetër. Pas hetimeve disa muajshe, dhunuesi përmes krahasimit të qimeve të trupit në një rast tjetër të dhunimit ishte identifikuar dhe me pas kishte pranuar vrasjen.

Ekspertiza mjeko ligjore ka një rëndësi të jashtëzakonshme dhe tek identifikimi i vrasjes së foshnjëve gjatë lindjes e cila shpesh herë kryhet nga vajzat dhe gratë të cilat kanë marrëdhënie seksuale me persona të caktuar apo lindja e femijës konsiderohet si e palejuar nga motive tradicionale (vajzat e pamartuara, gra të veja). Përmes ekspertizës mjekoligjore mund të konstatohet koha e kryerjes së vrasjes, sepse në disa legjislacione penale, koha prej 24 orësh është koha e cila mund ta bëjë klasifikimin në vrasje të klasifikuar.

7.2.3. Ekspertimi psikologjik

Në praktikë ndodh që autorë të veprës penale të jenë persona të mitur dhe persona të rritur. Por në aspektin penal juridik është me rëndësi të dihet se në momentin e kryerjes së veprës penale të vrasjes, autori ka qenë i aftë mendërisht. Ky element shkakton papërgjegjësi penale sepse personat e kësaj kategorie vuajnë nga sëmundje të ndryshme mendore dhe nuk janë të vetëdijshëm për pasojat e veprimit të kryer. Për ta vërtetuar këtë fakt, gjykata, gjatë procesit penal kërkon bërjen e ekspertimit me të cilin duhet të vërtetohet shkalla e aftësisë mendore. Në varësi të mendimit të ekspertit, autori i tillë duhet të izolohet nga mjedisi shoqëror dhe duhet të dërgohet në institucione të veçanta ku i nënshtrohet një kontrolli dhe mbikyrjeje institucionale mjeksore për një kohë të caktuar e cila caktohet nga ana e gjykatës. Pas përfundimit të këtij afati, ekspertët e fushës japin mendimin e tyre profesional në bazë të të cilit gjykata mund të vendosë për dënimin e tij me burgim apo vazhdimin e tij deri në shërim të detyrueshëm psikiatrik.

7.2.4. Ekspertimi toksikologjik

Në rast se dyshohet se vdekja e një personi është si pasojë e përdorimit të helmeve të ndryshme, gjykata urdhëron ekspertimin toksikologjik i cili kryhet në institutin për hulumtime toksikologjike. Pas analizimit të mostrave, eksperti njofton gjykatën për rezultatin e hulumtimit duke e përcaktuar llojin e helmit që është përdorur kundër viktimës, sasinë e përdorur dhe efektin e helmit.

7.2.5 Ekspertimi balistik

Mbasi në shumicën e rasteve vrasjet kryhen me armë të ndryshme zjarri (revole, pushkë gjyëtie, pushkë të ndryshme ushtarake, armë artizanale etj) kërkohet ekspertimi balistik me qëllim identifikimin e armës së zjarrit, gëzhgojave dhe predhave të qitura dhe të gjetura në vendin ku është kryer vepra penale e vrasjes. (Latifi & Beka, 2013c, f:67-78). Ky ekspertim kërkohet për vet faktin se të gjitha armët kanë karakteristikat e tyre individuale duke përfshirë viaskat, qendrën goditëse, distancën goditëse (logaritur në metra largësi), gjilperën, tytën, gëzhjojën, kapsollën, mbeturinat e barutit etj. Fishekët që përbëhen nga gëzhhojat, predha dhe baruti kanë karakteristika të veçanta secila prej tyre duke filluar nga kalibri, forma e gëzhjës deri te shifrat e shënuara në fund të gëzhgojave, numrat, emrat dhe shifra të fabrikave që i prodhojnë ato, viti i prodhimit, emri i fabrikës, etj. Armet e gjahut nuk kanë vijaska sepse fishekët që përdoren në këto armë janë në forma sferike të ndryshme dhe të barabarta. Përmes këtyre karakteristikave që kanë secila nga armet, ekspertiza balistike në bazë të krahasimit me qitje eksperimentale

arrin të identifikojë armën konkrete me të cilën është kryer vrasja.

7.2.6. Ekzaminimet molekulare dhe gjenetike

Me qëllim të identifikimit dhe kapjes së autorit të vrasjes, policia gjyqësore që në fillim të procedurës hetimore, ndërmerr të gjitha masat që të mari sa më shumë dëshmi nga vendi i ngjarjes me qëllim që përmes rezultateve shkencore të shkojë deri tek zbardhja e vrasjeve. Gjurmët biologjike të cilat gjenden në vendin e ngjarjes përmes një procedure të urdhëruar nga gjykata mund t'i nënshtrohen ekzaminimeve molekulare dhe gjenetike me qëllim të përcaktimit të prejardhjes së atyre. Është me rëndësi të dihen se gjurmët biologjike të cilat gjenden në vendin e ngjarjes janë të personit të autorit të vrasjes apo viktimës. Krahasimi i tyre bëhet duke marrë mostrat nga i pandehuri dhe identifikimi i tyre realizohet përmes ekzaminimit molekular të AND-së. Ekzaminimi i tillë duhet të bëhet me qëllim që të eliminohen dilemat rreth identitetit të autorit të veprës penale të vrasjes.

7.2.7. Analizat kompjuterike

Zbulimet teknike teknologjike kanë shënuar një rritje epokale të cilat kanë ndryshuar dhe kanë ndikuar në zhvillimin e gjithëashëm njerëzor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Mirëpo zhvillimet e tilla kanë ndikuar edhe negativisht në rritjen e kriminalitetit duke përfshirë edhe veprat penale të vrasjeve të cilat janë si produkt i krimit të organizuar dhe grupeve kriminale. Në aspektin penal juridik, ndërhyrja në sistemet kompjuterike është vepër penale e parashikuar në Kodin Penal, por në kontekstin më të gjërë të luftës kundër krimit kibernetik, Kosova ka një ligj të veçantë i cili rregullon këtë fushë në mënyrë specifike. Duhet pranuar se teknologjia kompjuterike ka shënuar progres të madh sa që aplikimi dhe përdorimi i saj është jetësor në marrëdhëniet e ndryshme mes njerëzve (komunikimi mes tyre përmes sms-it, email-it, përmes rrjeteve të ndryshme sociale, facebook-ut, chat-it, viber-it, twitter-it etj) ekonomike (mbajtja e librave kontabël, faturave të ndryshme etj), financiare (pasqyrat bankare, marrëveshje të ndryshme financiare) dhe shoqërore (mbajtja e regjistrave të gjendjes civile të shtetasve, të dhënat e tjera me interes të përgjithshëm etj). Në aspektin e kërkimit të dëshmive që lidhen me krimin e kryer të vrasjes janë më rëndësi komunikimet midis viktimës dhe personave të tjerë përmes dërgimit të sms-ve, letrave përmes email-it, komunikimet në rrjetet sociale dhe ndryshimi i të dhënave të identitetit dhe futja e këtyre të dhënave në regjistrin qendror të shtetasve. Zhvillimi i shpejtë dhe komunikimi i njerëzve në rrjetet e ndryshme sociale të cilat kanë selitë jashtë vendit ka

krijuar vështirësi praktike dhe procedurale. Derisa për komunikimet përmes operatorëve ekonomikë të telekomunikacioneve që selitë i kanë në vendin tonë janë krijuar kushtet për nxjerrjen e të dhënave relevante që janë me rëndësi për çështjet penale, kurse operatorët ekonomike të cilët kanë selitë jashtë vendit (rrjete të ndryshme sociale) kërkojnë një komunikim më të ndërlikuar dhe bashkëpunim ndërkombëtar i cili sjell edhe vonesa të ndryshme procedurale me ndikim të drejtpërdrejtë në procesin penal. Siç e trajtuam më lartë, ndërhyrjet e ndryshme në sistemet kompjuterike janë të sanksionuara në Kodin Penal, por përveç kësaj, në Kosovë ekziston një ligj i veçantë ku përfshihen procedurat, menaxhimi dhe sanksionimi i veprimeve të personave të paautorizuar në sistemet kompjuterike. Sipas nenit 14 të këtij ligji, “Futja e informatave, ndryshimi ose shlyerja pa autorizim e të dhënave kompjuterike ose kufizimi pa autorizim i qasjes në të dhëna të tilla, që rezultojnë në të dhëna joautentike” konsiderohet vepër penale e dënueshme me burgim gjashtë (6) muaj deri tre (3) vjet. (Ligji për parandalimin e krimit kibernetik, 2010). Në rast se gjatë procedurës hetimore të vrasjes ka indicie se rrjetet sociale apo përmes adresës elektronike i janë dërguar kërcënime të ndryshme viktimës, atëherë me urdhëresë të gjykatës duhet kërkuar nga institucionet përkatëse laboratorike nxjerrjen e atyre të dhënave sepse ato janë prova materiale të cilat tregojnë raportet victimë-autor para se të ndodhi vepra penale e vrasjes. Kriminelë të ndryshëm janë të përfshirë në shkeljet të tilla ligjore, po përmendim një rast i cili ka ndodhur në Rajonin e Pejës. Një shtetas boshnjak nga qyteti i Tuzlës (BiH) kishte vrarë një bashkëqytetar të tij dhe ishte larguar nga vendi. Ai pas disa ditësh kishte ardhur në Kosovë ku ishte vendosur tek të afërmit e tij. Pas disa ditësh qëndrimi, i vetëdijshëm për krimin e kryer, dhe me qëllim të fshehjes dhe ikjen nga përgjegjësia penale e vrasjes, kishte vendosur t’u ndërronte identitetin e tij në mënyrë të kundërligjshme. Ai, përmes një zyrtari të regjistrimit civil kishte arritur të regjistrohej në regjistrin civil të shtetasve të Kosovës me emër dhe mbiemër tjetër. Me krijimin e identitetit të ri, ai kishte jetuar i lirë dhe kishte lëvizur lirisht edhe jashtë vendit. Identitetifikimi i tij është bërë përmes rrugës operative të komunikimit ndërkombëtar, por para se të kapej nga policia, ai ishte larguar nga Kosova, tani me dy identitete: kosovare dhe boshnjake.

7.2.8. Analizat financiare

Edhe pse analizat financiare në shikim të parë kanë të bëjnë më tepër me veprat penale kundër ekonomisë, ekspertimi i saj si një proces i ndërlikuar ka një rëndësi të madhe edhe për nxjerrjen e shkaqeve dhe motiveve të vrasjes dhe veprave të tjera kundër jetës

dhe shëndetit. Si çdo masë tjetër edhe ekspertiza financiare kërkohet nga ana e prokurorit të shtetit dhe zbatohet me urdhër të lëshuar nga ana e gjykatës. Ekspertiza financiare Kjo masë ekspertimi nuk kërkohet vetëm kur kemi të bëjmë me veprën penale të shmangies së tatimit, pastrimit të parave apo veprat e tjera që lidhen me terrorizmin, por mund të kërkohen edhe në rastet kur pala ka kryer veprën penale për përfitim material dmth. mund ta ketë kryer vrasjen për përfitim material (Salihu, Zhitija, & Hasani, 2014, f:402-403). Kjo kërkesë lidhet me faktin se në vendin tonë janë kryer disa vrasje për interes, vrasje për borxhe të ndryshme dhe për dhënie të parasë me fajde. Raporti i nxjerë nga analizat financiare tregon motivin e kryerjes së vepres penale të vrasjes. Verifikimi këtij fakti ndikon edhe në cilësimin juridik të vrasjes nga ajo e rëndomtë në vrasje të kualifikuar apo cilësuar.

7.2.9. Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit për veprën penale të vrasjes

Masat e fshehta teknike të hetimit nga aspekti procedural janë masa të cilat duhet të zbatohen nga ana e policisë me qëllim luftimin e kriminalitetit, krimit të organizuar dhe veprave të tjera të rënda penale.

Sipas nenit 91 të Kodit të Procedurës Penale, janë të listuara një numër i madh i veprave që kryhet ekspertim financiar i çertifikuar dhe që janë të regjistruar pranë gjykatës kompetente.

Për zbulimin e vrasjeve kërkohet zbatimi i masave të fshehta të hetimit e për të cilat masa, duhet të ushtrohet kërkesë me shkrim nga ana e prokurorit të shtetit dhe të lejohet me urdhëresë të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente. Procedurat e përcaktuara në këtë kod e të cilat i referohen masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe të hetimit janë mjaftë strikte dhe ato i nënshtrohen procedurës gjyqësore për vlefshmërinë e tyre.

Në kuadër të masave të fshehta hetimore, ligjvënësi ka parashikuar një mori masash të fshehta teknike të vëzhgimit të cilat mund të përdoren gjatë hetimit të rastit konkret. (KPPK, 2013, neni 91 pika 1) Këto masa mund të aplikohen në vendet publike dhe private siç janë: fotografimi i fshehtë ose vëzhgimi me video në vende publike dhe private; monitorimi i bisedave në vende publike dhe private; regjistrimi i bisedave telefonike; kontrollimi i dërgesave postare; përgjimi i telekomunikimeve, përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike dhe ato përmes rrjetit kompjuterik, shfrytëzimi i mjeteve teknike për të zbuluar vendndodhjen e autorit, blerje të simuluar të një sendi shitja e të cilit i nënshtrohet një procedure të veçantë (psh shitblerja e armës) e deri te zbulimi i të dhënave financiare. Kontrollimi i të dhënave financiare ka një

rendësi të veçantë sepse edhe në vendin tonë vrasjet për çështje biznesi, borxhesh të ndryshme financiare janë evidente.

Për zbatimin e masave të fshehta të hetimit parimisht autorizohet policia gjyqësore nga ana e prokurorit të shtetit dhe duhet të lejohet me urdhëresë të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente dhe duhet të kryhen mbrenda afatit të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale (KPPK, 2013, neni 91). Në urdhërin e zbatimit të masave të fshehta duhet të shkruhet emri i zyrtarit të policisë gjyqësore që duhet t'a zbatojë atë urdhër. Zbatimi i masave të fshehta mund të urdhërohet edhe ndaj të dyshuarit të panjohur përmes përgjimit të telefonit. Në rastin e tillë është e mjaftueshme të dihet se një numër telefoni që dyshohet, po përdoret në kryerjen e një veprë penale edhe pse nuk dihet se kush është poseduesi i tij (KPPK, 2013, neni 84 pika 1 dhe 2). Përmes zbatimit të masave të tilla, hetuesit gjyqësorë arrijnë të identifikojnë autorin e veprës penale, vendndodhjen e tij ose vendndodhjen se ku ka qenë (sipas hartografisë së thirrjeve), raportet mes tij dhe viktimës, ndihmësve, shtytësve, bashkëpunëtorëve dhe personave të tjerë të përfshirë në krimin e vrasjes (psh. drejtuesi i një taksie), telekomunikimet e realizuara mes tij dhe viktimës, mesazhet e shkruara, fotografitë, komunikimin e drejtëpërdrejtë të zhvilluar mes tij dhe viktimës apo personave të tjerë të përfshirë.

Në aspektin procedural janë paraqitur dilema nëse gjatë aplikimit të masave të fshehta kemi ardhur në dijeni edhe të ndonjë krimi tjetër ndërsa urdheresa për përgjim është lëshuar vetëm për hetimin e veprës penale të vrasjes. Në këtë rast ligjvënësi ka lënë një hapsirë juridike sepse është e vështirë të pranohet si dëshmi një fakt i tillë sepse konsiderohet se kjo informatë është marë pa qenë i autorizuar nga gjykata. Mendojmë se në raste të tilla duhet rinisur një kërkesë e re për urdhëresë ose nëse çështja është urgjente të kërkohet lejimi nga ana e prokurorit të shtetit i cili më pas brënda afatit ligjor do parashtrojë kërkesë tek gjyqtari i procedurës parapenale.

7.2.10. Rindërtimi i vendit të ngjarjes për veprën penale të vrasjes

Rindërtimi i vendit të ngjarjes është një shikim i jashtëzakonshëm i vendit të ngjarjes i cili fillohet me kërkesën e palës më qëllim të vertetimit të disa të fakteve kontestuese me urdhër të prokurorit të shtetit, dhe kryhet nga ana e policisë gjyqësore. Me kusht që procesi të jetë i pranueshëm duhet të njoftohet i dyshuari, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Kur i pandehuri nuk dihet, rindërtimi i vendit të ngjarjes udhëhiqet nga prokurori i shtetit por i tërë procesi vëzhgohet nga gjyqtari i procedurës penale. Duhet theksuar se

në këtë proces procedural mund të marrë pjesë edhe eksperti. Rindërtimi i vendit të ngjarjes bëhet në raste kur disa gjëra nuk përputhen apo janë të pashpjegueshme në mënyrë të mjaftueshme gjatë procedurës penale të gjyqimit. Pavarësisht asaj se kërkohet vetëm një detaj, rindërtimi i vendit të ngjarjes është “një film që luhet nga fillimi deri në fund” nga i pandehuri, dëshmitarët dhe “luhet” në prezencën e organeve kompetente. Por që të kryhet rindërtimi i vendit të ngjarjes duhet patjetër që organet që marrin pjesë në këtë procedurë e cila pothuajse duhet të fillohet që nga fillimi, të kenë kujdes në organizimin dhe përfundimin e tij pa rrezikuar jetët e palëve që marrin pjesë në proces. Pra, vet rindërtimi i vendit të ngjarjes na jep të kuptojmë se diçka nuk ka shkuar mirë gjatë shikimit të vendit të ngjarjes apo janë krijuar dilema që duhen sqaruar në rindërtimin e vendit të ngjarjes që mund të lidhen me vendin e kryerjes, pozitën e viktimës, armët e përdorura, vendndodhjen e dëshmitarit etj. Riorganizimi i procedurës së rindërtimit të vendit të ngjarjes duhet të bëhet në kushte të njejta ose të përafërta me kohën kur rasti kishte ndodhur vërtetë. Psh nëse ngjara ka ndodhur në orët e para të muzgut, duhet të organizohet rindërtimi i vendit të ngjarjes në atë kohë me qëllim të verifikimit të të dhënave të paraqitura nga dëshmitarët okularë. Ky fakt duhet verifikuar duke e dëshmuar se vërtetë nga vendi ku supozohet se kishte qenë dëshmitari mund të identifikohet autori i veprës penale të vrasjes. Në këtë rast, hetuesi duhet të ketë parasysh edhe faktin se dëshmitari në fjalë ka patur mundësi që prej një distance të caktuar ta shohë dhe ta njohë apo të përshkruajë saktë në dëshminë e tij atë që ka parë apo ta percjellë atë që ka dëgjuar nga dikush tjetër. Ose a ka mundësi që nga një distancë e caktuar të dëgjojë atë që është folur mes viktimës dhe autorit të vrasjes para se vrasja të ndodhte, se a mund ta njoh zërin e tij vërtetë. Kjo për faktin se dëshmitë e tilla janë bazike dhe mund të sjellin përgjegjësinë penale për autorin por edhe përgjegjësinë penale për deklaruesin i cili mund të deklarojë gjëra të pavërteta. Rindërtimi i vendit të ngjarjes mund të kërkohet edhe pas ngritjes së akuzës kur i pandehuri nuk pajtohet dhe kërkon sqarime shtesë rreth paqartësisë dhe kontradiktoritetit të deklaratave të dëshmitarëve ose kur mendon se vrasja është kryer në mbrojtje të nevojshme. Rindërtimi i vendit të ngjarjes, tek veprat penale të vrasjes është pothuajse i shpeshtë dhe në rrethana të caktuara mund të urdhërohet nga kryetari i trupit gjykues ose nga anëtarët e trupit gjykues edhe gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor. Të gjitha veprimet që realizohen në vendin e ngjarjes ku është kryer eksperimenti shënohet në procesverbal duke përfshirë edhe vërejtjet e palëve në proces (neni 343 par 2 dhe 3 I KPPK) (Sahiti, 1999a, f:154-158).

Kapitulli VIII: Analiza dhe rezultatet e kërkimit

8.1 Analiza e hulumtimit me autorë të veprave penale të vrasjes dhe organet për zbatimin e ligjit

Duke marr parasysh se vrasjet si njëra nga veprat më të rënda penale të cilat kanë qenë dhe janë objekt i studimit anembanë botës, prapë kjo vepër penale është mjaft aktuale dhe studimi i këtyre veprave penale edhe në Kosovë është i një rëndësie të veçantë. Është mjaft me rëndësi hulumtimi i fenomenit të vrasjes dhe zbulimi i faktorëve fenomenologjik dhe etiologjik sepse nga rezultatet e përfituara shkencore mund të parashtrihen detyra konkrete para institucioneve ligjzbatuese dhe penitenciare për uljen deri në kufinj të më maksimalë të mundshëm.

Me qëllim të verifikimit të hipotezës së parë, se sa ndikon (mos)funksionimi i pushtetit shtetëror në periudha të ndryshme kohore në fenomenin e vrasjeve, kam konsultuar një literaturë të gjërë nga autorë të ndryshëm, shqiptar dhe të huaj. Sipas këtyre të dhënave rezulton se pushteti në një shtet ligjor apo diktatorial ndikon në vellimin dhe dinamikën e vrasjeve në përgjithësi.

Ndërsa për verifikimin e hipotezës së dytë: mosreagimi institucional dhe konform ligjit i pushtetit shtetëror ndikon në rritjen dhe rënjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit është kryer në bazë të një hulumtimi ku janë përfshirë gjashtë grupe fokusi, persona zyrtarë të cilët punojnë në organet ligjzbatuese (oficerë të policisë gjyqësore, prokurorë të krimeve të rënda dhe gjyqëtarë të krimeve të rënda) nga Peja, persona madhorë të dënuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit të cilët gjinden në vuajtje të denimit në Institucionin e Ekzekutimit të denimit në Dubravë dhe personat e dënuar femra dhe të mitur në Institucionin korrektues të të Miturve në Lipjan.

8.2 Pjesëmarrësit në hulumtim

Në grupin e parë, të dytë dhe të tretë janë përfshirë 12 oficerë të policisë gjyqësore, 10 gjyqtarë dhe 8 prokurorë të shtetit të cilët janë marrë me këtë fenomenin e vrasjes dhe kryesit e tyre. Meqenëse detyrat e organeve ligjzbatuese në parandalimin e krimeve janë të njëjta edhe pyetësi ishte i njëjtë për të gjithë.

Në grupin e katërt të këtij hulumtimi bëjnë pjesë 62 persona meshkuj të dënuar nga gjithsej 117 sa ishin duke vuajtur dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Dubravë të Istogut. Prej tyre janë përgjigjur 52 të dënuar ndërsa 10 nuk kanë dashur të përgjigjen .

Në grupin e pestë bëjnë pjesë të dënuarit në Institutin për të mitur dhe femra në Lipjan

me gjithsej 94 persona (të dënuar dhe në paraburgim) ku prej tyre 25 janë persona të dënuar të mitur dhe femra të rritura të cilët ishin në vuajtje të dënimit për veprë penale kundër jetës dhe trupit. Nga ky numër janë përgjigjur gjithsej 17 persona nga të cilët 8 femra të dënuara dhe 9 të dënuar të mitur, ndërsa 8 prej tyre nuk janë përgjigjur fare.

Pyetësorët për të dënuarit e mitur dhe femrat të cilët kanë qenë në vuajtje të dënimit në këtë institucion për të Mitur në Lipjan për veprën penale të vrasjes dhe veprave të tjera penale kundër jetës dhe trupit, në pikat kryesore janë të njëjta me pyetësorin që iu është ofruar të dënuarve madhor që për të njejtat vepra janë duke vuajtur dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Istog. Arsyeja e kësaj qendron për faktin se edhe të miturit, janë autorë të veprave të rënda penale me përjashtim se disa pyetje janë ndërtuar me qëllim që të nxjerrim në sipërfaqe ndikimin e faktorëve individualë dhe familjar, jetës në komunitet dhe gjëndjes së tyre ekonomike.

Edhe pse vrasjet nga ana e femrave dhe të të miturve janë më të pakta, ato janë më rëndësi për hulumtimin tonë. Përgjithësisht, analizimi i rezultateve të këtij hulumtimi ku marrin pjesë të dënuarit e rritur meshkuj , të dënuarat e rritura femra dhe të dënuarit e mitur do analizohen veç e veç.

Analizimi i të dhënave nga ky hulumtim i paraqitur përmes pyetësorëve nga policia gjyqësore do bëhet veçmas ndërsa rezultatet e hulumtimit të të dhënave të prokurorisë së shtetit dhe gjyqtarëve për krime të rënda do analizohen bashkërisht. Kjo është bërë me qëllim që të shihen ngjashmëritë dhe dallimet e policisë gjyqësore (ndër aktorët kryesorë në procedurën parapenale) dhe prokurorëve dhe gjyqtarëve (aktorë kryesorë gjatë tërë kohës së procedurës penale).

Ky hulumtim është bërë me miratimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të Republikës së Kosovës dhe është kryer gjatë muajit mars 2016 me të dënuarit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Dubravë dhe gjatë muajit mars 2017 me të dënuarit për veprat penale kundër jetës dhe shëndetit të cilët vuajnë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për femra dhe të mitur në qytetin e Lipjanit.

8.3 Analizimi dhe rezultatet e kërimit që janë realizuar me prokurorët, gjykatësit dhe policia gjyqësore për veprat penale të vrasjes – Analiza eregresionit

Përmbledhja e Modelit^b

Modeli	R	Katrori R	Katrori R i Rregulluar	Gabimi Std. i llogaritur	Statistikat e Ndryshuara				
					Katrorit R i ndryshuar	F i ndryshuar	df1	df2	Sig. F i ndryshuar
1	.615a	.378	.307	.31563	.378	5.275	3	26	.006

a. Parashikuesit: (Konstantet), C12, C10, C8

b. Variabla e Varur: C6

Tabela 13. Përmbledhja e modelit

Vlera R prezanton lidhjen (korelacionin) ndërmjet vlerave të vëzhguara pra C6, C8, C10 dhe C12 dhe vlerave të parashikuara të variablës së varur dhe variablave të pavarura (Krasniqi, 2012) ku në rastin tonë kemi vlerën e koeficientit të $C6 = 0,103$, pra, konstantja e vlerës B_0 ku parametrat e tjerë apo variablat e pavarura të cilat ndikojnë në parashikimn e fenomenit C6 kanë këto vlera: $C8=.058$, $C10=.264$, $C12=.051$ apo B_1 , B_2 dhe B_3 . Kështu që modeli i regresionit linear të fenomenit në fjalë është:

Mos reagimi i institucioneve shtetërore ndikon në rritjen dhe uljen e vrasjeve, $Y_c = C6$ (A ka korrelacion domethënës pozitiv në mes organeve ligjzbatuese dhe parandalimit të veprave penale kunder jetës dhe trupit?) $(0,103) + C8$ (Institucioni i faljes ndikon në uljen e vrasjeve (nga hakmarrja, gjakmarrja)) $(0,264)^*$

Ky model është plotësisht i saktë pasi vlera e R është 0,615 dhe si e tillë në shkencat shoqërore pranohen edhe vlerat të cilat janë prej 0,10 me saktësi apo domethënie (signifikancë) prej 0,006 për të gjitha parametrat e paraqitur në tabelën nr.13.

ANOVA^b

Modeli		Shuma e Katrorëve	df	Mesatarja e Katrorëve	F	Sig.
1	Regression	1.576	3	.525	5.275	.006 ^a
	Residual	2.590	26	.100		
	Total	4.167	29			

a. Predictors: (Constant), C12, C10, C8

b. Dependent Variable: C6

Koeficientët ^a					
Modeli	Koeficientët e Pastandardizuar		Koeficientët e Standardizuar	t	Sig.
	B	Gabimi Std.	Beta		
1 (Konstantja)	.103	.282		.365	.718
C8	.058	.054	.171	1.075	.292
C10	.264	.095	.433	2.790	.010
C12	.051	.023	.359	2.266	.032

a. Variabla e varur: C6

Siç mund të shihet gabimi standard i variabilitetit të rezultateve është 0,31563 prandaj të gjitha devijimet standarde të variablave në fjalë dhe bazuar në tabelën e sipërme janë të pranueshme apo nuk e sjellin devijimin e rezultatit përfundimtar sepse të gjitha janë më të ulta se sa Gabimi Std. Fillestar kurse këtu kemi saktësinë e ndikimit të variablave të pavarura në konstantën në fjalë, pra, më pak se 0,3.

8.4 Analizimi dhe rezultatet e kërkimit që janë realizuar me personat e rritur të dënuar për veprat penale të vrasjes që ekzekutojnë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Dubravë të Istogut – Analiza e regresionit

Përmbledhja e Modelit ^b									
Modeli	R	Katrori R	Katrori R i rregulluar	Gabimi Std. i llogaritur	Statistikat e Ndryshuara				
					Katrori R i ndryshuar	F i ndryshuar	df1	df2	Sig. F i ndryshuar
1	.431 ^a	.186	.143	1.16908	.186	4.342	2	38	.020

a. Parashikuesit: (Konstantet), C16,C2

b. Variabla e Varur: C13

Tabela 14. Përmbledhja e modelit (II)

Vlera R prezanton lidhjen (korelacionin) ndërmjet vlerave të vëzhguara pra C13, C2 dhe C16 dhe vlerave të parashikuara të variablës së varur dhe të pavarura (Krasniqi, 2012) ku në rastin tonë kemi vlerën e koeficientit të C13 = 1,647 pra, konstata e vlerës B₀ ku parametrat e tjerë apo variablat e pavarura të cilat ndikojnë në parashikimin e fenomenit C13 kanë këto vlera: C2=.156, C16=.500 apo B₁ dhe B₂. Kështu që modeli i regresionit linear i fenomenit në fjalë është:

Mos reagimi i institucioneve shtetërore ndikon në rritjen dhe uljen e vrasjeve $Y_c = C13$ (Vendi i kryerjes së vepres penale) (0,186) + C2 (Mosha e juaj) (0,156)*

Ky model është plotësisht i saktë pasi vlera e R është 0,431 dhe si e tillë në shkencat shoqërore pranohen edhe ato vlera të cilat kanë saktësi apo domethënie (signifikancë) prej 0,10 prej 0,006 për të gjitha parametrat e paraqitur në tabelën nr. 14.

ANOVA^b

Modeli	Shuma e Katrorëve	df	Mesatarja e Katrorit	F	Sig.
1 Regression	11.869	2	5.934	4.342	.020 ^a
Residual	51.936	38	1.367		
Total	63.805	40			

a. Parashikuesit: (Konstantet), C16,C2

b. Variabla e Varur: C13

Koeficientët^a

Modeli	Koeficientët e Pastandardizuar		Koeficientët e Standardizuar	t	Sig.
	B	Gabimi Std.	Beta		
1 (Konstantja)	1.647	.561		2.936	.006
C2	.156	.128	.179	1.221	.230
C16	.500	.184	.399	2.722	.010

a. Variabla e Varur: C13

Siç mund të shihet gabimi standard i varibalitetit të rezultateve është 1,16908 prandaj të gjitha devijimet standarde të variableve në fjalë duke u bazuar në tabelën e mësipërme janë të pranueshme apo nuk sjellin devijim të rezultatit përfundimtar sepse të gjitha vlerat janë më të ulta se sa gabimi Std. fillestar, ndërsa këtu kemi saktësinë e ndikimit të variablave të pavarura në konstantën në fjalë, pra, më pak se 1,17.

8.5. Analizimi dhe rezultatet e kërkimit që janë realizuar me personat e mitur të dënuar për veprën penale të vrasjes që janë duke ekzekutuar dënimin në Institutin për femra dhe të mitur në Lipjan – Analiza e regresionit

Përmbledhja e Modelit^b

Modeli	R	Katrori R	Katrori R i rregulluar	Gabimi Std. i llogaritur	Statistikat e Ndryshuara				
					Katrori R i ndryshuar	F i ndryshuar	df1	df2	Sig. F i ndryshuar
1	.831 ^a	.691	.381	.47275	.691	2.232	4	4	.228

a. Parashikuesit: (Konstantet), C7, C6, C19,C10

b. Variabla e Varur: C9

Tabela 15. Përmbledhja e modelit (III)

Vlera R prezanton lidhjen (korelacionin) ndërmjet vlerave të vëzhguara pra C9, C10, C6, C19 dhe C7 dhe vlerave të parashikuara të variablës së varur dhe të pavarura (Krasniqi, 2012) ku në rastin tonë kemi vlerën e koeficientit të C9 = 0,200 pra, konstanta e vlerës B₀ ku parametrat e tjerë apo variablat e pavarura të cilat

ndikojnë në parashikimin e fenomenit C9 kanë këto vlera: C10=.392, C6= -.017, C19=.238, C7=.196 apo B₁, B₂, B₃ dhe B₄. Kështu që modeli i regresionit linear i fenomenit në fjalë është:

Mos reagimi i institucioneve shtetërore ndikon në rritjen dhe uljen e vrasjeve $Y_c = C9$ (Në cilën klasë keni qenë kur ju ka ndodh rasti) (0,186) + C10 (Çfarë nxënësi keni qenë) (0,156)*

Ky model është plotësisht i saktë pasi që vlera e R është 0,831 dhe si e tillë në shkencat shoqërore pranohen edhe ato vlera të cilat kanë saktësi apo domethënie (signifikancë) prej 0,10 prej 0,006 për të gjitha parametrat e paraqitur në tabelën nr. 15.

ANO
VA^b

Modeli	Shuma e Katrorëve	df	Mesatarja e Katrorit	F	Sig.
1 Regression	1.995	4	.499	2.232	.228 ^a
Residual	.894	4	.223		
Total	2.889	8			

a. Parashikuesit: (Konstantet), C7, C6, C19, C10

b. Variabla e Varur: C9

Koeficientët^a

Modeli	Koeficientët e Pastandardizuar		Koeficientët e Standardizuar	t	Sig.
	B	Gabimi Std.	Beta		
1 (Konstantja)	.200	.738		.271	.800
C10	.392	.255	.565	1.535	.199
C6	-.017	.236	-.025	-.073	.945
C19	.238	.149	.527	1.595	.186
C7	.196	.407	.163	.482	.655

a. Variabla e Varur: C9

Siç mund të shihet gabimi standard i variabilitetit të rezultateve është 0,47275 prandaj të gjitha devijimet standarde të variableve në fjalë duke u bazuar në tabelën e mësipërme janë të pranueshme apo nuk sjellin devijim të rezultatit përfundimtar sepse të gjitha vlerat janë më të ulta se sa gabimi Std. fillestar, ndërsa këtu kemi saktësinë e ndikimit të variablave të pavarura në konstantën në fjalë, pra, më pak se 0,47.

8.6. Analizimi dhe rezultatet e kërimit që janë realizuar me femrat e dënuara për veprën penale të vrasjes që janë duke ekzekutuar dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për femra dhe të mitur në Lipjan – Analiza e regresionit

Përmbledhja e Modelit^b

Mode li	R	Katrori R	Katrori R i rregulluar	Gabimi Std. i llogaritur	Statistikat e Ndryshuara				
					Katrori R i ndryshuar	F i ndryshuar	df1	df2	Sig. F i ndryshuar
1	.692 ^a	.479	.088	1.01313	.479	1.224	3	4	.410

a. Parashikuesit: (Konstantet), C4, C1, C3

b. Variabla e Varur: C13

Tabela 16. Përmbledhja e modelit (IV)

Vlera R prezanton lidhjen (korelacionin) ndërmjet vlerave të vëzhguara pra C13, C1, C3 dhe C4 dhe vlerave të parashikuara të variablës së varur dhe të pavarura (Krasniqi, 2012) ku në rastin tonë kemi vlerën e koeficientit të C13 = -0,67 pra, konstanta e vlerës B₀ ku parametrat e tjerë apo variablat e pavarura të cilat ndikojnë në parashikimin e fenomenit C13 kanë këto vlera: C1=.673, C3=.538 dhe C4=.135 apo B₁ dhe B₂ dhe B₃. Kështu që modeli i regresionit linear i fenomenit në fjalë është:

Mos reagimi i institucioneve shtetërore ndikon në rritjen dhe uljen e vrasjeve $Y_c = C13$ (Sa është masa e dënimit tuaj (në bazë të viteve) (0,67) + C1 (Mosha e juaj) (0,538)* Ky model është plotësisht i saktë pasi vlera e R është 0,692 dhe si e tillë në shkencat shoqërore pranohen edhe ato vlera të cilat kanë saktësi apo domethënie (signifikancë) prej 0,10 prej 0,006 për të gjitha parametrat e paraqitur në tabelën nr.16.

ANOVA^b

Modeli		Shuma e Katrorëve	df	Mesatarja e Katrorit	F	Sig.
1	Regression	3.769	3	1.256	1.224	.410 ^a
	Residual	4.106	4	1.026		
	Total	7.875	7			

a. Parashikuesit: (Konstantet), C4, C1, C3

b. Variablat e Varura: C13

Koeficientët ^a					
Modeli		Koeficientët e Pastandardizuar		t	Sig.
		B	Gabimi Std.		
1	(Constant)	-.067	1.450	-.046	.965
	C1	.673	.562	.480	.297
	C3	.538	1.051	.235	.636
	C4	.135	.444	.136	.777

a. Variabla e Varur: C13

Siç mund të shihet gabimi standard i varibalitetit të rezultateve është 1,01313 prandaj të gjitha devijimet standarde të variableve në fjalë duke u bazuar në tabelën e mësipërme janë të pranueshme apo nuk sjellin devijim të rezultatit përfundimtar sepse të gjitha vlerat janë më të ulta se sa gabimi Std. fillestar, ndërsa këtu kemi saktësinë e ndikimit të variablave të pavarura në konstantën në fjalë, pra, më pak se 1,013.

Kapitulli IX: Konkluzione përfundimtare dhe rekomandime

9.1 Konkluzione përfundimtare

Përkundër studimeve të shumta dhe interdisiplinare të vrasjeve në opinionin publik dhe shkencor ekziston një interesim i madh për studimin e fenomenit të vrasjes. Me vet faktin se humb jetën një njeri nga përdorimi i dhunës fizike të kundërligjshme nga vet njeriu i cili këtë dhunë e përdorë për t'ia marr jetën tjetrit (me armë, me varje, përmes helmimit, ngulfatjes në ujë etj), paraqet bazën e interesimit të studiuesve të ndryshëm shkencor që të arrijnë në identifikimin e shkaqeve të kësaj “egërsie” të njeriut kundër llojit të vet. Dihet se vrasjet janë një fenomen i hershëm i shoqërisë njerëzore dhe vazhdon ta shoqërojë edhe sot e tutje. Shkaqet e vrasjeve, pavarësisht nga vendi se ku shfaqen, mund të jenë të ndryshme, motivet mund të jenë të ndryshme, dhe vetëm me një studim multidisiplinar mund të arrihet në një shpjegim shkencor edhe pse nganjëherë ai mund të jetë vetëm fragmentar. Kështu do jetë edhe përkundër përpjekjeve të parreshtura të shkencëtarëve për ndriqimin e shkaqeve të fenomenit të vrasjeve edhe në të ardhmen. Për shkak të kompleksitetit dhe pamundësisë që të ndërhyhet në mendjet njerëzore e aq më pak të ndërpriten ato “fije” që ndikojnë apo shtyjnë njeriun të bëhet aq agresiv sa t'ia marr edhe jetën tjetrit do të mbeten sfida për shkencën edhe për një kohë të gjatë.

Edhe nga ky studim, ka rezultuar se vepra penale e vrasjes është një dukuri shoqërore mjaft e ndërlikuar, vëllimi dhe dinamika e saj janë të varura nga faktorë të ndryshëm fenomenologjik dhe etiologjik. Si dukuri e tillë, vrasja është e ndërlidhur nga faktorë të ndryshëm objektiv dhe subjektiv, faktorë ekonomik dhe politik dhe e shfaqur me tërë kompleksitetin e vet edhe në Kosovë.

1. Nga burime të ndryshme shkencore është provuar se numri i vrasjeve në Kosovë, në faza të ndryshme historike ka patur një rënje - ngritje të këtij fenomeni. Rënje të fenomenit të vrasjeve janë regjistruar atëherë kur regjimet antipopullore shtonin presionin politik dhe ekonomik ndaj popullatës së Kosovës ndersa me rënjen e presionit të pushtetit kurba e vrasjeve shënonte rritje. Pra, në periudha të caktuara historike, (gjatë luftërave, terrorit shtetëror serb e malazez, reforma agrare dhe shpërngulja drejt Turqisë, presioni për ndërrimin e identitetit kombëtar, presioni policor-ushatark gjatë periudhës së regjimit të Titos, periudhës së ashpërsimit dhe terrorit komunist pas demonstratave të studentëve të vitit 1981 dhe regjimit diktatorial të Millosheviçit 1989-1999) kemi një rënie të kriminalitetit në përgjithësi dhe të vrasjeve të qytetarët shqiptarë. Në anën tjetër

gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar (1989-1999), kemi një pjesëmarrje në rritje të serbëve dhe malazezëve në kryerjen e veprave penale të vrasjes. Ky trend në rënje i numrit të vrasjeve është shënuar edhe në territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës.

2. Në anën tjetër, me demokratizimin e shoqërisë kosovare pas vitit 1966 (pas renjës së Rankoviçit nga pozita e ministrit të brendshëm të Jugosllavisë) e deri në vitin 1981 dhe pas vendosjes së Kosovës nën administrimin e OKB-së dhe UNMIK-ut (1999), vrasjet dhe veprat tjera kundër jetës dhe trupit shenojnë një rritje të konsiderueshme. Duke analizuar situatën e tillë nëpër të cilën ka kaluar Kosova, fenomeni i rritjes së vrasjeve mund të shpjegohet me faktin se problemet e ndryshme të pazgjidhura nën regjime të ndryshme shtypëse kanë dalë në shesh mbas rënies së këtyre regjimeve ku qytetarët duke e shfrytëzuar “liberalizimin” e pushtetit, moskonsolidimin e tij, prezencën e madhe të armëve në duar të qytetarëve ka krijuar një ambient të përshtatshëm për aplikimin e normave të së drejtës zakonore, vetëgjyqësi, hakmarrje dhe gjakmarrje, që në raste të caktuara janë të vjetra dhe disa vjeçare.

3. Duke patur parasysh numrin me të madh të vrasjeve që kanë ndodhur në viset rurale dhe në periudhën pranëverë-verë mund të konkludojmë se pushteti shtetëror nuk i kushton kujdesin e duhur problemeve të fshatit (çështjeve të ndryshme pronësore, ujitjes, të drejtës së servitutit etj.) të cilat për banorët janë burim i jetës dhe njëkohësisht burim i konflikteve që përfundojnë me vrasje.

4. Prezenca e madhe e armëve të zjarrit në duar të popullsisë civile është njëri ndër shkaqet në rritje të fenomenit të vrasjeve në Kosovë dhe në Rajonin e Pejës në veqanti.

5. Sa i përket motivit të vrasjeve, ka dominuar motivi pasuror sepse në të shumtën e rasteve ato janë shkaktuar për shkak të marrëdhënieve të pazgjidhura me çështjet e pronave, por nuk duhet lenë anash dhe motivet tjera siç janë marrëdhëniet e prishura ndërfamiljare, xhelozia, provokimi i viktimës, motive që kanë të bëjnë me hakmarrjen dhe gjakmarrjen. Sa i përket motivit politik, në periudhën e parë janë shënuar disa raste, ndërsa në periudhën e dytë është shënuar vetëm një vrasje e mbetur në tentativë me qëllime politike dhe kjo kishte ndodhur në Komunën e Klinës.

6. Mungesa e profesionalizmit dhe seriozitetit të organeve të ndjekjes penale në periudha të caktuara kohore dhe aplikimi i politikës ndëshkimore joadekuate ndaj kryesve të veprave penale të vrasjes dhe veprave tjera kundër jetës dhe trupit është njëri ndër faktorët që ka ndikuar në rritjen e kriminalitetit në Kosovë dhe në regjionin e Pejës.

7. Mosekzekutimi i vendimeve administrative dhe gjyqësore gjithashtu është njëri ndër

faktorët shqetësues i cili ka ndikim të drejtëpërdrejtë në zgjidhjen e problemeve me dhunë, sidomos kur kemi parasysh mjedisin ku normat zakonore janë ende të forta. Fundja nxjerrja e vendimeve të ndryshme administrative dhe gjyqësore nuk kanë kurrfarë kuptimi dhe vlere juridike nëse mbesin të paekzekutuara nga organet të cilat i nxjerrin ato dhe të cilat kanë për qëllim që njerëzit të heqin dorë nga përdorimi i dhunës dhe vendosja e sundimit të ligjit.

8. Njeri ndër shqetësimet që është paraqitur në këtë punim lidhet me institucionin e faljes, institucion ky i rregulluar me ligj, zbatimi i të cilit varet drejtëpërdrejtë nga presidenti i vendit. Pavarësisht se sipas këtij ligji, është një panel i cili zhvillon dhe përcjell tërë procedurën e faljes deri te presidenti, praktika ka treguar se Zyra e Presidentit ka falur autorë të veprave penale të vrasjes së rëndë. Kjo praktikë e faljes se kryesve të veprave të rënda të vrasjes nga presidenti i vendit ka ngjall mosbesim, pasiguri dhe mund të sjell pasoja të rënda për vet sistemin e drejtësisë në vend.

9.2 Rekomandime

Parandalimi i krimit është detyrë e një shoqërie moderne, krimi duhet të parandalohet që në fazën fillestare ose para se të fillojë kryerja e veprës. Parandalimi i krimit nga të gjithë personat është detyrë dhe obligim ligjor dhe kushtetues i të gjithë shtetasve dhe i organeve dhe institucioneve shtetërore me qëllim të parandalimit të veprave kriminale. Të gjitha përpjekjet publike dhe private në tërësi, me programe dhe me masa parandaluse që e trajtojnë krimin si fenomen shoqëror, kanë për qëllim zvogëlimin ose uljen e pasojave të tij. Si pasoja negative përfshihen pasojat mendore, fizike ose materiale, po ashtu frikën nga krimi e në veçanti frika e të qenit viktimë. Qëllimi i parandalimit të krimit, është të mbajë sigurinë e qëndrueshme në shoqëri

Duke u bazuar në studimin e çështjes, në mënyrë që vepra penale e vrasjes të njihet më mirë dhe të realizohet parandalimi i saj rekomandojmë që:

1. Institucionet kompetente (policia, prokuroria dhe gjykatat, instituti i psikologjisë gjyqësore, shkollat, shërbimi social i Komunës, Ministria e drejtësisë) duhet të angazhohen;

- a) në krijimin e një baze të të dhënave elektronike unike në të cilën do futën të gjitha të dhënat për vrasjet dhe autorët e tyre - të dhënat e detajuara kuantitative në mënyrë që në çdo periudhë kohore të përcjellin dinamikën dhe intensitetin e veprës penale të vrasjes, lënda të regjistrohet me një numër unik dhe ai numër të jetë identifikues në të gjitha shkallët e

gjykatave;

- b) në krijimin e një institucioni- instituti për psikologjinë gjyqësore, i cili në mënyrë shkencore do të analizojë të dhënat kuantitative dhe nëpërmjet përpunimit shkencor, do i transformojë në të dhëna kualitative që shpjegojnë thelbin e fenomenit të vrasjes; të ofrojë të dhëna për gjykatën sa i përket të dhënave rreth personalitetit të autorit të vrasjes (cilësitë biofizike, gjëndjen psikologjike, karakterin, temperamentin, inteligjencën, si dhe emocionet) gjatë të gjitha fazave të procedimit penal, në fazën e hetimeve dhe gjykimit në mënyrë që të njihen motivet e aktit penal. Caktimi i profilit të vrasësit - në rastet me të shpeshta mundëson më mirë njohjen e personalitetit të tij me qëllim që të dihet se a bëhet fjalë për vrasës profesionist dhe me pagesë, vrasës të rastit apo vrasës me paramendim (vrasje për gjakmarrje, hakmarrje etj.)
- c) të angazhohen seriozisht në kompletimin e të dhënave rreth identitetit të plotë të viktimës, evidentimin e të kaluarës së personalitetit të saj duke filluar që nga shkolla fillore e tutje;
- d) identifikimin dhe evidentimin e delikuentëve të mitur nga drejtoria e shkollës dhe shërbimi social i komunave, me qëllim të parandalimit në kohë të veprimeve të tyre antisociale dhe kundërligjore;
- e) të bashkëpunojnë më shumë me shoqërinë civile për shkak se roli i saj në shoqërinë bashkëkohore është i pazëvendësueshëm;
- f) me qëllim të rritjes së efikasitet të gjykatave për zgjidhjen e çështjeve administrative, civile (përfshirë edhe ato rreth trashëgimisë), problemet e dhunës në familje, të cilat si të tilla janë burim potencial për kryerjen e veprës penale të vrasjes dhe prandaj duhet të realizohen në mënyrë të rregullt inspektime periodike nga Ministria e Drejtësisë;

2. Në aspektin legjislativ:

- a) Meqenëse gjatë hulumtimit të këtij studimi kemi hasur në dënime tejet të ulta dhe të paarsyetuara për shkak se edhe formulimi i disa veprave penale ka krijuar vështirësi në praktikë (psh. vepra penale e fajdes), parashkrimi i çështjeve në tavolinën e gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit ose në Zyrat e Ekzekutimit të gjykatës, janë hasur procedura të stërzgjatura nganjëherë edhe të pajustificueshme, është e udhës që të përcaktohen afatet pothuajse në të gjitha

shkallët e gjyqësorit me qëllim që të mos të lejohet që procedurat të zgjasin me vite të tëra. Ky korigjim i afateve do të ndikojë pozitivisht në opinionin publik i cili është i interesuar që autori i vepres penale të vrasjes të dënohet sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Për shkak se vrasja ka një ndikim tejet negativ në opinionin publik është e udhës të përshpejtohen procedurat me qëllim që ato të kryhen në afatin sa më të shkurtër të mundshëm.

Me qëllim të funksionimit sa më mirë të sistemit të drejtësisë është mirë që herë pas here të shikohen edhe formulimet ligjore për vepra apo procedura të cilat shkaktjnë probleme dhe paqartësi në praktikë. Në këtë sens kërkohet të bëhet plotësimi i nenit 343 i Kodit Penal ku bëhet fjalë për veprën penale të fajdës, dukuri kjo e shpeshtë në Kosovë dhe njeri ndër faktorët kriminogjenë të vrasjes. Në këtë nen ligjëvënësi, nga Kodi i vjetër ka parashkruar veprën penale „Kontraktimi i fitimit joproporcional” duke e riformuluar me „fajde” sipas të cilit elementi më i rëndësishëm i kryerjes së kësaj vepre penale nga ana e autorit ishte shfrytëzimi i situatës së vështirë ekonomike, sociale dhe shëndetësore dhe përvojën e pamjaftueshme të viktimës. Në fakt “viktima” të kësaj vepre penale nuk janë vetëm personat që janë në vështirësi ekonomike dhe shëndetësore por janë njerëz të pasur, biznesmenë të cilët nga pamundësia e kthimit të parasë janë vrarë, vetëvrarë ose kanë falimentuar, prandaj kërkohet një plotësim i Kodit Penal për veprën penale të fajdes dhe të jetë: 1. Kushdo që jep para me fajde dënohet..... dhe 2. Paratë dhe pasuria e fituar duke kryer veprën penale të fajdës të konfiskohet në llogari të buxhetit të shtetit.

Të riformulohet vepra penale e „Keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose e autorizimit (neni 422 paragrafi 2 pika 2.2 moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj dhe të jetë: mosprocedimi me dashje i çështjeve penale nga ana e gjyqtarit, prokurorit të shtetit, zyrtarit të ekzekutimeve sipas procedurës së parashikuar me ligj dhe me këtë rast vjen deri te parashkrimi i ndjekjes penale, parashkrimi i vepres penale dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit gjyqtari, prokurori ose zyrtari i policisë gjyqësore dënohet me...”

Me qëllim të eliminimit të interpretimeve të ndryshme mendoj se duhet të ndryshohen zgjidhjet e dyfishta që janë parashikuar në nenet 423 dhe 418 të KPP

të Kosovës. Sipas nenit 423 paragrafi 2 KPP parashihet e drejta e të pandehurit që në afatin prej 5 vjetëve të bëjë kërkesë për rishikimin e çështjes penale të përfunduar me vendim të formës së prerë. Ky nen është në kundërshtim me nenin 418 paragrafi 1 i KPP sipas të cilit e drejta e të pandehurit për të ushtruar mjetin e jashtëzakonshëm juridik, pra rishikimi i çështjes penale kundër vendimit të formës së prerë mund të bëhet në afat prej 2 vjetësh nga dita e nxjerrjes së vendimit të formës së prerë. Për shkak të shkurtimit të procedurës, mendoj se: *afati për rishikimin e procedures penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë duhet të jetë 2 vjet.*

- b) Në kuadër të KGJK të formohet një komision i përhershëm që do përcjell çdo çështje penale të vrasjeve dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit me qëllim që autori të gjykohet në kohë të arsyeshme dhe konform ligjit. Ky komision të kryejë kontrolle në gjykata, në të gjitha shkallët, sëpaku një herë në muaj dhe të raportoj në KGJK me qëllim të ndermarrjes së masave administrative adekuate kundër atyre që nuk respektojnë afatet ligjore.
- c) Nga Ministria e Drejtësisë të formohet një “task forcë” që ushtrojë kontroll në të gjithë Kosovën e cila do merrej me kontrollimin dhe shqyrtimin e të gjitha çështjeve penale të cilat i janë nënshtruar parashkrimit të ndjekjes penale dhe parashkrimit të ekzekutimit të dënimit dhe në bazë të raportit të tyre të nxjerrin para përgjegjësisë të gjithë aktorët e këtyre shkeljeve.
- d) Të procedohen çështjet sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, pavarësisht kombësisë së autorit, të ndalohej aplikimi i drejtësisë hibride dhe aplikimi i legjislacionit të Serbisë në Kosovë.
- e) Të rishikohet dhe të plotësohet ligji Nr. 03/L-101 për Faljen (2008) për shkak se ky ligj është i vjetëruar dhe normat e tij janë në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës. Sipas nenit 4 paragrafi 5 i këtij ligji vetëm personat që kanë kryer vepra penale kundër Kosovës (kreu XIII i KPPK) dhe personat që kanë kryer vepra penale kundër të drejtës ndërkombëtare (kreu XIV i KPPK) nuk kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë për falje. Nga kjo del se të gjithë personat e tjerë të cilët kanë kryer vepra të rënda penale kanë pasur të drejtë të ushtrojnë kërkesën për falje dhe disa nga këta autorë të veprave të rënda penale edhe kanë përfituar nga falja e presidentit. Kërkohet një rishikim i këtij ligji dhe nxjerrja e një ligji të ri në kuadër të së cilit mund të përfshihen kritere të reja dhe të ashpra sa i përket të drejtës së përfitimit të faljes nga autorët e veprave të rënda penale të vrasjes.

Kritere të tilla janë parashikuar në mënyrë mjaft të qartë në Ligjin nr 10295 të datës 1.7.2010 të Republikës së Shqipërisë. Sipas këtij ligji janë të përjashtuar nga e drejta për të përfituar faljen autorët e veprave të rënda penale të kryera në mënyrë mizore, vrasje me paramendim, vrasje të kryera kundër grave dhe femijëve, autorët e veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare (gjenocidi, krimet kundër njerzimit, krimet e luftës, terrorizmi) trafikimi i qenieve njerëzore, autorë që kanë marrë pjesë në krimin e organizuar. Pra, kërkohet nxjerrja e një ligji të ri për faljen i cili do jetë në përputhje me normat e Kodit Penal në fuqi në Kosovë. Në këto ndryshime dhe plotësime të këtij ligji duhet të përcaktohen kriteret e qarta përmes të cilave, të dënuarve që ju lind e drejta për të aplikuar të jetë transparente. Kriteret ndaluese për ata që nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga ligji për falje duhen të përshkruhen qartë : *nuk kanë të drejtë të kërkojnë falje personat e dënuar sipas nenit 179 nga paragrafi 1 deri në paragrafin 12 të KPK. Më pas në këtë kriter të përfshihen: nuk mund të përfitojnë nga falja as autorët që kryejnë veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës (kapitulli XIV), autorët që kanë marrë pjesë në organizata kriminale”.*

Ligji për Faljen duhet të plotësohet “*të krijohet një panel gjithëpërfshirës për falje me pjesëmarrje të një pjestari të shoqërisë civile, përfaqësuesit të avokatit të popullit, përfaqësuesit të Këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirinë e njeriut të cilët do përpilojnë raportin zyrtar me emrat e përfituesve të faljes Ministrisë së Drejtësisë e cila ia dorëzon presidentit të vendit”.*

3. Me ligj të veçantë të krijohet policia gjyqësore.

4. Pranë prokurorive të shtetit dhe gjykatave themelore, në çështjet penale të vrasjes dhe veprave të tjera kundër jetës dhe trupit të angazhohen prokurorë dhe gjyqtarë të caktuar të cilët do merren vetëm me hetimin dhe gjykimin e vrasjeve.

5. Masat shoqërore:

- a) Njoftimi i popullsisë lidhur me mënyrën e aplikimit dhe realizimit të të drejtave të tyre ligjore përmes programeve të ndryshme edukative duke përfshirë edhe mediat;
- b) Eliminimin ose zbutjen e faktorëve ekonomik, social apo kushteve ekonomike të individëve, t’iu ofrohet ndihmë juridike falas personave që kanë nevojë në realizimin e të drejtave të tyre në qarkullimin juridik të paluajtshmërisë, në realizimin e të drejtave të tyre sa i përket barazisë gjinore (trashigimisë, ndarjes

se pasurisë së përbashkët) etj;

- c) Ndërhyrja në fushën e strukturave shoqërore: marja e masave edukative dhe institucionale të elementeve problematike sidomos të të miturve, forcimi i disiplinës në shkollë, shtimi i përgjegjësisë së kuadrit arsimor në shkollë dhe jashtë saj, aplikimi i programeve të ndryshme edukative në kultivimin e sportit dhe kulturës, aplikimi i programeve të ndryshme dhe aktivitetet gjatë kohës së lirë.
- d) Të shtohen kompetencat dhe përgjegjësia e Shërbimit Social në Komunë me qëllim që ky shërbim të mund të kryejë shërbimet sipas ligjit kur bëhet fjalë për të miturit dhe gratë që janë objekt i dhunës në familje.
- e) Të funksionojë institucioni i ndërmjetësimit në çdo lagje, fshat e qytet të cilët bashkë me policinë e komunitetit duhet të konstatojnë lëvizjet delikuede në mjediset e tyre me qëllim të eliminimit të pasojave të mëvonshme të cilat mund të sjellin konflikte të ndryshme shoqërore.

Sistemi i drejtësisë duhet forcuar dhe jo goditur herë pas here me afera të ndryshme. Nëse ka problem me kolizionin e ligjeve ato duhen ndryshuar.
Meqenëse, gjyqësori në Kosovës është i stërngarkuar me çështje të vjetra të cilat disa edhe janë parashkruar, mendoj se duhet krijuar një trup të veçantë në gjyqësor që të merret me shqyrtimin e vetem të këtyre lëndëve, ndërsa ata që kanë kontribuar me mospunën dhe neglizhencën e tyre të ngarkohen me përgjegjësi administrative ose edhe përgjegjësi penale.
- ë) Për vrasjet nga hakmarrja dhe gjakmarrja të aplikohet Kodi Penal me një rigorozitet të ashpër me qëllim që të mos lejohet vetëgjyqësia dhe të funksionojë shteti ligjor.

Literatura

Burime parësore:

LIGJET

1. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, 2003
2. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, 2003
3. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, 2012
4. Kodi Penal i Kosovës, 2012
5. Ligji i Procedurës Penale i Jugosllavisë, 1977
6. Ligji mbi Rendin dhe Qetësinë Publike, 1981
7. Ligji Penal i Jugosllavisë, 1977
8. Ligji Penal i Kosovës, 1977
9. Ligji Penal i Serbisë, 1990
10. Ligji për faljen i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-101
11. Ligji për Këshillat e Pajtimimit, Gazeta zyrtare Nr. 37/71
12. Ligji për parandalimin e krimit kibernetik, Nr. 03/L-166
13. Zakon o sedistima i producjima sudova i javnih tuzilastva Srbije, 2001
14. Zakon o sedistima i producjima sudova i javnih tuzilastva Srbije, 2002
15. Zakon o sedistima i producjima sudova i javnih tuzilastva Srbije, 2008
16. Zakon o sedistima i producjima sudova i javnih tuzilastva Srbije, 2013

RREGULLORET ME FUQI LIGJORE

1. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, 10 Qeshor 1999, New York.
2. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 1999/6
3. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 1999/18
4. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 1999/24
5. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 2000/01
6. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 2000/13
7. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 2000/15
8. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 2000/64
9. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 2001/7
10. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 2001/17
11. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 2003/25
12. Regullore e UNMIK-ut, Nr. 2003/26

Burime dytësore:

1. Ademaj, X. (2003). *Hetimet në vendin e ngjarjes kriminale*. Prishtinë: Twins.
2. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosoves. (2005). *Akte të Kuvendit të Republikës së Kosoves, 2 Korrik 1990 - 2 Maj 1992*. Prishtinë: Rilindja.
3. Bajrami, H. (2002). *Politika serbe për rikolonizimin e Kosoves me sllavë 1945-1948*. Prishtinë: Era.
4. Bajrami, H. (2015). *Dosja Fazli Grajqevci dhe dokumente tjera deri në plenumin e bioneve (1966)*. Prishtinë: Shkrola Print.
5. Bajgora, A. (1998). *Krimet kundër lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë*. Prishtinë.
6. Bassiouni, C. M. (2003). *Introduction to International Law*. New York: Transnational Publishers, Inc Ardsley.
7. Benedet, B. (1990). *Helmimin e bënë agjentet e Beogradit*. Zëri i Rinisë.
8. Bieber, F., & Daskalovski, Z. (2003). *Understanding the War in Kosovo*. Great Britain: Frank Cass Publisher.
9. BIGZ. (1981). *Sta se dogadjalo na Kosovu*. Beograd: Gazeta Politika.
10. Bue, A. (2011). *Shqipëria në Turqinë Europiane*. Tiranë.
11. Bytyqi, A. A. (2009). *Terrori shtetëror dhe gjenocidi serbo-malazias në Kosovë 1878-1991*. Prishtinë.
12. Cajkanovic, V. (1973). *Mit i religjia u srba*. Beograd: Sprska Knjizevna Zadruga.
13. Cana, Z. (1996). *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
14. Casopis kritiko znanosti. (1989). *Srbija i Albanici*. Ljubljana: Studentska založba.
15. Clark, H. (2000). *Civil Resistance in Kosovo*. London: Pluto Press London.
16. Cohen, P. J. (1997). *Tajne rat Srbije*. Zagreb: Ceres.
17. Council for the defence of human rights and freedoms in Prishtina. (1992). *Knocking on europe's conscience: Kosova, Evidence & Documents*. Prishtinë: Council for the defence of human rights and freedoms in Prishtina.
18. Demolli, H. (2006). *Vrasjet në Kosoven e Pasluftes*. Prishtinë: Qendra juridike e Kosoves.

19. Douglas, J., Burgess, A., Burgess, A., & Ressler, R. (2006). *Crime classification manual: a standard system for investigating and classifying violent crimes*. USA: Jossey-Bass.
20. Dragicevic-Dicic, R., & Jankovic, I. (2011). *Sprecavanje i kaznjavanje mucenja drugih oblika zlostavljanja*. Beograd.
21. Elezi, I. (1994). *E drejta zakonore e Labërisë në planin krahasues*. Tiranë: SHBLU.
22. Elezi, I. (2000). *Vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje në Shqipëri*. Tiranë.
23. Elezi, I. (2006). *Kanuni i Labërisë*. Tiranë: Toena.
24. Elezi, I. (2014). *E drejta penale, pjesa e posaçme*. Tiranë.
25. Elezi, I., Kapuci, S., & Maksim, H. (2014). *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: KUMI.
26. Elsie, R. (2002). *Gathering Clouds: the Roots of Ethnic Cleansing in Kosovo and Macedonia*. Pejë: Dukagjini.
27. Enti i Statistikës së Kosovës. (1978). *Vjetari statistikor i KSAK-ut 1978*. Prishtinë: Enti i Statistikës së Kosoves.
28. Enti republikan i Serbisë. (1999). *Vjetari Statistikor i Serbisë*. Beograd: Enti republikan i Serbisë.
29. Euripidi. (1973). *Medea*. Prishtinë.
30. Folic, Z. (2013). *Istorijska muslimanska Crna Gore (1455-1918)*. Podgorica: Stampa IVPE-Cetinje.
31. Gashi, A., & Musliu, B. (2012). *Kontrolli i armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë: Progresi dhe sfidat*. Prishtinë: Forumi për Siguri.
32. Gashi, R. (2003). *Politika ndëshkimore ndaj delikteve të gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980-1989*. Prishtinë.
33. Gjecovi, S. (2015). *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Shkodër: Shtëpia Botuese Kuvendi.
34. Gjeqovi, S. (1999). *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Tiranë: Shtëpia Botuese Kuvendi.
35. Gjoncaj, L., & Gjoncaj, G. (2009). *Peneloggjia*. Tiranë: Adel Print.
36. Gjoncaj, L., & Gjoncaj, G. (2013). *Kriminologjia*. Tiranë: AdelPrint.
37. Gjorgevic, T. (1900). *Obicaj Naroda Srpskoga*. Beograd: Akademija Knjizevine Srbije.

38. Gjorgjevic, V. (2012). *Shqiptarët dhe fuqitë e mëdha*. Tiranë.
39. Goluboviq, V. (2000). *Krvni delikti maloletnika u Crnoj Gori*. Podgorica.
40. Hajdari, A. (2004). *Kriminaliteti i të miturve në Kosovë 2001-2003*. Prishtinë: Twins.
41. Halilbegoviq, N. (2002). *Mama, moram im glavu dati-stradanje vojnika - regruta u bivsoj JNA I njihovo spasavanje*. Sarajevo.
42. Halili, R. (1995). *Kriminologjia me Penologji*. Prishtinë.
43. Halili, R. (2016). *Kriminologjia*. Prishtinë.
44. Hanel, B. (2004). *Bazat e Menagjimit për Mbikqyrjen dhe Menagjimin Policor-Shkolla e Shërbimit Policor*. Vushtri.
45. Hasluck, M. (2005). *Kanuni, Ligji i pashkruar shqiptar*. Tiranë: Cambridge press 1954.
46. Herring, J. (2013). *E drejta Penale*. Tiranë: UET press.
47. Horvat, B. (1989). *Kosovsko pitanje (2.dopunjeno izdanje)*. Zagreb: Globus.
48. Horvat, B. (1989). *Kosovsko Pitanje (drugo dopunjeno izdanje)*. Zagreb: Globus.
49. Human Rights Watch. (2001). *Po Naredjenju Ratni Zlocini na Kosovu*. Beograd: Narodna bibloteka Srbije.
50. Hysi, V. (2000). *Hyrje në Kriminologji dhe Penellogji*. Tiranë.
51. Hysi, V. (2010). *Kriminologjia*. Tiranë.
52. Ignjatovic, G. (2015). *Kriminologjia*. Beograd.
53. Ilia, F. (1993). *Kanuni i Skendërbeut*. Shkodër.
54. Islami, H. (2012). *Aspekti Etnik i migrimeve ASHAK*. Prishtinë.
55. Ismaili, H. (2001). *Burime të zgjedhura juridike historike*. Prishtinë.
56. Janjic, D., Lalaj, A., & Pula, B. (2009). Kosovo under the Milosevic Regime. In C. Ingrao, & T. Emmert, *Confronting the Yugoslav Vontroversies* (pp. 272-302). Washington DC: Purdue University Press.
57. Jehle, J.-M. (2015). *Criminal Justice in Germany*. Berlin: Federal Ministry of Justice and Consumer Protection.
58. Jovanoviq, M. V. (2006). *Tokovi Istorije (nr.3/2006)*. Beograd: Journal of the Institute for Recent History of Serbia.

59. Jovanoviq, M. V. (2007). *Tokovi Istorije (nr.1-2/2007)*. Beograd: Journal of the Institute for Recent History of Serbia.
60. Kampanella, T. (1990). *Qyteti i Diellit ose mbi idenë e republikes filozofike*. Prishtinë.
61. Karadzic, V. s. (1867). *Zivot i Obicaj naroda srpskoga*. Vjenë.
62. Kojcini-Ukaj, S. (1997). *Kuadri arsimor shqiptar në Kosovë në shënjestren e Sigurimit Shtetëror (1945-1952)*. Prishtinë: Lumi.
63. Konstantinovic-Vilic, S. (1986). *Zene Ubice*. Nis.
64. Krasniqi, M. (1984). *Lugu i Baranit*. Prishtinë: ASHAK.
65. Krasniqi, B. A. (2012). *Metodat kërkimore në shkenca sociale - Udhëzues i analizës statistikore në SPSS*, Prishtinë: The Institute for Entrepreneurship and Small Business.
66. Kurti, B. (2008). *Pararendësit e Lirisë*. Prizren.
67. Latifi, V. (1982). *Kriminalistika e Delikuences së të miturve*. Prishtinë: Rilindja.
68. Latifi, V. (2011). *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit*. Prishtinë.
69. Latifi, V., & Beka, A. (2013). *Vrasjet krimi i organizuar terrorizmi, zbulimi dhe të provuarit*. Prishtinë: Juridica.
70. Lester, D. (2010). *Suicide in Mass Murderers and Serial Killers*. Vjenë: Suicidology online 2010.
71. Lluka, J. (2014). *Kosova na 'Nacertanie' deri te Pavarësia (1844-2008)*. Prishtinë: Dukagjini.
72. Malcom, N. (2011). *Kosova një histori e shkurtër*. Prishtinë: Koha.
73. Maljeviq, A., Datzner, D., Muratbegovic, E., & Budimlic, M. (2006). *Overtly about Police and Corruption*. Sarajevo: Fakulteti Kriminalisticki Nauka.
74. Marks, K., & Engels, F. (1980). *Mbi çështjen irlandeze*. Tiranë.
75. Martinsen, J. (2006). *Puset e vdekjes në Kosovë*. Prishtinë: Grafoprint.
76. Mendelson, S. E. (2006). *Barracks and Brothels: Peacekeepers and Human Trafficking in the Balkans*. Washington DC: CSIS Press.
77. Mertus, J. A. (1999). *Kosovo how myths and truths started a war*. London: Univesity of California press Ltd.
78. Mihaceviq, A. L. (2006). *Nëpër Shqipëri 1883-1907*. Tiranë: Gjergj Fishta.
79. Millutinoviq, M. (1981). *Kriminologjia*. Prishtinë.

80. Mladenovic, B. (2006). *Porodica u Srbiji u Prvom Svetskom Ratu*. Beograd: Instituti Istorije .
81. Moroli, E., & Sibona, R. (2000). *Skllavët e Perëndimit: Pas gjurmeve të Tregtarëve të Mishit të Bardhë*. Tiranë: Korbi.
82. Muci, S. (2012). *E drejta Penale*. Tiranë: Gutenberg.
83. Nikolic-Ristanovic, V., Caplic, S., Milivojeviq, S., Patric-Simeunovic, B., & Mihiq, B. (2003). *Trgovna Ljudima u Srbiji*. Beograd: Viktimolosko Drustvo Srbije.
84. Nopca, F. (2013). *Fiset e Malësisë së Shqipërisë Veriore dhe e drejta Zakonore e tyre*. Tiranë.
85. Pettijohn, T. F. (1996). *Psikologjia*. Tiranë: Lilo.
86. Popovic-Obradovic, O. (2008). *Kakva ili kolika Drzava*. Beograd: Zagorac.
87. Pupovci, S. (1971). *Marrëdhënjet Juridike Civile në Kanunin e Lekë Dukagjinit*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe mjeteve të KSAK-ut.
88. Ramosaj, F. (2008). *Krimet serbe në Kosovë - Pa Apollogji (vëllimi i dytë)*. Prishtinë: Anatema.
89. Republicki zavod Srbije. (1999). *Statisticki godisnjak Srbije* . Beograd: Republicki zavod Srbije.
90. Republicki Zavod za Statistiku. (2012). *Prirodno kretanje stanovnistva u Republici Srbije 1961-2010*. Beograd: Republicki Zavod za Statistiku.
91. Republicki Zavod za Statitiku. (2010). *Насилне смрти у Републици Србији 1997-2007* . Beograd: Republicki Zavod za Statistiku.
92. Ristovic, M. (2006). *Trgovina bebama u Srbija, Rodjeni da nestanu*. Nis: Pelikant Print.
93. Rummel, R. (1994). *Death by government*. New Brunswick: New Jersey Transaction Publishers.
94. Sahiti, E. (1993). *Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurën penale*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik.
95. Sahiti, E. (1999). *Argumentimi në procedurën penale*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
96. Sahiti, E., & Murati, R. (2013). *E drejta e procedurës penale*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

97. Salihu, I. (1981). *Vepra penale e kufizimit të lirisë*. Prishtinë.
98. Salihu, I. (1985). *Vrasjet në Krahinen Socialiste Autonome të Kosovës*. Prishtinë: Rilindja.
99. Salihu, I. (2012). *E drejta Penale, pjesa e përgjithshme*. Prishtinë.
100. Shabani, A., Bojaniq, N., & Obradoviq, V. (2007). *Trafikimi i Qenjëve Njerëzore*. Sarajeve: FKN.
101. Shatri, M., & Shatri, X. (2011). *Një gurë për varrin e ushtarit që e vranë*. Prishtinë: Koha.
102. Stojanovic, D. (2010). *Ulje na vodi, Ogledi iz istorije sadasnjosti Srbije*. Beograd: Cigoja.
103. Tomaniq, M. (2006). *Kisha Serbe në luftë dhe lufrat brenda saj*. Shkodër: Camaj-Pipa.
104. Tucovic, D. (1946). *Srbija i Arbanija*. Zagreb: Kultura Beograd.
105. The Kvinna till Kvinna Foundation. (2001) *Getting it Right?*, Stockholm.
106. Williams, X. F. (2003). *Shqiptarët*. Tiranë: Argeta LMG.
107. Zurl, M. (1978). *Krvna Osveta na Kosovu*. Zagreb: August Cesarec.

RAPORTE

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2013). *Rezultatet e anketës së fuqisë puntore 2012 në Kosovë*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2017). *Raportet përmbledhëse dhe detajet e shitjes së pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore që ka pasur UZURPATORE në kohën e përfundimit të shitjes*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
3. Amnesty International. (1994). *Police Violence in Kosovo Province: The Victims*. Amnesty International.
4. Bashkimi Evropian. (2010). *Raporti i progresit për Kosovën*. Bruksel: SEC (2010)1329.
5. Carcash, C., & Conroy, R. (2001). *Alcohol and Homicide: A Routine Activities Analysis*. Australia: Australian Institute of Criminology
6. Cornegie Endowment for International Peace. (1914). *Report of the International Commission, To inquire into the Causes and Conduct of the Balkan War*. Washington DC: Endowment.

7. Demhasaj, A., Bajrami, L., & Kalaja, B. (2012). *Parashkrimi i Ndjekjeve Penale dhe Ekzekutimeve Penale*. Prishtinë: Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU!
8. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës. (2017). *Raporti vjetor i DRP-së*. Pejë: Zyra për Informim e Policisë së Kosovës, Drejtoria Rajonale në Pejë.
9. Gashi, A., & Musliu, B. (2012). *Falja në Kosovë*. Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi.
10. Hartmann, M. E. (2003). *International Judges and Prosecutors in Kosovo*. Washington: United States Institute of Peace.
11. Humans Rights Watch. (1993). *Open Wounds: Human Rights Abuses in Kosovo*. New York.
12. Hunt, K., & Dumville, R. (2006). *Recidivism Among Federal Offenders: A Comprehensive overview*. Washington: United States Sentencing Commission.
13. International Crisis Group. (2002). *Unmik's Kosovo Albatros: Tackling Division in Mitrovica*. Brussels: ICG Ballkans.
14. Kermabon, Y. D. (2009). *Eulex Report to the UN*. European Union External Action.
15. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. (2013). *Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 2013*. Prishtinë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
16. Këshilli për mbrojtjen e të drejtave të lirive të njeriut. (2002). *Krimet e luftës në territorin e Komunes së Pejës (mars-qershor 1999)*. Pejë: Qendra Rajonale në Pejë.
17. Knutsen, D. (2008). *Comprehensive interim Audit of UNMIK Mandate Impementation - Police and Justice*. Prishtinë: OIOS.
18. Legget, T. (2008). *Crime and its impacts in Balkans and affected countries*. Slovakia: United Nations Office on Drugs and Crime.
19. Makkai, R., Ratcliffe, J., Veraar, K., & Collins, L. (2004). *ACT Recidivist Offenders*. Australia: Australian Institute of Criminology.
20. Makkai, T., & Payne, J. (2003). *Key Finding from the Drug Use Careers of Offenders (DUCO) Study*. Australia: Australian Institute of Criminology.
21. OSCE. (2003). *Kosovo/Kosova as Seen, as Told*. Warsaw: Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE).

22. OSCE. (2003). *Paralelne Struktura na Kosovu*. Organization for Security and Co-operation in Europe.
23. OSCE. (2007). *Strukturat paralele në Kosovë 2006-2007*. Organization for Security and Co-operation in Europe.
24. OSCE. (2009). *Shitblerjet e Prones me Qëllim Mashtrimi në Rajonin e Pejës*. Organization for Security and Co-operation in Europe.
25. Policia e Kosovës. (2013). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës*. Prishtinë: Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore.
26. Policia e Kosovës. (2014). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës*. Prishtinë: Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore.
27. Policia e Kosovës. (2015). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës*. Prishtinë: Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore.
28. Policia e Kosovës. (2016). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës*. Prishtinë: Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore.
29. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese- BIRN. (2011). *Raporti vjetor i monitorimit të Gjykatave*. Prishtinë: BIRN.
30. Savezno Javno Tuzilastvo Jugoslavije. (1965). *Isvjestaj o radu javnih Tuzilastva za 1964 godine*. Beograd: Savezno Javno Tuzilastvo Jugoslavije.
31. Sokolova, J., Richards, A., & Rynn, S. (2006). *SALW Survey of Kosovo*. Beograd: SEESAC.
32. Taylor, Z., & Philips, C. (2005). *Ziveti sa nasledjem, Istrazivanje o SALW*. Beograd: UNDP.
33. Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje. (2013). *Aktivitetet kundër Dhunës në Familje, Raporti vjetor i progresit 2012*. Prishtinë: Ministria e Drejtësisë.

PUBLIKIME

1. Araj, S. K. (2000). Crimes of Honor and Shame: Violence against Women in Non-Western and Western Societies. *Crimes of Honor and Shame: Violence against Women in Non-Western and Western Societies*. The Red Feather Journal of Postmodern Criminology.
2. CADY, J.-C. (2012). Establishing the Rule of Law The U.N Challenge in Kosovo. *Institut francis des relations internationales*, 49.

3. Dujmovic, Z. (1997). Opseg i kretanje kriminaliteta u Hrvatskoj u razdoblju od 1992 do 1997 godine. *Kriminologija i socijalna integracija*, pp. 31-52.
4. Glet, A. (2009). The German hate crime Concept: An Account the classification and registration of bias-motivated offences and the implementation of the hate crime model into Germany's Law Enforcement system. *Internet Journal of Criminology*, 20.
5. IOM. (2002). Projekti i kthimit dhe riintegrimit. *Projekti i kthimit dhe riintegrimit*. Prishtinë, Kosovë: Zyra e IOM-it për Kosovë.
6. Jeliq, I. M. (1927). Krvna osveta i umir kod starih kulturnih naroda. *Glasnik Etnografskog Muzeja*, 72-80.
7. Jovanic, G. (2014). (Ne) Sigurnost u Zatvoru. *Specijalna Edukacija i rehabilitacija*, pp. 141-172.
8. Kabashi, H. (2016). Isolation - sanction without a trial for Kosovo's Albanians (1981-1989). *European Journal of Sustainable Development*, 44-50.
9. Kosovar Stability Initiative. (2007, Janar 6). Reconstruction National Integrity System Survey Kosovo 2007. *Reconstruction National Integrity System Survey Kosovo 2007*. Kosovo: Tiri.
10. Latifi, V. (1984). Aspekti kriminalistik i vrasjes në Krahinen Socialiste të Kosovës. *Përparimi*, pp. 350-363.
11. Mitrovic, D., Ciric, D., Miletic, E., Bogoslovic, M., Mladenovic, M., & Dordevic, M. (2015). Lapot u knjizevim delima i na filmskom platnu. *Timocki Medicinski Glasnik*, 111-112.
12. Patic-Simeunovic, B. (2003). Ubistva u Srbiji kontekstu tranzicije i rata. *Tema br.3 god 6*, pp. 33-45.
13. Salihu, I., Zhitija, H., & Hasani, F. (2014, Mars). *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*. Prishtinë, Kosovo: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).
14. The New York Times. (1912, Dhjetor 31). Servian army left a trail of blood. *The New York Times*.
15. The New York Times. (1998). Serbian mayor slain in Kosovo new sweep on rebels ordered. *The New York Times*.

16. Trajanovic, S. (1927). Neki problemi o srpskom narodu. *Glasnik Etnografskog Muzeja*, 44.
17. UNICEF. (2004, Qeshor). Trafficking in children in Kosovo. *Trafficking in children in Kosovo, A study on protection and assistance provided to children victims of trafficking*. Kosovë: UNICEF Kosovo.
18. UNMIK. (2004). Pillar I Police and Justice. *Pillar I Police and Justice*. Kosovë.
19. Vukedin, I. K. (2011). Analiza dinamike i strukture kriminaliteta u Republici Hrvatskoj u razdoblju između dviju velikih reforma kaznenih zakonodavstva (1997-2011). *Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu*, pp. 359-416.

AKTGJYKIME

1. Aktakuza sipas lëndës PP-nr 429/08 e datës 13.01.2010
2. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë P.nr.8/94
3. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr.106/2000
4. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr. 78/2000
5. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr. 46/2001
6. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr. 76/2001
7. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr. 70/2002
8. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr.201/2002
9. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr. 77/2002
10. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr. 32/2002
11. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr. 79/2002
12. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr. 31/2002
13. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr.243/2002
14. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Pnr.247/2002
15. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr.195/2002
16. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr.384/2003
17. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 55/2003
18. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 7/2003
19. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 16/2004
20. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 22/2005
21. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 04/2006
22. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 76/2006

23. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 38/2007
24. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 25/2008
25. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr.268/2008
26. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 39/2008
27. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 38/2008
28. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 78/2008
29. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 58/2009
30. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 61/2009
31. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr.145/2009
32. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 8/2010
33. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 59/2011
34. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr.473/2011
35. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr.328/2012
36. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 68/2012
37. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në PejëPnr. 30/2012

TË DHËNAT E MARRA NGA AGJENSIONI SHETETËROR I ARKIVAVE TË KOSOVËS – ARKIVI REGJIONAL PEJË, FONDI: GJYKATA E QARKUT, LLOJI I LËNDËVE: PENALE

1. Viti 1989 – Numri i kutisë: 202; 206; 212; 214; 215; 216; 217; 218; 219; 220; 221. Numri i inventarit: 109.
2. Viti 1990 – Numri i kutisë: 222; 223; 227; 228; 229. Numri i inventarit: 109.
3. Viti 1991 – Numri i kutisë: 231; 232; 233; 234; 235; 236. Numri i inventarit: 109.
4. Viti 1992 – Numri i kutisë: 238; 238A; 239; 242. Numri i inventarit: 109.
5. Viti 1993 – Numri i kutisë: 243; 244; 245; 246; 248. Numri i inventarit: 109.
6. Viti 1994 – Numri i kutisë: 249; 252; 252; 253; 250. Numri i inventarit: 109.
7. Viti 1995 – Numri i kutisë: 260; 261; 262; 263; 264. Numri i inventarit: 109.
8. Viti 1996 – Numri i kutisë: 265; 267; 268; 270. Numri i inventarit: 109.
9. Viti 1997 – Numri i kutisë: 271; 272; 273; 274; 276; 279. Numri i inventarit: 109.
10. Viti 1998 – Lloji i lëndëve: të ndryshme. Numri i kutisë: 280; 281; 282; 283; 284. Numri i inventarit: 109.

11. Viti 1962 – 1999– Arkivi Regjional Pejë. Fondi: Burgu i Qarkut. Kutia: 8.
Numri i inventarit: 1-6.
- 12.

WEBFAQE

1. Amnesty International. (1994, Shkurt 1). *Amnesty International*. Marrë nga <https://www.amnesty.org/en/documents/eur70/001/1994/en/> (parë me 27 dhjetor 2015)
2. Binder, D. (1987, Nëntor 1). *The New York Times*. Marrë nga The New York Times: <http://www.nytimes.com/1987/11/01/world/in-yugoslavia-rising-ethnic-strife-brings-fears-of-worse-civil-conflict.html?pagewanted=all> (parë me 18 dhjetor 2016)
3. Cetinjski, S. P. (1803, 08 17). *Project Rastko*. Marrë nga Electonska Biblioteka Kulture i Tradicije Crne Gore: http://www.rastko.rs/rastko-cg/povijest/sveti_petar_cetinjski-zakonik.html(parë me 6 mars 2016)
4. Commision on Human Rights. (1992, Dhjetor 15). *Anti-Torture Initiative*. Marrë nga Anti-Torture Initiative: <http://antitorture.org/wp-content/uploads/2012/07/Y3-Mixed-Report-Mandate-and-Methods-Visit-to-former-Yugoslavia-Follow-up-to-Visits-Information-reviewed.pdf> (parë me 26 dhjetor 2015)
5. Djorovic, L. (2013, Mars 3). *Zockster Something*. Marrë nga Zockster Something: <https://zokstersomething.com/2013/03/26/lakic-djorovic-vojna-bezbednost-je-ubijala-i-pripadnike-jnavj/> (parë me 11 shtator 2016)
6. Dorovic, L. (2012). *Elektronske Novine*. Marrë nga Elektronske Novine: <http://www.e-novine.com/srbija/srbija-tema/73336-Tajni-vojni-sudovi-Srbije.html> (parë me 21 shtator 2016)
7. Edwards, J. (2015, Tetor 1). *Mirror*. Marrë nga Mirror: <http://www.mirror.co.uk/news/uk-news/10-chilling-serial-killers-how-814426> (parë me 20 dhjetor 2016)
